



ISBN 978-9928-210-12-8

ISSN 2413-1334

Konferenca V Shkencore Ndërkombëtare

VËLLIMI I PARË



Policimi dhe **SIGURIA**

Krimi mjedisor, siguria mjedisore
dhe siguria kombëtare

SHKURT
2020

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2020



KONFERENCA V NDËRKOMBËTARE

Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare

PROCEEDINGS

Vëllimi I

Botimi u financua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë dhe Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Akademia e Sigurisë

Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare :
konferenca V ndërkombëtare : proceedings / AS ; red.
shkenc. Albert Hitoallaj.- Tiranë : Akademia e Sigurisë, 2020
Vol. 1, 258 f. : 165X240cm.
ISBN 978-9928-210-12-8

1.Mjedisi 2.Mbrojtja 3.Konferenca 4.Shqipëri

504(496.5)(062)

NR **18**
SHKURT
2020

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Ferdinand ELEZI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Redaktor shkencor
Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike
MP Andi OSMANI

Realizimi teknik
Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978-9928-210-12-8
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA V SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”

Komiteti shkencor/ Scientific Committee

Kryetar i Bordit/Chair

Prof. Dr. Ismet ELEZI
Kriminolog

Anëtarë/Members

Prof. Dr. Xhovani ARCUDI

Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali.

Prof. Dr. Vasilika HYSI

Kriminologe, ligjvënëse.

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Dekan i Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesor, Universiteti i Barit, Itali.

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI

Rektore e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Itali.

Prof. Dr. Ethem RUKA

Rektor, Kolegji i Lartë Universitar “Luarasi”.

Prof. Dr. Orinda MALLTEZI

*Shefe e Departamentit të Shkencave Politike,
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.*

Prof. Asc. Idriz HAXHIAJ

*Drejtor i Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive
të Rendit e Sigurisë Publike, Ministria e Brendshme.*

Prof. Asc. Ferdinand ELEZI

Prokuroria e Apelit, Durrës, Anëtar.

Dr. Elton QENDRO

Prezenca e OSBE-së Tiranë.

Dr. Bilbil MEMAJ

Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë.

Dr. Xhavit SHALA

Drejtor/Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Dr. Frank HARRIS

University of Portsmouth.

Z. Ismail SMAKIQI

Drejtor i Përgjithshëm i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

Dr. Albert HITOALIAJ

Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë, Tiranë.

AKADEMIA E SIGURISË
ISBN 978-9928-210-12-8
ISSN 2413 - 1334

KONFERENCA V SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare"

Komiteti organizator/Organizational Committee

Kryetar/Chair

Dr. Bilbil MEMAJ, Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Zëvendëskryetarë

Dr. Xhavit SHALA, Drejtori i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Dr. Elton QENDRO, Prezenca e OSBE-së, Tiranë

Anëtarë/Members

Prof. Asc. Dr. Elton NOTI

Zëvendësrektor, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

MSc. Mehdi ÇANGA

Drejtor i administratës dhe shërbimeve mbështetëse, Akademia e Sigurisë

MSc. Arjan MUÇAJ

Prokuror, Prokuroria e Përgjithshme, Tiranë

MSc. Redian DENGËRI

Drejtor, Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë

Prof. Dr. Laura TAFARO

Profesor, Universiteti i Barit, Itali

Prof. Asc. Dr. Rezana KONOMI

Dekane e Fakultetit Juridik, Universiteti "Luarasi"

Prof. Dr. Emiljano GIARDINA

Profesor, Universiteti i Romës "Tor Vergata" Itali.

MSc. Diana MILE

Drejtoreshë e politikave dhe edukimit mjedisor, Bashkia Tiranë.

Dr. Artur BEU

Oficer kontakti i Policisë së Shtetit, në Itali.

MSc. Bilbil DERVISHI

Shefi i sektorit të burimeve njerëzore, Akademia e Sigurisë

Koordinatorët / Coordination

Dr. (proc.) Gjon VORFI, Koordinator i përgjithshëm, QKSH, Akademia e Sigurisë

Dr. (proc.) Anisa HYESANI, Koordinatore, QKSH, Akademia e Sigurisë

MSc. Anisa AGASTRA, Koordinatore, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MSc. Qetësor GURRA, Koordinator, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë

MP. Andi OSMANI, Koordinator, Qendra Kërkimore Shkencore, Akademia e Sigurisë

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Punimet grafike

MP. Andi OSMANI, Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë.

Realizimi teknik: Qendra e Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

© Akademia e Sigurisë, Tiranë 2020



**AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE**

KONFERENCA V SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
KRIMI MJEDISOR, SIGURIA MJEDISORE DHE SIGURIA KOMBËTARE

Në bashkëpunim me:

Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Departamentin e Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin "Luarasi", Tiranë,

dhe me mbështetjen e:

Prezencës së OSBE-së Shqipëri
dhe, të Bashkisë së Tiranës,

Akademia e Sigurisë, organizon

konferencën V shkencore ndërkombëtare: "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare".

11 shkurt 2020, Tiranë



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Përmbajtja

FJALË PËRSHËNDETËSE

- Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë, Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ**
«Roli i Akademisë së Sigurisë, si i vetmi institucion i shkollimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë, është i dorës së parë, për luftimin e krimeve mjedisore» 14
- Zëvendësministre e Brendshme, znj. Romina KUKO**
«Fakti, që edhe në vendin tonë diskutohet kaq shpesh, në forume të tilla, me një nivel të lartë akademik, është tregues i rëndësisë dhe veçanësisë që ka mbrojtja e mjedisit» 16
- Ministër i Turizmit dhe Mjedisit, z. Blendi KLOSI**
Pjesa e “mjedisit” në «Kodin penal». 18
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ardi VELIU**
«Realizimi i këtyre konferencave kërkimore-shkencore, me pjesëmarrjen e ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë, përbën një sukses për Akademinë e Sigurisë» 22
- Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Bernd BORCHARDT**
«Synimi i kësaj konference: të arrijë t'i bëjë më të dukshme krimet mjedisore, dhe për pasojë, të nxisë reagime si nga institucionet shtetërore edhe nga shoqëria» 24
- Kryetar i Bashkisë së Tiranës, z. Erjon VELIAJ**
Tirana, përballë krimit mjedisor, për të siguruar mjedisin e duhur për çdo qytetar të saj 28

SESIONI I PARË

Siguria mjedisore në kuadrin e sigurisë kombëtare dhe globale (këndvështrim strategjik, gjeopolitik, politik dhe teorik)

- Dr. Xhavit SHALA**
Krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri, mes realitetit dhe perceptimit. 34
- MSc. Adrian NESSEL**
The Situational Prevention of Globalised Criminal Logging and Corruption 112
- Dr. Artur BEU, Dr. doc. Ariana NEPRAVISHTA**
Materialet e rrezikshme që kërcënojnë mjedisin dhe sigurinë kombëtare. 124
- Dr. Dhurata MILORI**
Siguria mjedisore dhe politikat e Bashkimit Evropian 134
- Dr. (proc.) Gjon VORFI**
Mjedisi dhe siguria, parë nga këndvështrimi i NATO-s 148

MSc. Silvana JAKAJ	
Siguria mjedisore, si pjesë përbërëse e sigurisë kombëtare	164
Dr. (proc.) Anisa HYSESANI	
Gjeopolitika dhe ekologjia: kontekstet e sigurisë mjedisore.	172
MSc. Tonin PRENDI	
Siguria mjedisore në fokus të sigurisë kombëtare	180
Dr. Albert HITOALIAJ	
Mjedisi si armë gjeopolitike	192

SESIONI I DYTË

Krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri:

kuadri ligjor dhe institucional, eksperiencia ndërkombëtare në këtë fushë

Inxh. MSc. Petrit IMERAJ	
Legjislati i mjedisit dhe llojet e veprave penale kundër mjedisit	220
MSc. Qetësor GURRA, MSc. Jonida GURRA	
Mbrojtja e mjedisit në kuadër të standardeve të Bashkimit Evropian	232
Abstraktet në anglisht / Abstracts.	250



Të nderuar lexues! Varianti i botimit që mbani në duar, është ribotim i punimeve të konferencës “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”. Në këtë ribotim, janë shtuar: fjala përshëndetëse e drejtorit/rektorit të AS-së, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj; fjala përshëndetëse e zëvendësministres së Brendshme, znj. Romina Kuko; fjala përshëndetëse e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, z. Blendi Klosi; fjala përshëndetëse e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtues madhor Ardi Veliu; punimi i dr. Artur Beu dhe dr. doc. Ariana Nepravishta. Pjesa tjetër e botimit është plotësisht e njëjtë me variantin e botimit që u shpërnda ditën e konferencës për të pranishmit (Tiranë: mars 2020).

KONFERENCA V SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
“KRIMI MJEDISOR, SIGURIA MJEDISORE DHE SIGURIA KOMBËTARE”
Shkurt 2020, Tiranë

Akademia e Sigurisë organizoi konferencën e 5-të shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare". Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të gjithë institucioneve ligjzbatuese e më gjerë, morën pjesë me punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën.

Në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës "Tor Vergata", Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, departamentin e shkencave politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin "Luarasi", Tiranë; dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe të Bashkisë së Tiranës, Akademia e Sigurisë, organizoi konferencën V shkencore ndërkombëtare: "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare". Konferencat shkencore ndërkombëtare të organizuara nga Qendra Kërkimore Shkencore e AS tashmë kanë hyrë në rrugën e traditës vjetore.

Në fokus të kësaj konference është siguria mjedisore, e cila, në dekadat e fundit, është shndërruar në një nga shtyllat më të rëndësishme të sigurisë njerëzore, të asaj kombëtare e sigurisë ndërkombëtare. Meqenëse siguria mjedisore përqendrohet te hetimi i kërcënimeve që sillen përmes mjedisit, te komuniteti ndërkombëtar i kombeve, te shoqëria dhe te njeriu, atëherë fokusi i kësaj konference ishte i gjerë, gjithëpërfshirës dhe i lidhur me këto kërcënime. Ky fokus do të shërbejë ndërtimit të një kornize të plotë që ka lidhje me sigurinë mjedisore. Kjo kornizë do të jetë në funksion të kthjellimit dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

të rritjes së informacionit e vetëdijes së institucioneve, shoqërisë, agjencive ligjzbatuese dhe Policisë së Shtetit, si institucion, që ka pjesën e vet në drejtim të sigurisë mjedisore. Krahas fokusit të gjerë të konferencës, specifika e saj, qëndron te evidentimi dhe trajtimi i sigurisë mjedisore në këndvështrimin e përgjegjësive, nevojave, strategjive dhe detyrimeve që dalin para policisë, lidhur me krimet mjedisore. Roli i policisë në zgjidhjen e problemeve mjedisore është i rëndësishëm, për shkak se këto probleme, shpeshherë kanë natyrë kriminale dhe janë me kalime ndërkuftare.

OBJEKTIVAT E KONFERENCËS

Objekti kryesor i kësaj konference, është paraqitja e analizave dhe prognozave, si nga aspekti i hetimit të krimeve mjedisore, edhe në aspektin e trajtimit të sigurisë mjedisore në tërë rrafshin e saj të gjerë, ku ndikimet dhe gërshetimet gjenden te siguria kombëtare e ajo ndërkombëtare. Konferenca ka si objekt përmirësimin e dijes akademike lidhur me sigurinë mjedisore duke kontribuar përmes punimeve shkencore. Kjo dije synohet që t'i shërbejë përmirësimit të nivelit akademik e profesional policor që ka lidhje me krimin mjedisor dhe përballjen me veprat penale që kanë natyrë të tillë apo që gërshetohen me elementin mjedisor.

QËLLIMI I KONFERENCËS

Konferenca ka si qëllim trajtimin në mënyrë shkencore të shkallës së rëndësishme të mbrojtjes juridiko-penale të mjedisit; kuptimin e veprave penale kundër mjedisit dhe trajtimin përmes e figurave të përgjithshme të tyre; llojet e veprave penale kundër mjedisit; trajtimin e kuptimit dhe veçorive të hetimit të veprave penale mjedisore, etj. Qëllimi është përmirësimi i sigurisë mjedisore në vendin tonë, përmes kontributit akademik policor e jo vetëm: duke ndarë praktikat më të mira mjedisore dhe mësimet e nxjerra; duke formuar bashkëpunimin dypalësh dhe shumëpalësh, duke identifikuar aktorët dhe përgjegjësitë, mungesat ligjore dhe rekomandimet për të ardhmen; për paraqitjen e praktikave ekzistuese dhe rekomandime të mëtejshme të kurrikulave, programeve e trajnimeve për fushën e sigurisë mjedisore te punonjësit e policisë e më gjerë.

SYNIMI I KONFERENCËS

Kjo konferencë synoi të bashkojë njëzëri akademikë, shkencëtarë, profesionistë dhe ekspertë të fushave të sigurisë, të mjedisit, të marrëdhënieve ndërkombëtare etj.; prokurorë, gjyqtarë, oficerë të policisë gjyqësore si dhe ekspertë të tjerë për të ndarë eksperiencat, praktikat, punimet shkencore dhe gjetjet në të gjitha aspektet gjithëpërfshirëse të sigurisë mjedisore. Konferenca ka këto synime kryesore:

- përforcimin dhe theksimin se siguria mjedisore është një përbërës i prekshëm, i vërtetë, i qenësishëm dhe shumë i ndjeshëm i sigurisë kombëtare, i çdo shteti dhe, duke bërë qasje specifike te Shqipëria;
- zgjerimin e bashkëpunimit dhe shpëniën përpara, të dialogut të sigurisë mjedisore midis aktorëve në vend dhe në rajon;
- rritjen e vetëdijes për çështjet e sigurisë mjedisore, praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e aftësisë themelore të sigurisë mjedisore të Shqipërisë;
- trajtimin e aspekteve ligjore dhe juridike e historike krahasuese, të krimin

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

mjedisor brenda dhe jashtë vendit;

- dhënien e rekomandimeve, për politika të zgjeruara, Policisë së Shtetit e strukturave përkatëse që trajtojnë këtë problematikë, në kuadër të përmirësimit të punës së policisë dhe reduktimit të krimeve apo dhe parandalimit të dukurisë së krimit mjedisor;

- mbulimin në detaje të së gjitha aspekteve ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve mjedisore në shkallë vendore, në kushtet e Shqipërisë dhe duke shfrytëzuar praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë fushë;

- ngritjen cilësore të metodave të hetimit të krimeve mjedisore.

TIPI I KONFERENCËS

Konferenca është e llojit "konferencë shkencore ndërkombëtare". Ajo do të zhvillohet para një auditori që do të ketë kërkues nga vendi dhe bota si dhe staf akademik nga Akademia e Sigurisë; studiues dhe ekspertë vendas e të huaj, të çështjeve të sigurisë; drejtues dhe specialistë të strukturave të Policisë së Shtetit, agjencive të tjera ligjzbatuese; përfaqësues të misioneve të huaja policore që asistojnë Policinë e Shtetit; përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve e universiteteve policore, partnere, të huaja.

STRUKTURA E KONFERENCËS

Sesioni I

*Siguria mjedisore në kuadrin e sigurisë kombëtare dhe globale.
(Këndvështrimi strategjik, gjeopolitik, politik dhe teorik)*

- Ndryshimet klimatike dhe siguria.
- Politikat mjedisore kombëtare e globale.
- Gjeopolitika dhe siguria mjedisore.
- Mjedisi, siguria dhe iniciativat globale.
- Shfrytëzimi i burimeve të përbashkëta natyrore dhe siguria mjedisore.
- Masat frenuese kundër ndryshimeve klimatike dhe politikat kombëtare.
- Ndërgjegjësimi publik, informimi dhe siguria mjedisore.
- Interesi kombëtar dhe politikat globale mjedisore.
- Organizatat e ndërkombëtare mjedisore, aktorë të marrëdhënieve ndërkombëtare.
- Siguria mjedisore si pjesë përbërëse e sigurisë njerëzore.
- Raportet e sigurisë mjedisore me shoqërinë, kulturën dhe ekonominë.
- Rritja ekonomike, agrikultura dhe siguria mjedisore.

Sesioni II

Krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri: kuadri ligjor dhe institucional

- Kuptimi i përgjithshëm dhe juridik mbi krimin mjedisor dhe format e tij.
- Legjislacioni shqiptar mbi krimin mjedisor aspektet ligjore dhe teknike lidhur me menaxhimin praktik të problemeve mjedisore në shkallë vendore, në kushtet e Shqipërisë dhe duke shfrytëzuar praktikën më të mirë ndërkombëtare

në këtë fushë.

- Vështrim analitik i krimeve mjedisore të ndodhura në Shqipëri.
- Evidentimi i problematikes, faktorët që e nxisin, mundësojnë, krijojnë terren për zhvillim të dukurisë së krimit mjedisor në vendit.
- Trendi i përhapjes së krimit mjedisor sipas viteve: analiza statistikore dhe raporte.
- Perceptimi publik dhe institucional mbi sigurinë mjedisore.
- Analizë e shkaqeve dhe shtrirjes gjeografike të krimit mjedisor.

Sesioni III

Qasja e policisë së shtetit dhe agjencive ligjzbatuese ndaj krimeve mjedisore si krime të një natyre specifike, si dhe për parandalimin e këtyre veprave penale

- Rëndësia e mbrojtjes juridike penale të mjedisit.
- Llojet e veprave penale kundër mjedisit.
- Veprimet e punonjësit të policisë në rastet e konstatimit të veprave penale kundër mjedisit dhe ndërtimeve pa leje etj.
- Bashkëpunimi i Akademisë së Sigurisë me OSBE lidhur me mundësinë e rishikimit të kurrikulave ekzistuese në sistemin arsimor.
- Policimi në komunitet.

Sesioni IV

Kuptimi, veçoritë, specifikat dhe metodat e hetimit të veprave penale kundër mjedisit

- Ngritja cilësore e metodave të hetimit të krimeve mjedisore.
- Studim/përvojë mbi praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë fushë.
- Trajnim i specializuar i specialistëve të hetimit të krimit mjedisor.

PJESËMARRJA NË KONFERENCË

Pjesëmarrja ishte e hapur: për staf akademik, studentë të Akademisë së Sigurisë, ekspertë e studiues nga radhët e strukturave të Policisë së Shtetit e agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, akademikë të institucioneve të tjera të arsimit të lartë publik e privat në vend, studiues e ekspertë të çështjeve të hetimit dhe të sigurisë në vend dhe vende partnere, përfaqësues nga organizma ndërkombëtare partnere të Policisë së Shtetit etj.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

«Roli i Akademisë së Sigurisë, si i vetmi institucion i shkollimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë, është i dorës së parë, për luftimin e krimeve mjedisore»



Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ
DREJTORI/REKTORI I AKADEMISË SË SIGURISË

Në jetën njerëzore ka vetëm një raport të pazëvendësueshëm, ai i vet njeriut me natyrën, me mjedisin. Ky raport është ndërtuar në mënyrë të tillë, që njeriu duhet të kuptojë se natyra është ajo që t’i jep të gjitha. Nëse silllesh mirë me të, ajo të shërben dhe të mban në një jetë të shëndetshme; nëse jo, ajo të kthehet kundër. Në këtë raport, si në çdo raport tjetër, është njeriu përcaktues. Fatkeqësisht, njerëzit nuk tregohen gjithmonë të kujdesshëm në përdorimin e natyrës duke mos përdorur si duhet ligjësitë natyrore. Pasojat e kësaj sjellje rëndojnë mbi të gjithë shoqërinë tonë, sot dhe në të ardhmen. Me vlerësimin e kësaj gjëje siç duhet, vitet e fundit, qasja e Policisë së Shtetit ndaj krimeve mjedisore ka një ndryshim cilësor, duke mos i konsideruar më krimet mjedisore si “krime të nivelit të dytë”, duke u nisur nga ndjeshmëria e shtuar e institucioneve dhe organizatave të ndryshme, si dhe e publikut, por edhe nga pasojat që kanë shkaktuar këto krime në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit.

Është fakt se krimet mjedisore janë të një natyre specifike. Për to kërkohet jo vetëm një angazhim në terren i punonjësve të policisë për parandalimin e këtyre veprave penale, por edhe marrja e njohurive të duhura profesionale e ligjore mbi kuptimin e

Fjala e drejtorit/rektorit të AS-së, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, në konferencën V shkencore ndërkombëtare: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

tyre, format e shfaqjes, si dhe metodat e hetimit të krimeve mjedisore.

Në këtë aspekt, roli i Akademisë së Sigurisë, si i vetmi institucion i shkollimit dhe trajnimit të punonjësve të policisë të së gjitha niveleve, është i dorës së parë. Për të nënvizuar rëndësinë e krimi mjedisor në shoqërinë tonë, ne vendosëm që të organizonim këtë konferencë shkencore që me punimet e saja do të japë një kontribut të rëndësishëm në problematikën që ka kuptimi dhe goditja ligjore e kësaj figure krimi.

Punimet shkencore që do të prezantohen janë të një niveli shumë të lartë shkencor, përfundimet dhe gjetjet e kësaj konference do të jenë një dokumentacion shkencor për të bërë ndryshime ligjore dhe për të ndryshuar politika të cilat do të sjellin rezultate në dobi të shoqërisë. Kjo konferencë do të sjellë përvojën e kolegëve tanë nga shumë vende të tjera të cilat do të jenë një vlerë e shtuar për t'u përballur me këtë fenomen shumë të rëndësishëm. Në Akademinë e Sigurisë, trajtimi i krimeve mjedisore zhvillohet edhe në formën e trajnimeve të vazhdueshme e të specializuara, duke zhvilluar tema të tilla, si: rëndësia e mbrojtjes juridike penale të mjedisit, kuptimi i veprave penale kundër mjedisit dhe figura e përgjithshme e tyre, llojet e veprave penale kundër mjedisit, veprimet e punonjësit të policisë në rastet e konstatimit të veprave penale kundër mjedisit dhe ndërtimeve pa leje etj., veçoritë e hetimit të veprave penale që cenojnë regjimin juridik të tokës.

Akademia e Sigurisë e vlerëson këtë konferencë edhe për kontributin e pritshëm në sigurinë mjedisore dhe atë kombëtare pasi krimet e mjedisit janë krime me ndikim të madh shoqëror. Të gjitha sesionet e kësaj konference do të japin një eksperiencë pozitive për të gjithë studiuesit, por edhe për vazhdimësinë e trajnimeve me personelin e policisë.

«Fakti, që edhe në vendin tonë diskutohet kaq shpesh, në forume të tilla, me një nivel të lartë akademik, është tregues i rëndësisë dhe veçanësisë që ka mbrojtja e mjedisit»



Znj. Romina KUKO
ZËVENDËSMINISTRE E BRENDSHME

Mbrojtja e mjedisit sot është një ndër temat më të rrahura në botë dhe së cilës i kushtohet vëmendje qoftë nga struktura shtetërore, ashtu edhe nga aktivistë të dedikuar ndaj kësaj kauze. Fakti që edhe në vendin tonë diskutohet kaq shpesh, në forume të tilla me një nivel të lartë akademik, është tregues i rëndësisë dhe veçanësisë së këtij subjekti. Po kështu, pjesëmarrja e ekspertëve të huaj, të njohur ndërkombëtarë, dëshmon njëherazi edhe interesin ndaj kësaj kauze, edhe vëmendjen tonë që të tërheqim ekspertizën më të mirë të fushës. Mjedisi lidhet pazgjidhshmërisht me shëndetin e secilit prej nesh që jetojmë në këtë vend, dhe dëmtimi i tij ka ndikim të padiskutueshëm për të ardhmen e të gjithë shoqërisë. Natyra ka ditur të gjejë ekuilibrat e duhura për të mbrojtur dhe zhvilluar jetën në tokë. Tashmë është detyrë e njeriut të tregojë kujdesin e duhur për të mbrojtur mjedisin në të cilin ai zhvillon veprimtarinë dhe ndërton jetën e vet.

Është fakt i njohur se dëmtimet në natyrë sot në botë shkaktohen në masë dërrmuese nga dora e njeriut. Në raste të caktuara këto dëme janë madje të pakthyeshme. Në këto kushte, ndërgjegjësimi i të gjithë shoqërisë dhe parandalimi i ndotjeve, janë vërtet prioritare në përpjekjet tona të përbashkëta për mbrojtjen e mjedisit. Ruajtja e mjedisit në gjendjen e tij natyrale e sidomos parandalimi i ndotjeve apo shkatërrimeve të mundshme, është

Fjala e zëvendësiministres së Brendshme, znj. Romina Kuko, në konferencën V shkencore ndërkombëtare: "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare".

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare»

në vëmendjen e të gjithë aktorëve të angazhuar në këtë fushë. Edhe për qeverinë shqiptare dhe posaçërisht për Ministrinë e Brendshme, mbrojtja e mjedisit është një ndër prioritetet e punës sonë. Aktualisht me reformën e inspektorateve shtetërore, çështjet e mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve kanë kaluar në varësi të Ministrisë së Brendshme. Inspektorati për Mbrojtjen e Territorit, tashmë është shtuar edhe me pjesën e mbrojtjes së mjedisit, përveç detyrave që ka pasur më parë për çështjet e ndërtimit. Tashmë ky inspektorat ka një detyrë të dyfishtë, edhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, por edhe mbrojtjen e mjedisit, nga ndërhyrjet dëmtoese.

Me qëllim që ne t'ia dalim në përpjekjen tonë për mbrojtjen e mjedisit, pyjeve, monumenteve natyrore, na duhet një angazhim i të gjithë qytetarëve që kanë ndjeshmërinë e duhur e në radhë të parë i organeve zyrtare, të zgjedhura apo të ngarkuara me ligj. Në këtë prizëm, ka vlerë të pallogaritshme bashkëpunimi i ngushtë mes njësisë të qeverisjes vendore, me Policinë e Shtetit, përkatësisht me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit dhe Mjedisit. Çdo dëmtim i natyrës, është një krim pavarësisht nga përmasat, por tashmë ne kemi përcaktuar edhe me ligj ato vepra penale që emërtohen si “krim mjedisor”. Fakti që në ligj është parashikuar një vepër e tillë penale, është tregues i qartë i vëmendjes sonë si shtet ndaj këtyre fenomeneve. Ajo që duam të theksojmë është fakti që deri më sot strukturat që kanë pasur detyrë mbrojtjen e mjedisit, gjurmimin apo identifikimin e personave të papërgjegjshëm që kryenin krime në mjedis, kanë qenë strukturalisht larg Ministrisë së Brendshme. Tashmë mbrojtja e mjedisit dhe e pyjeve është pjesë organike e Inspektoratit përkatës nën varësinë e Ministrisë dhe rrjedhimisht edhe me Policinë e Shtetit. Të kemi parasysh se kjo është një përpjekje e përbashkët, një luftë që na përket të gjithëve, por në radhë të parë e strukturave qendrore apo lokale që janë ngarkuar me detyra specifike. Për të pasur sukses këto struktura, pra këtë njësi inspektimi në çdo rreth, kanë nevojë për mbështetjen dhe bashkëpunimin e çdo organi qendror apo vendor, i cili merret drejtpërdrejt apo tërthorazi me çështjet e mbrojtjes apo mbikëqyrjes së territorit. Në këtë prizëm, roli i Prefektit të Qarkut është mjaft i rëndësishëm bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm, pasi ai mund të shërbejë si një hallkë kyçe në ekzekutimin e shpejtë të masave mbrojtëse apo parandaluese në mjedis. Siguria mjedisore duhet të jetë në top-listën e prioriteteve të zyrtarëve vendorë, qoftë të zgjedhur, qoftë të emëruar, të cilët duhet të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre dhe nga ana tjetër të marrin përsipër pasojat sipas rastit, kur nuk zbatojnë kompetencat e ngarkuara nga ligji. Në këtë vështrim, merr vlerë si akt, vendosja para përgjegjësisë e të gjithë aktorëve që nuk ushtrojnë kompetencat e tyre.

Rritja e masës së ndëshkimit mund të jetë një masë tjetër që i shërben kësaj kauze prandaj e shohim si të mundshme dhe me interes forcimin dhe përshkallëzimi i masave ndëshkuese për të gjithë autorët që kryejnë vepra penale të parashikuara si krime mjedisore. Megjithatë qëllimi ynë është që të ndërgjegjësojmë të gjithë shoqërinë me çështjet e mbrojtjes së mjedisit, pasi vetëm një shoqëri që ka këtë ndjeshmëri qytetare, mund të përballojë më mirë këtë betejë tashmë e shtrirë në shkallë globale. Nuk mund të lëmë jashtë vëmendjes sonë edhe bashkëpunimin me partnerët ndërkombëtarë e sidomos me vendet fqinje, pasi ne ndajmë jo vetëm një hapësirë të caktuar në këtë rajon, por edhe ekosisteme të ndryshme, hapësira ujore, liqene, lumenj, etj.. Ne kemi nevojë të marrim nga përvojat më të mira të fqinjëve tanë e të mundim të ofrojmë gjithashtu gjithë bashkëpunimin tonë në çështjet e mbrojtjes së mjedisit, qoftë kjo përmes strukturash të specializuara, ashtu edhe përmes agjencive ligjzbatuese. Tashmë siguria mjedisore është pjesë e sigurisë së përgjithshme të jetës dhe zhvillimit të një vendi dhe me një ndikim afatgjatë, prandaj kërkohet ndërgjegjësim në radhë të parë, parandalim dhe masa efikase mbrojtëse.

Pjesa e “mjedisit” në «Kodin penal»



Z. Blendi KLOSI
MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT

Ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndotja në sipërfaqe apo në thellësi e tokës, dëmtimi i rëndë i kafshëve ose i bimëve, nëpërmjet shkarkimit, emetimit ose futjes së rrezatimit jonizues ose të një sasive materialesh në ajër, tokë apo ujë, tej kufirit të normave të lejuara me ligj, janë ndër çështjet kryesore të trajtuara në kodin penal. Dhe kur kjo vepër, kryhet në zona të mbrojtura posaçërisht me ligj, si zona me vlera mjedisore, kulturore, artistike, historike, arkitektonike apo arkeologjike, ose kur ka shkaktuar apo ka mundësi të shkaktojë dëmtim të rëndë të ekosistemit, biodiversitetit, të florës ose faunës, po sipas kodit penal, janë vepra për të cilat dëmi i shkaktuar konsiderohet më i madh, duke marrë në këtë mënyrë peshë më të madhe për sa i takon masës së marrë.

Konkretisht, vlera e krimeve mjedisore është duke u rritur: tregtia e paligjshme e botës së egër vlerësohet në 7-23 miliardë USD në vit. Krimi mjedisor tashmë vlerësohet të jetë 91-258 miliardë USD (2016) në vit, me një rritje prej 26% nga vlerësimi i

AKADEMIA E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

Fjala e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, z. Blendi Klosi, në konferencën V shkencore ndërkombëtare: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

fundit. Krimet mjedisore po rriten me 5-7% çdo vit, 2-3 herë sa raporti i rritjes së ekonomisë globale. Humbjet e të ardhurave për qeveritë, përmes të ardhurave nga taksat, për shkak të shfrytëzimit kriminal, llogaritet të paktën 9-26 miliardë dollarë amerikanë çdo vit. Krimet në pyje dhe prerjet e paligjshme llogariten në 51-152 miliardë dollarë amerikanë; peshkimi i paligjshëm, në 11-24 miliardë dollarë amerikanë; shfrytëzimi i minierave në mënyrë të paligjshme, 12-48 miliardë dollarë amerikanë; mbetjet në 10-12 miliardë dollarë amerikanë.

Në Shqipëri krimi mjedisor, dhe trajtimi i tij deri vonë, etiketohej si “luks”, në tutelën e krimeve të tjera. Megjithatë, të gjithë jemi dëshmitarë të dëmtimit të zonave të mbrojtura, hedhjes së paligjshme të mbetjeve urbane dhe joubane, keqmenaxhimit të mbetjeve të rrezikshme spitalore dhe industriale. Është koha që krimi mjedisor të merret seriozisht në Shqipëri, pasi përbën një krim fitimprurës nga mosreagimi institucional.

Krimet mjedisore, duket sikur nuk janë akute duke qenë se i sjellin më pas efektet e tyre, në shumicën e rasteve në një hark kohor të zgjatur, duke mos shfaqur kështu, dëmet e tyre, në momenti e kryerjes së krimit. Pavarësisht vonesës në kohë të shpalosjes së efekteve në mjedis, dëmet e shumta që shkaktohen nga dëmtimi i mjedisit nuk janë të izoluar, por ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së çdo individi.

Krimi mjedisor, ka marrë kohët e fundit vëmendjen e duhur dhe janë bërë veprime konkrete të menjëhershme për ta parandaluar apo për ta luftuar, si një domosdoshmëri jo vetëm për të ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, por si një element që lidhet ngushtë me cilësinë e jetës së njerëzve.

Miratimi i “Kodit penal”, përfshirë këtu dhe amendamentet në përputhje me “Direktivën 2008/99/EC, për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal”, e njohur ndryshe si “Direktiva për krimin mjedisor”, patën si qëllim kryesor rritjen e pajtueshmërisë së ligjeve kombëtare të shteteve anëtare me legjislacionin mjedisor të BE-së, në mënyrë që “lufta” kundër krimit mjedisor të unifikohet dhe eliminimi i pasojave të jetë më efektiv.

Ato që konsiderohen si krime mjedisore në kontekstin e kësaj direktive, janë tërësia e aktiviteteve të paligjshme individuale apo kolektive që dëmtojnë apo prishin cilësinë e mjedisit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë:

- i. shkarkimi i paligjshëm i substancave të dëmshme ose rrezatimit në ajër, tokë apo ujë;
- ii. mbledhja, transportimi, rikuperimi ose asgjësimi i mbeturinave në mënyrë të paligjshme;
- iii. transportimi i mbetjeve në mënyrë të paligjshme;
- iv. operimi i një instalimi industrial, në të cilin, substanca ruhen të rrezikshme ose përdoren në një mënyrë që shkakton ose rrezikon dëmtimin e mjedisit;
- v. Menaxhimi ose trajtimi i materialeve nukleare ose substancave të tjera radioaktive të rrezikshme në mënyrë të paligjshme;
- vi. transporti, shkatërrimi i bimëve, kafshëve ose specieve të mbrojtura të tyre;
- vii. tregtimi i paligjshëm me ekzemplarët e bimëve dhe kafshëve të mbrojtura;
- viii. shkaktimi i përkeqësimit të habitatit në tokat e mbrojtura;
- ix. prodhimi, tregtimi ose përdorimi i substancave ozonholluese.

Po në frymën e “Direktivës për krimin mjedisor”, ne i qëndrojmë mendimit se

duke përforsuar sanksionet për secilin prej krimeve mjedisore respektive si dhe duke transpozuar këto krime mjedisore si pjesë e paketës së ndëshkimeve penale vendase, do të realizojmë paralelisht rritjen e ndërgjegjësimit të çdo individi apo subjekti juridik që kryen një krim mjedisor, mbajtjen e përgjegjësive penale në aspektin personal për krimet në fjalë. Në këtë këndvështrim, masat që do të merren për secilin prej krimeve të listuara nuk janë shteruese. Problematika e derisotme në zbatimin dhe detyrimin e legjislacionit për mjedisin, ka treguar se mjedisi nuk mund të mbrohet siç duhet, vetëm përmes legjislacionit specifik /administrativ, por duhet të plotësohet edhe me veprat penale në fushën e mjedisit dhe sanksionet përkatëse të parashikuara.

Ndryshimet e realizuara tek nenet nga 201 deri në 203 duke transpozuar "Direktivën 2008/99/EC" për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal, si dhe shtimi me 5 dispozita të reja për të ashpërsuar dënimet e krimeve mjedisore si ndotja e ajrit dhe e tokës, shkaktimi i fatkeqësive mjedisore, keqmenaxhimi i mbetjeve, transportimi i mbetjeve në kundërshtim me ligjin, zhvillimi i aktiviteteve të rrezikshme, veprimtaritë në kundërshtim me ligjin në lidhje materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme, mendoj se kanë qenë hapa mjaft pozitivë në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri.

Rrethana rënduese në caktimin e dënimit parashikohen në rastet kur shkaktohet dëmtim i rëndë në shëndet apo humbje të jetëve njerëzore. Pa dyshim problematikat mbeten akoma të konsiderueshme dhe Shqipëria përditë përballet me fenomene që në tërësinë e tyre mund të konsiderohen një krim mjedisor. Probleme si ndotja e ajrit përtej normave të lejuara, ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substance të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, peshkimi i ndaluar në kohë, me mjete, vende dhe mënyra të ndaluara përbën kundërvajtje penale, prerja e paligjshme e pyjeve, shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor etj. dhe shkatërrimi i florës dhe faunës, janë jo vetëm elemente të krimit mjedisor, por edhe një kërcënim i zhvillimit tonë turistik dhe atij ekonomik.

Sot përballemi me të dyja anët e medaljes: një turizëm të zhvilluar dhe një ambicie reale për të ardhmen; dhe e dyta, kërcënim i që vjen nga ekzistenca e krimeve mjedisore, mungesës së ndërgjegjësimit për parandalimin, hetimin dhe dënimin e krimit mjedisor.

Ajo që duhet theksuar është se krimi mjedisor kërkon bashkëpunimin e gjithë aktorëve, shtetërorë dhe joshetërorë si dhe ndërveprimin mes tyre në mënyrë të sinkronizuar. Ne, si Ministri e Turizmit dhe Mjedisit, kemi marrë tashmë nismat tona, së bashku me partnerët tanë, për ta luftuar krimin mjedisor.

Në këtë kuadër, kjo konferencë që ka përfshirë jo vetëm Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, por edhe atë të Brendshmen dhe Komisionin Parlamentar të Mjedisit, dëshmon se procesi i luftës ndaj krimit mjedisor kërkon bashkëpunim, ekspertizë, ndarje informacioni, rrjetëzim mes strukturave vendore dhe atyre bashkiake dhe qëndrueshmëri në programet tona edukuese e mësimore.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka punuar dhe po punon për t'i dhënë mjedisit vlerën që ka. Prej disa kohësh specialistë të drejtuar nga OSBE-ja dhe nga delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë kanë sugjeruar madje të fusin edhe një kurrikul në Akademinë e Sigurisë për kodin mjedisor. Ka kohë që ministria po bën një reformë të gjithë institucioneve të saj të varësisë, duke i kaluar një sërë kompetencash edhe Policisë së Shtetit për çështjet e krimit mjedisor, prandaj krimi mjedisor do të jetë

tashmë një realitet në vendin tonë dhe do të ndëshkohet ashtu siç duhet.

Së pari që të jemi eficientë duhet që veprimet tona të jenë në vazhdimësi dhe në përputhje mes kërkesave ligjore të legjislacionit specifik për mjedisin të përafuara me ato të BE-së dhe me parashikimet e kodit penal. Së dyti, është domosdoshmëri rritja e kapaciteteve të strukturave tona shtetërore për mbarëvajtjen e turizmit, por dhe mbrojtjen e mjedisit. Së treti, rritja e bashkëpunimit dhe e ndërgjegjësimit qytetar dhe shoqërisë civile përmes nismave të shumta si: “Smile Albania”, “Clean and Green 2020”, “Mbjellja e pemëve”, etj.

«Realizimi i këtyre konferencave kërkimore-shkencore, me pjesëmarrjen e ekspertëve kombëtarë e ndërkombëtarë, përbën një sukses për Akademinë e Sigurisë»



Drejtuës Madhor Ardi VELIU
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË SË SHTETIT

Organizimi i konferencës së 5-të shkencore, me pjesëmarrje të gjerë kombëtare e ndërkombëtare binjakëzimi me një sërë akademish homologe, tregon se tashmë Akademia e Sigurisë është ngritur dhe vijon të ngrihet në nivelet që kërkohen vërtet për një institucion që përgatit elita dhe breza që prodhojnë siguri për jetën e qytetarëve dhe siguri kombëtare. Zhvillimi i konferencës së sotme, duke trajtuar temën e “Krimet mjedisore, sigurisë mjedisore dhe sigurisë kombëtare” merr një rëndësi të veçantë, pasi parandalimi i krimeve mjedisore është në fokusin e punës së përditshme të strukturave të Policisë së Shtetit në të gjithë vendin. Policia e Shtetit, në përbushje të prioriteteve të qeverisë për parandalimin e krimeve mjedisore, vitet e fundit ka intensifikuar veprimet, duke parandaluar ndërtimet pa leje, furrat e gëlqeres, prerjen e paligjshme të pyjeve, gërryerjen e lumenjve dhe ndotjen e tyre, djegien e pyjeve dhe kullotave, ku në të gjithë vendin janë qindra shtetas të arrestuar dhe proceduar.

Ndaj për mua është kënaqësi të përshëndes hapjen e kësaj konference, me bindjen se përfundimet e saj do të jenë domethënëse e inkurajuese në interes të punës së Policisë së Shtetit, por dhe për shumë institucioneve shtetërore që i ngarkon ligji për të marrë

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtuës madhor Ardi Veliu, në konferencën V shkencore ndërkombëtare: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

dhe zbatuar masa parandaluese në këtë drejtim, pasi parandalimi i krimeve mjedisore është në interes të gjithë shoqërisë. Shqetësimet për krimet mjedisore dhe sigurinë mjedisore në tërësi janë sot shqetësimet më të mprehta në shkallë globale. Njerëzimi ndodhet përballë kërcënimeve serioze klimatike dhe mjedisore të patrajuara gjerësisht më parë. Është kjo arsyeja që institucionet shtetërore dhe çdo qytetar të kontribuojnë në kufizimin e dëmeve që i shkaktohen mjedisit. Policisë i lind detyra të shtojë masat për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

Janë të shumta krimet mjedisore për të cilat nevojitet një qasje e re. Kjo qasje lidhet sa me përmirësimet ligjore që trajtojnë veprat penale që lidhen me cenimin e mjedisit, aq edhe me funksionet dhe strukturat e agjencive ligjzbatuese, të cilat duhet të parandalojnë e të frenojnë këto akte kriminale ndaj mjedisit. Që të arrihet sukcesi në punën e të gjitha agjencive ligjzbatuese, por edhe në sferën e ligjbërjes, nevojitet trajtimi sa më i saktë dhe sa më informues i problematikave mjedisore. Kontributi më i mirë në këtë drejtim, padyshim që vjen përmes arsimit dhe kërkimit shkencor. Organizimi i kësaj konference nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë dëshmon se sa i nevojshëm është arsimimi cilësor policor dhe kërkimi shkencor në polici.

Realizimi i këtyre konferencave kërkimore-shkencore me pjesëmarrjen e eksperteve kombëtarë e ndërkombëtarë përbën një sukses për Akademinë e Sigurisë dhe e ngre në një nivel më të lartë përgatitjen profesionale të punonjësve të Policisë së Shtetit. E theksova këtë moment, pasi trajtimi i llojeve të veprave penale dhe kuptimi i tyre në lidhje me krimin mjedisor në Shqipëri, i parë në kuadrin ligjor dhe institucional duhet të jenë, jo vetëm pjesë e objektit të punës së Policisë të Shtetit, por duhet të zënë fill që nga programet e cikleve studimore e deri te trajnimet shumë specifike policore. Nisur nga puna shumë serioze që po bëhet nga të gjitha institucionet për plotësimin e detyrimeve të anëtarësimit në BE, edhe hartimi i një legjislacioni penal mjedisor, të përafuar me legjislacionin e BE-së, është një mbështetje shumë solide për rezultatet e institucioneve ligj zbatuese.

Në këtë kontekst, Policisë së Shtetit i del si detyrë intensifikimi i punës së strukturave të saj për shtimin e numrit, por edhe rritjen e cilësisë së hetimit të veprave penale që lidhen me krimet mjedisore. Nën këtë prizëm do të doja të shihnim edhe këtë konferencë shkencore: si një shtim të përpjekjeve të Policisë së Shtetit për të dhënë kontribut në përmirësimin e strategjive të ardhshme që lidhen me parandalimin e krimit mjedisor dhe me shtimin e sigurisë mjedisore. Edhe njëherë shpreh bindjen se punimet e konferencës do të jenë një vlerë e shtuar në punën e Policisë, pasi ato do të rezultojnë me përfundime e sugjerime shumë të vlefshme!

«Synimi i kësaj konference: të arrijë t'i bëjë më të dukshme krimet mjedisore, dhe për pasojë, të nxisë reagime si nga institucionet shtetërore edhe nga shoqëria»



Ambasadori Bernd BORCHARDT
KRYETAR I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

Ditët e sotme, gjurmët e krimit mjedisor janë më të dukshme, nuk njohin kufi dhe shtyjnë më shumë se kurrë komunitetin ndërkombëtar të marrë masa ndaj pasojave të tij. Nëpërmjet studimit, *Lindja e krimit mjedisor*, studiuesit përllëgarisin se krimi mjedisor tejkombëtar i heq ekonomisë botërore rreth 91 miliardë deri në 259 miliardë dollarë amerikanë në vit, çka është e barabartë me 64% të financave të krimit të organizuar.¹ Mbetjet e rrezikshme dhe trafikimi vijojnë të jenë çështjet më problematike, për arsye të përfitimit të madh ekonomik që mbartin, si dhe të gjurmueshmërisë së ulët. Mbetjet e rrezikshme janë problem i rëndë. Në çfarëdo lloji forme qofshin, nëse rrjedhin, ato mund të shkaktojnë katastrofa të tmerrshme mjedisore. Praktikisht, ato jo vetëm që kanë ndikim në mjedis, por kanë gjithashtu mundësinë të dëmtojnë florën dhe faunën dhe madje edhe popullatën njerëzore.

Në Shqipëri, është e vështirë të përllëgaritet përmasa apo ndikimi i vërtetë i krimit mjedisor sepse mungojnë të dhënat e plota. Edhe pse këtë lloj fenomenin po e përjetojmë, vendi ende nuk zotëron mekanizma të saktë raportimi dhe ka mbetur prapa me ndjekjen

¹ Përshtendja e ambasadorit Bernd Borchardt, Kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, për konferencën e pestë shkencore ndërkombëtare, "Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare"

penale të këtij lloji krimi. Duke iu referuar *Raportit vjetor të Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2018*², vetëm 247 çështje janë referuar në Prokurori, nga të cilat vetëm 78 shkuan në gjykatë dhe 73 prej tyre janë gjykuar. Këto shifra tregojnë se pikësëpari referohet një numër shumë i ulët çështjesh dhe se shumica e tyre nuk përmbajnë prova të mjaftueshme për tu trajtuar në gjykatë. Për këtë arsye, duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet inspektoratit, policisë, prokurorisë dhe gjykatës.

Sidoqoftë, mungesa e të dhënave është vetëm njëri aspekt. Krimet mjedisore janë shumë të organizuar dhe të sofistikuara dhe kundërvënia ndaj tyre kërkon burime të shtuara njerëzore, bashkëpunim ndërmjet agjencive, zgjerim të bashkëpunimit në nivelin rajonal si dhe ndryshime në legjislacion, duke përfshirë këtu edhe kodin penal.

Krimi mjedisor është përparësi e Shqipërisë. Disa vite më parë, *Prezenca* ndihmoi Ministrinë e atëhershme të Mjedisit të krijonte një grup ndërinstytucional kundër krimit mjedisor, anëtarët e të cilit mund të shkëmbenin informacione, të kryenin veprime të përbashkëta dhe të propozonin ndryshime legjislative. Grupi numëron arritje të tilla si: zhvillimin e më shumë se 12 aktiviteteve vendore në bashki të ndryshme, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të publikut rreth kësaj çështjeje; krijimin e një plani strategjik veprimi kundër krimit mjedisor për periudhën 2018-2021; ofrimin e kontributit të specializuar për ndryshimet legjislative në lidhje me krimin mjedisor, siç është rasti i ndryshimeve në “Kodin penal”; dhe përgatitjen e një udhërrëfyesi me temë krimin mjedisor për kurrikulën e Akademisë së Policisë.

Synimi i konferencës së 5-të shkencore “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”, e cila organizohet nga *Prezenca* e OSBE-së në Shqipëri në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, është, që të arrijë t’i bëjë më të dukshme krimet mjedisore, dhe për pasojë, të nxisë reagime si nga institucionet shtetërore edhe nga shoqëria. Studimet akademike kanë dëshmuar të jenë shumë të efektshme për rritjen e ndërgjegjësimit, por edhe për ofrimin e zgjidhjeve për vështirësitë e ndryshme me të cilat përballen institucionet ligjzbatuese.

Prezenca do të vazhdojë ta përdorë në të ardhmen, këtë instrument të fuqishëm, edhe për fusha të tjera që janë pjesë e mandatit të saj.

¹ Nellemann, C. (Kryeredaktor); Henriksen, R., Kreilhuber, A., Stewart, D., Kotsova, M., Raxter, P., Mrema, E., dhe Barrat, S. (Eds). 2016. The rise of environmental crime – A Growing Threat To Natural Resources, Peace, Development And Security. A UNEP/INTERPOL Rapid Response Assessment

² Prokuroria e Përgjithshme. 2019. *Raport i Prokurorit të Përgjithshëm për Nivelin e Kriminalitetit në vitin 2018*. Tiranë.

«The ambition of this Conference, is to succeed in rendering environmental crimes more visible, and then to provoke reactions from both the state institutions and society»



Ambassador Bernd BORCHARDT
HEAD OF OSCE PRESENCE IN ALBANIA

Today, the fingerprints of environmental crime are more visible, know no bound-
aries, and more than ever prompt the international community to take
measures against its effects. In the study *The Rise of Environmental Crimes*, researchers
claim that transnational environmental crime robs an estimated US\$91 to \$259 billion
from the world's economy per year and accounts for 64% of organized crime fi-
nances.¹ Hazardous waste and trafficking remain the most challenging issues due to their
high profit and low traceability. Hazardous waste is a serious problem, if any form of it
is leaked it can cause tremendous environmental catastrophes. In practical terms, not
only does it affect the environment, but it also has the ability to affect wildlife and the
human population.

In Albania, it is difficult to estimate the real dimension or impact of environmental
crime, because of the lack of comprehensive data. Although we experience such prob-
lems, the country still lacks accurate reporting mechanisms and lags behind in prosecut-
ing such crimes. In referring to the *General Prosecution Annual Report 2018*², there

were only 247 referred cases to the Prosecution, of which only 78 cases were tried in court and 73 were sentenced. Such figures show that a low number of cases are initially referred, and amongst them, most do not have sufficient evidence to be tried in court. Therefore, cooperation amongst the inspectorate, police, prosecution, and courts needs to be strengthened.

However, lack of data is only one aspect. Environmental crimes are very organized and sophisticated, and fighting it needs additional human resources, multi-agency co-operation, enhanced cooperation at the regional level and legislative changes, including in the penal code.

Environmental Crime is a priority for Albania. Some years ago, the Presence supported the (then) Ministry of Environment to establish an inter-institutional group against environmental crime so they could share information, conduct joint actions and propose legislative changes. The group has achieved such milestones as: conducting more than 12 local events in various municipalities to raise public awareness of the issue; finalizing a strategic action plan against environmental crime for 2018-2021; providing expert input towards legislative changes on environmental crime such as the amendment of criminal code; and preparing a road map for a training curriculum on the issue for the Police Academy.

The ambition of the 5th Scientific Conference “*Environmental Crime, Environmental Security and National Security*”, organized by the Presence in Albania in collaboration with Academy of Security, is to succeed in rendering environmental crimes more visible, and then to provoke reactions from both the state institutions and society. Academic work has shown to be very effective in raising awareness of many issues, and providing solutions to various challenges faced by law enforcement institutions.

The Presence will continue to employ this powerful instrument in the future for other topics of its mandate.

¹ Nellemann, C. (Editor in Chief); Henriksen, R., Kreilhuber, A., Stewart, D., Kotsova, M., Raxter, P., Mrema, E., and Barrat, S. (Eds). 2016. *The Rise of Environmental Crime – A Growing Threat To Natural Resources Peace, Development And Security*. A UNEP/INTERPOL Rapid Response Assessment

² General Prosecution. 2019. *Report of General Prosecutor on the Criminality level for 2018*. Tirana.

Tirana, përballë krimit mjedisor, për të siguruar mjedisin e duhur për çdo qytetar të saj



Z. Erjon VELIAJ
KRYETAR I BASHKISË SË TIRANËS



Tërmeti ku humbën jetën 51 njerëz, e vuri sigurinë mjedisore në plan të parë, për të gjithë qytetarët, edhe në zonat që nuk u prekën. Por, krimi mjedisor dhe siguria mjedisore kanë qenë në plan të parë të administratës time që nga 2015-ta, në fillim: me përmbytjet, me erozionin, etj.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

Përshëndetja e z. Erjon Veliaj, Kryetar i Bashkisë së Tiranës, në konferencën e pestë shkencore ndërkombëtare,
“Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”

Tërmeti ku humbën jetën 51 njerëz, e vuri sigurinë mjedisore në plan të parë, për të gjithë qytetarët, edhe në zonat që nuk u prekën. Por, krimi mjedisor dhe siguria mjedisore kanë qenë në plan të parë të administratës time që nga 2015-ta, në fillim: me përmbytjet, me erozionin, etj. Shqetësimi më i madh i sigurisë për Tiranën nuk është terrorizmi lokal, sepse kemi një nacionalizëm laik, të bazuar në gjuhë e jo në fe, nacionalizëm gjithëpërfshirës! Tirana është nga qytetet më të sigurta në Evropë.

Shqetësimi më i madh, është siguria e fëmijëve, për të jetuar në shtëpi të sigurta, çerdhe, kopshte dhe shkolla të pastra; të luajnë në terrene sportive, në kënde lodrash, në sheshe dhe parqe publike pa ndotje dhe pa rrezik nga makinat; të hanë shëndetshëm dhe mirë. Besoj se e kemi dëshmuar me punën tonë, se vizioni për ndërtimin e një qyteti të qëndrueshëm, miqësor ndaj fëmijëve, ndërton një qytet të sigurt. Isha në Bazel për "Forum-in e paqes". Qytet aq i bukur, sa që asnjë nuk guxon të hedhë mbeturina në tokë, apo të pështyjë. E bukura sjell gjithmonë paqe dhe ndërton ndjenjën e komunitetit.

Tirana ka pësuar transformim dhe është bërë një destinacion i bukur: nga "Qyteti i ngjyrave", tani, duke u bërë një qytet gjithëpërfshirës; 2015, simbol, Kulla e Sahatit...

Por, si arrihet ndryshimi? Planifikimi dhe angazhimi kanë qenë "sekretet" tona:

- planifikim strategjik: Tirana 2030: policentrike; pylli orbital kundër erozionit dhe për ajër më të pastër, "Plani veprimit për qytet të gjelbër", cilësia ujit, ajrit (BERZH), "Plani i veprimit për mobilitet të qëndrueshëm" (GIZ)/"Min Bike Grid";

- angazhimi i fëmijëve dhe aktivizimi i të rinjve: siguruam kushte optimale për fëmijët në çerdhe-kopshte dhe po vazhdojmë me shkollat e konviktet; fëmijë të sigurt, - prindër produktiv!

Bazuar te kjo filozofi mjedisore, kemi krijuar një "akupunkturë" urbane përmes këndeve të lojërave: sheshe të mëdha si, ai "Skënderbej" dhe "Pazari i Ri" dhe të vegjël, si "Vojo Kushi", "Medreseja", "Kafe Flora" etj., për këmbësorë, e kanë zbuluar dhe siguruar më shumë Tiranën. Mund të përmend këtu, edhe projekte konkrete, të qëndrueshme, që e bënë Tiranën më të sigurt: 50 kënde lojërash që u kthyen në zonat e evakuimit nga tërmetet; shndërrimi për përdorim këmbësorësh, i shesheve publike si "Skënderbej" dhe "Pazari i Ri", të cilët janë të siguruar me blloqe guri kundër sulmeve terroriste me automjete; krositë e biçikletave, ofrojnë më tepër siguri për çiklistët, të cilët po shtohen dita-ditës, dhe e kanë bërë Tiranën më tërheqëse; gjithashtu, nuk duhet harruar shtimi e përmirësimi i sinjalistikës.

Një tjetër projekt, si ai i "Unazës së Madhe", siguron uljen e ndotjes nga makinat duke pakësuar trafikun. Por, projekti më i mirë, është ndërtimi i qytetit ku ne duam të jetojmë! *Kryeqyteti evropian i rinisë* do të aktivizojë rininë edhe për këtë. Tirana e re nuk ndalet. Dhuron pemë! "UN Trees in City Challenge".

Tirana in the face of environmental crime to provide the right environment for each of its citizens



Mr. Erjon VELIAJ
MAYOR OF TIRANA, ALBANIA



The Earthquake that killed 51 people put Environmental Safety at the forefront of all citizens even in areas not affected. But Environmental Crime and Environmental Safety have been in the forefront of my administration since 2015, initially with floods, erosion, etc.

The Earthquake that killed 51 people put Environmental Safety at the forefront of all citizens even in areas not affected.

But Environmental Crime and Environmental Safety have been in the forefront of my administration since 2015, initially with floods, erosion, etc.

The biggest security concern for Tirana is not local terrorism because we have a secular nationalism based on language, not religion, an all-inclusive nationalism! Tirana is one of the safest cities in Europe.

The greatest concern is the safety of children to live in safe houses, nurseries, kindergartens and clean schools; to play on playgrounds, to have squares and public parks without pollution and car hazards; eat healthy and well.

I believe we have proven through our work that the vision of building a sustainable, child-friendly city, builds a safe city.

I was in Basel for the Peace Forum. A city so beautiful that no one dares to dump garbage or spit.

The beauty always brings peace and builds a sense of community.

Tirana has undergone a transformation and has become a beautiful destination - from the City of Color now becoming an inclusive city!

2015 Clock Tower Symbol. How do we achieve change?: 1) Strategic Planning: Tirana 2030 polycentric, anti-erosion and cleaner orbital forest / Green City Action Plan, Water, Air Quality (EBRD) / Sustainable Mobility Action Plan (GIZ) / Min Bike Grid 2) Child Engagement and Youth Activation.

We provided optimal conditions for children in kindergartens and continue with schools, dormitories. Safe kids, productive parents!

Urban acupuncture from toy corners, large squares like Skanderbeg Square, the New Bazaar and micro squares such as Vojo Kushi, Madrese, Coffee Flora (etc.) for pedestrians have further decorated and secured Tirana.

Sustainable concrete projects that make Tirana safer:

- 50 playgrounds that were returned to earthquake evacuation zones.
- Pedonalization of public squares like Skanderbeg and New Bazaar are provided with stone blocks against terrorist vehicle attacks.
- Bike lanes, safer for cyclists that are being added, have made Tirana more attractive. Also the signage.
- Big Ring ensures reduction of pollution from cars and traffic.
- The best project is to build the city we want to live in! The European Youth Capital will activate Youth for this as well.

The New Tirana does not stop. Donate Trees! UN Trees in City Challenge.



~ Sesiioni I ~

Siguria mjedisore në kuadrin e sigurisë kombëtare
dhe globale (këndvështrimi strategjik, gjeopolitik,
politik dhe teorik)

Krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri, mes realitetit dhe perceptimit



■ **Dr. Xhavit SHALA**
Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është skanimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me krimin mjedisor dhe sigurinë mjedisore, si dhe të faktorëve ndikues, me synim dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e këtyre krimeve e përmirësimin e sigurisë mjedisore në vendin tonë. Sot, çështjet mjedisore, shkaqet e rreziqeve mjedisore dhe pasojat e tyre nuk mund të jenë vetëm çështje e një kombi apo e kufizuar brenda kufijve shtetëror të një vendi. Ashtu si fenomenet ekstreme të natyrës (tërmetet, përmytjet), edhe katastrofat ekologjike nuk i njohin kufijtë kombëtarë.

Nga studimi i dokumenteve të shumta arkivore, të cilat do të prezantohen në këtë punim, janë dokumentuar angazhimet e shtetit shqiptar për krimin dhe sigurinë mjedisore, sipas periudhave, duke filluar nga viti 1912 e deri në ditët e sotme.

Gjatë këtij punimi janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore. Analizimin dhe vlerësimin e krimeve dhe sigurisë mjedisore është bazuar duke u mbështetur në dy shtylla kryesore. E para, mbi bazën e treguesve objektivë, pra të dhënave reale të administruara nga strukturat policore dhe të prokurorisë për periudhën 2014-2018 dhe e dyta mbi bazën e treguesve subjektivë, pra perceptimet e qytetarëve për krimin, sigurinë mjedisore dhe nivelin e kënaqësisë me punën e agjencive që menaxhojnë këtë drejtim. Të dhënat lidhur me perceptimet e qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore janë siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë të realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë gjatë muajit tetor-nëntor 2019. Në përfundim të punimit jepen rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e krimeve mjedisore me qëllim përmirësimin e sigurisë mjedisore në vendin tonë.

Fjalëkyçe:

krimi mjedisor, siguria mjedisore, parandalim, sigurizimi, rrezik, kërcënim, Policia e Shtetit, prokuroria, gjykata, politikat.

1. Kuptimi mbi krimin mjedisor dhe tipologjitë e tij

Krimin mjedisor mund ta shpjegojmë duke u nisur edhe nga semantika e fjalëve *krim* dhe *mjedisi*.

1.1. Kuptimi i përgjithshëm dhe juridik mbi krimin mjedisor

Në kuptimin e përgjithshëm, me “krim”, në gjuhën shqipe kuptojmë një veprim që kryhet në kundërshtim me ligjet në fuqi, që ka pasoja të dëmshme e të rrezikshme për shtetin, për shoqërinë a për ndonjërin nga pjesëtarët e saj dhe që dënohet në bazë të kodit penal. Ai është një veprim i keq e i dënueshëm që dëmton rëndë dikë a diçka dhe që është në kundërshtim me arsyen e shëndoshë¹. Afërsisht, të njëjtin kuptim për krimin e gjejmë edhe në disa fjalorë e enciklopedi të njohura. Sipas tyre, krimi është një akt shoqërisht i rrezikshëm që kryhet me dashje e që dënohen sipas ligjit penal². Ai është një veprim ose mosveprim që përbën një vepër penale dhe që dënohet me ligj³.

Ndërsa, me “*mjedisi*” në gjuhën shqipe kuptojmë tërësinë e kushteve natyrore, në të cilat jeton e zhvillohet njeriu a një qenie tjetër..., gjithçka që rrethon një organizëm dhe ndikon mbi të; hapësira a sendet që na rrethojnë; ambient⁴. Gjithashtu, mjedisi përfshin dhe kushtet shoqërore dhe të jetës, në të cilat rron e vepron njeriu⁵.

Edhe sipas “Enciklopedisë britanike” koncepti për mjedisin përfshin kompleksin e faktorëve fizikë, kimikë dhe biotikë që veprojnë mbi një organizëm ose një komunitet ekologjik dhe përcaktojnë përfundimisht formën dhe mbijetesën e tyre⁶. Ndërsa, sipas

¹ Kuptimi i krimit sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe.

² Marrë nga Encyclopedia Britannica në <https://www.britannica.com/topic/crime-law>.

³ Marrë nga Oxford Dictionary në <https://www.lexico.com/en/definition/crime>

⁴ Fjalori i gjuhës së sotme shqipe.

⁵ Po aty.

⁶ Marrë nga Encyclopedia Britannica në <https://www.britannica.com/science/environment>.

“Fjalorit të Oxfordit” mjedisi përfshin kushtet në të cilat një person, kafshë ose bimë jeton ose vepron⁷.

Pra, tre përkufizimet e përmendura, ai në gjuhën shqipe, në *Enciklopedinë britanike* dhe në *Fjalorin e Oxfordit*, e lidhin mjedisin me tërësinë e kushteve apo kompleksin e faktorëve që lidhen me jetën dhe zhvillimin e njeriut apo të një qenie tjetër që përcakton përfundimisht formën dhe mbijetesën e tyre. Por, mbijetesa përfshin një pikë pa kthim pas së cilës do të jetë tepër vonë për të vepruar, është kusht për sigurinë e tyre. Pra, mbijetesa është kusht për mjedisin, por dhe për sigurinë. Në këtë mënyrë mbijetesa është një gjendje që lidh dhe mjedisin me sigurinë.

Krimi mjedisor është një term kompleks për të cilin nuk ka një përkufizim të pranuar ndërkombëtarisht. Vetë veprat penale në fushën e mjedisit, të cilat janë të njohura gjerësisht si krimet mjedisore, mund të përcaktohen si akte të paligjshme që dëmtojnë drejtpërdrejt mjedisin. Shpesh, këto perceptohen si krime pa viktima, të momentit e për pasojë, renditen si joparësore në listën e përparësive të zbatimit të ligjit. Për këtë, edhe sanksionet ndaj tyre, më shumë janë administrative.

Kriminologë dhe studiues që kanë trajtuar marrëdhëniet midis krimit dhe mjedisit shpesh janë përqendruar në nocionin e dëmit të shkaktuar. Ata priren të strukturojnë konceptin e krimit në këtë fushë duke iu referuar më shumë parametrave të dëmit të parashikuar nga ligji. Për këtë, ata përdorin termin “krim mjedisor”, por e quajnë dhe si “krimi i gjelbër”⁸. Vetë legjislacioni mjedisor shpesh përmban kriteret të përgjithshme për ndjekjen penale, duke ngatërruar në praktikë çështjet e përgjegjësive administrative, civile dhe penale. Duke iu referuar legjislacionit penal në këtë fushë, shpesh përdoret dhe termi “ligj penal mjedisor”, i cili përfshin ligjin penal për mbrojtjen e mjedisit dhe kontrollin mbi aktivitetet e rrezikshme për mjedisin.

Statuti i Romës, i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, e cila është institucioni i përhershëm që ka kompetencë të ushtrojë juridiksionin e saj mbi personat në lidhje me krimet më serioze që janë shqetësim për bashkësinë ndërkombëtare, e përcakton krimin mjedisor në kategorinë e krimeve të luftës në rastin kur një sulm ushtarak do të shkaktonte dëmtime serioze të mjedisit natyror. Në nenin 8 të këtij statuti renditet si krim lufte edhe rasti kur fillimi i qëllimshëm i sulmit do të shkaktonte . . . dëmtimin në masë, afatgjatë dhe serioz të mjedisit natyror, që do të ishin haptazi në shpërpjesëtim me avantazhet ushtarake konkrete të pritura⁹.

Ndërsa sipas Komisionit Evropian krimi mjedisor përfshin ato akte që shkelin legjislacionin mjedisor dhe shkaktojnë dëm të konsiderueshëm dhe që përbëjnë rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut¹⁰. Ata listojnë si fushat më të njohura të krimit mjedisor emetimin ose shkarkimin e paligjshëm të substancave në ajër, ujë ose tokë, tregtinë e paligjshme të jetës së egër, tregtinë e paligjshme të substancave që shkatërrojnë ozonin dhe dërgesa e paligjshme ose hedhja e mbeturinave.

Në përfundim, mund të themi se krimi mjedisor është një akt i cili cenon marrëdhëniet juridike të vendosura në mbrojtje të jetës së individit dhe të mjedisit, të sanksionuara këto në legjislacionin penal mjedisor. Këto krime shkaktojnë dëme të konsiderueshme në mjedis. Kjo veprimtari siguron fitime të mëdha për autorët, ndërkohë që mundësitë

⁷ Marrë nga Oxford Dictionary në <https://www.lexico.com/en/definition/environment>

⁸ Brisman, Avi (2007) “Crime-Environment Relationships and Environmental Justice, *Seattle Journal for Social Justice*: Vol. 6: Iss. 2, Article 14.

⁹ Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr. Nr. 8984, datë 23.12.2002. Neni 8, Pika 2/iv.

¹⁰ Marrë nga webfaqja e Komisionit Evropian në <https://ec.europa.eu/environment/legal/crime/>

e zbulimit të këtij aktiviteti kriminal, janë relativisht më të vogla në raport me veprat e tjera penale.

Krimi mjedisor nuk mund të jetë i suksesshëm nëse nuk mbështetet nga zyrtarët e korruptuar. Këto krime shpesh kanë një aspekt ndërkuftar, por edhe kufikalues, çka i shton shumë vështirësitë në parandalimin dhe goditjen e tij pa një policim të udhëhequr nga inteligjenca. Kjo metodë policimi jo vetëm që ndihmon në parandalimin dhe goditjen e këtij aktiviteti kriminal, por mundëson reagim strategjik ndaj këtij krimi nga ana e agjencive të zbatimit të ligjit¹¹.

1.2. Çështjet mjedisore, një paralele me shtetformimin dhe shtetndërtimin shqiptar

Dokumentet provojnë se, që me shpalljen e Pavarësisë, shteti shqiptar, ka treguar një interes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit nga dëmtimet dhe krimi, duke miratuar akte të veçanta ligjore si dhe duke përcaktuar detyra konkrete në këtë fushë për administratën e re që po krijohet. Për këtë Qeveria e Vlorës miratoi dhe vuri në zbatim “Kanunin e dëmeve” dhe “Kanunin e përtashëm të administratës civile të Shqipërisë”.

1.2.1. “Kanuni i dëmeve”, si akt i parë jo vetëm i legjisllacionit civil, por edhe i atij mjedisor shqiptar

“Kanuni i dëmeve”, i miratuar nga Qeveria e Vlorës¹² përveçse si akt për zgjidhjen e konflikteve civile, mund të cilësohet edhe si akti i parë i legjisllacionit penal mjedisor në historinë e shtetit të ri shqiptar. Në këtë kanun përcaktoheshin sanksione për rastet kur shkaktohej dëm në elementët përbërës të mjedisit si arat, vende me ullinj, pyjet, etj. Sipas këtij kanuni “Njeri do mos ketë të drejtë të hyjë a të lëshojë bagëti në ara të mbjella, në vreshta, në kopshtëra, në vende me ullinj, në pyje e në cdo vend që ka dru të buta, a të egra, me pemë a pa pemë, të thurtura a të pathurtura”¹³. Në qoftë se dikush do të bëjë dëme vetë apo duke lëshuar bagëtinë përveç se në pronat e tij që i ka me tapi “do dënohetë pas këtij kanuni, nga ana e katundaries”¹⁴.

Sanksionet në raste të tilla ishin të rënda. Ato përfshinin pagimin e dëmit që do të përcaktojë çmuesi si dhe një gjobë nga dhjetë deri njëqind franga. Gjithashtu, sipas rastit “pasi të dënohet të paguajë dëmet dhe gjobën, do dërgonetë në gjykatë për tu gjykuar pas kanunit të dënimit”¹⁵. Sipas këtij ligji, në rastet kur dëmi nuk përbënte vepër penale gjykimi do të bëhej nga gjyqet e dëmeve të ngritura në qytete, krahina apo fshatra ku ka ndodhur dëmi. “Të këtilla gjyqe të demëvë do gjykohen në katundarië të çdo qytetit, a të krahinavë, a të katunëvë, ku të jetë bërë dëmi”¹⁶.

Kanuni parashikonte dhe një strukturë të veçantë për parandalimin e dëmeve në pronat private, por dhe shtetërore (në mjedis). Ky do të ishte rojtari apo “dragati”. Sipas kanunit “Çdo qytet dhe katunt është nëvojë të kenë nga një ruajtës (dragat) për të ruajturë arat e mbjellura e të pa mbjellura, çajret (livadhetë), ullijt, pyjetë, kopshtëratë,

¹¹ Gibbs, C., McGarrell, E. & Sullivan, B. (2015). Intelligence-led policing and transnational environmental crime: A process evaluation. *European Journal of Criminology*, 12(2), pp.242- 259. DOI: 10.1177/147737081557194 7.

¹² “Kanuni i Dëmeve”, është miratuar nga Qeveria e Vlorës me 13 Maj 1913 dhe është publikuar në Revistën “Përlindja e Shqipërisë” Nr. 11, Vjeti II, datë 5/18 Shkurt 1914, faqe 4-5; Nr.12, Vjeti II, datë 8/21 Shkurt 1914, faqe 4-5.

¹³ “Kanuni i Dëmeve”, Revista “Përlindja e Shqipërisë” Nr. 11, Vjeti II, datë 5/18 shkurt 1914, faqe 4.


¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty. Faqe 5.

¹⁶ Po aty. Neni 4.

barëratë, pernetë, dru me pemë a pa pemë, si dhe çdo farë bime, për të mos prishurë me bagëti, a nga njëzëzia...¹⁷. Këtu përcaktohej se dragati do të emërohej nga strukturat e pushtetit vendor (katundaritë) dhe duhej të konfirmohej nga qeveria. Ai duhet të ishte njëri i nderuar e “të mos jetë i dëgjuarë në no një të ligë”¹⁸. Nëse ai konstatonte dëme në ato që ruante, do të përgatiste një raport për strukturat e pushtetit vendor (katundaritë). Nëse ai nuk e gjente dëmtuesin për një javë dhe nëse nuk e vërtetonte dëmin me dëshmitarë të besuar, do ta paguante vetë dëmin. Çdo qytet apo fshat do të zgjidhte me vota, nga njerëz të nderuar, tre çmues (vlerësues) të dëmeve që do të raportonte dragati. Pas kësaj çmuesit e dëmeve përgatisnin raportin për strukturat e pushtetit vendor. Pas kësaj kryekatundari (i pari i pushtetit vendor) mbledh këshillin për të dhënë vendimin për dëmin sipas raportit të çmuesve si dhe përcakton gjobën shtesë. Për këtë ai përgatit një letërvendim të cilin e dërgon tek kryeqeveritari. Pasi e shqyrton kryeqeveritari e dërgon letërvendimin në xhandarmëri, si organin përgjegjës përmbarimor. Xhandarmëria thërret autorin e dëmit, i cili brenda tre ditëve duhet të paguajë dëmin dhe gjobën dhe “në mos pagoftë dëmete dhe gjobën që është dënuarë, do të burgoset dhe do të mbahetë në burgë jo më tepër se një vit”¹⁹. Nëse ka pasuri, do t’i shitet ajo për të paguar dëmin dhe gjobën ose, nëse i paguan vetë, do të nxirret nga burgju.

Dëmtuesi pasi të ketë paguar dëmin dhe gjobën, nëse nuk bie dakord me to, merr një kopje të letërvendimit dhe ankimon në gjykatë brenda dhjetë ditëve. Nëse gjykata i jep të drejtë ankimuesit dhe shfuqizon aktin administrativ të ekzekutuar, atij i kthehen të gjitha paratë dhe ata që e kanë akuzuar padrejtësisht dënohen me burg²⁰.



Sipas raportimeve të shtypit të kohës, duket se Qeveria e Vlorës kishte kërkuar dhe ekspertizë shkencore ndërkombëtare lidhur me ekzaminimin dhe vlerësimin në vend të gjendjes në tërësi, përfshirë këtu dhe të elementëve të mjedisit si tokës, pyjeve, ujërave etj. Lajmi për ardhjen e këtij komisioni ndërkombëtar për këtë problem është publikuar në revistën “Përlindja e Shqipërisë”, në vjeshtën e vitit 1913²¹. Revista njoftonte se kishte arritur në Vlorë një komision me njerëz të shkencës dhe ditorisë dhe se “kjo komisië ka për qëllim t’a shëtisë tanë Shqipëriën duke studiuar vendin nga gjithë pikëpamjet. Passi t’a sosin këtë studim, Zotënia e ‘tyne do t’i apin edhe Qeverriës s’onë

¹⁷ Po aty. Neni 5.

¹⁸ Po aty.


¹⁹ “Kanuni i Dëmeve”, Nr.12, Vjети II, datë 8/21 Shkurt 1914, Neni 8.

²⁰ Po aty.

²¹ Revista “Përlindja e Shqipërisë” Nr. 16, Vjети I, datë 21/4, Vjeshtë e I-rë, 1913. Faqe 4.

²² Po aty.

*një shkrim ku do të tregohet gjendj' e Shqipëriës nga pikëpamje e dheut*²².




Siç shihet nga emrat e publikuar në njoftimin e shtypit të kohës, ky komision ishte i përbërë nga shkencëtarë, inxhinierë dhe personalitete në nivel evropian për pyjet, bujqësinë, ujërat, ndërtesat, etj.

1.2.2 Mbrojtja e mjedisit ndër detyrat kryesore të administratës civile të Shqipërisë

Në vizionin e qeverisë së Vlorës, mbrojtja e elementëve të mjedisit përbënte një nga detyrat kryesore të administratës së re civile shqiptare. Kjo ishte përcaktuar në *Kanunin e Përtashëm të Administratës Civile të Shqipëniës*²³, i cili ishte një akt i rëndësishëm juridik në organizimin strukturor të qeverisjes vendore në Shqipëri²⁴. Në këtë akt renditen dhe detyrat e përgjegjësitë për administratën e re të shtetit shqiptar, duke përfshirë dhe ato që lidheshin me mbrojtjen e administrimitin e tokave, pyjeve, etj.

Kështu, ndër detyrat e drejtorit të financave në Prefekturë ishte që *“të ruhen mirë kamja e pa-tundur, arat, pyjet dhe proniët e tjera të shtetit”*²⁵. Detyra për mjedisin



AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

²³ [Ky dokument është shpallur më 22 Nëntor 1913]

²⁴ *Kanuni i Përtashëm i Administratës Civile të Shqipëniës është publikuar për herë të parë në Revista “Përlindja e Shqipëniës” Nr.26. E Premte, 15/28. Vjeshtë e Tretë, Viti 1913. f. 11.*

²⁵ *Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës, Artikulli 23 “Detyrat e Drejtorit të Financave”, pika “d”. Publikuar në “Përlindja e Shqipëniës”, Vjeti I, Nr.27, E mërkurë, 20/3, Vjeshtë e III, 1913, faqe 4.*

Kanuni përcaktonte edhe për drejtorin e bujqësisë dhe të tregtisë. Kështu, ky i fundit duhet “*Të bajë të rjedhën mirë punërat e pyjëve publikë dhe vetanake, sidomos, të shikojë mos prishen pyjet*”²⁶.

Në përfundim, në analizë të raporteve të Qeverisë së Vlorës me çështjet e mjedisit në Shqipëri, mund të nxjerrim përfundimin se, që me shpalljen e pavarësisë qeveria shqiptare ka treguar një interes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit nga dëmtimet dhe krimi, duke miratuar akte të veçanta ligjore, duke përcaktuar detyra konkrete në këtë fushë për administratën e re që po krijohet si dhe duke kërkuar dhe ekspertizë ndërkombëtare në këtë fushë.

1.2.3. Elementet e mbrojtjes së mjedisit në “Statutin organik të Shqipërisë”

Në Janar 1914 Ismail Qemali, i bindur se i vetmi mjet për t’i dhënë fund përçarjes dhe anarkisë në vend ishte formimi i një qeverie të vetme për të gjithë Shqipërinë, vendosi t’i dorëzojë pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit²⁷. Në muajin prill 1914 Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit miratoi “Statutin organik të Shqipërisë”²⁸. Në këtë statut në pjesën ku flitet për organizimin dhe përgjegjësitë e administratës lokale, përcakton si çështje që i përket Këshillit të Sanxhakut të mbledhur në seancë plenare që të marrë vendime për “*prerjen e drurëve në pyjet që i përkasin komunave*”²⁹ dhe nëpër kënetat si dhe “*ripyllëzimin e vendit*”³⁰, çështje këto që lidhen me mbrojtjen e mjedisit. Ndërsa e linte nën autoritetin e këshillit të kazasë autorizimin për “*asgjësimin e kafshëve të dëmshme në pyjet e komunave*”³¹.

Statuti përcaktonte zhvillimin e pyjeve si detyrë të seksionit të bujqësisë, i cili ishte pjesë e Departamentit të Bujqësisë, Tregtisë dhe Industrisë në Ministrinë e Brendshme³². Po këtu është përcaktuar se “*ligjet dhe urdhëresat osmane që kanë të bëjnë me pyjet do të qëndrojnë gjithashtu në fuqi deri në një urdhër të dytë*”³³ dhe ngarkonte inspektorin e përgjithshëm të pyjeve me zbatimin e tyre.

Gjithashtu, statuti organik ka përcaktuar këshillin e pleqve, i cili ngrihet në çdo fshat, me atributet e një autoriteti gjyqësor, me kompetenca për gjykimin e rasteve që rrjedhin prej dëmeve (përfshi dhe ato në mjedis) që bëhen në fshat “*të cilat shkaktojnë një jobitje prej dhjetë deri në njëqind franga*”³⁴.

Në përfundim të kësaj mund të themi se edhe në “Statutin organik të Shqipërisë”, miratuar nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, gjejmë elementë që lidhen me mbrojtje e mjedisit dhe ndëshkimin e autorëve që i shkaktojnë dëme në atë mjedis.

1.2.4. Lufta e Parë Botërore si shkallë e lartë e kërcënimit mjedisor në Shqipëri Pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, Shqipëria u kthye në një teatër operacional

²⁶ Kanun i Përtashëm i Administratës qivile të Shqipëniës, Artikulli 28 “Detyrat e Drejtorit të Bujqësisë-Tregëtisë-Publike”, pika “d”. Publikuar në “Përlindja e Shqipëniës”, Vjeti I, Nr. 27, E mërkurë, 20/3, Vjeshtë e III, 1913, faqe 4.

²⁷ Vendim mbi dorëheqjen e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe mbi kalimin e pushtetit Komisioni Ndërkombëtar të Kontrollit. Vlorë 22 Janar 1914. Publikuar nga Prof. Dr. Arben Puto në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializimit”, Vëllimi II. Shtëpia botuese “8 Nëntori”. F 567-568.

²⁸ Statutin Organik i Shqipërisë u miratua me 10 Prill 1914.

²⁹ Statutin Organik i Shqipërisë. Këshilli i Sanxhakut, paragrafi 117. Publikuar nga Prof. Dr. Arben Puto në “Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializimit”, Vëllimi II. Shtëpia botuese “8 Nëntori”. f 586-587.

³⁰ Po aty.

³¹ Po aty. Këshilli i Kazasë, paragrafi 131. F.589.

³² Po aty. Kapitulli XIV. Paragrafi 197. F.598.

³³ Po aty. Paragrafi 199. F.599.

³⁴ Po aty. Kapitulli X, Drejtësia, paragrafi 159-160. F. 593.

lufte. Nisur nga palët ndërluftuese, Shqipëria u nda në katër zona pushtimi. Zona e pushtimit austro-hungarez e cila përfshinte territoret shqiptare duke filluar nga Vjosa e lart, gjithë Veriun shqiptar. Zona franceze e pushtimit e cila përfshinte Korçën dhe territoret përreth dhe zona italiane e pushtimit që përfshinte pjesën jugperëndimore të Shqipërisë, por që më pas u shtri edhe në Gjirokastër e deri në Ersekë. Ndërsa, forcat bullgare, që kishin arritur deri në Elbasan, u tërhoqën duke mbajtur nën pushtim Pogradecin edhe Librazhdin.

Në këto kushte, kur e gjithë Shqipëria ishte e pushtuar dhe e copëtuar mes palëve ndërluftuese, nuk mund të bëhej fjalë për çështjet që lidheshin me mjedisin. Vetë kthimi i territorit shqiptar në vatër luftime tregonte për një shkallë të lartë të kërcënimit mjedisor. Çështjet e mjedisit, ashtu si dhe ato gjyqësore tashmë kishin mbetur nën autoritetin e komandave pushtuese.

1.2.5. Përpyjekjet në mbrojtje të mjedisit në periudhën 1920-1924

Në fillim të vitin 1920 u finalizuan përpjekjet e patriotëve shqiptarë për rikthimin e pavarësisë dhe filluan përpjekjet për vendosjen e autoritetit shtetëror në gjithë vendin. Një ndër vendimet më të rëndësishme të Kongresit të Lushnjës, mbajtur në janar 1920, ishte miratimi i një akti kushtetues ku sanksionohej sovraniteti i plotë i shtetit shqiptar dhe krijimi i strukturave përkatëse shtetërore si Këshilli i Lartë, një organ kolegjal prej katër vetash që përfaqësonte kryetarin e shtetit, Këshilli Kombëtar (senatit) prej 37 vetash që do të kryente rolin e parlamentit, qeverisë (ekzekutivit) dhe të gjyqësorit. Kongresi rivendosi *de facto* pavarësinë e Shqipërisë³⁵. Me krijimin e qeverisë së parë në Kongresin e Lushnjës, fillojnë përpjekje serioze për vendosjen e rendit e të sigurisë në të gjithë territorin e vendit.

Nga studimi i dokumentacionit të kësaj periudhe gjejmë dhe fillimin e një pune të mirëorganizuar për mbrojtjen e elementeve të mjedisit si tokës, ujërave, pyjeve etj. Deri në hartimin e legjislationit të ri në këtë fushë, iu dha fuqi vazhduese legjislationit të perandorisë osmane. Ndërkohë dora-dorës filloi hartimi dhe zbatimi i akteve të reja ligjore të cilat përfshin dhe çështje të mjedisit. Kështu u miratua “Ligji i administratës civile të shtetit shqiptar”. Në këtë ligj për struktura të pushtetit vendor u përcaktuan dhe përgjegjësitë e tyre në raport me elementë të mjedisit. Kështu *Krahinari* kishte për detyrë “...të ndalonte kontrabandën, të shtyjë popullin për me zhvillue bujqësinë e për mos më mprue pyjet...ndalon të gjuejtunit pa leje të posaçme, ndalon dhe me rreptësi djegijen e kollotave e të barishtave qi ndodhen afër pyjeve dhe mban ni vrojtim mbi oxhakët e gëlqeres e të tjegullave”³⁶. Detyra të tilla në fushën e ruajtjes së mjedisit ligji përcaktonte edhe për pleqësinë e katundeve³⁷. Në këtë ligj si pjesë e administratës civile ishin dhe ruajtësit të cilët kishin si detyrë “Të zanunit e kusarvet dhe kriminelëve, të rujtunit e pyjeve dhe të arave, përmbarim i urdhnave të policisë”³⁸. Sipas këtij ligji rojtarët ishin “policët e katundit” dhe zgjidheshin nga populli³⁹.

Në muajin prill 1922 u miratua “Ligja e Pyjeve dhe e Kullotave”⁴⁰, një ligj mjaft i detajuar me 174 nene gjithsej, duke filluar nga përcaktimet e deri tek dënimet.

³⁵ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, f. 146-147, Botuar Toena 2007.

³⁶ Ligji i Administratës Civile të Shtetit Shqiptar, datë 5.3. 1922. Publikuar në Gazetën “Dit’ e Re”, 24 Maj 1922, Nyji 33. F. 5-7.

³⁷ Po aty. Nyji 55.

³⁸ Po aty. Nyji 34.

³⁹ Po aty. Nyji 55.

⁴⁰ Miratuar me 5.4.1922. Filluar publikimi në Gazetën “Dit’ e Re”, datë 2 Korrik 1922, f.3 e në numrat në vazhdim.

Ligja dhe rregullore

Ligj e Testamanteve

(Vijes nga N. 15)

KRYE I II.

Përmbi kushtet e testamentit

Neni 14. Është testamenti asht një ndër ligjet ligjore (akti condicione) formohet vetëm me propozimin (ishab); por se tërheh mbas vdekjes të testatorit në qoftë se legatosi e refuzon.

Neni 15. Nuk asht nevoja se përdoret fjala „testament“ në rast të propozimit; testamenti mund të kërkohet edhe me përdorje njanës ndër ligjet „testament“ (testamentum) ose „fideicommissum“ (fideicommissum) ose „fideicommissum“ në cilat rregullohet se ç'është ligji që për testament.

Neni 16. Në qoftë se veshja e legatosit dëbhet, por i varet shprehë ose emër, testamenti përfundon vetëm në legatosin që mështet i gjallë këbën e të bënë të testamentit.

Por megjithë në qoftë se testator

trëgëtohet shtet, përbëtohet si me tharë nga e treta ose e katërta pjesë e vdekjes.

Neni 21. Për një pasuri të caktuar me (marrja liri) e të testamentit në (këllim-in-ruhe) asht i fideicommissum si me ligjet asht me vepër.

Neni 22. Propozimi me ligjet: habet formë qortit (verbalitet) propozimin.

Neni 23. Në pasuri që i testatorit është testamenti mbetet i vlefshëm për të dytën e zy i parë gjatëzohet.

Neni 27. Mirasi që njëri të i testamentit një tjetri pasurin e tij e marrja qortit një kart pasuri t'i a testamentit dhe një vebatë së treti, por se në një mënyrë që janë-shprehë shprehim (shprehjet) në këtë, zotoretit kjo prej të dy këtyre legatositve shprehim.

Ligjorët nuk trajtohen (trëgëtohet) një shkak pengues (shprehjet) mirasi të ç'është testamenti; vetëm legatosi lypset detyrohet të jetë mbashtrës shprehim.

Neni 37. Testamenti mund të mirasitet në kushte, për shprehim: një njëri që ka qëllim me detyrë me shprehjet tjetër se, në qoftë që kurrë të të vdekun në atë vënd ku do të shkojë ose një njëri që asht i shtetit tjetër se po të mirasitet vdekja nga kjo shtet, ç'është njëri i bashkë qortit prej të tretës të pasurisë t'ij; por po ka përtosi të mirasitet në të shtetit vënd me kurrë të holla një shkollë e mandej vënd ai njëri, testamenti atëherë përbëtohet e ndër esatë të përkundërta testamenti mbetet i pa fjalëshim.

KRYE I V.

Përmbairim i Testamentitvet e ndërja e tyre.

Neni 38. Sudi i testamentit asht si autoritet (vedja-shprehjet) asht të detyrë të trashigimtarëve edhe para se t'i a propozimit asht (vedja e testamentit) legatosit; por në rast të tilla rregullohet detyrë.

Ligja e Pyjeve e e kullosave

Artikulli 1.

Vendi, në të cilin gjenden e rriten me shumicë dru që kanë një trup qortit Pyll.

Artikulli 2.

Vendi, në të cilin bledhin e kullosave bagna qortit Kullosat ose Livadh. Kullosat ndahet në vetore (sajllak) e detyrore (vishllak).

Artikulli 3.

Zotërimi i Pyjeve e i Kullosave i shtrohet zotërim të tokës, prandaj ai që nuk ka zotërimin e tokës, nuk mundet me pasë zotërimin e Pyllit, të korrijës e të kullosat që asht për mirë at tokë.

Artikulli 4.

Për me pasë zotërimin e një tokës lypset të detyrë kurrë. E drejta zotërimin e të përfundim, përbëtohet vetëm për mbretëria kullorët; këtu qortit, edhe këtu asht detyrës në përfundim të dita aranzim ligjore miri pasurin ose zotërimin e një tokës, pa një detyrë e caktuar kullorët, e drejta e zotërimin të tokës ose kullorët.

Ky ligj përbëhej nga pesë pjesë. Në pjesën e parë “Të ndamit e pyjeve dhe të kullotave” flitet për klasifikimin sipas pronësisë të pyjeve dhe të kullotave në private e komune (publike) si dhe klasifikimin e tokave e të kullotave. Në pjesën e dytë trajtohet mënyra e kufizimit të caktimit të kufijve të pyjeve dhe kullotave. Në pjesën e tretë, të titulluar “*Policia e pyjeve dhe kullotave*” parashikohet në detaje mënyra e ruajtjes së pyjeve të shtetit dhe të atyre private. Sipas kësaj pyjet dhe kullotat e shtetit do të ruhen me anë të kryerorjtareve dhe të rojtarëve të emëruar nga ana e qeverisë⁴¹. Për pyjet e bashkive rojtarët do të caktohen nga ana e autoriteteve bashkiake. Edhe pyjet private janë të detyruara të ruhen nga rojtarët e caktuar nga ana e pronarëve të tyre. Sipas këtij ligji “*Rojtarët e kryerorjtaret e pyjeve, të Bashkive a privat, në rojen e pyjeve do t'i nënshtrohen plotësisht rregullave të ligjeve si ato të shtetit; vëshjen, uniformën do ta mbajnë një më ato të Shtetit; do të kenë shejë të posaçmë e kanë të drejtë me mbajt armë...*”⁴².

Ligji e ndalonte rreptësisht prerjen e drurëve. “Në çdo lloj pylli qi asht kufijzu nuk ka të drejtë me pre asnji degë as me nxjerrë asnji fletë a një grusht dhe pa leje”⁴³. Në rast zjarri në pyje kryeplaku i secilit fshat që shikonte tymin ishte i detyruar me ligj që të angazhonte fshatin për shuarjen e zjarrit, pa prituri ardhjen e kryerorjtarit⁴⁴.

Policia e pyjeve dhe e kullosave

Artikulli 26

Pyjet e kullosat e Shtetit do të ruhen me anën e kryerorjtareve e rojtarëve të emëruar prej Qeverisë.

Pyjet e Bashkive do të ruhen prej rojtarëve të zgjedhur nga ana e pleqsis të mbajtur nga Bashkija.

Pyjet e korrijet private do të ruhen me rojtarët e zotëruarve por në kjoftë se gjansija e ndonji pyllit të Bashkisë asht aq e vogël sa mos me mujtë me mbajtë një rojtar, atëherë roja e tyre do t'i shtetet pyjeve të Bashkive të tjera për qark. E për në kjoftë se nuk ndodhen pyje të bashkive për qark atë-herë do të kërkohet roja së bashkë me pyje private, e për në kjoftë se dhe këto mungojnë atëherë do të përdoren me një shpërblim rroge rojtarët e pyjeve të Shtetit.

Artikulli 27

Rojtarët e kryerorjtaret e pyjeve, të Bashkive a private në rojen e pyjeve do t'i shtrohen plotësisht rregullave të ligjeve si ato të Shtetit; vëshjen (uniformën) do t'a kenë një me ato të Shtetit; do të kenë shejë të posaçmë, e kanë të drejtë me mbajtë armë e, për çdo ngjarje pa vanesë do t'ia lajmërojnë kryerorjtare të pyjeve të Shtetit.

NDËSHKIME PËR ZJARME

Artikulli 162

Ata qi guxonjë me djegë ndonji pjesë të pyjeve të Shtetit, me qëllim qi të ç'lin arë, kullo-a as me dëbue shtazë t'egra, e këshu shkaktojnë të djegurit e lastarëve a të druive të mëdha; gjohet si mbas Art. 118 e burgosen qy-sh prej 6 muajet e deri më tri vjet.

Për në kjoftë se nuk bien në dorë guxonjë, g'oba edhe shpërblimi, nxirret prej njerzisë që ka undit si mbas paragrafit të fundit t' Art. 158.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

«Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare»

⁴¹ Gazeta “Dit’ e Re”, datë 9 Korrik 1922, f.4, Artikulli 26.
⁴² Po aty. Artikulli 27.
⁴³ Po aty. Artikulli 29.
⁴⁴ Po aty. Artikulli 43.

Pjesa e katërt e këtij ligji përcaktonte rregullat për mbarështimin e pyjeve dhe të kullotave. Këtu, përcaktoheshin rregulla strikte për prerjen e drurëve në pyje që mund të shfrytëzohen për djegie ose për qymyr si në ato të shtetit, ashtu dhe në ato private.

Në pjesën e pestë janë vendosur procedurat për caktimin e sasisë, çmimit, mënyrës së shitjes si dhe punimi dhe transportimi i drurëve që do të priten në pyje. Çdo druri që është caktuar të pritet në pyjet shtetërore do t'i vihet një numër rendor një metër mbi tokë dhe me një ngjyrë të qëndrueshme.

Në pjesën e gjashtë trajtohen rregullat e nxjerrjes së rrëshirës së pishës në pyje, përgatitjes së katranit, marrja e materialeve për shartesa, etj.

Në pjesën e fundit (të shtatë) trajtohen masat ndëshkimore për ata që presin dru e dëmtojnë pyjet. Në ligj parashikohet se ata që prisnin dru pa leje në pyje gjobiteshin me gjoba të rënda sipas një renditje që i kishte bërë vetë ligji, në varësi kjo dhe të trashësisë së drurit. Ndërkohë që për drurin e lisit gjoba dyfishohej dhe për atë të arrës trefishohej⁴⁵. Ata që do të guxonin të digjnin ndonjë pjesë të pyjeve të shtetit me qëllim për të hapur tokë të re apo kullota, etj., dënoheshin nga 6 muaj deri në tre vjet burg⁴⁶. Por edhe ata që ndezin zjarre në vende të hapëta deri në 200 metra larg pyllit gjobiten nga 20 deri 100 franga ari⁴⁷. Nga 10 deri në 20 franga parashikohet dënimi dhe për udhëtarët të cilët hidhnin cigare apo shkrepsë të pafikura në pyllin ku kalonin⁴⁸. Edhe ata fshatarë që janë njoftuar për të marrë pjesë në fikjen e zjarrit në pyll, por që kanë refuzuar, të shkojnë gjobiten deri 5 franga ari⁴⁹. Pra, ndëshkimet në rastet e dëmtimit të pyjeve si elementë të mjedisit ishin të ashpura.

DEKRET-LIGJË, 16 Mars 1925.

Për konçesjonin e shfrytëzimit të pyjeve shtetnore që gjinden gjatë dy brigjeve të lumit Drin ç' prej Vau-i Dëjës deri n'Ura te Vezirit me Pietër Taragjain

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 1 Prill 1925, Nr. 13)

1. Qeverija Shqiptare i ep z. Pjetër Daragjati, nënshtetash shqiptar, i quajtur tash e mrapa „Konçesjonari” vepruës për njësi të vetën ase n'emën të një shoqënis anonime që aj detyrohet të formojë e cilla do të majnë emnin „Shoqëni Anonime Daragjati për Industrin e Drurit” konçesjonin për shfrytëzimin e të gjitha pyjeve shtetnore qi gjinden gjatë të dy ana-

Nr. 33.
DEKRET-LIGJË, 16 Prill 1925
Për dame

(e botueme në Fletoren Zyrtare, 20 Prill 1925, Nr. 46)

Parathanie

Neni 1. Ç' do njeri ka të drejtë të përdorë si të dojë vendet qi i ka në zotim të tij mbas ligjeve vepruese.

I.

Damet dhe mënyra e dënitit

Neni 2. As njeri s'ka të drejtë pa leje të zot të hyjë vetë a të lëshojë, me qëllim, a pa kujdesisht, bagti të vegla e të mbëdhna e shepa damtuesa n'ara të mbjelluna e të pambjelluna të cilat lihen për preheje e përmirësim, (dhe për fitim nga bari që quhet cimble, në pyje e në ç' do vend që ka dru me pemë e pa pemë këto vende qofshin të thuruna e të pa thuruna si ullishte, vneshta etj. Kundra veprimit do të dënohen mbas kësaj ligje prej këshillave të bashkvet a prej këshillave pleqore të katundeve.

1.2.6. Mbrojtja e mjedisit dhe legjislacioni i tij, në periudhën 1925-1939

Në “Statutin themeltar të Republikës Shqiptare”, miratuar në vitin 1925 ishte përcaktuar që dispozitat ligjore mbi tokat (ato të periudhës osmane) do të mbeteshin në fuqi “deri sa të ndrrohen me ligjë të posaçme”⁵⁰. Ky përcaktim mbeti dhe në “Statutin themeltar të Mbretërisë Shqiptare”⁵¹.

Pas vendosjes së rregullave të forta për kontrollin e pasurisë pyjore, shtetërore dhe private, u tregua kujdes për shfrytëzimin e kontrolluar të kësaj pasurie. Për këtë filloi dhënia në shfrytëzim e pyjeve me koncesion. Kështu, me një dekretligj të veçantë, u dhanë për shfrytëzim pyjet shtetërore që gjendeshin gjatë dy brigjeve të lumit Drin në

⁴⁵Gazeta “Dit’ e Re”, datë 31 Gusht 1922, f. 4, Artikulli 151.

⁴⁶ Gazeta “Dit’ e Re”, datë 3 Shtator 1922, f.3, Artikulli 162.

⁴⁷ Po aty. Artikulli 164.

⁴⁸ Po aty. Artikulli 166.

⁴⁹ Po aty. Artikulli 171

⁵⁰ Statuti i Themeltar i Republikës Shqiptare, artikulli 130.

⁵¹ Statuti Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, miratuar nga Kuvendi i Dytë Kushtetues më datë 1 dhjetor 1928.

LIGJE, 19 Maj 1934.

Mbi disa shtime e ndryshime në Ligjin e Gurorëve
(e botuara në Fletoren Zyrtare, 4 Qershor 1934, Nr. 32).

Neni 1.

Neni i posaçëm i Ligjit Otomane mbi gurorë me datë 5 Tetor 1318 ndryshohet si vijon:

Kur gurorët punohen për nevoja private leja jepet për një vjet dhe merret taksë vetëm 5 (pesë) fr. ari.

Neni 2.

Paragrafi i dytë i nenit 13 ndryshohet në këtë mënyrë:
Kryetari i Komunës ose i ngarkuemi i tij, kur do të shkojë në vend për me bë hetime, ka të drejtë të kërkojë prej t'interesuemve vetëm mjedin e udhimit.

Neni 3.

Kur një furrë a po kumi hapet e rë do të matet prej Kryetrit të Komunës ose të ngarkuemit të tij.

Art. 4.

Në bazë të raportës s'Agronomit, Zyra e Pyjevet kryen formalitetet e lejes së premit simbas përkrahimeve të Ligjit të Pyjeve për drunjt e rregullt, tue marrë njëheri masat e rojes për drunjt qi nuk duhet prë.

Për drunjt e damkuem ose të thamë vullnetisht, personal i zyrës së pyjeve, tue pasë për' anë Plakun e Lagjes ose ndonji nëpunës të Komunës ose të Gjindarmaris, formon proceset dhe i-a releton Gjyqit, tue kërkuë dënimin e guximtarëve.

Art. 5.

Kushdo qi në pronën e tij ose të një tjetrit guxon me pre një ose ma shum dru arre pa pasë leje nga Zyra e Pyjeve, ose pa pasë krye plotisht formalitetet e përkrahimeve në këtë Dekret-Ligjë, dënohet me gjoben e caktueme për drunjt arre me paragrafin e lum-

segmentit nga Vau i Dejës deri tek Ura e Vezirit⁵².

Gjithashtu, në fillim të vitit 1925, u miratua dekret-ligji “Për dame”⁵³. Në një farë mënyrë ky dekret-ligj ishte një “përditësim” pothuajse i plotë i “*Kanunit të dëmeve*” të miratuar në vitin 1913 nga Qeveria e Vlorës. Edhe në këtë dekret-ligj duket “dora” e Petro Pogës, si ministër i drejtësisë në të dy periudhat. Në këtë dekret-ligj parashikohen dënime nga dhjetë deri në njëqind franga për dëme që mund të bëhen në ara, ullishta e pyje. Vlerësimi i dëmeve dhe dhënia e gjobave bëhej nga këshillat e bashkive e të pleqësive. Në këtë akt parashikohej se “*Nëqoftëse veprat ...sjellin edhe dënim sipas ligjës ndëshkimore, lajmërohet Prokuroria a Gjykata ose gjykatësi kompetent për të bamun ndjekjet ligjore*”⁵⁴.

Më pas edhe në periudhën e Mbretërisë, në fushën e mjedisit, krahas akteve të reja ligjore të miratuara pas vitin 1920, kanë vazhduar të veprojnë edhe disa akte të tilla të periudhës otomane. Një nga këto ishte Ligji i Gurorëve. Kështu, në vitin 1934 këtij ligji otoman i bëhen vetëm disa shtesa e ndryshime, të cilat kishin të bënin me taksën dhe rolin e komunës në dhënien e lejeve të shfrytëzimit.

Në këtë periudhë u miratua dhe një dekret-ligj i veçantë në mbrojtje të arroveve duke përcaktuar rregulla të rrepta për rastet kur mund të pritej një dru arre jo vetëm në prona publike, por dhe në ato private. Dekret-ligji “Mbi premjen e drujve të Arrave”⁵⁵ ngarkonte agronomin e pyjeve për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave në rastet e prerjeve të drunjve të arrës. Çdo shkujesje nga ana e agronomit, në kryerjen e kësaj detyre e dënonte atë në bazë të nenit 203 të kodit penal, me gjobë nga 50 deri në 1500 franga ari⁵⁶. Nëse ai bënte një akt të falsifikuar për këtë problem, dënohej më burgim të rëndë nga 5 deri 12 vjet, sipas nenit 306 të kodit penal.

“Kodi penal i Mbretërisë” parashikonte si vepër penale edhe rastin e vënies së zjarrit në pyje duke parashikuar një dënim për autorin nga 5 deri në dhjet vjet burgim⁵⁷.

Në përfundim mund të themi se për periudhën 1925–1939 shteti shqiptar ka vijuar në kompletimin e një baze ligjore për mbrojtjen e elementëve të mjedisit si tokat, pyjet, etj., duke miratuar një legjislacion të qartë dhe me masa ndëshkimore të ashpra për të parandaluar dhe ndëshkuar dëmet në mjedis.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

⁵² Dekret-Ligjë datë 16 Mars 1925 “Për koncensionin e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore ç’i gjinden gjatë dy brigjeve të lumit Dri ç’prej Vaut Dejës deri në Ura të Vezirit me Pjetër Taragjain”, botuar në Fletorën Zyrtare Nr.13, datë 1 Prill 1925.

⁵³ Dekret-Ligjë 16 Prill 1925 “Për dame”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.16, datë 29 Prill 1925.

⁵⁴ Po aty, Neni 3.

⁵⁵ Dekret-ligjin “Mbi premjen e drujve të Arrave”, botuar në Fletoren Zyrtare Nr.52, datë 15 Shtator 1925.

⁵⁶ Po aty, artikulli 6.

⁵⁷ Kodi Penal i vitit 1928. Neni 330.

1.2.7. Mjedisi “i shtetëzuar”, në periudhën 1945-1991

Në periudhën 1945-1991 elementet e mjedisit si toka, pyjet, ujërat e kullotat doradorës kaluan në pronësi shtetërore. Në kushtetutën e vitit 1976 u përcaktua përfundimisht se “...Janë pronë vetëm e shtetit: toka dhe pasuritë e nëntokës, minierat, pyjet, kullota, ujërat, burimet natyrore të energjisë...”⁵⁸. Në këtë ligj themelor të shtetit socialist gjithashtu u përcaktua se “Mbrojtja e tokës, e pasurive të natyrës, e ujërave dhe e ajrit nga prishja dhe ndotja është detyrë e shtetit, e organizatave ekonomike e shoqërore dhe e të gjithë shtetasve”⁵⁹. Pra, detyra për mbrojtjen e mjedisit të shtetëzuar ishte detyrë e shtetit dhe e shtetasve. Gjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe zbatuar ligje të ashpra në mbrojtjen e ujërave, tokës e të pasurive pyjore nga drejtoritë e pyjeve, të cilat menaxhonin edhe gjuetinë e shpendëve dhe të kafshëve. Kështu që në vitin 1964, me qëllim mbrojtjen e ujërave detare nga ndotja e anijeve e tankerave të huaj me hidrokarbure etj., u miratua dekreti “Mbi ndalimin e të ndoturit të ujërave detare të Republikës së Shqipërisë”⁶⁰.

Në vitin 1966 me qëllim mbrojtjen e disa masiveve të madha pyjore me një vendim të Këshillit të Ministrave u shpallën parqe kombëtare zonat pyjore të Lurës, Divjakës, Llogarasë, Thethit dhe Dajtit⁶¹.

Në vitin 1968, me qëllim shtimin, përmirësimin dhe mbrojtjen e pyjeve nga dëmtimi u miratua ligji “Mbi pyjet”⁶². Në të përshkruheshin rregullat për administrimin e fondit pyjor. Ligji e barazonte personelin e organeve pyjore gjatë kryerjes së detyrës së tyre me organet e Policisë Popullore⁶³.

Ndërkohë, me një urdhëresë të veçantë të qeverisë u vendosen rregulla për përmirësimin e mëtejshëm të punës në drejtim të shfrytëzimit të kullotave dhe rritjes së aftësisë së tyre prodhuese⁶⁴. Po në këtë vit, më qëllim që të sigurohej një mbrojtje më e mirë e kafshëve dhe e shpendëve të egra të dobishme, si dhe për të vënë një rregull të detyrueshëm për gjuetinë e tyre u miratua dekreti “Mbi gjuetinë”⁶⁵.

Në vitin 1971 doli dekreti “Për mbrojtjen e tokës”. Dekreti synonte rritjen e kujdesit për administrimin dhe mbrojtjen e tokës, rregullat për ndryshimin e destinacionit të tokës nga fond pyjor në tokë bujqësore etj.⁶⁶.

Po këtë vit qeveria shqiptare miratoi një rregullore “Mbi përdorimin, ruajtjen dhe transportimin e lëndëve radioaktive dhe burimeve të rrezatimeve jonizuese”, duke krijuar pranë Institutit të Fizikës Bërthamore një “Komision për kontrollin e njësive bërthamore” me përfaqësues nga ai institut, Ministria e Mbrojtjes Popullore, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë⁶⁷.

⁵⁸ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Neni 18.

⁵⁹ Kushtetuta e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, Neni 20. Miratuar me Ligjin Nr. 5506, datë 28.12.1976.

⁶⁰ Dekret Nr. 3877, datë 10.8.1964 “Mbi ndalimin e të ndoturit të ujrave detare të Republikës Popullore të Shqipërisë”. Publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 6 të Vitit 1964.

⁶¹ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 96, datë 26.11.1966 “Mbi shpalljen e parqeve kombëtare pyjore”. Publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 8 të Vitit 1966.

⁶² Ligji Nr. 4407, datë 25.6.1968 “Mbi pyjet”, publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.7, Viti 1968.

⁶³ Po aty, Neni 16.

⁶⁴ Urdhëresë e Qeverisë Nr. 2, datë 24.5.1968 “Mbi administrimin e kullotave”. Publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 2, të vitit 1968.

⁶⁵ Dekret Nr.4411, datë 16.7.1968 “Mbi gjuetinë”, publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 7 të Vitit 1968.

⁶⁶ Dekret Nr.4823, datë 2.3.1971 “Mbi mbrojtjen e tokës”. Publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 2/1971.

⁶⁷ Rregullore “Mbi përdorimin, ruajtjen dhe transportimin e lëndëve radioaktive dhe burimeve të rrezatimeve jonizuese”, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 83, datë 27.5.1971. Publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.7 të vitit 1971.

**«T'U QEPEMI KODRAVE E MALEVE,
T'I ZBUKUROJMË E T'I BËJMË ATO
PJELLORE SI EDHE FUSHAT»**

Për zhvillimin e shpejtë të bujqësisë, krahas me luftën për intensifikimin, duhet të ndiqet për një kohë të gjatë edhe rruga e hapjes së tokave të reja. Vendi ynë, ndonëse me relief të theksuar malor, ka akoma rezerva të mëdha për të zgjeruar sipërfaqet e mbjella me drithra buke e bimë të tjera bujqësore. Këto rezerva gjënden në përgjithësi

Me hapjen në shkallë të gjere të tokave të reja në këtë pesëvjeçar e në pesëvjeçarët e ardhshëm zonave kodrinore e malore u hapen perspektiva të mëdha e të ndritura zhvillimi. Parulla e partisë, e pushtetit dhe e gjithë popullit duhet të jetë: «T'u qepemi kodrave e maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si edhe fushat».

Enver Hoxha

Që në vitin 1973 ishte miratuar dekret-ligji “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja”⁶⁸. Këtij dekreti iu bënë ndryshime në vitin 1991. Këto ndryshime, përfshinin dhe detyrat për Inspektoratin e Mbrojtjes së Mjedisit nga Ndotja, si strukturë pranë Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit, që ushtronte kontroll mbi ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve e të rajoneve, ndërmarrjet, institucionet e kooperativat për çështje që lidheshin me mbrojtjen e mjedisit⁶⁹ si dhe sanksionet për shkelësit, për rastet kur nuk kishte veprë penale.

Por, në këtë periudhë, të ndodhur nën trysinë e plotësimit brenda vendit të nevojave për drithëra me qëllim sigurimin e bukës në vend, duket se një kërcënim real për mjedisin u bënë vetë politikat shtetërore për përfitimin e tokës arë në dëm të pyjeve, kullotave, sipërfaqeve kënetore, etj.

Ndërkohë në vitet në vijim, për një zhvillim të shpejtë të bujqësisë, u kthye në politikë shtetërore për një kohë të gjatë dhe “rruga e hapjes së tokave të reja”. Për këtë, Kongresi V i PPSH-së vuri si objektiv që, në pesëvjeçarin të vijim, të hapeshin 115 mijë hektarë tokë e re nën parullën e partisë “T'u qepemi kodrave dhe maleve, t'i zbukurojmë t'i bëjmë ato pjellore si fushat”⁷⁰. Kjo nismë bëri që të zhvisheshin nga gjelbërimi territore të tëra, të cilat do të menaxhoheshin tashmë nga kooperativat apo ndërmarrjet bujqësore.

Në vitin 1988 kam punuar në zonën e Dumresë, një zonë e pasur kjo me liqene të shumta, por tërësisht e zhveshur nga pyllëzimi. Banorët e zonës dëshmonin se vite më parë degët e pemëve binin në ujërat e liqeneve sepse zona ishte tërësisht e pyllëzuar dhe plot me gjallesa të egra. Më pas, nën direktivën e Partisë “T'u qepemi kodrave dhe maleve, t'i zbukurojmë e t'i bëjmë ato pjellore si fushat”, gjithçka mbaroi. Në një farë mënyre, në Dumre e në shumë zona të Shqipërisë, kishte ndodhur një krim mjedisor shtetëror.

Ndërkohë në “Kodin penal të Republikës së Shqipërisë” ishte parashikuar në këtë fushë fushë “Ndotja e ambientit”⁷¹ si kundërvajtje penale në fushën e shëndetësisë, duke

⁶⁸ Dekreti nr. 5105, datë 30.10.1973 “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja”

⁶⁹ Dekreti Nr. 7451, datë 05.01.1991 “Për disa ndryshime në Dekretin nr. 5105, datë 30.10.1973 “Për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja”.

⁷⁰ Raportit i Enver Hoxhës, mbajtur në Kongresin e V-të të PPSH në vitin 1966. Botime 2, faqe 64-66.

⁷¹ Neni 235 i Kodit Penal të RPSSH-së, “Ndotja e ambientit”: Shkelja e dispozitave lidhur me mbrojtjen e tokës, të pasurive të natyrës, të ujërave dhe të ajrit nga prishja dhe ndotja, kur janë shkaktuar pasoja të rënda, dënohet: me qortim shoqëror ose me gjobë gjer në një mijë lekë, me redukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

parashikuar dënimin deri në 2 vjet heqje lirie, nëse sillte pasoja të rënda. Dy veprat e tjera të kësaj fushe “Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre”⁷² si dhe “Peshkimi i paligjshëm”⁷³ ishin parashikuar si kundërvajtje penale në fushën e ekonomisë, duke përfshirë dënime me gjobë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

Në përfundim mund të nxjerrim përfundimin se në periudhën 1945-1991 mbrojtja e tokës, e pasurive të natyrës, e ujërave dhe e ajrit nga prishja dhe ndotja ishte detyrë e shtetit, e organizatave ekonomike e shoqërore dhe e të gjithë shtetasve, por kërcënimi i madh për mjedisin u bënë politikat shtetërore për përfitimin e tokës arë në dëm të pyjeve e kullotave. Në legjislacionin penal veprat penale në fushën e mjedisit trajtoheshin si kundërvajtje penale.

1.2.8 Degradimi mjedisor, si rrezik për sigurinë kombëtare, pas vitit 1992

E drejta e qytetarëve shqiptarë për një mjedis të sigurt është parashikuar si një e drejtë themelore pothuajse në të gjithë regjimet politike të periudhës post pavarësisë së Shqipërisë. Por, problematikat në fushën e rendit dhe të sigurisë që shoqëruan zhvillimet pas vitin 1992, krijuan kushte për shfrytëzimin pa kriter të pasurive mjedisore për përfitime abuzive pasurore, me pasoja deri në degradim mjedisor në Republikën e Shqipërisë.

1.2.8.1. Mjedi si në dokumentet kryesore strategjike të Republikës së Shqipërisë

Mbrojtja e mjedisit dhe ndikimi i faktorit mjedisor në sigurinë e vendit është parashikuar edhe në dokumentet kryesore strategjike të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në konceptin e “Strategjisë së sigurisë kombëtare” të vitit 2004 është vlerësuar për herë të parë ndikimi i faktorit mjedisor në sigurinë e vendit. Ndotja e mjedisit u përcaktua jo vetëm si një rrezik global, por dhe një rrezik me tendencë në rritje për jetën e njerëzve dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë⁷⁴. Në të, është përcaktuar se mbrojtja dhe rigjenerimi i natyrës shqiptare do të sigurojnë një mjedis ekologjik e kushte të favorshme për jetesë për qytetarët dhe shoqërinë. Interesat kombëtare kërkojnë marrjen e masave për shfrytëzimin racional të burimeve të natyrës nëpërmjet zhvillimit të një strategjie të balancuar sektoriale për mbrojtjen e mjedisit natyror në interes të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë.⁷⁵ Ndër objektivat kryesore të sigurisë në këtë strategji, u përcaktua edhe mbrojtja e mjedisit dhe e burimeve natyrore. Sipas saj, mjedi dhe burimet natyrore janë elemente të pashtershme të gjenerimit të instrumenteve të sigurisë⁷⁶. Për këtë, mbrojtja e mjedisit dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve

⁷² Neni 173 i Kodit Penal të RPSSH-së, “Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre”: Prerja e paligjshme e pyjeve ose dëmtimi i tyre, kur vepra nuk formon kundërvajtje administrative, dënohet: me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit.

⁷³ Neni 174 “Peshkimi i paligjshëm”: Peshkimi në dete, liqene, lumenj ose rezervuarë me mjete dhe mënyra të ndaluara, dënohet: me qortim shoqëror, me gjobë gjer në një mijë lekë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit. me gjobë gjer në pesëqind lejë, me riedukim nëpërmjet punës ose me heqje të lirisë gjer në një vit. Po kjo veprë, e kryer me dhunë, dënohet: me heqje të lirisë gjer në dy vjet.

⁷⁴ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar më ligjin nr. 9322, datë 25.11.2004, paragrafi 30.2. Strategjia rendit këto shkaqe të ndotjes mjedisore, si: industriale (të shkaktuara nga mbetjet e uzinave e mjeteve të transportit), teknologjike (të shkaktuara nga aksidentet teknologjike), biologjike, kimike (të shkaktuara nga shpërndarja e mbetjeve e materialeve toksike). Ato shkaktohen, gjithashtu, nga pakujdesitë e njerëzve, nga tregtimi i ushqimeve të pakontrolluara, etj.

⁷⁵ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar më ligjin nr. 9322, datë 25.11.2004, paragrafi 13.

⁷⁶ Po aty, paragrafi 16/4.

mjedisore, u përcaktua si përparësi strategjike e sigurisë së Republikës së Shqipërisë⁷⁷.

Edhe në “Strategjinë e sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë” të vitit 2014 i është kushtuar një rëndësi e veçantë mbrojtjes së mjedisit. Për herë të parë, në dokumentin më të rëndësishëm strategjik të shtetit shqiptar, flitet për degradimin mjedisor në Republikën e Shqipërisë si një dukuri shumë shqetësuese. Ky degradim shfaqet në forma të ndryshme si shtrirja kaotike e qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike dhe gërryerja e lumenjve. Këto dukuri kanë prodhuar pasojë të domethënëse në territor, peizazhin urban, në shëndetësi dhe në ekonominë e vendit⁷⁸. Në këtë dokument strategjik, degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore; shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut, janë evidentuar si rrezik i nivelit të parë për Republikën e Shqipërisë.

Për këtë mbrojtja e mjedisit për brezat e ardhshëm, parandalimi i degradimit mjedisor dhe reduktimi i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit është përcaktuar si domosdoshmëri strategjike⁷⁹.

1.2.8.2. Mbrojtja e mjedisit dhe legjislacioni i tij, në periudhën 1992-2019

Legjislacioni mjedisor për këtë periudhë përfshin një shumëllojshmëri aktesh, duke përfshirë që nga normat juridike kushtetuese, ligjet organike, legjislacioni penal e deri në aktet nënligjore. Kështu që në fillim, në dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë⁸⁰, mbrojtja e mjedisit u përcaktua si një nga detyrat kryesore të Këshillit të Ministrave⁸¹. Ndërsa në kushtetutën e parë të Republikës së Shqipërisë, të miratuar në vitin 1998, çështjet mjedisore u përfshinë në kuadrin e të drejtave kushtetuese të shtetasve shqiptarë. Në të u parashikua se “Kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij”⁸². Krijimi i “një mjedisi të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm” është përcaktuar në Kushtetutë si një objektiv social i shtetit shqiptar⁸³.

Më pas, për herë të parë, në vitin 1993 u miratua ligji “Për mbrojtjen e mjedisit”⁸⁴. Ndërmjet të tjerave, ligji synonte të përcaktonte dhe procedurat për dhënien e lejeve për personat juridikë e fizikë, kur ata do të merreshin me veprimtari ekonomike e sociale të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë ndaj mjedisit. Këtij ligji në vitin 1998 iu bënë dhe disa shtesa e ndryshime⁸⁵ të tjera të cilat konsistonin në përcaktimin e kategorive të mbetjeve të rrezikshme, pjesëmarrjen e publikut në mbrojtjen e mjedisit, disa kompetenca shtesë për Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes së Mjedisit, etj.

Më pas, në vitin 2002 u miratua një ligj tjetër për mbrojtjen e mjedisit⁸⁶. Qëllimi i

⁷⁷ Po aty, paragrafi 55.

⁷⁸ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar më ligjin nr. 103/2014, f. 15

⁷⁹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar më Ligjin Nr. 103/2014, f. 21.

⁸⁰ Dispozitat Kryesore Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991.

⁸¹ Po aty. Kreun e III “Organet e Larta të Administratës Shtetërore”, në nenin 36, paragrafi 10.

⁸² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 56. Miratuar me referendum më 22.11.1998. Miratuar me Ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 të Kuvendit Popullor. Shpallur me Dekretin nr. 2260, datë 28.11.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.

⁸³ Po aty, neni 59/d.

⁸⁴ Ligji nr. 7664, datë 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

⁸⁵ Ligji nr. 8364, datë 2.7.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7664, date 21.1.1993 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

⁸⁶ Ligji nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

këtij ligji ishte të rregullonte marrëdhëniet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, të mbrojë përbërësit e mjedisit dhe proceset mjedisore, të sigurojë kushtet materiale për zhvillimin e qëndrueshëm, duke plotësuar kuadrin e nevojshëm për zbatimin e kërkesës kushtetuese për një mjedis ekologjikisht të pastër⁸⁷. Në vitin 2011, në kuadër edhe të proceseve integruese të vendit për në BE, u miratuan dy ligje të tjera që lidhen me mjedisin. Ligji i ri i miratuar, “Për mbrojtjen e mjedisit”⁸⁸, përcaktonte parimet, kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj kishte për qëllim “mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit”⁸⁹.

Ndërsa ligji tjetër i miratuar “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” përcakton rregullat e përgjithshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve, përfshirë parandalimin ose pakësimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i tyre, përmes pakësimit të përdorimit të burimeve dhe përmirësimit të efikasitetit të këtij përdorimi⁹⁰.

Mbrojtja e mjedisit ishte përcaktuar si detyrë që në fillim edhe për legjislacionin e ri penal të Republikës së Shqipërisë⁹¹. Në Kodin Penal të RSH, të miratuar në vitin 1995, u përfshinë si vepra penale në fushën e mjedisit ndotja e ajrit, transportimi i mbeturinave toksike, ndotja e ujërave, peshkimi i ndaluar, prerja e paligjshme e pyjeve, prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë si dhe shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Më pas, në vitin 2008 u shtuan dhe dy vepra të tjera penale: shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor si dhe shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe i mjedisit pyjor⁹².

Duke filluar nga viti 2014, nga Policia e Shtetit filloi një punë më e organizuar ndaj këtyre veprave penale. Për këtë periudhë gjejmë të dhëna me të plota statistikore për veprat penale në fushën e mjedisit. Gjithashtu, me qëllim të rritjes së efikasitetit të luftës kundër krimeve mjedisore, në vitin 2019 u bënë ndryshime ligjore në kodin penal, duke i zgjeruar e shtruar disa vepra të reja penale në fushën e mjedisit si dhe duke ashpërsuar sanksionet e tyre⁹³. Këto ndryshime janë bërë dhe në kuadër të përafrimit me legjislacionin e BE-së në këtë fushë⁹⁴.

Në përfundim, mund të nxjerrim përfundimin se, pavarësisht legjislacionit të miratuar për mbrojtjen e mjedisit, problematikat në fushën e rendit dhe të sigurisë që shoqëruan zhvillimet pas vitin 1992, krijuan kushte për përfitime abuzive pasurore në dëm të shfrytëzimit pa kriter të pasurive mjedisore, duke bërë që degradimi mjedisor të kthehet në një rrezik real për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

1.3. Tipologjia e krimeve mjedisore

Për kategorizimin e krimeve mjedisore përdorin kriteret e ndryshme. Kështu ato

⁸⁷ Po aty.

⁸⁸ Ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

⁸⁹ Po aty. Neni 1.

⁹⁰ Ligji nr. 10 463, datë 22.9. 2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”

⁹¹ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë. Neni 1/b.

⁹² Shtuar me ligjin nr. 10 023, datë 27.11.2008.

⁹³ Ndryshuar me Ligjin Nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

⁹⁴ Ky ligj është përafruar pjesërisht me Direktivën 2008/99/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008 “Për mbrojtjen e mjedisit përmes legjislacionit penal”, numri CELEX 32008L0099, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr. 328, datë 6.12.2008, faqe 28-37.

mund të kategorizohen sipas llojit të mjedisit të prekur, duke i parashikuar si krime që lidhen me ndotjen e ajrit, të ujit apo të tokës, etj. Edhe në kodin tonë penal është përdorur pjesërisht ky kriter. Kështu, në nenin 201 të kodit penal është parashikuar si veprë penale “Ndotja e ajrit” ndërsa, në nenin 203, është penalizuar “Ndotja e ujërave”. Por kategorizimi i krimeve mjedisore mund të bëhet edhe sipas llojit të ndotësit të përfshirë, si për shembull të mbeturinave elektronike, vajrave, azbestit, etj. Në kodin tonë penal sipas këtij kategorizimi mund të veçojmë nenin 202 të titulluar “Transportimi i mbeturinave toksike”. Ato gjithashtu mund të klasifikohen duke u nisur edhe nga metodat e përdorura për kryerjen e tyre. Kështu, në kodin tonë penal sipas këtij kategorizimi mund të veçojmë parashikimet në nenet 204 “Peshkimi i ndaluar”, 205 “Prerja e paligjshme e pyjeve”; neni 206 “Prerja e drurëve dekorativë e frutorë”; neni 206 “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”; neni 206/1 “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr e pyjeve” apo dhe neni 207 “Shkelja e karantinës së kafshëve”. Ndërsa, nisur nga gjeografia e shtrirjes krimet mjedisore mund t’i klasifikojmë si krime mjedisore të brendshme, kur ndodhin brenda kufijve shtetëror si dhe krime mjedisore ndërkufitare, por dhe kufikalues⁹⁵.

Në “Kodin penal të Republikës së Shqipërisë” tipologjia e krimeve mjedisore në Shqipëri, deri në ndryshimet ligjore të korrikut të vitit 2019, ka përfshirë 9 vepra penale të cilat sipas neneve përkatëse janë si më poshtë: neni 201, “Ndotja e ajrit”; neni 202, “Transportimi i mbeturinave toksike”; neni 203, “Ndotja e ujërave”; neni 204, “Peshkimi i ndaluar”; neni 205, “Prerja e paligjshme e pyjeve”; neni 206, “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutore”; neni 206/a, “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”; neni 206/b, “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve”; neni 207, “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve”.

Siç e theksuam dhe më lart, në korrik të vitit 2019, në kuadër të ashpërsimit të luftën kundër krimit mjedisor dhe të përafrimit më legjislaionin e BE-së në këtë fushë u bënë disa ndryshime ligjore në veprat penale në fushën e mjedisit, duke i zgjeruar dhe shtruar disa vepra të reja penale si dhe duke ashpërsuar sanksionet⁹⁶.

Konkretisht, neni 201 ndryshoi në “Ndotja e ajrit, ujit dhe tokës”. Pas tij u shtuan si vepra të reja penale neni 201/a “Menaxhimi i mbetjeve”; neni 201/b “Transportimi i mbetjeve”; neni 201/c “Aktivitetet e rrezikshme”; neni 201/ç “Materialet bërthamore dhe substancat radioaktive të rrezikshme”. Ndërsa neni 202 ndryshoi në “Dëmtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”. Pas tij u shtua neni 202/a “Tregtimi i specieve të mbrojtura të florës dhe faunës së egër”, Neni 202/b “Dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore”. Edhe neni 203 u ndryshua në “Substancat ozonholluese”.

Gjithashtu pas nenit 207 u shtuan si vepra të reja penale neni 207/a “Braktisja e kafshës së shoqërimin”, Neni 207/b “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimin”, Neni 207/c “Keqtrajtimi i kafshës” dhe Neni 207/ç “Ndeshjet ndërmjet kafshëve”.

1.4. Profilizimi i autorëve të veprave penale mjedisore

Profili i subjekteve të krimit mjedisor është i ndryshëm. Profilizimi i subjekteve të këtyre veprave penale merr rëndësi pasi mundëson zhvillimin e strategjive të

⁹⁵ Carole Gibbs and Rachel Boratto: Environmental Crime. Printed from the Oxford Research Encyclopedia, 5Criminology and Criminal Justice (oxfordre.com/criminology). (c) Oxford University Press USA, 2019. Faqe 10.

⁹⁶ Ndryshuar me ligjin nr. 44/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

përshtatshme për parandalimin e tyre. Studiues të kësaj fushe kanë bërë një profilizim të autorëve të krimeve mjedisore duke u nisur nga këndvështrime të ndryshme. Kështu, studiuesit Yingyi Situ dhe David Emmons autorët e këtyre veprave penale i klasifikojnë në pesë kategori dhe konkretisht në autorë individë dhe në grupe, autorë të lidhur në biznese, qeveritë e korporatat shtetërore⁹⁷.

Autorët individë i kryejnë këto vepra penale kryesisht për përfitime ekonomike. Ndërsa, kur dy ose më shumë individë së bashku kryejnë një krim mjedisor, ata konsiderohen shkelës (autorë) në grup të krimeve mjedisore. Më tej këta mund ta kryejnë këtë vepër penale në një bashkëpunim të thjeshtë ose në kuadër të krimit të organizuar (organizatë apo grup të strukturuar kriminal).

Edhe krimet mjedisore të lidhura me bizneset mund të ndahen në disa nënkategori, duke përfshirë këtu ato të lidhura me individë të punësuar, biznesin e vogël apo edhe ato të kryera nga korporatat e mëdha. Në shumë raste kryerja e këtyre krimeve më tepër është interes i grup punonjësve për fitime se sa në e tërësi e organizatës punuese. Këtu, mund të përmendim rastet kur punonjës apo grup punonjës të punësuar në biznese të vogla apo të mëdha kryejnë krime mjedisore duke keqadministruar mbetjet e proceseve të punës të bizneseve, me apo pa dijeninë e pronarëve të tyre.

Ndërsa termi krim mjedisor qeveritar mund të duket pak sa i çuditshëm duke pasur parasysh se qeveritë, supozohet, se mbrojnë dhe zbatojnë ligjin mjedisor. Megjithatë ka raste kur organizatat qeveritare “nuk respektojnë, ose nuk zbatojnë ligjin, duke shkaktuar

kështu një dëm mjedisor”⁹⁸. Raste të tilla mund të përmendim për shembull kur impiantet e trajtimit të mbeturinave të administruara prej strukturave të pushtetit vendor hedhin në mënyrë të paligjshme ujërat e zeza të patrajtuara në liqene dhe lumenj, apo çlirim prej tyre i gazrave apo ndotësve të tjerë të ajrit, etj.

Edhe krimi i korporatave shtetërore ngjason me nocionin e krimeve mjedisore qeveritare, por këtu vihet theksi në lidhjen unike midis qeverive dhe sektorit të korporatave në shkaktimin e dëmit mjedisor. Krimet e korporatave shtetërore përcaktohen si veprime të paligjshme që vijnë nga një ndërveprim i fortë e i ndërsjellë midis politikave ekonomike shtetërore dhe praktikave të prodhimit të korporatave të mëdha në dëm të standardeve ndërkombëtare në mbrojtjen e mjedisit. Në këtë rast, kjo aleancë kriminale mes qeverive dhe korporatave të mëdha është e mbrojtur nga legjislacioni i brendshëm. Ky lloj krimi mund të kufizohet vetëm nga ligji ndërkombëtar nëpërmjet nënshkrimit të konventave. Por edhe kjo paraqet vështirësi në vetvete pasi duhet që qeveria në aleancë kriminale me korporatat të jetë nënshkruese e kësaj konvente.

2. Siguria mjedisore, pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare

Pasiguria në vetvete nënkupton një gjendje në të cilën vlerat që mbrohen janë të rrezikuara, nuk janë të sigurta. Ndërsa siguria, si koncept, mund të aplikohet për gjëra dhe objekte referuese të vlerësuar nga ana jonë si të domosdoshme dhe që janë jashtë

⁹⁷ Yingyi Situ dhe David Emmons. Environmental crime: The criminal justice system's role in protecting the environment, Sage Publications, Inc, International Educational and Professional Publisher, Thousand Oaks, California 91320.

⁹⁸ Carole Gibbs and Rachel Boratto: Environmental Crime. Printed from the Oxford Research Encyclopedia, Criminology and Criminal Justice (oxfordre.com/criminology). (c) Oxford University Press USA, 2019. Faqe 14.

çdo rreziku apo të papriture. Në dekadat e fundit si objekt referues i sigurisë është parë dhe mjedisi me elementët e tij si ujin, tokën, ajrin etj. Këto janë pranuar si vlera të shoqërisë që duhen mbrojtur e siguruar pasi ndikojnë në cilësinë e jetës së komuniteteve njerëzore. Në këtë rast, kur objekt referimi i sigurisë është mjedisi në tërësi apo elementët e tij përbërës kemi të bëjmë me sigurinë mjedisore. Për këtë ndryshimet mjedisore si dhe rreziqet e kërcënimeve ndaj tij vlerësohen si rreziqe e kërcënime ndaj sigurisë mjedisore. Siguria mjedisore, apo dhe ambientale siç dhe përmendet shpesh, është një koncept relativisht i ri, është një zgjerim i konceptit jo tradicional të sigurisë dhe është akoma i papërkufizuar e i pranuar ndërkombëtarisht.

Siguria ambientale u bë objekt i rëndësishëm i studimeve të sigurisë për shkak zhvillimeve në çështjet mjedisore që në vitet 1960-të. Në këtë kohë evidentohet rritja e ndërgjegjshmërisë ambientale në vendet në zhvillim dhe filluan të kristalizohen lëvizjet ambientale. Midis tyre mund të veçojmë publikimin në vitin 1962 të librit gjerësisht të lexuar të Rachel Carson, "Pranvera e heshtur", e cila shpjegonte ndikimet e pesticideve DDT mbi kafshët dhe zinxhirin ushqimor. Carson ishte midis të parëve, ndër shumë njerëz, që përdorën median e printuar dhe atë elektronike për të krijuar dhe mbështetur rritjen e ndërgjegjshmërisë mbi çështjet mjedisore. Ndër të tjerët në këtë lëvizje përfshihen personalitete të shquara si David Attenborough, Jacques Cousteau dhe David Suzuki⁹⁹. Këto publikime si dhe veprimtaria intensive e mbi 100 mijë organizatave që ushtronin aktivitet në këtë fushë bëri që çështjet mjedisore të konceptoheshin si çështje sigurie. Kjo nxiti miratimin, më pas, të dhjetëra konventave ndërkombëtare në mbrojtje të mjedisit. Më vonë, në vitin 1983, një nga studiuesit e çështjeve të sigurisë, Richard Ullman, publikoi në "International Security" artikullin "Redefining Security"¹⁰⁰, në të cilin çështjet e sigurisë mjedisore i trajtoi si çështje të sigurisë kombëtare. Sipas tij është rrezik për sigurinë kombëtare gjithçka që mund të degradojë me shpejtësi cilësinë e jetës së banorëve të një shteti, ose që ngushton zgjedhjet në dispozicion të njerëzve dhe të organizatave brenda shtetit¹⁰¹.

Një autor tjetër Norman Myers, në artikullin e tij "The environmental dimension to security issues" publikuar në vitin 1986, thekson se varfërimi i mjedisit është një shkak kryesor për tensionin dhe armiqësitë midis kombeve. Për këtë ai këmbëngul që vlerësimi i koncepteve të sigurisë duhet të përfshijë dhe një masë të stabilitetit mjedisor bazuar në burime. Sipas tij "nëse shturen themelet mjedisore të një kombi, ekonomia e tij do pësojë rënie të vazhdueshme, struktura sociale do të shkatërrohet dhe struktura e tij politike do të destabilizohet. Produkti ka shumë gjasa të jetë konflikti, qoftë ai në formën e trazirave dhe kryengritjeve brenda kombit, apo në formën e tensioneve ose akteve armiqësore ndaj kombeve të tjerë"¹⁰². Për këtë, siguria e vërtetë nuk mund të arrihet duke ngritur armë (mbrojtje në një kuptim të ngushtë), por vetëm duke siguruar kushte themelore për zgjidhjen e problemeve joushtarake që i kërcënojnë ato. Mbijetesa jonë varet jo vetëm nga ekuilibri ushtarak, por nga bashkëpunimi global për të siguruar një mjedis të qëndrueshëm biologjik¹⁰³.

Sot, çështjet mjedisore, shkaqet e rreziqeve mjedisore dhe pasojat e tyre nuk mund

⁹⁹ Jon Barneet "Siguria mjedisore". Publikuar në Studimet Bashkëkohore të Sigurisë. Përgatitur nga Alan Collins. Botimet UET, F.235.

¹⁰⁰ Richard H. Ullman, *International Security*, Vol. 8, No. 1 (Summer, 1983), pp. 129-153.

¹⁰¹ Po aty.

¹⁰² Norman Myers The environmental dimension to security issues. *Environmentalist*. December 1986, Volume 6, Issue 4, pp 251.

¹⁰³ Po aty.

të jenë vetëm çështje e një kombi apo e kufizuar brenda kufijve shtetërorë të një vendi. Ashtu si fenomenet ekstreme të natyrës (tërmetet, përmytjet), edhe katastrofat ekologjike nuk e njohin kufijtë kombëtarë. Për këtë vendet fqinjë, të një rajoni apo dhe me gjerë, me të njëjta probleme mjedisore, e kanë të pamundur të garantojnë sigurinë mjedisore pa bashkëpunuar midis tyre e më gjerë.

Është provuar se ndryshimet ambientale mund të përbëjnë rrezik për sigurinë kombëtare e njerëzore. Gjithashtu, pabarazia në resurse apo rrezikimi i tyre mund të gjenerojë konflikte të dhunshme dhe luftë të armatosur. Njihet në histori rasti i dinastisë shqiptare të Egjiptit për të marrë nën kontroll territoret në dy anët e lumit Nil që nga burimet e tij, pasi uji ishte vetë jeta e Egjiptit.

Jon Barnett në shkrimin e tij “Siguria mjedisore” trajton gjashtë qasje kryesore ndaj sigurisë ambientale¹⁰⁴ si pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare, të cilat janë: Së pari, siguria ambientale mund të shihet si diçka që ka të bëjë me pasojat mjedisore të aktiviteteve njerëzore. Kjo njihet shpesh dhe “siguri ekologjike”. Kërcënimi kryesor, në këtë rast, ndaj integritetit ekologjik, është aktiviteti njerëzor dhe proceset që duhen konceptuar brenda sigurisë, të cilat janë proceset e ekosistemeve dhe ato ekologjike. Sipas kësaj qasjeje, njerëzit sigurohen vetëm kur ata bëhen (dhe janë) pjesë e ambientit. Si qasje të dytë ndaj sigurisë ambientale, Barnett trajton rastin kur siguria ambientale mund të fokusohet në konceptin e zakonshëm të sigurisë. Shkaqet dhe pasojat e disa problemeve mjedisore nuk kufizohen brenda kufijve të shtet-kombeve. Disa probleme, si hollimi i shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimaterike, kanë natyrë tepër globale, sepse ato shkaktohen nga lëshimi i gazrave në atmosferë nga shumë vende, e rrjedhimisht prekin shumë vende. Kjo do të thotë që grupe vendesh me probleme të ngjashme mjedisore nuk mund të arrijnë dot sigurinë ambientale lehtësisht dhe në mënyrë njëanshme. Kështu, interesat e tyre të përbashkëta kombëtare kërkojnë veprimtari kolektive.

Si qasje të tretë ndaj sigurisë ambientale, Barnett trajton rastin kur kuptimi mbi sigurinë ambientale fokusohet në lidhjet midis ndryshimeve ambientale dhe konfliktit të dhunshëm. Kjo bazohet në lidhje të qarta midis degradimit ambiental dhe dhunës. Në këtë rast resurset mund të përbëjnë qëllime ose mjete strategjike dhe se pabarazitë në resurse mund të shndërrohen në burim konflikti dhe luftëra. Në këta rast etniteti që duhet siguruar nga lufta është shteti-komb¹⁰⁵.

Si qasje të katërt ndaj sigurisë ambientale, Barnett trajton rastin kur kuptimi mbi sigurinë ambientale fokusohet në lidhjen midis ndryshimeve mjedisore dhe sigurisë kombëtare. Siguria kombëtare mund të dobësohet edhe kur ndryshimet mjedisore shkaktohen nga mënyra më pak të dhunshme. Ndryshimi ambiental mund të dobësojë bazën ekonomike që përcakton kapacitetin ushtarak, ndikuese kjo në sigurinë kombëtare të një vendi. Ato dobësojnë sektorët kyç si bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe minierat, si dhe shërbime që varen prej mjedisit, si turizmi, duke dobësuar kështu bazën ekonomike të një vendi¹⁰⁶.

Si qasje të pestë ndaj sigurisë ambientale, Barnett trajton rastin kur kuptimi mbi sigurinë ambientale fokusohet në lidhjen midis ushtrisë si një nga institucionet kryesore të sigurisë dhe mjedisit. Synimi i ushtrive është të fitojnë luftën, pavarësisht pasojave të

¹⁰⁴ Jon Barneet “Siguria mjedisore”. Publikuar në Studimet Bashkëkohore të Sigurisë. Përgatitur nga Alan Collins. Botimet UET, f. 243.

¹⁰⁵ Po aty. Faqe 244.

¹⁰⁶ Po aty. Faqe 246.

saj shkatërruese e ndikimit të saj në mjedis. Në këtë rast ushtria është edhe një nga institucionet kryesore të sigurisë kombëtare, por që veprimet e saj luftarake mund të kenë pasoja katastrofike më mjedis. Si shembull mund të përmendim përdorimin e armëve bërthamore në Japoni, municioni i pasur me uranium në Kuvajt dhe Kosovë, djegia e puseve të naftës në Kuvajt, etj.¹⁰⁷

Si qasje të gjashtë ndaj sigurisë ambientale, Barnett trajton rastin kur kuptimi mbi sigurinë ambientale fokusohet në lidhjen midis sigurisë ambientale e sigurisë njerëzore. Mjedis është një prej shtatë sektorëve të identifikuar në vitin 1994 në përkufizimin për sigurinë njerëzore të “Programit të zhvillimit të Kombeve të Bashkuara”¹⁰⁸. Kështu, ndryshimi mjedisor është identifikuar si çështje e sigurisë njerëzore dhe, mënyra se si ndryshimi mjedisor ndikon në mirëqenien e individëve dhe komuniteteve, tashmë është shumë e qartë. Ndryshimet mjedisore, ndotësit e ujit dhe të atmosferës etj kanë ndikim në sigurinë e përdorimit nga individët të burimeve natyrore dhe të shërbimeve¹⁰⁹.

Në përfundim, mund të themi se siguria mjedisore, është një koncept relativisht i ri, një zgjerim i konceptit jotradicional të sigurisë dhe i papërkufizuar akoma, pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

3. Analizimin dhe vlerësim i krimit mjedisor në vendin tonë bazuar në treguesit objektivë, veprat penale të evidentuara e zbuluara nga policia, të hetuara nga prokuroria dhe të gjykuara nga gjykata

Në vijim, do të studiojmë e do të analizojmë krimin dhe sigurinë mjedisore në Shqipëri, duke marrë për bazë treguesit objektivë dhe rezultatet në luftën ndaj këtij fenomeni, sipas të dhënave të administruara nga strukturat e policisë dhe prokurorisë për periudhën 2014-2018.

3.1. Analizimi dhe vlerësimi i krimit mjedisor në vendin tonë, bazuar në treguesit e veprave penale të evidentuara e zbuluara nga policia dhe masat e marra ndaj autorëve të tyre

3.1.1. Analiza e dinamikës së veprave penale mjedisore, për periudhën 2014-2018

Në funksion të këtij studimi, kemi arritur të sigurojmë të dhëna më të plota për krimet në fushën e mjedisit vetëm për periudhën 2014-2018, kur nga Policia e Shtetit filloi dhe një punë më e organizuar ndaj këtyre veprave penale.


Dinamika e veprave penale në fushën e mjedisit për vitet 2014-2018 në paraqitje tabelore e grafike janë si më poshtë:

Vepra penale	2014	2015	2016	2017	2018	Ndodhur 2014-2018	Zbuluar 2014-2018
Ndotja e Ajrit	29	27	20	33	95	204	190
Transportimi Mbeturinave Toksike	1	1	0	0	0	2	2
Ndotja e Ujërave	4	10	7	13	17	51	38
Peshkimi i Ndaluar	29	24	21	19	13	106	100
Prerja e paligjshme e pyjeve	268	319	183	219	214	1203	1171
Prerja e drurëve dekorative dhe frutore	24	27	16	26	25	118	110
Shk. me zjarr pyjeve	2	5	4	14	3	28	8
Shkatërrimi nga Pakujdesia me Zjarr i Pyjeve	3	4	0	10	10	27	21
Shkelja e Karantinës së Bimëve dhe Kafshëve	6	0	4	0	5	15	14
GJITHSEJ SIPAS VITIT	366	417	255	334	382	1754	1654

¹⁰⁷ Po aty. Faqe 248.

¹⁰⁸ Sektorët e tjerë të përcaktuar janë ai ekonomik, i ushqimit, i shëndetësisë, individual, komunitar dhe politik

VEPRA PENALE GJITHSEJ PER VITIN 2014-2018



Nga analiza e të dhënave të mësipërme, të dinamikës së krimeve në fushën mjedisore për periudhën 2014-2018, gjejmë se janë evidencuar gjithsej 1754 vepra penale dhe janë zbuluar 1654 ose 94.2% e tyre. Nga këto, sipas veprave penale:

- Ndotja e ambientit është evidencuar në 204 raste dhe zbuluar 190 raste ose 93.1% e tyre. Kjo veprë penale përbën 12% të totalit të veprave penale në fushën e mjedisit.

- Transportimi i mbeturinave toksike është evidencuar vetëm në 2 raste, të dy të zbuluara. Kjo veprë penale përbën 0.11% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Ndotja e ujërave është evidencuar në 51 raste dhe zbuluar 38 ose 74.5%. Kjo veprë penale përbën 2.9% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Peshkimi i ndaluar është evidencuar në 106 raste dhe zbuluar 100 prej tyre. Kjo veprë penale përbën 6.04% të totalit të veprave penale në fushën e mjedisit.

- Prerja e paligjshme e pyjeve është evidencuar në 1203 raste dhe zbuluar 1171 prej tyre. Kjo veprë penale përbën 68% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë është evidencuar në 118 raste dhe zbuluar 110 raste ose 93.2% e tyre. Kjo veprë penale përbën 7% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Shkatërrimi me zjarr i pyjeve është evidencuar në 28 raste dhe zbuluar 8 ose 28.5% e tyre. Kjo veprë penale përbën 1.59% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve është evidencuar në 27 raste dhe zbuluar në 21 raste ose 77.7% e tyre. Kjo veprë penale përbën 1.52% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

- Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve është evidencuar në 15 raste dhe zbuluar në 14 raste ose 93.3% e tyre. Kjo veprë penale përbën 0.85% të totalit të veprave penale në këtë fushë.

Nga studimi i gjetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se prerja e paligjshme e pyjeve është forma më e përhapur e krimeve në fushën e mjedisit, duke

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

zënë 68% të totalit të veprave penale në këtë fushë. Ndërsa, në rend zbritës, vjen ndotja e ajrit (12%); prerja e drurëve dekorativë frutorë (7%); peshkimi i ndaluar (6.04%) dhe ndotja e ujërave (2.9%). Ndërkohë, transportimi i mbeturinave toksike është vepra penale më pak e evidentuar, vetëm në 2 raste.

3.1.2. Analiza e masave të marra ndaj autorëve të veprave penale mjedisore.

Ndërsa, masat e marra ndaj autorëve të veprave penale sipas veprave penale mjedisore në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

Neni	VEPRA PENALE SIPAS TENDENCEVE	MASAT E MARRA 2014-2018					GJITHSEJ AUTORE
		Arrestuar	Ndaluar	Gj.Lirë	Larguar	Ndryshme	
201	Vepra Penale Kundër Mjedisit Ndotja e Ajrit	32	1	434	4	0	471
202	Transportimi Mbeturinave Toksike	0	0	0	1	0	1
203	Ndotja e Ujërave	5	0	34	1	0	40
204	Peshkimi i Ndaluar	13	1	135	6	1	156
205	Prerja e paligjishme e pyjeve	102	7	1190	33	1	1333
206	Prerja e Drurëve dekorativë dhe frutorë	3	0	125	3	0	131
206/a	Shk me zjarr pyjeve	5	1	3	1	0	10
206/b	Shkatërrimi nga Pakujdesia me Zjarr i Pyjeve	3	2	16	0	0	21
207	Shkelja e Karantinës së Bimëve dhe Kafshëve	3	0	15	0	0	18
	GJITHSEJ SIPAS MASAVE TE MARRA	166	12	1952	49	2	2181


Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me masat e marra ndaj autorëve të veprave penale sipas veprave penale mjedisore për periudhën 2014-2018, gjejmë se janë identifikuar gjithsej 2181 autorë. Nga këta:


- janë arrestuar gjithsej 166 autorë ose 7.61% e totalit të autorëve të identifikuar.
- janë ndaluar 12 autorë ose 0.55% e autorëve;
- janë ndjekur në gjendje të lirë 1952 autorë të dyshuar ose 89.5% e autorëve;
- janë larguar gjithsej 49 autorë ose 2.24% e totalit të autorëve;
- kanë masa të tjera gjithsej 2 autorë.

Nga studimi i gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se, në pesë vite (2014-2019) për krimet mjedisore janë arrestuar e ndaluar vetëm 178 autorë ose rreth 8% e totalit të autorëve. Pjesa më e madhe e autorëve (89.5%) janë ndjekur në gjendje të lirë. Nisur nga kjo mund të nxjerrim përfundimin se gjithashtu, masat e marra ndaj autorëve të këtyre veprave penale, nuk kanë mbështetur luftën kundër veprave penale në fushën e mjedisit.

3.1.3. Analizë e autorëve të ndarë sipas veprave penale mjedisore

Ndërsa autorët, të ndarë sipas veprave penale në fushën e mjedisit, në paraqitje grafike janë si më poshtë:





Nëse studimi i të dhënave të mësipërme gjejmë se:

- Për veprën penale “Ndotja e ajrit” janë dënuar gjithsej 468 autorë ose 21.45% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Transportimi Mbeturinave toksike” janë dënuar gjithsej 4 autorë ose 0.18% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Ndotja e ujërave” janë dënuar gjithsej 40 autorë ose 1.83% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Peshkimi i ndaluar” janë dënuar gjithsej 145 autorë ose 6.64% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” janë dënuar gjithsej 1309 autorë ose 60. % e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” janë dënuar gjithsej 163 autorë ose 7.47% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Shkatërrim me zjarr të pyjeve” janë dënuar gjithsej 13 autorë ose 0.59% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve” janë dënuar gjithsej 21 autorë ose 0.96% e totalit të autorëve.

- Për veprën penale “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” janë dënuar gjithsej 18 autorë ose 0.82% e totalit të autorëve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur ndarjen e autorëve sipas veprave penale, mund të nxjerrim përfundimin se numri më i madhe i autorëve me rend zbritës sipas veprave penale është për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” (60% e totalit të autorëve), “Ndotja e ajrit” (21.45%), “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” (7.47%), “Peshkimi i ndaluar” (6.64%), dhe “Ndotja e ujërave” (1.83%). Numri më i vogël i autorëve (0.18%) është dënuar për “Transportimi mbeturinave toksike”.


**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

3.1.4. Analizë e autorëve të veprave penale mjedisore sipas moshës dhe arsimit

3.1.4.1. Analizë e autorëve të veprave penale mjedisore sipas moshës

Autorët e veprave penale në fushën e mjedisit sipas grupmoshave, për periudhën 2014-2019, sipas të dhënave të Policisë së Shtetit, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:



Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me grupmoshat e autorëve të veprave penale të krimeve mjedisore gjejmë se janë evidentuar 2192 autorë të veprave penale mjedisore. Nga këta:

- 6 autorë ose 0.27% janë të moshës nën 14 vjeç;
- 18 autorë ose 0.82% e tyre janë të moshës nën 15-17 vjeç;
- 433 autorë ose 19.85% e totalit të autorëve janë të moshës 18-29 vjeç;
- 711 autorë ose 32.59% e totalit të autorëve janë të moshës 30-44 vjeç;
- 782 autorë ose 35.85% e totalit të autorëve janë të moshës 45-59 vjeç;
- 231 autorë ose 10.59% e totalit të autorëve janë të moshës mbi 60 vjeç;
- numri më i madh i autorëve të veprave të krimeve mjedisore i përket grupmoshës 45-59 vjeç.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me grupmoshat e autorëve të veprave penale mjedisore, mund të nxjerrim përfundimin se numri më i madh i tyre me rend zbritës i përket grupmoshës 45-59 vjeç (35.85%), grupmoshës 30-44 vjeç (32.59%), grupmoshës 19-29 vjeç (19.85%). Më pak zënë ata të grupmoshës mbi 60 vjeç (10.59%) dhe deri në 17 vjeç (1.09%).

3.1.4.2. Analizë e autorëve të veprave penale mjedisore sipas arsimit

Niveli arsimor i autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit, në paraqitje tabelore dhe grafike është si më poshtë:

NENI	ARSIMI							
	fillor		mesë		NIK	Autët		
201	VEPRA PENALE							
202	Vepra Penale Kunder Mjedisit Ndotja e Ajrit	16	223	146	83	0	1	469
203	Transportimi Mbeturinave Toksike	0	1	0	0	0	0	1
204	Ndotja e Ujërave	0	8	16	16	0	0	40
205	Peshkimi i Ndaluar	3	85	50	5	1	12	156
206	Prerja e paligjshme e pyjeve	36	865	354	40	3	38	1336
206/a	Prerja e Drurëve dekorative dhe frutore	5	64	43	18	0	1	131
206/b	Shk me zjarr pyjeve	3	5	2	0	0	0	10
207	Shkatërrimi nga Pakujdesia me Zjarr i Pyjeve	4	13	3	1	0	0	21
	Shkelja e Karantinës së Bimëve dhe Kafshëve	0	11	4	2	0	0	17
	GJITHSEJ AUTORËT SIPAS ARSIMIT	67	1275	618	165	4	52	2181

Nga studimi i të dhënave të mësipërme lidhur me nivelin arsimor të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit gjejmë se:

- me arsim fillor janë gjithsej 67 autorë ose 3% e totalit të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit;

- me arsim 9 vjeçar janë 1275 autorë ose 59% e autorëve;

- me arsim të mesëm janë 618 autorë ose 28% e autorëve;

- me arsim të lartë janë 165 autorë ose 8% e autorëve;

- me arsim të ulët janë 52 autorë ose 2% e autorëve;

- 4 persona ose 0.18% të autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se pjesa më e madhe e autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit është me arsim 9 vjeçar (59%) dhe të mesëm (28%). Më pak autorë janë më arsim të lartë (8%) dhe të ulët (2%).

3.1.5. Përcaktimi i profilit të krimit mjedisor nisur nga treguesit objektivë (të dhënave të evidentuara nga policia)

Sipas treguesve objektivë, në Shqipëri për periudhën 2014-2018, janë evidentuar 1754 vepra penale dhe janë zbuluar 1654 ose 94.2% e tyre. Niveli i zbulimit së këtyre veprave penale është i lartë në raport me veprat e tjera penale pasi, në përgjithësi, ato që konstatohen, raportohen të gjitha të zbuluara. Prerja e paligjshme e pyjeve është forma më e përhapur e krimeve në fushën e mjedisit, duke zënë 68% të totalit të veprave penale në këtë fushë. Ndërsa, në rend zbritës vijnë ndotja e ajrit (12%); prerja e drurëve dekorativë frutorë (7%); peshkimi i ndaluar (6.04%) dhe ndotja e ujërave (2.9%). Ndërkohë, transportimi i mbeturinave toksike është vepra penale më pak e evidentuar, vetëm në 2 raste.

3.1.6. Përcaktimi i profilit të autorëve të krimit mjedisor nisur nga treguesit objektivë (të dhënave të evidentuara nga policia)

Sipas treguesve objektivë numri më i madh i autorëve të veprave penale mjedisore me rend zbritës i përket grupmoshës 45-59 vjeç (35.85%), grupmoshës 30-44 vjeç (32.59%), grupmoshës 19-29 vjeç (19.85%). Më pak zënë ata të grupmoshës mbi 60

vjeç (10.59%) dhe deri në 17 vjeç (1.09%). Pjesa më e madhe e autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit është me arsim 9 vjeçar (59%) dhe të mesëm (28%). Më pak autorë janë me arsim të lartë (8%) dhe të ulët (2%). Pjesa më e madhe e autorëve (89.5%) janë ndjekur në gjendje të lirë. Për krimet mjedisore janë arrestuar e ndaluar vetëm 178 autorë ose rreth 8% e totalit të autorëve.

3.2. Analizimi dhe vlerësimi i krimit mjedisor në vendin tonë bazuar në treguesit e procedimeve penale të regjistruara, të procedimeve të dërguar për gjykim, të pandehurve të regjistruar e të dërguar për gjykim si dhe atyre të dënuar nga gjykata.

3.2.1. Analizimi dhe vlerësim i krimit mjedisor në vendin tonë bazuar në treguesit e procedimeve penale të regjistruara nga prokuroria

Dinamika e krimit mjedisor për periudhën pesëvjeçare 2014-2018, sipas procedimeve penale të regjistruara nga Prokuroria, në paraqitje tabelore dhe grafike, është si më poshtë:

VITI	2014-2018				
	Nr. Procd Regj	Nr. proced per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pandper gjykim	Nr. Pandden uar
Neni 201 Ndotja e ajrit	135	93	121	98	81
Neni 202 Transportimi i mbeturinave toksike	0	0	0	0	0
Neni 203 Ndotja e ujërave	28	4	4	7	0
Neni 204 Peshkim i ndaluar	75	40	86	68	82
Neni 205 Prerja e paligjshme e pyjeve	717	175	448	209	144
Neni 206 Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë	76	20	20	34	16
Neni 206/a Shkatërrimi me zjarr i pyjeve	111	2	8	2	2
Neni 206/b Shkatërrimi nga pakujd. me zjarr i pyjeve	23	3	8	5	2
Neni 207 Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve	3	0	3	0	0
Totali	1168	337	698	423	327

Nga studimi i numrit të përgjithshëm të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit, të regjistruara nga prokuroria për vitet 2014-2018 gjejmë se:

- janë regjistruar gjithsej 1168 procedime penale për vepra penale kundër mjedisit;
- numrin më të madh të procedimeve e përbëjnë “Prerja e paligjshme e pyjeve” me gjithsej 717 procedime të regjistruara, të cilat përbëjnë 61.3% të totalit të procedimeve të regjistruara për veprat penale kundër mjedisit;
- në vendin e dytë renditet procedimet për “Ndotja e ajrit”, me 135 raste të regjistruara, të cilat përbëjnë 11.55% të totalit të veprave të regjistruara;
- në vendin e tretë renditet procedimet për “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”, me 111 raste të regjistruara, të cilat përbëjnë 9.5% të totalit të veprave të regjistruara;
- ndërsa, numri më i vogël të procedimeve penale të regjistruara është për “Shkelje të karantinës së bimëve dhe kafshëve” me 3 raste ose 0.25% e totalit; “Shkatërrimi nga

pakujdesia me djegie e pyjeve” me 23 raste ose 1.96% e totalit dhe “Ndotja e ujërave” me 28 raste, të cilat zënë 2.39% të totalit të procedimeve të regjistruara për krime kundër mjedisit.

Nga gjetjet e mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se, për periudhën 2014-2018 për krimet kundër mjedisit, numrin me të madh të procedimeve penale të regjistruara e përbëjnë ato për veprat “Prerja e paligjshme e pyjeve”, me 61.3% të totalit të procedimeve të regjistruara; “Ndotja e ajrit”, me 11.55% të totalit dhe “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”, 9.5% të totalit të veprave të regjistruara. Ndërsa më pak procedime penale janë regjistruar për veprat penale “Shkelje të karantinës së bimëve dhe kafshëve”, me 0.25% të totalit; “Shkatërrimi nga pakujdesia me djegie e pyjeve”, me 1.96% e totalit dhe “Ndotja e ujërave”, me 2.39% të totalit të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër mjedisit.

3.2.2. Analizë krahasuese e numrit të procedimeve të regjistruara nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018, me ato të evidentuara nga policia për të njëjtën periudhë

Nëse e krahasojnë numrin e procedimeve të regjistruara nga prokuroria për veprat penale në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018, me ato të evidentuara nga Policia për të njëjtën periudhë do të gjejmë se:

- prokuroria ka regjistruar 586 raste ose 33.4% më pak procedime penale për veprat penale në fushën e mjedisit se sa rastet e evidentuara nga Policia në të njëjtën periudhë;

- për veprën “Ndotja e ajrit” janë regjistruar 33.8% më pak raste;
- për veprën penale “Ndotja e ujërave” 45% më pak raste;
- për veprën penale “Peshkim i ndaluar” 29.2% më pak raste;
- për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” 40.3% më pak raste;
- për veprën penale “Prerja e drurëve dekorativ dhe frutor” 35.5% më pak raste;
- për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve” janë regjistruar 82% më shumë raste;
- për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr nga pakujdesia i pyjeve” 14% më pak raste;
- për veprën penale “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” janë regjistruar 3 herë më pak procedime penale se sa rastet e evidentuara nga policia në të njëjtën periudhë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se nga ana e prokurorisë, për periudhën 2014-2018, janë regjistruar në total 33.4% më pak raste procedimesh penale për veprat penale në fushën e mjedisit se sa rastet e evidentuara nga Policia e Shtetit. Më pak raste ka të regjistruara edhe sipas veprave penale të veçanta. Këtu bën përjashtim vetëm rasti i veprës penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve” ku janë regjistruar 82% më shumë raste. Kjo mund të shpjegohet dhe me referimet që institucionet përgjegjëse për pyjet mund të kenë bërë drejtpërsëdrejti në prokurori. Pra, prokuroria ka regjistruar procedime penale rreth 1/3 më pak nga rastet e referuar nga Policia e Shtetit.

Pra, ka një mospërputhje të madhe në shifra mes të dhënave statistikore të evidentuara nga Policia dhe të regjistruara nga prokuroria lidhur me veprat penale në fushën e krimeve mjedisore. Normalisht, të dhënat e policisë, duhet të ishin më të vogla ose të barabarta me regjistrimet e prokurorisë, plus mosfillimet. Nga krahasimi i të dhënave

statistikore të dy institucioneve, rezulton se në vlerë numerike, të dhënat e për veprat penale në fushën e mjedisit të evidentuara nga policia janë shumë më të mëdha se ato të prokurorisë. Edhe sikur mosfillime, të jenë nga ana e prokurorisë, shifra prej 33.4% është shumë e lartë.

3.2.3. Analizë e numrit të përgjithshëm të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit, të dërguara për gjykim nga prokuroria për vitet 2014-2018

Nga studimi i numrit të përgjithshëm të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit, të dërguara për gjykim nga prokuroria për vitet 2014-2018 gjejmë se janë dërguar për gjykim 337 procedime penale. Nga këto:

- 93 procedime penale ose 27.59% janë për veprën penale “Ndotja e ajrit”;
- 4 procedime ose 1.18% janë për veprën penale “Ndotja e ujit”;
- 40 procedime penale ose 11.86% janë për veprën “Peshkimi i ndaluar”;
- 175 procedime ose 51.92% janë për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”;
- 20 procedime penale ose 5.93% janë për veprën penale “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë”;
- 2 procedime ose 0.59% janë për veprën penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”
- 3 procedime ose 0.89% janë për veprën penale “Shkatërrim nga pakujdesia me zjarr i pyjeve”;
- për veprat penale “Transportim i mbeturina toksike” dhe “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” nuk ka pasur asnjë procedim penal të dërguar për gjykim nga prokuroria.

Nga gjetjet e mësipërme, lidhur me numrin e përgjithshëm të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit, të dërguara për gjykim nga prokuroria për vitet 2014-2018, mund të nxjerrim përfundimin se janë dërguar për gjykim, 337 procedime penale. Numrin më të madh e përbëjnë procedimet për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve”, me 51.92%; “Ndotja e ajrit”, me 27.59%; dhe “Peshkimi i ndaluar”, me 11.86% të totalit.

Ndërsa, më pak procedime penale, janë dërguar në gjykatë për veprat penale “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” (5.93%), “Ndotja e ujit” (1.18%), “Shkatërrim nga pakujdesia me zjarr i pyjeve” (0.89%), “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” (5.93%).

Për veprat penale “Transportim i mbeturina toksike” dhe “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” në këtë periudhë nuk ka pasur asnjë procedim penal të dërguar për gjykim nga prokuroria.

3.2.4. Analizë krahasuese e numrit të përgjithshëm të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit të dërguara për gjykim me ato të regjistruara në fillim nga prokuroria për vitet 2014-2018

Nëse do të krahasojnë numrin e procedime të dërguara në gjykatë me ato të regjistruara më parë nga prokuroria do të gjejmë se:

- janë dërguar në gjykatë në total 3.46 herë më pak procedime nga ato të regjistruara;
- nga këto 1.4 herë më pak procedime për “Ndotja e ajrit”;
- 7 herë më pak për “Ndotja e ujërave”;
- 1.87 herë më pak për “Peshkimi i ndaluar”;
- 4 herë më pak për “Prerja e paligjshme e pyjeve”;
- 3.8 herë më pak për “Prerja e drurëve dekorativ e frutorë”;


- 55.5 herë më pak për “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve”;
- 7.6 herë më pak për “Shkatërrimi nga pakujdesia me djegie e pyjeve”;
- 3 herë më pak për “Shkelje të karantinës së bimëve dhe kafshëve”.

Nga gjetjet e mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se numri i procedimeve penale në fushën e mjedisit, të dërguara në gjykatë, është disa herë më i vogël se numri i procedimeve të regjistruara, si në totalin e tyre (3.46 herë më pak) ashtu edhe për secilën vepër penale më vete. Kjo tregon për një pamjaftueshmëri në punën me procedimet penale në fushën e krimeve mjedisore, në fazën e hetimit paraprak.

3.2.5. Analizë krahasuese lidhur me numrin e të pandehurve të regjistruar nga prokuroria, numrin e të pandehurve të dërguar prej saj për gjykim si dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata për vitet 2014-2018

Të dhënat lidhur me numrin e të pandehurve të regjistruar nga prokuroria, numrin e të pandehurve të dërguar prej saj për gjykim si dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

VITI	2014-2018		
	Nr. i Pand. Regj.	Nr. Pandper gjykim	Nr. Panddenuar
VEPRA PENALE KUNDËR MJEDISIT			
Totali per Vepra Penale ne fushen e Mjedisit	698	423	327
Veprapenale "Prerja e paligjshme e pyjeve"	448	209	144



Ndërsa nga studimi i të dhënave të mësipërme gjejmë se:

- janë regjistruar në total për periudhën 2014-2018 gjithsej 698 të pandehur dhe janë dërguar për gjykim 424 prej tyre ose 60.7% e të pandehurve të regjistruar.
- nga 424 të pandehurit e dërguar për gjykim, janë dënuar 327 prej tyre, ose 77% e numrit të pandehurve të dërguar për gjykim.
- numri i të pandehurve të dënuar (327) përbën vetëm 46% të numrit të pandehurve të regjistruar nga prokuroria.
- për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” janë regjistruar 448 të pandehur dhe janë dërguar për gjykim 209 të pandehur ose 46.6% e tyre.
- për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” nga 209 të pandehur të dërguar për gjykim, janë dënuar vetëm 144 ose 68.8% e tyre.

AKADEMIA E SIGURISË


Konferencë shkencore ndërkombëtare:
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se ka një diferencë të madhe, mes numrit të pandehurve të regjistruar dhe numrit të pandehurve të dërguar për gjykim. Ka një diferencë të madhe mes numrit të pandehurve të dërguar për gjykim dhe atyre të dënuar. Ka një diferencë akoma më të madhe mes numrit të pandehurve të regjistruar në prokurori dhe numrit të pandehurve që janë dënuar në fund nga gjykata. Kjo flet për mangësi të mëdha në veprimtarinë hetimore lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit.

3.2.6. Analizë krahasuese lidhur me numrin e të autorëve të veprave penale mjedisore të identifikuar e referuar nga policia në prokurori numrin e tyre të regjistruar të pandehurve nga prokuroria për të njëjtën periudhë, numrin e të pandehurve të dërguar për gjykim nga ana e prokurorisë dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata

Të dhënat lidhur me numrin e autorëve të identifikuar nga policia për veprat penale në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018 dhe të referuar prej saj në prokurori, numrin e tyre të regjistruar të pandehurve nga prokuroria për të njëjtën periudhë, numrin e të pandehurve të dërguar për gjykim nga ana e prokurorisë dhe numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

VITI	2014-2018			
	Nr. autorë referuar nga Policia në Prokurori	Nr. i pand. Regjistruar nga Prokuroria	Nr. Pand. dërguar për gjykim	Nr. Pand dënuar nga gjykata
Total për Vepra Penale në fushën e Mjedisit	2181	698	423	327
Vepra penale "Prerja e paligjshme e pyjeve"	1336	448	209	144



Nga studimi i të dhënave të mësipërme gjejmë se:

- numri i autorëve të identifikuar nga policia për veprat penale në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018 dhe të referuara prej saj në prokurori është gjithsej 2181 persona;
- nga prokuroria janë regjistruar si të pandehur për të njëjtën periudhë është gjithsej 698 persona;
- numri i të pandehurve të dërguar për gjykim nga ana e prokurorisë është gjithsej 424 persona;
- numri i të pandehurve të dënuar nga gjykata është gjithsej 327 persona.

Nga analiza krahasuese e gjetjeve të mësipërme të numrit të autorëve të identifikuar e referuar nga policia në prokurori, të pandehurve të regjistruar nga prokuroria, të pandehurve të dërguar për gjykim dhe numrit të tyre të dënuar nga gjykata nxjerrim përfundimin se, nga gjykata janë dënuar 6.7 herë më pak të pandehur nga numri i autorëve të referuar nga policia në prokurori. Kjo provon për një mosfunksionim të zinxhirit investigim-hetim-gjykim apo polici-prokurori-gjykatë në luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

3.3. Përfundimet e analizimit e vlerësimit të krimit mjedisor në vendin tonë bazuar në treguesit objektivë, veprat penale të evidentuara e zbuluara nga policia, të hetuara nga prokuroria dhe të gjykuara nga gjykatat për periudhën 2014-2018

Në përfundim të analizimit e vlerësimit të krimit mjedisor në vendin tonë, bazuar në treguesit objektivë, veprat penale të evidentuara e zbuluara nga policia, të proceduara e hetuara nga prokuroria dhe të gjykuara nga gjykata për periudhën 2014-2018, është nxjerrë përfundimi se:

- Në funksion të këtij studimi, kemi arritur të sigurojmë të dhëna më të plota për krimet në fushën e mjedisit vetëm për periudhën 2014-2018, kur nga Policia e Shtetit filloi dhe një punë më e organizuar ndaj këtyre veprave penale.

- Në Shqipëri për periudhën 2014-2018, janë evidentuar gjithsej 1754 vepra penale dhe janë zbuluar 1654 ose 94.2% e tyre. Niveli i zbulimit së këtyre veprave penale është i lartë, në raport me veprat e tjera penale, pasi në përgjithësi ato vepra penale që konstatohen, raportohen të gjitha të zbuluara.

- Prerja e paligjshme e pyjeve është forma më e përhapur e krimeve në fushën e mjedisit, duke zënë 68% të totalit të veprave penale në këtë fushë. Ndërsa, në rend zbritës, vjen ndotja e ajrit (12%); prerja e drurëve dekorativë e frutorë (7%); peshkimi i ndaluar (6.04%) dhe ndotja e ujërave (2.9%). Ndërkohë, transportimi i mbeturinave toksike është vepra penale më pak e evidentuar, me vetëm 2 raste.

- Në pesë vite (2014-2018) për krimet mjedisore janë arrestuar e ndaluar vetëm 178 autorë ose rreth 8% e totalit të autorëve. Pjesa më e madhe e autorëve (89.5%) janë ndjekur në gjendje të lirë. Nisur nga kjo mund të nxjerrim përfundimin se masat e marra ndaj autorëve të krimeve mjedisore nuk e kanë mbështetur luftën kundër veprave penale në fushën e mjedisit.

- Numri më i madh i autorëve, sipas veprave penale, me rend zbritës është për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” (60% e totalit të autorëve), “Ndotja e ajrit” (21.45%), “Prerja e drurëve dekorativë dhe frutorë” (7.47%), “Peshkimi i ndaluar” (6.64%), dhe “Ndotja e ujërave” (1.83%). Numri më i vogël i autorëve (0.18%) është dënuar për “Transportim i mbeturinave toksike”.

- Numri më i madh i autorëve të veprave penale të krimeve mjedisore, me rend

zbritës, i përket grupmoshës 45-59 vjeç (35.85%), grupmoshës 30-44 vjeç (32.59%), grupmoshës 19-29 vjeç (19.85%). Më pak zënë ata të grupmoshës mbi 60 vjeç (10.59%) dhe deri në 17 vjeç (1.09%).

- Pjesa më e madhe e autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit është me arsim 9 vjeçar (59%) dhe të mesëm (28%). Më pak autorë janë me arsim të lartë (8%) dhe të ulët (2%).

- Numri më i madh i procedimeve penale të regjistruara nga prokuroria për krimet kundër mjedisit, në periudhën 2014-2018, në rend zbritës, janë për veprat “Prerja e paligjshme e pyjeve” me 61.3% të totalit të procedimeve të regjistruara; “Ndotja e ajrit”, me 11.55% të totalit dhe “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve” 9.5% të totalit të veprave të regjistruara. Ndërsa më pak procedime penale janë regjistruar për veprat penale “Shkelje të karantinës së bimëve dhe kafshëve” me 0.25% të totalit; “Shkatërrimi nga pakujdesia me djegie e pyjeve” me 1.96% e totalit dhe “Ndotja e ujërave” me 2.39% të totalit të procedimeve penale të regjistruara për veprat penale kundër mjedisit.

- Nga ana e prokurorisë, për periudhën 2014-2018, janë regjistruar në total 33.4% më pak raste procedimesh penale për veprat penale në fushën e mjedisit se sa rastet e evidentuara nga Policia e Shtetit. Pra, prokuroria ka regjistruar procedime penale rreth 1/3 më pak nga rastet e referuara nga Policia e Shtetit.

- Më pak raste të evidentuara ka edhe sipas veprave penale të veçanta. Këtu bën përjashtim vetëm në rastin e veprës penale “Shkatërrimi me zjarr i pyjeve” ku janë regjistruar 82% më shumë raste. Kjo mund të shpjegohet dhe më referimet që institucionet përgjegjëse për pyjet mund të kenë bërë drejtpërsëdrejti ne prokurori.

- Pra, ka një mospërputhje mes të dhënave statistikore të evidentuara nga policia dhe prokuroria lidhur me veprat penale në fushën e krimeve mjedisore. Normalisht të dhënat e policisë duhet të ishin më të vogla ose të barabarta me regjistrimet e prokurorisë, plus mosfillimet. Nga krahasimi i të dhënave statistikore të dy institucioneve rezulton se në vlerë numerike, të dhënat e për veprat penale në fushën e mjedisit të evidentuara nga policia janë shumë më të mëdha se ato të prokurorisë, pavarësisht mosfillimeve të saj.

- Numrin më të madh të procedimeve për veprat penale në fushën e mjedisit, të dërguara për gjykim nga prokuroria për vitet 2014-2018, me rend zbritës e përbëjnë procedimet për veprën penale “Prerja e paligjshme e pyjeve” me 51.92% të totalit të procedimeve; “Ndotja e ajrit” me 27.59%; dhe “Peshkimi i ndaluar” me 11.86% të totalit. Ndërsa më pak procedime penale janë dërguar në gjykatë për veprat penale “Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë”(5.93%), “Ndotja e ujit” (1.18%), “Shkatërrim nga pakujdesia me zjarr i pyjeve” (0.89%), “Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë”(5.93%). Për veprat penale “Transportim i mbeturina toksike” dhe “Shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve” në këtë periudhë nuk ka pasur asnjë procedim penal të dërguar për gjykim nga prokuroria.

- Numri i procedimeve penale të dërguara në gjykatë është disa herë më i vogël se numri i procedimeve të regjistruara si në totalin e tyre (3.46 herë më pak), ashtu dhe për secilën vepër penale më vete në fushën e mjedisit. Kjo tregon për një pamjaftueshmëri në punën me procedimet penale në fushën e krimeve mjedisore në fazën e hetimit paraprak.

- Ka një diferencë të madhe mes numrit të pandehurve të regjistruar dhe numrit të pandehurve të dërguar për gjykim. Ka një diferencë të madhe mes numrit të të pandehurve të dërguar për gjykim dhe atyre të dënuar. Ka një diferencë akoma më të

madhe mes numrit të pandehurve të regjistruar në prokurori dhe numrit të pandehurve që janë dënuar në fund nga gjykata. Kjo flet për mangësi të mëdha në veprimtarinë hetimore e gjyqësore lidhur me veprat penale në fushën e mjedisit.

- Nga analiza krahasuese e numrit të autorëve të identifikuar nga Policia për veprat penale në fushën e mjedisit për periudhën 2014-2018 dhe të referuara prej saj në Prokurori (gjithsej 2181 persona), me numrin e tyre të regjistruar si të pandehur nga Prokuroria për të njëjtën periudhë (gjithsej 698 persona), me numrin e të pandehurve të dërguar për gjykim nga ana e prokurorisë (gjithsej 424 persona), më numrin e të pandehurve të dënuar nga gjykata (gjithsej 327 persona) arrijmë në përfundimin se nga Policia deri tek gjykata ka ardhur duke "frruar" dukshëm numri i autorëve të veprave penale në fushën e mjedisit. Dhe në fund nga gjykata janë dënuar 6.7 herë më pak nga numri i autorëve të referuar nga Policia në Prokurori.

Në përfundim, bazuar në treguesit objektivë, të dhënat e Policisë dhe të Prokurorisë për krimet mjedisore mund të nxjerrim përfundimin për një mosfunksionim të zinxhirit investigim-hetim-gjykim, apo polici-prokurori-gjykatë për ta bërë të suksesshme luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

4. Analizimi dhe vlerësimi i perceptimeve të qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë çështjet mjedisore në vendin tonë

Treguesit subjektivë, perceptimet e qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë çështjet mjedisore janë siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë të realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë gjatë muajit tetor-nëntor 2019.

4.1. Disa të dhëna për anketimin e organizuar

Qëllimi i këtij anketimi është që të sigurojë informacionin e nevojshëm për të realizuar skanimin, analizimin dhe vlerësimin e perceptimeve të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre (qytetarëve) për punën e strukturave që menaxhojnë çështjet mjedisore në Shqipëri. Për identifikimin e problematikave që lidhen me krimin dhe sigurinë mjedisore, të faktorëve ndikues e të rrugëve për përballimin e tyre, përveç të tjerave është e domosdoshme të administrohen dhe analizohen edhe perceptimet e qytetarëve shqiptarë, si aktorë dhe faktorë që ndikohen dhe ndikojnë në çështjet mjedisore në vendin tonë.

Për këtë arsye, është organizuar ky anketim i gjerë i shtresave e profesioneve të ndryshme të shoqërisë shqiptare dhe janë analizuar perceptimet e tyre rreth krimit dhe sigurisë mjedisore. Nëpërmjet analizimit të këtyre perceptimeve synohet evidentimi i problematikave, faktorëve ndikues si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin e reduktimin e krimit mjedisor e rritjen e sigurisë mjedisore.


4.2. Demografia e të anketuarve

4.2.1. Koha e zhvillimit dhe pjesëmarrja në anketim

Procesi i anketimit u zhvillua në një hark kohor prej 30 ditëve, në platformën

“Analyzer”. Si rezultat përfundimtar u administruan të dhënat e datës 23 nëntor 2019, në ora 14 e 28 minuta. Të dhënat për pjesëmarrjen në anketim në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

Raporti i Përgjigjeve	
Statistika	
Përgjigje	Total
Pa përgjigje	30
Refuzuar	0
Të paplota	636
Të plota	893
Total	1559




Nga këta e të dhënat të mësipërme gjejmë se:

- në anketim kanë marrë pjesë gjithsej 1559 persona shifër kjo e kënaqshme dhe brenda standardeve ndërkombëtare të anketimeve;
- nga personat pjesëmarrës në anketim, 893 persona ose 57.28% e totalit kanë dhënë përgjigje të plota për të gjithë pyetëtorin;
- ndërsa 636 persona ose 40.8% e totalit të pjesëmarrësve në anketim nuk kanë dhënë përgjigje të plota për të gjithë pyetëtorin;
- kjo mund të shpjegohet me faktin që, për një arsye apo një tjetër mund ta kenë filluar dhe ndërprerë plotësimin e pyetëtorit; kanë pasur vështirësi dhe mungesë eksperience në anketimet *online* apo nuk kanë klikuar në fund të pyetëtorit në komandën “end survey”.

4.2.2. Ndarja gjinore e pjesëmarrësve të anketimit

Pjesëmarrësit në anketim, të ndarë sipas gjinisë, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

Gjinia	
Statistika	
Përgjigje	Total
Femer	656
Mashkull	691
Total	1347



Nga analiza e të dhënave të mësipërme gjejmë se:

- meshkujt përbëjnë 51.3% të të anketuarve;
- ndërsa femrat përbëjnë 48.7% të të anketuarve.


Nga gjetjet e mësipërme mund të arrijmë në përfundimin e një pjesëmarrjeje dhe interesimi gati të barabartë prej të dy gjinive, lidhur me çështjet e sigurisë mjedisore në Shqipëri.

4.2.3. Moshë e të anketuarve

Pjesëmarrësit në anketim, të ndarë sipas grupmoshave, në paraqitje tabelore dhe

grafike janë si më poshtë:

Mosha:	
Statistika	
Përgjigje	Total
16-25 vjeç	396
26-35 vjeç	317
36-45 vjeç	275
46-60 vjeç	310
mbi 60 vjeç	35
Total	1333



Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me moshën e pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:


- pjesëmarrësit që i përkasin grupmoshës 16-25 vjeç përbëjnë 29.71% të totalit të anketuarve;
- pjesëmarrësit që i përkasin grupmoshës 26-35 vjeç përbëjnë 23.78% të të anketuarve;
- pjesëmarrësit e grupmoshës 36-45 vjeç përbëjnë 20.63% të të anketuarve;
- pjesëmarrësit që i përkasin grupmoshës 46-60 vjeç përbëjnë 23.26% të të anketuarve.
- Ndërsa pjesëmarrësit e grupmoshës mbi 60 vjeç përbëjnë 2.63% të të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se numri më i madh i pjesëmarrësve në këtë anketim i përket grupmoshave të reja 16-35 vjeç (53.49%). Kjo tregon për një interesim dhe përgjegjësi më të madhe publike të brezit të ri për çështje të sigurisë mjedisore.

4.2.4. Niveli arsimor i të anketuarve

Niveli arsimor i pjesëmarrësve në anketim, në paraqitje tabelore dhe grafike është si më poshtë:

Arsimi që keni përfunduar së fundmi :	
Statistika	
Përgjigje	Total
8/9 vjeçar	5
I mesëm	261
I lartë	650
Master	387
Doktor/Profesor	21
Total	1324



Nga analiza e të dhënave të mësipërme lidhur me nivelin arsimor të pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:

- pjesëmarrësin në anketim me arsim 8/9 vjeçar përbëjnë 0.38% të totalit të të

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

anketuarve;


- të anketuarit me arsim të mesëm përbëjnë 19.71% të totalit të të anketuarve;
- pjesëmarrësit në anketim me arsim të lartë përbëjnë 49.09% të totalit të anketuarve;
- të anketuarit me arsim të niveli “Master” përbëjnë 29.23% të totalit të të anketuarve;
- pjesëmarrësit në anketim me gradë dhe titull doktor/profesor përbëjnë 1.59% të totalit të të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme, lidhur me nivelin arsimor të pjesëmarrësve në anketim, mund të arrijmë në përfundim, për një pjesëmarrje aktive të personave më nivele të ndryshme shkollimi, por numrin më të madh e përbëjnë ata me arsim të lartë (49.09%). Pjesëmarrja në anketim e numrit më të madh të personave me arsim të lartë, me master dhe grada e tituj shkencorë, të cilët përbëjnë 79.91% të totalit të të anketuarve, çka supozon që kanë më shumë informacion për krimin dhe sigurinë mjedisore, na bën të besojmë më shumë në objektivitetin e cilësinë e përgjigjeve të administruara dhe analizuara në këtë anketim.

4.2.5. Profesionit i të anketuarve

Pjesëmarrësit në anketim, sipas profesioneve, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

Ju jeni :	
Statistika	Total
Punonjës në Administratë Publike	86
Punonjës në biznes privat	63
Punonjës në bankë	14
Punonjës në Policinë e Shtetit	321
Student	343
Nxënës	10
Arsimtar	384
Punëtor	8
Fermer	1
Pensionist	9
Të tjera	28
Pa punë	40
Total	1307



Nga analiza e të dhënave të mësipërme lidhur me profesionin e pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:


- pjesëmarrësit në anketim përfaqësojnë një larmi profesioneve si punëtor, pensionist, fermer, arsimtar, nxënës, student, punonjës banke, të pa zënë në punë, punonjës të administratës publike, punonjës në biznesin privat e punonjës të Policisë së Shtetit;
- arsimtarët përbëjnë numrin më të madh të të anketuarve, gjithsej 384 persona ose 29.38% e totalit të të anketuarve;
- studentët zënë vendin e dytë me gjithsej 243 persona ose 26.24% e totalit;
- punonjësit e Policisë së Shtetit zënë vendin e tretë me gjithsej 321 pjesëmarrës ose 24.56% e totalit të të anketuarve;
- punëtorët, nxënësit, fermerët e pensionistët përbëjnë nga 0.08 deri 0.77% të totalit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, lidhur me profesionet e pjesëmarrësve në anketim, mund të nxjerrim përfundimin se pjesëmarrësit përfaqësojnë një larmi profesionale, çka flet për një përgjegjshmëri të shtresave dhe profesioneve të ndryshme në Shqipëri për çështjet mjedisore. Numrin më të madh të pjesëmarrësve në anketim e zënë arsimtarët (29.38%), studentët (26.24%) dhe punonjësit e Policisë së Shtetit (24.56%). Pjesëmarrja e gjerë e arsimtarëve dhe studentëve tregon për një përgjegjshmëri publike në rritje të tyre për çështjet e mjedisit në Shqipëri.

4.2.6. Përbërja e pjesëmarrësve sipas ndarjes zonë rurale/urbane

Përbërja e pjesëmarrësve në anketim sipas ndarjes së tyre nga zonat rurale/urbane, në paraqitje tabelore dhe grafike është si më poshtë:

Ju jetoni në:	
Statistika	
Përgjigje	Total
Qytet	1122
Fshat	180
Total	1302



Nga analiza e të dhënave të mësipërme lidhur me përkatësinë e pjesëmarrësve nga zonat rurale/urbane gjejmë se:


- pjesëmarrësit në anketim i përkasin komuniteteve që jetojnë edhe në fshat dhe në qytet;
- pjesëmarrësit nga qyteti përbëjnë 86.18% të totalit të pjesëmarrësve në anketim;
- pjesëmarrësit nga fshati përbëjnë 13.82% të totalit të pjesëmarrësve në anketim.

Nga gjetjet e mësipërme, lidhur me përkatësinë e pjesëmarrësve nga zonat rurale/urbane mund të nxjerrim në përfundimin, për një pjesëmarrje në anketim nga komunitetet që iu përkasin të dy zonave, si qytetit ashtu dhe fshatit, çka tregon për një interesim të të dy komuniteteve për çështjet mjedisore në Shqipëri. Pjesëmarrja më e madhe nga qyteti mund të shpjegohet me problematikën dhe, për pasojë, me një sensibilitet më të madh të komuniteteve nga qyteti për sigurinë e tyre mjedisore, si dhe aksesin më të madh që ky komunitet mund të ketë pasur në anketimin *online*.

4.2.7. Shtrirja gjeografike e pjesëmarrësve në anketim

Pjesëmarrësit në anketim, sipas shtrirjes gjeografike, në paraqitje tabelore dhe grafike janë si më poshtë:

Ju banoni në:	
Përgjigje	Total
Tirane	904
Durres	70
Elbasan	43
Lezhe	28
Shkoder	31
Diber	21
Kukes	10
Vlore	51
Fier	53
Gjirokaster	21
Berat	21
Korçe	34
Jashteshtetit	13
Total	1300



Nga analiza e të dhënave të mësipërme, lidhur me shtrirjen gjeografike të pjesëmarrësve në anketim gjejmë se:

- në anketim kanë marrë pjesë qytetarë nga të gjithë prefekturat e vendit si dhe, në një numër të kufizuar qytetarët që banojnë jashtë vendit;
- numri më i madh i pjesëmarrësve gjithsej 904 persona ose 69.54% e totalit të pjesëmarrësve është nga qyteti i Tiranës;
- pas Tiranës, numri më i madh i pjesëmarrësve është nga qyteti i Durrësit, me 5.38% e totalit të pjesëmarrësve;
- numri më i vogël i pjesëmarrësve është nga Kukësi me 0.77%.
- nga jashtë vendit kanë marrë pjesë 1% e të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme, lidhur me shtrirjen gjeografike të pjesëmarrësve në anketim, mund të nxjerrim përfundimin se pjesëmarrësit kanë një shtrirje gjeografike nga i gjithë vendi dhe një numër i reduktuar i tyre (1%) janë nga jashtë vendit. Numri më i madh i të anketuarve është nga Tirana (69.54%) dhe nga Durrësi (5.38%). Kjo mund të shpjegohet me problematikën, dhe për pasojë edhe me ndjeshmërinë, që ka në metropolin Tiranë-Durrës për çështjet mjedisore, me faktin që në këto dy qytete janë qendrat me të mëdha universitare në vend të interesuara për këto çështje si dhe mundësia më e madhe e tyre për të pasur qasje në këtë anketim *online*.


Në përfundim të vlerësimit demografik të pjesëmarrësve në anketim, mund të themi se, kjo përbërje është gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese për objektin tonë të studimit.

4.3 Përgjigjet e pyetësorit

Përgjigjet e të anketuarve lidhur perceptimet e tyre për çështje të krimit dhe të sigurisë mjedisore, sipas pyetjeve janë si në vijim.

1. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: "Nga cila prej ndodhive të mëposhtme ndihen më të rrezikuar në Shqipëri?"

Nga cila prej ndodhive të mëposhtme ndiheni më i rrezikuar në Shqipëri?	
Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Krimet kibernetike	83
Krimet mjedisore	342
Vjedhjet	107
Vrasjet	181
Aksidentet	496
Të tjera	61
Gjithsej	1270




Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se nga cila prej ndodhive të mëposhtme ndiheni më i rrezikuar në Shqipëri gjejmë se:

- nga aksidentet rrugore ndjehen të rrezikuar pjesa më e madhe e të anketuarve, gjithsej 496 persona ose 39.06% e totalit;
- nga krimet mjedisore ndjehen të rrezikuar 26.93% e të anketuarve;
- nga vrasjet ndjehen të rrezikuar 14.25% e të anketuarve;
- nga vjedhjet ndjehen të rrezikuar 8.43% e të anketuarve;
- ndërsa për kategorinë “të tjera” ndjehen të rrezikuar 4.8% e të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se të anketuarit, rrezikun më të madh për jetën e tyre e perceptojnë nga aksidentet automobilistike (39.06%) dhe krimet mjedisore (26.93%) si dhe më pak nga vrasjet (14.25%), vjedhjet (8.43%) dhe krimet kibernetike (6.54%). Pra, nga krimi mjedisor, të anketuarit ndjejnë rrezik më shumë se sa nga vrasjet dhe vjedhjet.


2. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “Sa e njohin fushën e krimit mjedisor dhe sigurinë mjedisore?”

Sa e njihni ju fushën e krimit mjedisor dhe sigurinë mjedisore?	
Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
1 - Aspak	45
2 - Pak	230
3 - Disi	313
4 - Mjaftueshëm	550
5 - Shumë	118
Gjithsej	1256



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se sa e njihni ju fushën e krimit mjedisor dhe sigurisë mjedisore gjejmë se:

- kanë shumë njohuri në fushën e krimit mjedisor dhe sigurisë mjedisore vetëm 9.39% e të anketuarve;
- pjesa më e madhe e të anketuarve (43.79%) përgjigjen se kanë njohuri të mjaftueshme për krimin dhe sigurinë mjedisore;



Nga studimi i 10 368 përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se sa janë dakord me alternativat e renditura nga ana jonë se krimet mjedisore:

- paraqesin rrezikshmëri të lartë në gjithë botën,
- janë dukuri në rritje,
- janë dukuri për të cilën janë hartuar ligje të forta në Shqipëri,
- po shkaktojnë zhdukjen e florës dhe të faunës,
- janë përgjegjësi e qeverisë dhe shtetit,
- janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve,

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

g. reduktohen në qoftë se mbeturinat ndahen në të thata, të lëngshme dhe të riciklueshme,

h. po shkaktojnë ngrohjen globale,

i. po shkaktojnë ndryshimin e temperaturave.

Gjejmë se:

- në total, 54.4% e përgjigjeve janë “shumë dakord” me alternativat e mësipërme;

- në total, 30.99 e përgjigjeve janë “dakord” me alternativat e renditura;

- në total, 10.28 janë “neutral”;

- në total 4.33% e përgjigjeve në vlerësuar se janë “aspak dakord” me alternativat e mësipërme;

- alternativa që krimet mjedisore “paraqesin rrezikshmëri të lartë në gjithë botën” gjen, në masën “shumë dakord” dhe “dakord”, mbështetjen e 94.54% të përgjigjeve të anketuarve;

- alternativa që krimet mjedisore “janë dukuri për të cilën janë hartuar ligje të forta në Shqipëri” gjen, në masën “shumë dakord” dhe “dakord”, mbështetjen e 41.32% të përgjigjeve të anketuarve;

- alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e qeverisë dhe shtetit” gjen, në masën “shumë dakord” dhe “dakord”, mbështetjen e 81.77% të përgjigjeve të anketuarve;

- alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve” gjen, në masën “shumë dakord” dhe “dakord”, mbështetjen e 96.27% të përgjigjeve të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme mund të arrijmë në përfundim se pjesa më e madhe e përgjigjeve (85.39%) të së anketuarve mbështesin në masën “dakord” dhe “shumë dakord” alternativat e mësipërme lidhur me krimet mjedisore. 94.54% e përgjigjeve mbështesin alternativën që krimet mjedisore “paraqesin rrezikshmëri të lartë në gjithë botën”. Ndërkohë, alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve”, ka gjetur mbështetjen në masën “dakord” dhe “shumë dakord” të më shumë përgjigjeve (96.27%), se alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e qeverisë dhe shtetit” (81.77%). Pra, të anketuarit mbështesin një angazhim më të madh qytetar në këtë fushë.

4. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon më së shumti në ndotjen e ajrit?”

Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon më së shumti në ndotjen e ajrit, gjejmë se:

- 36.29% e të anketuarve mendojnë se aktivitetet industriale ndikojnë më shumë në ndotjen e ajrit;

- 16.42% e të anketuarve mendojnë se shpyllëzimi ndikon më shumë në ndotjen e ajrit;


- Për trenat, anijet dhe automjetet si ndotës të ajrit i mendojnë 14.02% e të anketuarve;

- 8.96% e të anketuarve mendojnë se konsumi i plastikës ndikon më shumë në ndotjen e ajrit;

- për urbanizimin e shpejtë si faktor ndikues në ndotjen e ajrit e mendojnë 11.27% e të anketuarve.

Nga gjetjet e mësipërme, lidhur me përgjigjet e të anketuarve për faktorët ndotës të


Cili nga faktorët e mëposhtëm ndikon më së shumti në ndotjen e ajrit?	
Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Aktivitetet industriale	409
Mbeturinat e ngurta	26
Konsumimi i plastikës	101
Automjetet, trenat, anijet, aeroplanët	158
Urbanizimi i shpejtë	127
Mbiopullimi	54
Djegja e fosileve	39
Mbeturinat bujqësore	3
Shpyllëzimi	185
Niveli në ulje i biodiversitetit	24
Gjithsej	1127



ajrit, mund të nxjerrim përfundimin se ata, identifikojnë aktivitetet industriale (36.29%); shpyllëzimin (16.42%); trenat, anijet dhe automjetet (14.02%); urbanizimin e shpejtë (11.27%) dhe konsumin e plastikës (8.96%).

5. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “A janë në dijeni të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Po	312
Jo	152
Deri diku	625
Nuk e di	20
Gjithsej	1109



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen se a jeni në dijeni të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja, gjejmë se:

- “janë në dijeni” të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja 28.13% e të anketuarve;
- “deri diku”, janë në dijeni të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja 56.36% e të anketuarve.
- “nuk janë në dijeni”, 13.71% e të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se janë në dijeni të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja 28.13% e të anketuarve. Pjesa më e madhe e tyre (56.36%) janë deri diku në dijeni, ndërsa 13.71% e tyre nuk janë në dijeni të politikave dhe iniciativave globale për këtë problem. Pra, ndonëse të anketuarit përbëjnë një kampion me arsim të lartë, me master dhe grada e tituj shkencor në masën 79.91%, pjesa më e madhe e tyre nuk janë dijeni ose janë deri diku në dijeni në masën 68.07% (13.71% + 56.36%) të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja.

6. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “A aplikohen në vendin tonë praktika në bashkëpunim me organizata vendase e të huaja për parandalimin e reduktimin e krimeve mjedisore?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Po	245
Jo	161
Deri diku	490
Nuk kam dijeni	202
Gjithsej	1098



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen: “A aplikohen në vendin tonë praktika në bashkëpunim me organizata vendase e të huaja për parandalimin e reduktimin e krimeve mjedisore?”, gjejmë se:

- për 22% të të anketuarve, në vendin tonë aplikohen praktika në bashkëpunim me organizata vendase e të huaja për parandalimin e reduktimin e krimeve mjedisore;

- për 15% të të anketuarve, në vendin tonë nuk aplikohen praktika të tilla;
- për 45% të të anketuarve, në vendin tonë aplikohen deri diku praktika të tilla;
- ndërsa 18% e të anketuarve nuk kane dijeni për këtë çështje;

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se për 22% të të anketuarve, në vendin tonë aplikohen praktika në bashkëpunim me organizata vendase e të huaja për parandalimin e reduktimin e krimeve mjedisore dhe për 15% të anketuarve nuk aplikohen. Ndërsa, për pjesën më të madhe të anketuarve (45%) në vendin tonë praktika të tilla aplikohen deri diku.

7. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në fushat e mëposhtme për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore?”

Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në fushat e mëposhtme për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore?									
Respondent	10-48								
Mesazhi	4, 17								
Statistika	Aspak	Pak	Disi	Mjaftueshem	Shumë	Gjithsej	Mesazhi		
Edukimi në gjimnaze për parandalimin e krimit mjedisor	25	89	89	200	865	1048			4,35
Edukimi në universitete për parandalimin e krimit mjedisor	36	84	118	293	517	1048			4,12
Trajnime të specializuara të posaçme për parandalimin e krimit mjedisor	61	93	133	286	485	1048			4,01
Fus hatet e takimit ndërgjegjësues të publikut të gjërë	41	97	122	241	547	1048			4,1
Ligjet dhe politikat mbikëmbësore	29	82	97	191	649	1048			4,29
Ndërkombëtarë ekonomik i krimit mjedisor	35	61	133	308	511	1048			4,14
Gjithsej	217	486	682	1519	3374	6288			4,17
Përqindje									
Edukimi në gjimnaze për parandalimin e krimit mjedisor	Aspak	Pak	Disi	Mjaftueshem	Shumë	Gjithsej	Mesazhi		
Edukimi në universitete për parandalimin e krimit mjedisor	2,39%	6,58%	8,49%	19,08%	63,45%	100%	4,35		
Trajnime të specializuara të posaçme për parandalimin e krimit mjedisor	3,44%	8,02%	11,26%	27,96%	49,33%	100%	4,12		
Fus hatet e takimit ndërgjegjësues të publikut të gjërë	3,91%	9,26%	12,69%	27,29%	46,28%	100%	4,01		
Ligjet dhe politikat mbikëmbësore	2,77%	7,82%	9,26%	23,00%	52,19%	100%	4,1		
Ndërkombëtarë ekonomik i krimit mjedisor	3,34%	5,62%	12,69%	29,39%	48,76%	100%	4,29		
Gjithsej	3,45	7,73	11,01	24,16	53,66	100%	4,17		

AKADEMIA E SIGURISË


Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen se duhet investuar në fushat e mëposhtme për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore, gjejmë se:

- 83.25% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në fushën e edukimit nëpër gjimnaze për parandalimin e krimit mjedisor;
- 77.29% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në edukimin në universitete për parandalimin e krimit mjedisor;
- 75.57% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në trajnimet/specializimet e posaçme për parandalimin e krimit mjedisor;
- 75.19% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në fushat e takimit ndërgjegjësues me publikun e gjerë;
- 80.16% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në fushën e ligjeve dhe politikave mjedisore;
- 78.15% e përgjigjeve të anketuarve, për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore, mbështesin mjaftueshëm dhe shumë investimet në fushën e ndikimit ekonomik të krimit mjedisor.

Sipas mendimit tuaj, sa duhet investuar në fushat e mëposhtme për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore?




- Edukimi në gjimnaze për parandalimin e krimit mjedisor.
- Edukimi në universitete për parandalimin e krimit mjedisor
- Trajnime/specializime të posaçme për parandalimin e krimit mjedisor
- Fushat e takimit ndërgjegjësues të publikut të gjerë
- Ligjet dhe politikat mbi krimin mjedisor
- Ndikimi ekonomik i krimit mjedisor

politikave mjedisore (80.16%); në fushën e ndikimit ekonomik të krimit mjedisor (78.15%); në edukimin në universitete për parandalimin e krimit mjedisor (77.29%); investimet në fushatat e takimet ndërgjegjësuese me publikun e gjerë (75.19%) dhe në trajnimet/specializimet e posaçme për parandalimin e krimit mjedisor (73.57%). Sipas kësaj renditje rekomandohen dhe fushat me prioritet për të investuar, për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe për të parandaluar krimet mjedisore.

8. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “A mendoni se në vendin tonë po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Jo, nuk po punohet mjaftueshëm	548
Jo, por mund të bëhet më shumë se kaq	262
Po, po punohet në nivele mesatare	196
Po, po punohet maksimalisht	25
Gjithsej	1031



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen a mendoni se në vendin tonë po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit, gjejmë se:

- 53.15% e të anketuarve mendojnë se jo, nuk po punohet mjaftueshëm për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit;
- 25.41% e të anketuarve mendojnë se jo, por mund të bëhet më shumë se kaq;
- 19.1% e të anketuarve mendojnë se po, në vendin tonë po punohet në nivele mesatare për të përmirësuar sigurinë mjedisore;
- 2.4% e të anketuarve mendojnë se po, në vendin tonë po punohet maksimalisht për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se 78.56% e të anketuarve nuk mendojnë se në vendin tonë po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime dhe nuk po punohet mjaftueshëm për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Ndërkohë, vetëm 21.43% e të anketuarve mendojnë se, në vendin tonë po punohet në nivele mesatare e maksimalisht për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit.


9. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “A mendoni se veprimtaria për trajtimin e korrigjimin e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore duhet të jetë aspekti më i rëndësishëm për t’u kujdesur në vendin tonë?”

Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen nëse mendojnë se veprimtaria për trajtimin e korrigjimin e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore duhet të jetë aspekti më i rëndësishëm për t’u kujdesur në vendin tonë, gjejmë se:

- 13.5% e të anketuarve mendojnë se po, është çështja më e rëndësishme që ka nevojë për tu zgjidhur;
- 64.04% e të anketuarve mendojnë se po, është e rëndësishme ashtu siç janë edhe disa çështje të tjera;
- 15.37% mendojnë se veprimtaria për trajtimin e korrigjimin e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore duhet të jetë aspekti më i rëndësishëm për t’u kujdesur në vendin tonë është deri diku e rëndësishme;
- 7.09% e të anketuarve mendojnë se jo, ka çështje më të mëdha për t’u zgjidhur.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se, në pjesën më të madhe të tyre (77.54%), të anketuarit vlerësojnë si çështja më e rëndësishme që ka nevojë për tu zgjidhur (13.5%) apo çështje e rëndësishme ashtu siç janë edhe disa çështje të tjera (64.04%), alternativën se veprimtaria për trajtimin e korrigjimin e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore duhet të jetë aspekti më i rëndësishëm për t’u kujdesur në vendin tonë. Kjo tregon për një ndjeshmëri të madhe për çështjet e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore. Vetëm për 7.09% të të anketuarve, ka çështje më të mëdha për t’u zgjidhur, se sa kjo e ndotjes mjedisit dhe sigurisë mjedisore.

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Jo, ka çështje më të mëdha për t’u zgjidhur	72
Deri diku e rëndësishme	156
Po, është e rëndësishme ashtu siç janë edhe disa çështje të tjera	650
Po, është çështja më e rëndësishme që ka nevojë për t’u zgjidhur	137
Gjithsej	1015



10. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “Në cilën prej platformave të mëposhtme, keni dëgjuar më së shumti për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor?”

Përgjigjet	Gjithsej
Televizion	682
Radio	9
Gazete	29
Internet	593
Revista shkencore/artikuj shkencorë	82
Grupet për mbrojtjen e mjedisit	151
Shkolla, universitete	91
Institucionet shtetërore	26
Librari	4
Miqte / Koleget	49
Furnitorë të energjisë	5
Policia e Shtetit	53
Te tjera	8
Gjithsej	1013



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve për pyetjen e mësipërme, gjejmë se të anketuarit janë informuar nga platformat si më poshtë:

- televizioni 67.32%;
- interneti 58.54%;
- grupet për mbrojtjen e mjedisit 14.91%;
- shkollat e universitetet 8.98%;
- revistat shkencore e artikujt shkencor 8.09%;
- Policia e Shtetit 5.23%;
- miqtë e kolegët 4.84%;
- gazetatat 2.86%;
- institucionet shtetërore 2.57%.


Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se pjesa më e madhe e të anketuarve kanë marrë më shumë informacion për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor nga media dhe rrjetet sociale si televizioni (67.32%); interneti (58.54%); revistat shkencore e artikujt shkencorë (8.09%) dhe gazetatat (2.86%). Pas tyre renditen informacioni i marrë nga institucionet si shkollat e universitetet (8.98%); Policia e Shtetit (5.23%) dhe institucionet shtetërore (2.57%). Një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit në këtë fushë kanë luajtur dhe grupet për mbrojtjen e mjedisit (14.91%).

Kjo tregon për një rol në rritje të medieve dhe rrjeteve sociale dhe një mundësi për t'u shfrytëzuar më shumë në të ardhmen për të ndërgjegjësuar njerëzit për çështjet mjedisore. Ndërkohë, duhet ridimensionuar roli i institucioneve arsimore e shtetërore në dhënien e informacionit për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor pasi duket se veprimtaria e tyre në këtë fushë është dukshëm më pak ndikuese se e grupeve për mbrojtjen e mjedisit.

11. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “Cili është niveli juaj i besimit për informacionet lidhur me sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, që do ta merrnit nga burimet e listuara në vijim?”

Statistika	Cili është niveli juaj i besimit për informacionet lidhur me sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, që do ta merrnit nga:				Total	Mesatarisht
	Shumë	Pak	Disi	Aspak		
Familja	605	172	201	12	990	1.62
Miqe	373	275	318	24	990	1.99
Rrjetet sociale	448	237	274	31	990	1.89
Artikuj/revista shkencore	541	210	192	47	990	1.74
Institucionet shtetërore	409	236	256	89	990	2.03
Media	513	217	230	30	990	1.77
Policia e Shtetit	450	209	225	106	990	1.99
Total	3339	1556	1696	339	6930	1.86
Përqindje						
	Shumë	Pak	Disi	Aspak	Gjithsej	Mesatarisht
Familja	61.11%	17.37%	20.30%	1.21%	100%	1.62
Miqe	37.68%	27.76%	32.12%	2.42%	100%	1.99
Rrjetet sociale	45.25%	23.94%	27.68%	3.13%	100%	1.89
Artikuj/revista shkencore	54.65%	21.21%	19.39%	4.75%	100%	1.74
Institucionet shtetërore	41.31%	23.84%	25.86%	8.99%	100%	2.03
Media	51.62%	21.92%	23.23%	3.03%	100%	1.77
Policia e Shtetit	45.45%	21.11%	22.73%	10.71%	100%	1.99
Gjithsej	48.18	22.45	24.47	4.89	100%	1.86

Cili është niveli i juaj i besimit për informacionet lidhur me sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, që do ta merrnit nga:




- Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen e mësipërme gjejmë se:
- 61.11% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin në masën “shumë” informacionet e marra nga familja;
 - 54,65% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin në këtë masë informacionet e marra nga artikujt dhe revistat shkencore;
 - 51.82% e përgjigjeve mbështesin në këtë masë informacionet e marra nga media;
 - 45.45% e përgjigjeve mbështesin në këtë masë informacionet e marra nga Policia e Shtetit;
 - 45.25% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin në këtë masë informacionet e marra nga rrjetet sociale;
 - 41.31% e përgjigjeve të anketuarve mbështesin në këtë masë informacionet e marra nga institucionet shtetërore dhe 37.68% nga miqtë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se përgjigjet e të anketuarve lidhur me besueshmërinë e burimit të informacioneve që marrin për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit mbështesin si burim shumë të besueshëm familjen (61.11%); artikujt dhe revistat shkencore (54,65%); medien (51.82%); Policinë e Shtetit (45.45%); rrjetet sociale (45.25%); institucionet shtetërore (41.31%) dhe miqtë (37.68%). Nga këto përgjigje rezultojnë se familja, media dhe botimet shkencore janë burime më të besueshme se institucionet shtetërore, të cilat kanë dhe nivelin më të lartë (10.75% dhe 8.99%) të përgjigjeve si burime aspak të besueshme për informacionet për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit.

12. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen: “A keni dijeni për ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Po	276
Jo	139
Deri diku	546
Nuk e di	28
Gjithsej	989




Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve për pyetjen nëse kanë dijeni për ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit gjejmë se:

- 28% e të anketuarve janë përgjigjur se kanë dijeni;
- 14% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë dijeni;
- 55% e të anketuarve kanë deri diku dijeni;
- ndërkohë 3% nuk e dinë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se pjesa më e madhe e të anketuarve (69%) nuk kanë dijeni (14%) ose kanë deri diku dijeni (55%) lidhur me ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit, përkundrajt 28% të cilët përgjigjen se kanë dijeni. Nisur nga niveli i lartë arsimor i kampionit të anketuar mund të arrihet në përfundimin se shifra prej 69% e atyre që nuk kanë dijeni apo kanë deri diku dijeni për këto ligje është relativisht i lartë. Për këtë rekomandohet zhvillimi i njohurive ligjore për çështjet e sigurisë mjedisore.

13. Përgjigjet e të anketuarve për pyetjen lidhur me ashpërsinë e ligjeve për sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Duhet të jenë më shumë strikte e të rrepta	858
Duhet të jenë ashtu siç janë	54
Duhet të jenë më pak strikte e të rrepta	31
Nuk kemi nevojë për ligje të tilla	5
Nuk e di	41
Gjithsej	989



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve lidhur me ashpërsinë e ligjeve për sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit gjejmë se:

- për 86.75% të anketuarve këto ligje duhet të jenë më shumë strikte e të rrepa;
- 5.46% përgjigjen se këto ligje duhet të jenë ashtu siç janë;
- për 3.13% të anketuarve ligjet duhet të jenë ma pak strikte e të rrepta;
- 4.15% janë përgjigjur se nuk e dinë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se pjesa më e madhe e të anketuarve (86.75%) mendojnë se ligjet për sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit duhet të jenë me shumë strikte e të rrepta. Ndërsa vetëm 8.59% e të anketuarve ose dhjetë herë më pak, mbështesin *status quo*-në e ligjeve në këtë fushë apo dhe zbutjen e tyre. Nga kjo mund të arrijmë në përfundimin se ashpërsimi i legjislacionit në fushën e krimeve mjedisore është kërkesë dhe gëzon mbështetje të gjerë.

14. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me vlerësimet që ata kanë për secilën nga format e krimit në mjedis

Sipas mendimit tuaj, vlerësoni shqetësimin që keçi për secilën nga format e krimit në mjedis:					
Statistika	Shumë të shqetësuar	Te shqetësuar	Neutral	Te mashqetësuar	Gjithsej
Nësija e ajrit	752	187	13	8	960
Ngratim i burimeve të ujit të pijshëm	652	258	37	11	958
Rrëzja e temperaturës	485	372	92	11	960
Zhdukja e kalshëve të rrezikuara	488	345	98	16	947
Dëbardimi i mjedistit	730	206	23	2	961
Ndërkimi i rreptës së mjedisit në sistemin nervor të njeriut	708	208	33	11	960
Gjithsej	3925	1576	296	59	5772
Përqindje					
	Shumë të shqetësuar	Te shqetësuar	Neutral	Te mashqetësuar	Gjithsej
Nësija e ajrit	78.17%	19.44%	1.39%	0.83%	100%
Ngratim i burimeve të ujit të pijshëm	67.76%	26.62%	3.69%	1.14%	100%
Rrëzja e temperaturës	50.42%	38.67%	9.58%	1.44%	100%
Zhdukja e kalshëve të rrezikuara	51.77%	36.96%	10.19%	1.08%	100%
Dëbardimi i mjedisit	75.89%	21.41%	2.39%	0.21%	100%
Ndërkimi i rreptës së mjedisit në sistemin nervor të njeriut	73.60%	21.62%	3.43%	1.14%	100%
Gjithsej	66.27	27.3	5.13	1.02	100%

Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve lidhur me vlerësimet që ata kanë për secilën nga format e krimit në mjedis gjejmë se:

- nga 5772 vlerësimet e grumbulluara në total nga të anketuarit për të të gjithë krimet në mjedis të listuara më sipër, 66.7% e tyre ndjehen “shumë të shqetësuar”;
- 27.3% ndjehen “të shqetësuar”;
- 5.13% ndjehen “neutral”;
- 1.02% ndjehen “të pa shqetësuar” dhe 0.28% “aspak të shqetësuar”;

- sipas formës së krimit në fushën e mjedisit të anketuarit ndjehen shumë të shqetësuar nga ndotja e ajrit (78.17%); degradimi i mjedisit (75.88%); ndikimi i ndotjes së mjedisit në sistemin nervor të njeriut (73.6%); ngushtimi i burimeve të ujit të pijshëm (67.78%); zhdukja e kafshëve të rrezikuara 51.77% dhe rritja e temperaturës 50.42%.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të arrijmë në përfundimin se 66.27% e të anketuarve, ndjehen shumë të shqetësuar nga krimet mjedisore dhe 27.3%, të shqetësuar. Vetëm 1.02% ndjehen të pashqetësuar dhe 5.13%, neutral. Nga format e veçanta të krimit mjedisor të anketuarit ndjehen shumë të shqetësuar nga ndotja e ajrit (78.17%); degradimi i mjedisit (75.88%); ndikimi i ndotjes së mjedisit në sistemin nervor të njeriut (73.6%); ngushtimi i burimeve të ujit të pijshëm (67.78%); zhdukja e kafshëve të rrezikuara 51.77% dhe rritja e temperaturës 50.42%.

15. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa të shqetësuar janë për problemet e mëposhtme mjedisore që cenojnë sigurinë në mjedis?”

Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa të shqetësuar janë për problemet e mësipërme mjedisore që cenojnë sigurinë në mjedis?” gjejmë se:

- nga 6643 vlerësimet e grumbulluara në total nga të anketuarit për të gjithë problemet mjedisore të listuara më sipër që cenojnë sigurinë në mjedis, 72.21% e tyre ndjehen “shumë të shqetësuar”;
- 20.95% ndjehen “të shqetësuar”;
- 5.24% “mesatarisht të shqetësuar”;
- 1.28% “pak të shqetësuar” dhe 0.32% “aspak të shqetësuar”.

- Sipas problemeve mjedisore të listuara më sipër që cenojnë sigurinë në mjedis, të anketuarit janë shumë të shqetësuar nga prerja e pyjeve dhe drurëve frutorë (84.51%); ndotja e ujit (84.19%); ndotja e ajrit (83.77%); ndotja e tokës (74.08%); djegia e kazanëve të plehrave (69.23%); ndotja nga mbetjet inertë (61.01%) dhe ndotja akustike (48-68).

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se 72.21% e të anketuarve ndjehen “shumë të shqetësuar” se problemet mjedisore të listuara më sipër cenojnë sigurinë në mjedis, 20.95% ndjehen “të shqetësuar” dhe 5.24% ndjehen “mesatarisht të shqetësuar”. Ndërsa, sipas renditjes së problemeve mjedisore të listuara më sipër që cenojnë sigurinë në mjedis, të anketuarit janë shumë të shqetësuar nga prerja e pyjeve dhe drurëve frutorë (84.51%); ndotja e ujit (84.19%); ndotja e ajrit (83.77%); ndotja e tokës (74.08%); djegia e kazanëve të plehrave (69.23%); ndotja nga mbetjet inertë (61.01%) dhe ndotja akustike (48.68%).


Sa të shqetësuar jeni për problemete mëposhtëme mjedisore, që çënojnë sigurinë në mjedis?						
Respondent	949					
Mëatarisht	1.37					
Statistika						
	Shumë të shqetësuar	Te shqetësuar	Mesatarisht	Pak të shqetësuar	Aspak të shqetësuar	Mesatarisht
Ndofja akustike	462	325	12.3	32	7	1.73
Ndofja e ajrit	795	130	14	7	3	1.2
Ndofja e ujit	799	123	22	4	1	1.19
Ndofja e tokës	703	198	38	8	2	1.32
Ndofja nga mbetjet interte	579	288	68	12	2	1.49
Djegja e lëzave të plerave	657	213	57	18	4	1.42
Prerjadjegja e pyjeve dhe drurëve frutorë	802	115	26	4	2	1.2
Gjithsej	4797	1392	34.8	85	21	1.37
Perëndje						
	Shumë të shqetësuar	Te shqetësuar	Mesatarisht	Pak të shqetësuar	Aspak të shqetësuar	Mesatarisht
Ndofja akustike	48.68%	34.25%	12.96%	3.37%	0.74%	1.73
Ndofja e ajrit	83.77%	13.70%	1.48%	0.74%	0.32%	1.2
Ndofja e ujit	84.19%	12.96%	2.32%	0.42%	0.11%	1.19
Ndofja e tokës	74.08%	20.86%	4.00%	0.84%	0.21%	1.32
Ndofja nga mbetjet interte	61.01%	30.35%	7.17%	1.26%	0.21%	1.49
Djegja e lëzave të plerave	69.23%	22.44%	6.01%	1.90%	0.42%	1.42
Prerjadjegja e pyjeve dhe drurëve frutorë	84.51%	12.12%	2.74%	0.42%	0.21%	1.2
Gjithsej	72.21	20.95	5.24	1.28	0.32	1.37

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Sa të shqetësuar jeni për problemet e mëposhtme mjedisore që çënojnë sigurinë në mjedis?



16. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa të rrezikuar ndihen nga krimet mjedisore në zonën ku banojnë?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Shumë të rrezikuar	290
Te rrezikuar	368
Mesatarisht	207
Pak të rrezikuar	67
Aspak të rrezikuar	15
Gjithsej	947



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme, gjejmë se:


- “shumë të rrezikuar”, ndjehen 30.62% e të anketuarve;
- “të rrezikuar ndjehen”, 38.86% e të anketuarve;
- “mesatarisht të rrezikuar”, ndjehen 21.86% e të anketuarve;

- “pak të rrezikuar ndjehen”, ndjehen 7.08% e të anketuarve;
- “aspak të rrezikuar” ndjehen 1.58% të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të arrijmë në përfundimin se 91.34% e të anketuarve ndjehen shumë të rrezikuar, të rrezikuar dhe mesatarisht të rrezikuar nga krimet mjedisore në zonën ku banojnë. Pra, krimet mjedisore i perceptojnë si rrezik në zonën e tyre të banimit mbi 90% e të anketuarve: shifër kjo shumë e lartë. Aspak të rrezikuar ndjehen vetëm 1.58% e të anketuarve.

17. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa shpesh i veçoni mbeturinat, para se t’i hidhni në koshat e rrugës?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Asnjëherë	282
Një herë në kaq kohë	169
Gjysmën e kohës	131
Shumicën e kohës	246
Gjithmonë	116
Gjithsej	944




Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme: “Sa shpesh i veçoni mbeturinat, para se t’i hidhni në koshat e rrugës”, gjejmë se:

- “gjithmonë”, i veçojnë mbeturina 12% e të anketuarve.
- “asnjëherë”, 30% e të anketuarve;
- “shumicën e kohës”, 26% e të anketuarve;
- “gjysmën e kohës”, 14% e të anketuarve;
- “një herë në kaq kohë”, 18% e të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se, ndonëse 91.34% e të anketuarve ndjehen shumë të rrezikuar, të rrezikuar dhe mesatarisht të rrezikuar nga krimet mjedisore në zonën ku banojnë, vetëm 12% e tyre kryejnë veprime me ndikime në mjedis siç është veçimi i mbeturinave. Ndërkohë, 58% e të anketuarve janë të angazhuar pjesërisht në këtë veprimtari në shumicën e kohës, gjysmën e kohës apo ndonjëherë. Ndërsa 30% e të anketuarve nuk janë të angazhuar asnjëherë në këtë veprimtari në mbrojtje të mjedisit. Për këtë rekomandohet ndërgjegjësimi qytetar për të siguruar mbështetjen e tyre më mbrojtje të mjedisit.

18. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa të interesuar jeni për ruajtjen e mjedisit?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
1 - Shumë të interesuar	697
2 - Të interesuar	195
3 - Mesatarisht të interesuar	40
4 - Pak të interesuar	10
5 - Aspak të interesuar	2
Gjithsej	944




Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se sa të interesuar jeni për ruajtjen e mjedisit, gjejmë se:

- “shumë të interesuar” janë 73.83% e të anketuarve;
- “të interesuar” janë 20.66% e të anketuarve;
- “mesatarisht të interesuar”, janë 4.24% e të interesuarve;
- “pak të interesuar”, janë 1.06% e të anketuarve;
- “aspak të interesuar”, janë 0.21% e të anketuarve.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 94.49% e të anketuarve janë “shumë të interesuar” dhe “të interesuar” për ruajtjen e mjedisit. Ndërkohë “pak” dhe “aspak të interesuar” për këtë çështje janë vetëm 1.27% e të anketuarve. Kjo flet për një ndjeshmëri të madhe të anketuarve për ruajtjen e mjedisit.

19. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa gjasa ka që ju të ndryshoni stilin e jetesës për t’iu përshtatur më mirë mjedisit?”

Statistika	Gjithsej
Përgjigjet	j
Gjithmone	274
Shumë gjasa	467
Deri diku	166
Pak gjasa	22
Aspak gjasa	13
Gjithsej	942



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa gjasa ka që ju të ndryshoni stilin e jetesës për t’iu përshtatur më mirë mjedisit?”, gjejmë se:

- 29.09% e të anketuarve kanë gjithmonë gjasa për të ndryshuar stilin e jetesës për tu përshtatur më mirë me mjedisin;

- 49.58% e të anketuarve kanë shumë gjasa;

- 17.62% e të anketuarve kanë disa gjasa;

- 2.34% e të anketuarve kanë pak gjasa;


- 1.38% e të anketuarve nuk kanë aspak gjasa për të ndryshuar stilin e jetesës.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 78.67% e të anketuarve kanë gjithmonë gjasa ose shumë gjasa për të ndryshuar stilin e jetesës për t’u përshtatur më mirë me mjedisin, ndërsa 17.62% e tyre nuk janë plotësisht të sigurt për këtë (kanë disa gjasa). Vetëm 3.72% e të anketuarve kanë pak gjasa ose aspak gjasa për këtë çështje.

Pranimi nga pjesa më e madhe e të anketuarve për ndryshimin e stilit të jetesës për t’u përshtatur më mirë me mjedisin tregon për një ndjeshmëri të madhe të të anketuarve ndaj çështjeve mjedisore dhe gatishmërinë e tyre për të sakrifikuar deri në ndryshimin e stilit të jetesës.

20. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa gjasa ka që ju të blini një produkt më të shtrenjtë, vetëm që është në të mirë të mjedisit?”

Statitika	
Përgjigjet	Gjithsej
Gjithmonë	168
Shumë gjasa	305
Shumë gjasa, por nuk kam mundësi ekonomike	275
Deri diku	134
Pak gjasa	45
Aspak gjasa	14
Gjithsej	941



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme, gjejmë se:

- 17.85% e të anketuarve kanë gjithmonë gjasa për të blerë një produkt më të shtrenjtë, vetëm që është në të mirë të mjedisit;

- 32.41% kanë shumë gjasa;

- 29.22% kanë shumë gjasa por nuk kanë mundësi ekonomike;

- 14.24% kanë deri diku gjasa për këtë çështje;

- 4.78% kanë pak gjasa;


- dhe 1.49% nuk kanë aspak gjasa për të blerë një produkt më të shtrenjtë, vetëm që është në të mirë të mjedisit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 50.26% e të

anketuarve kanë gjithmonë dhe shumë gjasa për të blerë një produkt më të shtrenjtë, vetëm që është në të mirë të mjedisit. Ndërsa 29.22% kanë shumë gjasa, por nuk kanë mundësi ekonomike për ta bërë këtë. Kjo tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve (79.48%) janë gati të “sakrifikojnë” financiarisht në të mirë të mjedisit.

21. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit, sa shpesh mendoni se ata kanë sukses?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Asnjehere	56
Rralle	423
Shpesh	324
Shumë shpesh	136
Gjithsej	939
Gjithsej	100%




Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit, sa shpesh mendoni se ata kanë sukses, gjejmë se sipas të anketuarve mundësitë për sukses janë:

- “shumë shpesh”, 14.48%;
- “shpesh”, 34.5%;
- “rrallë”, 45.04%;
- “asnjëherë”, 5.56%.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 48.98% e të anketuarve mendojnë se mundësitë për sukses janë “shumë shpesh” dhe “shpesh”. Për 45.04% të të anketuarve mundësitë për sukses janë rrallë. Vetëm për 5.45% të të anketuarve nuk ka asnjëherë mundësi për sukses. Duket sikur ka një ndarje thuajse të barabartë, midis të anketuarve optimistë dhe pesimistë, për mundësinë e suksesit, kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit. Për këtë, rekomandohet gjetja e formave dhe metodave për zvogëlimin e numrit të pesimistëve, për pamundësinë e suksesit kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit.

22. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa gjasa ka që të rekomandoni një mik apo një koleg për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
1 - Aspak gjasa	61
2- Pak gjasa	98
3- Deri diku	181
4- Shumë gjasa	159
5 - Gjithmonë	438
Gjithsej	937



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme, gjejmë se:

- 46.74% e të anketuarve, kanë “gjithmonë” gjasa që të rekomandojnë një mik apo një koleg, për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore;

- 16.97% e të anketuarve, kanë “shumë gjasa”;
- 19.32% e të anketuarve, kanë “deri diku gjasa”;
- 10.46% e të anketuarve, kanë “pak gjasa”;
- 6.51% e të anketuarve, kanë “aspak gjasa” që të rekomandojnë një mik apo një koleg për këtë problem.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se 63.97% e të anketuarve, kanë “gjithmonë” dhe “shumë” gjasa që të rekomandojnë një mik apo një koleg, për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore. Kjo mënyrë sjelljeje e pjesës më të madhe të së anketuarve, të bën optimist, për zgjerimin e komunitetit që mendon dhe punon për reduktimin e krimeve mjedisore. Ndërkohë, 29.78% e të anketuarve kanë “pak gjasa” dhe “deri diku gjasa”, për këtë problem. Vetëm 6.51% e të anketuarve, nuk kanë “fare gjasa” që të rekomandojnë një mik apo një koleg, për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore. Rekomandohet, që me programe të veçanta, të punohet që këto dy kategori të përfshihen në komunitetin e atyre që mendojnë dhe punojnë për reduktimin e krimeve mjedisore.


23. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Si ndikon ndotja e mjedisit në shëndetin dhe sigurinë tuaj personale?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
1 - Nuk ndikon	12
2- Pothuajse nuk ndikon	12
3- Ndikon disi	97
4- Ndikon shumë	191
5 - Ndikon jashtëzakonisht shumë	622
Gjithsej	934

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve lidhur me pyetjen: “Si ndikon ndotja e mjedisit në shëndetin dhe sigurinë tuaj personale?”, gjejmë se:

- për 66.6% të të anketuarve, ndotja e mjedisit ndikon jashtëzakonisht shumë në shëndetin dhe sigurinë e tyre personale;
- për 20.45% të të anketuarve, ndotja e mjedisit ndikon shumë;
- për 10.39% të të anketuarve, ndotja e mjedisit ndikon disi;
- për 1.28% të të anketuarve, ndotja e mjedisit pothuajse nuk ndikon;
- për 1.28% të të anketuarve, ndotja e mjedisit nuk ndikon.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 87.05% e të anketuarve perceptojnë se ndotja e mjedisit ndikon jashtëzakonisht shumë dhe shumë në shëndetin dhe sigurinë e tyre personale. Për 10.39% të anketuarve ndotja e mjedisit ndikon vetëm disi. Ndërsa pjesa më e vogël e të anketuarve (2.56%) përgjigjen se ndotja e mjedisit pothuajse nuk ndikon ose nuk ndikon fare. Pra, pjesa më e madhe e të anketuarve e perceptojnë ndotjen e mjedisit si kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e tyre personale.


24. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Cili është autoriteti përgjegjës për parandalimin e krimeve mjedisore?”

Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen se kush është autoriteti përgjegjës për parandalimin e krimeve mjedisore, gjejmë se:

- 49.09% e të anketuarve, mendojnë se autoriteti përgjegjës për parandalimin e krimeve mjedisore është Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave;
- 19.59% mendojnë se është qeveria;
- 10.44% mendojnë se janë agjencitë rajonale të mjedisit;
- 7.64% mendojnë se është komuniteti;
- 2.8% mendojnë për Policinë e Shtetit si autoritet përgjegjës;
- 2.26% mendojnë për organizatat mjedisore.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se pjesa më e madhe e të anketuarve (49.09%), mendojnë se autoriteti përgjegjës për parandalimin e


Statistika	Gjithsëj
Përgjigjet	
Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave	456
Bashkia	57
Policia e Shtetit	26
Ushtria	8
Agjencia Rajonale e Mjedisit	97
Organizatat mjedisore	21
Qeveria	182
Komuniteti	71
Të tjera	11
Gjithsëj	929



krimeve mjedisore është Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave dhe 19.59% e tyre mendojnë se është qeveria. Ndërkohë, 10.44% identifikojnë agjencitë rajonale të mjedisit, 7.64% mendojnë se është e komuniteti. Vetëm 2.28% mendojnë se autoriteti përgjegjës është Policia e Shtetit. Në një farë mënyre, të anketuarit duket se perceptojnë si autoritet përgjegjës për parandalimin e krimeve mjedisore më shumë Inspektoriatin Shtetëror të Pyjeve dhe Kullotave, se sa ekzekutivin.

25. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Te cili nga institucionet keni më shumë besim se mund të ndikojë në parandalimin e krimeve mjedisore dhe të ruajë sigurinë në mjedis?”

Statistika	Gjithsëj
Përgjigjet	
Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave	190
Bashkia	58
Policia e Shtetit	199
Ushtria	9
Agjencia Rajonale e Mjedisit	56
Organizatat mjedisore	107
Qeveria	162
Komuniteti	119
Te tjera	28
Gjithsëj	928



Nga studimi i përgjigjeve të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme gjëjmë se:

- 21.44% e të anketuarve, kanë më shumë besim tek Policia e Shtetit;
- 20.47% kanë më shumë besim tek Inspektoriati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave;
- 17.46% kanë më shumë besim tek qeveria;
- 12.82% tek komuniteti;
- 11.53% tek organizatat mjedisore;
- 6.25% tek bashkia;

AKADEMIA E SIGURISË


Konferencë shkencore ndërkombëtare:
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

- 6.03% tek agjencitë rajonale të mjedisit.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se të anketuarit kanë më shumë besim, se institucioni që mund të ndikojë në parandalimin e krimeve mjedisore dhe të ruajë sigurinë në mjedis në rend zbritës janë Policia e Shtetit (21.44%); Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave (20.47%); qeveria (17.46%); komuniteti (12.82%); organizatat mjedisore (11.53%); bashkia (6.25%) dhe agjencitë rajonale të mjedisit (6.03%). Pra, sipas përgjigjeve të së anketuarve, institucionet më të besuara në parandalimin e krimeve mjedisore dhe ruajtjen e sigurisë në mjedis janë Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave dhe qeveria.

26. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “A mendojnë që Policia e Shtetit po punon për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Jo, nuk po punojnë mjaftueshëm	266
Jo, por mund të bëjnë më shumë se kaq	217
Po, po punojnë në nivele mesatare	322
Po, po punojnë maksimalisht	123
Gjithsej	928



Nga studimi i përgjigjeve të të anketuarve lidhur me pyetjen e mësipërme, gjejmë se:


- 13.25% e të anketuarve, mendojnë se Policia e Shtetit po punon maksimalisht për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore;

- 34.7% mendojnë se Policia e Shtetit po punon për në nivele mesatare;
- 23.38% mendojnë se, jo, nuk punojnë, por mund të bëjnë më shumë se kaq;
- 28.66% e të anketuarve mendon se Policia e Shtetit nuk po punon mjaftueshëm për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se 47.95% e të anketuarve mendojnë se Policia e Shtetit po punon në nivele mesatare dhe maksimalisht për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore. Ndërkohë që 52.04% mendojnë se nuk po punon mjaftueshëm dhe mund të bëjë më shumë se kaq. Pra, ndonëse Policia e Shtetit, në përgjigjen e pyetjes së mëparshme, identifikohet si institucion më i besueshëm që mund të ndikojë në parandalimin e krimeve mjedisore dhe të ruajë sigurinë në mjedis, pak më shumë se gjysma e të anketuarve nuk janë të kënaqur me punën e policisë në këtë fushë. Për këtë, rekomandohet që, jo vetëm të përmirësohet puna e policisë në këtë fushë, por të rritet edhe besueshmëria e komunitetit për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

27. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “A keni denoncuar ndonjëherë ndonjë krim mjedisor të kryer në lagjen ku banoni?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
Po	268
Jo	567
Nuk e di	93
Gjithsej	928




Nga studimi i përgjigjeve të së anketuarve, lidhur me pyetjen se a kanë denoncuar ndonjëherë ndonjë krim mjedisor të kryer në lagjen ku banojnë, gjejmë se:

- 61% e të anketuarve, nuk kanë denoncuar ndonjëherë ndonjë krim mjedisor;
- 29% përgjigjen se kanë denoncuar raste të krimit mjedisor;
- 10% përgjigjen se nuk e dinë.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se, pavarësisht ndjeshmërisë së madhe ndaj krimeve mjedisore, e evidentuar kjo gjatë këtij anketimi, pjesa më e madhe e të anketuarve (61%) nuk kanë denoncuar ndonjë rast të krimit mjedisor në lagjen ku banojnë, ndonëse ndjehen vazhdimisht të rrezikuar prej tij. Megjithatë, fakti që 29% kanë denoncuar raste të tilla, është një tregues i mirë që flet për rritjen e kulturës së reagimit qytetar kundër krimit mjedisor. Rekomandohet që, me programe të veçanta, të nxitet kultura e mospajtimit, reagimit dhe denoncimit qytetar kundër krimit mjedisor në zonat e tyre të banimit.

28. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: “Sa shpesh organizon Policia e Shtetit takime për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore në lagjen ku ju banoni?”

Statistika	
Përgjigjet	Gjithsej
1 - Shumë shpesh	25
2 - Shpesh	57
3 - Mesatarisht	99
4 - Ndonjëherë	194
5 - Asnjëherë	552
Gjithsej	927



AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:
 « Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »

Nga studimi i përgjigjeve të së anketuarve, lidhur me pyetjen e mësipërme, gjejmë se:

- 59.55% e të anketuarve shprehen se Policia e Shtetit nuk organizon asnjëherë takime për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore në lagjen ku ata banojnë;

- 20.93% përgjigjen se policia organizon ndonjëherë takime të tilla;

- 10.68% e të anketuarve mendojnë se policia organizon mesatarisht takime të tilla;

- për 6.15% të të anketuarve, policia organizon shpesh takime të tilla;

- për 2.7% të të anketuarve, policia organizon shumë shpesh takime të tilla.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme, mund të nxjerrim përfundimin se, për pjesën më të madhe të të anketuarve (80.43%), Policia e Shtetit nuk organizon asnjëherë ose organizon ndonjëherë, takime për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore në lagjen ku ata banojnë. Ndërkohë, 10% e tyre mendojnë se policia organizon mesatarisht, takime të tilla. Vetëm për 8.85% të të anketuarve, policia organizon shpesh ose shumë shpesh takime të tilla. Duke pasur parasysh përgjigjet e mëparshme për policinë, si institucioni më i besueshëm në këtë fushë, si dhe pretendimet për një angazhim më të madh të policisë për çështjet e sigurisë mjedisore, është i rekomandueshëm një bashkëpunim më i madh i saj me komunitetin, për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore.

29. Përgjigjet e të anketuarve lidhur me pyetjen: "A mendoni se subjektet e mëposhtme po ndërmarrin iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore?"

Nga studimi i përgjigjeve të së anketuarve, lidhur me pyetjen se a mendojnë se subjektet e mëposhtme po ndërmarrin iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore, gjejmë se nga 5484 përgjigje për pyetjen e mësipërme:

- 26.73% e përgjigjeve mbështesin alternativën që subjektet e listuara më sipër (institucionet përgjegjëse shtetërore, Policia e Shtetit, grupet e mjedisit, organizatat ndërkombëtare kompanitë e biznesit dhe qytetarët), nuk po ndërmarrin iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore;

- 37.86% e përgjigjeve mbështesin alternativën se subjektet ndërmarrin iniciativa të tilla një herë në kaq kohë;

- 16.25% e përgjigjeve mbështesin alternativën se subjektet marrin nisma të tilla në gjysmën e kohës;

- 13.04% e përgjigjeve mbështesin alternativën se subjektet marrin nisma të tilla shumicën e kohës;

- 6.13% e përgjigjeve mbështesin alternativën se subjektet gjithmonë marrin nisma të tilla.

Nga analiza e gjetjeve të mësipërme mund të nxjerrim përfundimin se pjesa më e madhe e përgjigjeve (64.59%) të së anketuarve mbështesin alternativën që institucionet përgjegjëse shtetërore, Policia e Shtetit, grupet e mjedisit, organizatat ndërkombëtare kompanitë e biznesit dhe qytetarët, nuk kanë ndërmarrë "asnjëherë" ose kanë ndërmarrë "një herë në kaq kohë" iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore. Ndërkohë që, 35.42% e përgjigjeve mbështesin alternativën që subjektet ndërmarrin nisma të tilla "gjysmën e kohës", "shumicën e kohës" apo "gjithmonë". Për sa më sipër, rekomandohet ridimensionimi i punës i subjekteve të përmendura, për të


përmirësuar sigurinë mjedisore dhe për të parandaluar krimet mjedisore.

A mendoni se subjektet e mëposhtme po ndër marrin iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore?									
Statistika	Asnjehere	Një herë në çdo kohë	Gjysmën e kohës	Shumicën e kohës	Gjithmonë	Gjithsej	Mesatarisht		
Institucionet përgjegjëse shtetërore	189	433	149	107	36	914	2.31		
Policia e Shtetit	271	313	151	121	58	914	2.32		
Kompanitë e biznesit	510	288	76	26	14	914	1.63		
Grupet e mjedisit	111	341	186	197	79	914	2.77		
Organizatat ndërkombëtare	105	304	186	209	110	914	2.91		
Oryetarët	280	397	143	55	39	914	2.1		
Gjithsej	1466	2076	891	715	336	6484	2.34		
Përqindje									
Institucionet përgjegjëse shtetërore	20.68%	47.37%	16.30%	11.71%	3.94%	100%	2.31		
Policia e Shtetit	29.65%	34.25%	16.52%	13.24%	6.35%	100%	2.32		
Kompanitë e biznesit	55.80%	31.51%	8.32%	2.84%	1.53%	100%	1.63		
Grupet e mjedisit	12.14%	37.31%	20.35%	21.55%	8.64%	100%	2.77		
Organizatat ndërkombëtare	11.49%	33.26%	20.35%	22.87%	12.04%	100%	2.91		
Oryetarët	30.63%	43.44%	15.65%	6.02%	4.27%	100%	2.1		
Gjithsej	26.73	37.86	16.25	13.04	6.13	100%	2.34		

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare »



4.4. Përfundimet e analizimit e vlerësimit të krimit mjedisor në vendin tonë, bazuar te treguesit subjektivë, perceptimet e qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe në nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë çështjet mjedisore në vendin tonë, të siguruara nëpërmjet një anketimi të gjerë, realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë

Në përfundim të analizimit e vlerësimit të krimit mjedisor në vendin tonë, bazuar te treguesit subjektivë, perceptimet e qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe në nivelin e kënaqësisë dhe vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë çështjet mjedisore në vendin tonë, të siguruara nëpërmjet një anketimi të gjerë, realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë, është arritur në këto përfundime:

- Perceptojnë si burimin më të madh, të rrezikut për jetën e tyre, aksidentet automobilistike (39.06%), krimet mjedisore (26.93%) dhe më pak nga vrasjet (14.25%), vjedhjet (8.43%) dhe krimet kibernetike (6.54%). Pra, nga krimi mjedisor, të anketuarit ndjejnë rrezik më shumë se sa nga vrasjet dhe vjedhjet.

- Në pjesën më të madhe të tyre (78.1%) kanë *disi, mjaftueshëm* dhe *shumë njohuri* (24.92% + 43.79% + 9.39% = 78.1%) në fushën e krimit mjedisor dhe sigurisë mjedisore. Kjo mund të shpjegohet me atë që, pjesa më e madhe e tyre (79.91%) janë me arsim të lartë, me “master” dhe grada e tituj shkencorë. Gjithashtu, kjo na bën të besojmë në nivelin e përgjigjeve të tyre në këtë anketim. Ndërkohë, nuk është e vogël pjesa e të anketuarve (21.89%) të cilët nuk kanë *aspak* apo kanë *pak* njohuri në këtë fushë.

- Pjesa më e madhe e përgjigjeve të tyre (85.39%) mbështesin në masën “dakord”

dhe “shumë dakord” alternativat se krimet mjedisore paraqesin rrezikshmëri të lartë në gjithë botën, janë dukuri në rritje, janë dukuri për të cilën janë hartuar ligje të forta në Shqipëri, po shkaktojnë zhdukjen e florës dhe të faunës, janë përgjegjësi e qeverisë dhe shtetit, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve, reduktohen në qoftë se mbeturinat ndahen në të thata, të lëngshme dhe të riciklueshme, po shkaktojnë ngrohjen globale dhe po shkaktojnë ndryshimin e temperaturave.

- Ndërkohë, alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve”, ka gjetur mbështetjen në masën “dakord” dhe “shumë dakord” të shumicës së përgjigjeve (96.27%) se alternativa që krimet mjedisore “janë përgjegjësi e qeverisë dhe shtetit” (81.77%). Pra, të anketuarit mbështesin një angazhim më të madh qytetar në këtë fushë.

- Perceptojnë me rend zbritës si faktorë që ndikojnë më shumë në ndotjen e ajrit aktivitetet industriale (36.29%); shpyllëzimin (16.42%); trenat, anijet dhe automjetet (14.02%); urbanizimin e shpejtë (11.27%) dhe konsumin e plastikës (8.96%).

- Ndonëse përbëjnë një kampion me arsim të lartë, me “master” dhe grada e tituj shkencorë në masën 79.91%, në një pjesë të madhe “nuk janë dijeni” ose “janë deri diku në dijeni” në masën 68.07% (13.71% + 56.36%) të politikave globale ose iniciativave të marra nga organizata të ndryshme që përmirësojnë sigurinë mjedisore nga ndotja.

- Gjithashtu vetëm 22% e tyre mendojnë se në vendin tonë *aplikohen* praktika në bashkëpunim me organizata vendase e të huaja për parandalimin e reduktimin e krimeve mjedisore. Ndërsa për pjesën me të madhe të së anketuarve (45%), në vendin tonë praktika të tilla aplikohen *deri diku*.

- Për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore mbështesin *mjaftueshëm* dhe *shumë*, me rend zbritës, investimet në fushën e edukimit nëpër gjimnaze për parandalimin e krimit mjedisor (83.25%); në fushën e ligjeve dhe politikave mjedisore (80.16%); në fushën e ndikimit ekonomik të krimit mjedisor (78.15%); në edukimin në universitete për parandalimin e krimit mjedisor (77.29%); investimet në fushatat e takimet ndërgjegjësuese me publikun e gjere (75.19%) dhe në trajnimet/specializimet e posaçme për parandalimin e krimit mjedisor (73.57%).

- Në masën 78.56% mendojnë se në vendin tonë *nuk po shpenzohet shumë kohë*, para dhe burime dhe *nuk po punohet mjaftueshëm* për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit. Ndërkohë, vetëm 21.43% e të anketuarve mendojnë se në vendin tonë po punohet në nivele *mesatare* e *maksimalisht* për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit.

- Në pjesën më të madhe të tyre (77.54%), *vlerësojnë, si çështjen më të rëndësishme* që ka nevojë për t’u zgjidhur (13.5%), apo çështje të rëndësishme ashtu siç janë edhe disa çështje të tjera (64.04%), alternativën se veprimtaria për trajtimin e korrigjimin e ndotjes së mjedisit dhe sigurisë mjedisore duhet të jetë *aspekti më i rëndësishëm* për t’u kujdesur në vendin tonë. Kjo tregon për një ndjeshmëri të madhe për çështjet e ndotjes mjedisit dhe sigurisë mjedisore. Vetëm për 7.09% të të anketuarve, *ka çështje më të mëdha për t’u zgjidhur se sa kjo e ndotjes së mjedisit dhe e sigurisë mjedisore*.

- Pjesa më e madhe e tyre kanë marrë më shumë informacion për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor nga media dhe rrjetet sociale si televizioni (67.32%); interneti (58.54%); revistat shkencore e artikujt shkencor (8.09%) dhe gazetat (2.86%). Pas tyre renditen informacioni i marrë nga institucionet, si shkollat e universitetet (8.98%); Policia e Shtetit (5.23%) dhe institucionet shtetërore (2.57%). Një rol të rëndësishëm në shpërndarjen e informacionit në këtë fushë kanë luajtur dhe grupet për mbrojtjen e

mjedisit (14.91%). Kjo tregon për një rol në rritje të medieve dhe rrjeteve sociale dhe një mundësi për t'u shfrytëzuar më shumë në të ardhmen për të ndërgjegjësuar njerëzit për çështjet mjedisore. Ndërkohë, duhet ridimensionuar roli i institucioneve arsimore e shtetërore në dhënien e informacionit për ndotjen e mjedisit dhe krimin mjedisor pasi duket se veprimtaria e tyre në këtë fushë, është dukshëm më pak ndikuese se e grupeve për mbrojtjen e mjedisit.

- Mbështesin si burim *shumë të besueshëm*, në të cilin marrin informacion për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, familjen (61.11%); artikujt dhe revistat shkencore (54.65%); medien (51.82%); Policinë e Shtetit (45.45%); rrjetet sociale (45.25%); institucionet shtetërore (41.31%) dhe miqtë (37.68%). Nga përgjigjet e tyre rezultojnë se familja, mediet dhe botimet shkencore janë burime *më të besueshme* se institucionet shtetërore. Këto institucione (shtetërore) kanë dhe nivelin më të lartë (10.75% dhe 8.99%) të përgjigjeve si burime aspak të besueshme për informacionet për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit.

- Në pjesën më të madhe të tyre (69%) *nuk kanë dijeni* (14%) ose kanë *deri diku dijeni* (55%) lidhur me ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit, përkundrajt 28% të së cilëve, që përgjigjen se *kanë dijeni*. Nisur nga niveli i lartë arsimor, i kampionit të anketuar, mund të arrihet në përfundimin se shifra prej 69% e atyre që *nuk kanë dijeni* apo kanë *deri diku dijeni* për këto ligje, është relativisht i lartë. Për këtë, rekomandohet zhvillimi i njohurive ligjore për çështjet e sigurisë mjedisore.

- Në pjesën më të madhe të tyre (86.75%) mendojnë se ligjet për sigurinë mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit duhet të jenë më shumë strikte e të rrepta. Ndërsa vetëm 8.59% e tyre ose dhjetë herë më pak, mbështesin *status quo*-në e ligjeve në këtë fushë apo dhe zbutjen e tyre. Nga kjo, mund të arrijmë në përfundimin se ashpërsimi i legjislacionit në fushën e krimeve mjedisore është kërkesë dhe gëzon mbështetje të gjerë.

- Në pjesën më të madhe të tyre (66.27%) ndjehen *shumë të shqetësuar* nga krimet mjedisore dhe 27.3% të shqetësuar. Vetëm 1.02% ndjehen *të pashqetësuar* e 5.13% *neutral*. Nga format e veçanta të krimit mjedisor, të anketuarit ndjehen *shumë të shqetësuar* nga ndotja e ajrit (78.17%); degradimi i mjedisit (75.88%); ndikimi i ndotjes së mjedisit në sistemin nervor të njeriut (73.6%); ngushtimi i burimeve të ujit të pijshëm (67.78%); zhdukja e kafshëve të rrezikuara 51.77% dhe rritja e temperaturës 50.42%.

- Në pjesën më të madhe të tyre (72.21%) ndjehen “shumë të shqetësuar” se problemet mjedisore të renditur më poshtë cenojnë sigurinë në mjedis: ndërkohë 20.95% ndjehen “të shqetësuar” e 5.24% ndjehen “mesatarisht të shqetësuar”. Ndërsa, sipas renditjes së problemeve mjedisore që cenojnë sigurinë në mjedis, të anketuarit janë shumë të shqetësuar nga prerja e pyjeve dhe drurëve frutorë (84.51%); ndotja e ujit (84.19%); ndotja e ajrit (83.77%); ndotja e tokës (74.08%); djegia e kazanëve të plehrave (69.23%); ndotja nga mbetjet inerte (61.01%) dhe ndotja akustike (48.68%).

- Në pjesën më të madhe të tyre (91.34%) ndjehen “shumë të rrezikuar”, “të rrezikuar” dhe “mesatarisht të rrezikuar” nga krimet mjedisore në zonën ku banojnë. Pra, krimet mjedisore i perceptojnë si rrezik në zonën e tyre të banimit mbi 90% e të anketuarve, shifër kjo shumë e lartë. *Aspak të rrezikuar* ndjehen vetëm 1.58% e të anketuarve.

- Ndonëse 91.34% e tyre ndjehen “shumë të rrezikuar”, “të rrezikuar” dhe “mesatarisht të rrezikuar” nga krimet mjedisore në zonën ku banojnë, vetëm 12% e tyre kryejnë veprime me ndikime pozitive në mjedis siç është veçimi i mbeturinave.

Ndërkohë 58% e të anketuarve janë të angazhuar pjesërisht në këtë veprimtari në shumicën e kohës, gjysmën e kohës apo ndonjëherë. Ndërsa 30% e të anketuarve nuk janë të angazhuar asnjëherë në këtë veprimtari në mbrojtje të mjedisit. Për këtë, rekomandohet ndërgjegjësimi qytetar për të siguruar mbështetjen e tyre në mbrojtje të mjedisit.

- Në pjesën më të madhe të tyre (94.49%) janë “shumë të interesuar” dhe “të interesuar” për ruajtjen e mjedisit. Ndërkohë *pak* dhe *aspak të interesuar* për këtë çështje, janë vetëm 1.27% e tyre. Kjo flet për një ndjeshmëri të madhe të së anketuarve për ruajtjen e mjedisit.

- Në pjesën më të madhe të tyre (78.67%) kanë “gjithmonë gjasa” ose “shumë gjasa” për të ndryshuar stilin e jetesës për tu përshtatur me mirë me mjedisin, ndërsa 17.62% e tyre nuk janë plotësisht të sigurt për këtë (kanë disa gjasa). Vetëm 3.72% e të anketuarve kanë “pak gjasa” ose “aspak gjasa” për këtë çështje. Pranimi nga pjesa më e madhe e të anketuarve për ndryshimin e stilit të jetesës për t’u përshtatur më mirë me mjedisin tregon për një ndjeshmëri të madhe të së anketuarve dhe gatishmëri “për të sakrifikuar” ndaj çështjeve mjedisore.

- Në masën 50.26% të tyre kanë “gjithmonë gjasa” dhe “shumë gjasa” për të blerë një produkt më të shtrenjtë, vetëm që është në të mirë të mjedisit. Ndërsa 29.22% e tyre kanë “shumë gjasa”, por nuk kanë mundësi ekonomike për ta bërë këtë. Kjo tregon se më shumë se gjysma e të anketuarve janë gati “të sakrifikojnë” edhe financiarisht në të mirë të mjedisit.

- Në masën 48.98% të tyre mendojnë se mundësitë për sukses kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit janë shumë shpeshta dhe të shpeshta. Për 45.04% të tyre mundësitë për sukses janë rrallë. Vetëm për 5.45% të anketuarve nuk ka asnjëherë mundësi për sukses. Duket sikur ka një ndarje thuajse të barabartë, midis të anketuarve optimistë dhe atyre pesimistë, për mundësinë e suksesit, kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit. Për këtë, rekomandohet gjetja e formave dhe metodave për zvogëlimin e numrit të pesimistëve, për pamundësinë e suksesit, kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit.

- Në pjesën më të madhe të tyre (63.97%) kanë “gjithmonë gjasa” dhe “shumë gjasa” që të rekomandojnë një mik apo një koleg për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore. Kjo mënyrë sjelljeje e pjesës më të madhe të së anketuarve, të bën optimist për zgjerimin e komunitetit që mendon dhe punon për reduktimin e krimeve mjedisore. Ndërkohë 29.78% e të anketuarve kanë “pak gjasa” dhe “deri diku gjasa” për këtë problem. Vetëm 6.51% e të anketuarve nuk kanë *fare gjasa* që të rekomandojnë një mik apo një koleg për të promovuar aktivitete që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore. Rekomandohet që me programe të veçanta të investohet që këto dy kategori të përfshihen në komunitetin e atyre që mendojnë dhe punojnë për reduktimin e krimeve mjedisore.

- Në pjesën më të madhe të tyre (87.05%) perceptojnë se ndotja e mjedisit ndikon “jashtëzakonisht shumë” dhe “shumë” në shëndetin dhe sigurinë e tyre personale. Për 10.39% të anketuarve ndotja e mjedisit ndikon vetëm *disi*. Ndërsa për pjesën më të anketuarve (2.56%) ndotja e mjedisit pothuajse *nuk ndikon ose nuk ndikon fare*. Pra, pjesa më e madhe e të anketuarve e perceptojnë ndotjen e mjedisit si kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e tyre personale.

- Në pjesën më të madhe të tyre (49.09%) mendojnë se autoriteti përgjegjës për

parandalimin e krimeve mjedisore është Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave dhe 19.59% e tyre mendojnë se është qeveria. Ndërkohë, 10.44% identifikojnë agjencitë rajonale të mjedisit, 7.64% mendojnë se është komuniteti. Vetëm 2.28% mendojnë se autoriteti përgjegjës është Policia e Shtetit. Në një farë mënyre, të anketuarit duket se perceptojnë si autoritet përgjegjës për parandalimin e krimeve mjedisore, më shumë Inspektoratin Shtetëror të Pyjeve dhe Kullotave, se sa ekzekutivin.

- Kanë *më shumë besim* se institucioni që mund të ndikojë në parandalimin e krimeve mjedisore dhe të ruajë sigurinë në mjedis në rend zbritës, janë Policia e Shtetit (21.44%); Inspektorati Shtetëror i Pyjeve dhe Kullotave (20.47%); qeveria (17.46%); komuniteti (12.82%); organizatat mjedisore (11.53%); bashkia (6.25%) dhe agjencitë rajonale të mjedisit (6.03%). Pra, sipas përgjigjeve të anketuarve, institucionet më të besuara në parandalimin e krimeve mjedisore dhe ruajtjen e sigurisë në mjedis janë Policia e Shtetit, Inspektorati Shtetëror i Pyjeve e Kullotave dhe qeveria.

- 47.95% e tyre mendojnë se Policia e Shtetit po punon “në nivele mesatare” dhe “maksimalisht” për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore. Ndërkohë, që 52.04% mendojnë se “nuk po punon mjaftueshëm dhe mund të bëjë më shumë se kaq”. Pra, ndonëse Policia e Shtetit, e cila më parë identifikohet si institucioni më i besueshëm që mund të ndikojë në parandalimin e krimeve mjedisore dhe të ruajë sigurinë në mjedis, tashmë performanca e saj në fushën e mjedisit nuk kënaq më shumë se gjysmën e të anketuarve. Për këtë, rekomandohet që jo vetëm të përmirësohet puna e policisë në këtë fushë, por dhe të rritet besueshmëria e komunitetit për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

- Pavarësisht ndjeshmërisë së madhe ndaj krimeve mjedisore, e evidentuar kjo gjatë këtij anketimi, pjesa më e madhe e tyre (61%) nuk kanë denoncuar ndonjë rast të krimit mjedisor në lagjen ku banojnë. Por, fakti që 29% kanë denoncuar raste të tilla është një tregues i mirë që flet për rritjen e kulturës së reagimit qytetar kundër krimit mjedisor. Rekomandohet që me programe të veçanta të nxitet kultura e mospajtimit, reagimit dhe denoncimit qytetar kundër krimit mjedisor në zonat e tyre të banimit.

- Për pjesën më e madhe e tyre (80.43%), Policia e Shtetit nuk organizon asnjëherë ose organizon ndonjëherë takime për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore në lagjen ku ata banojnë. Ndërkohë 10% e tyre mendojnë se policia mesatarisht organizon takime të tilla. Vetëm për 8.85% e të anketuarve Policia organizon shpesh ose shumë shpesh takime të tilla. Duke pasur parasysh përgjigjet e mëparshme për policinë, si institucioni më i besueshëm në këtë fushë, si dhe pretendimet për një angazhim më të madh të policisë për çështjet e sigurisë mjedisore, është i rekomandueshëm një bashkëpunim më i madh i saj me komunitetin për diskutime rreth problemeve, krimeve e sigurisë mjedisore.

- Pjesa më e madhe e tyre (64.59%) mbështet alternativën që institucionet përgjegjëse shtetërore, Policia e Shtetit, kompanitë e biznesit, grupet e mjedisit, organizatat ndërkombëtare dhe qytetarët nuk kanë ndërmarrë “asnjëherë” ose kanë ndërmarrë “një herë në kaq kohë” iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe për të parandaluar krimet mjedisore. Ndërkohë që 35.42% e përgjigjeve, mbështesin alternativën që subjektet ndërmarrin nisma të tilla “gjysmën e kohës”, “shumicën e kohës” apo “gjithmonë”. Për sa sipër rekomandohet ridimensionimi i punës i subjekteve të përmendura më sipër për të ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore.

Në përfundim të analizimit e vlerësimit të krimit mjedisor në vendin tonë, bazuar te

treguesit subjektivë, perceptimet e qytetarëve për krimin dhe sigurinë mjedisore si dhe në nivelin e kënaqësisë dhe në vlerësimin e tyre për strukturat që menaxhojnë çështjet mjedisore në vendin tonë, të siguruar nëpërmjet një anketimi të gjerë, realizuar me shtresa dhe profesione të ndryshme të popullsisë, mund të arrijmë në konkluzionin e përgjithshëm se: të anketuarit ndjejnë rrezik më shumë nga krimi mjedisor se sa nga vrasjet dhe vjedhjet; në vendin tonë nuk po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime dhe nuk po punohet mjaftueshëm për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit; institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe për të parandaluar krimet mjedisore; ndonëse besojnë tek Policia e Shtetit, performanca e saj në fushën e mjedisit nuk kënaq më shumë se gjysmën e të anketuarve.

5. Krahasimi i gjetjeve dhe përfundimeve të analizave dhe vlerësimeve të krimeve e sigurisë mjedisore, bazuar te treguesit objektivë dhe subjektivë

Duke krahasuar gjetjet dhe përfundimet e analizave dhe vlerësimit të krimeve dhe sigurisë mjedisore të arritura:

- Mbi bazën e treguesve objektivë, pra të dhënave reale të administruara nga strukturat policore dhe ato të prokurorisë, për periudhën 2014-2018, u arrit në përfundimin e një mosfunksionim të zinxhirit investigim-hetim-gjykim apo polici-prokurori-gjykatë për ta bërë të suksesshme luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Mbi bazën e treguesve subjektivë, pra perceptimet e qytetarëve për krimin, sigurinë mjedisore dhe nivelin e kënaqësisë me punën e agjencive që menaxhojnë këtë drejtim, u arrit në përfundimin se: të anketuarit ndjejnë rrezik më shumë nga krimi mjedisor se sa nga vrasjet dhe vjedhjet; në vendin tonë nuk po shpenzohet shumë kohë, para dhe burime dhe nuk po punohet mjaftueshëm për të përmirësuar sigurinë mjedisore e për të zvogëluar ndotjen e mjedisit; institucionet përgjegjëse nuk kanë ndërmarrë iniciativa për të përmirësuar sigurinë mjedisore dhe parandaluar krimet mjedisore; ndonëse besojnë tek Policia e Shtetit, performanca e saj në fushën e mjedisit nuk kënaq më shumë se gjysmën e të anketuarve.

Arrijmë në përfundimin se ka ngjashmëri, në vija të përgjithshme, në shumë gjetje e përfundime të arritura gjatë analizimit dhe vlerësimit të luftës kundër krimin mjedisor, si duke u mbështetur te treguesit objektivë, ashtu edhe te ata subjektivë, pra perceptimeve të qytetarëve për krimin, sigurinë mjedisore dhe për nivelin e kënaqësisë prej punës së agjencive që menaxhojnë këtë drejtim. Kjo na mundëson që, përveç rekomandimeve specifike, të dhëna për secilin nivel analize, të formulojmë rekomandimet e përgjithshme në vijim.

6. Rekomandimet

Nisur nga gjetjet dhe përfundimet e arritura pas skanimit, analizimit, vlerësimit dhe identifikimit të problematikave që lidhen me krimin mjedisor dhe sigurinë mjedisore, si dhe të faktorëve ndikues, më qëllim përmirësimin të politikave në këtë fushë rekomandojmë si më poshtë:

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

- Përmirësimin e mendimit dhe veprimit strategjik për parandalimin e krimit mjedisor dhe rritjen e sigurisë mjedisore me synim përmirësimin e jetës së qytetarëve.

- Kuptimin dhe vlerësimin e sigurisë mjedisore si një e mirë publike dhe personale, pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare, e pranuar dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut.

- Konceptim në kornizën e sigurisë, të luftës kundër krimeve mjedisore në Shqipëri, çka do të thotë që në vijim të vazhdojnë të ndiqen me strategji, legjislacion, struktura e masa të veçanta shtesë.

- Integrimin e mbrojtjes së mjedisit në të gjithë sektorët, në mënyrë që të jetë pjesë e politikave dhe programeve të përgjithshme të zhvillimit të tyre.

- Riorganizimin e inspektorateve shtetërore që merren drejtpërdrejt apo që kanë lidhje me mbrojtjen e mjedisit, për të qenë më të frytshëm në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore për parandalimin e krimeve e rritjen e sigurisë mjedisore.

- Mbështetjen e politikave afatgjata për rritjen e nivelit arsimor të shtresave të ndryshme të popullsisë, sidomos të atyre në zonat rurale pasi 64% e autorëve të veprave penale në këtë fushë janë me arsim të fillor, të ulët e 9 vjeçar.

- Mbështetjen e politikave për mirëfunksionimin e zinxhirit investigim-hetim-gjykim apo polici-prokurori-gjykatë për ta bërë të suksesshme luftën për parandalimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Kompletimin e legjislacionit dhe harmonizimin me *aquis*të BE-së dhe plotësimin gradual të standardeve të BE-së, për luftën kundër krimeve mjedisore dhe çështjeve të sigurisë mjedisore.

- Përmirësimin e politikave për rritjen e përgjegjësisë qytetare për parandalimin dhe luftën kundër krimeve mjedisore, pasi 96.27% e të anketuarve mbështesin alternativën që krimet mjedisore janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

- Përmirësimin e politikave për rritjen e besueshmërisë së qytetarëve në informacionet që institucionet shtetërore japin për sigurinë mjedisore dhe ndotjen e mjedisit, pasi rezultoi që besueshmëria në informacione e tyre është në nivele të ulëta.

- Përmirësimin e politikave për nxitjen e kulturës së mospajtitimit, reagimit dhe denoncimit qytetar kundër krimit mjedisor në zonat e tyre të banimit pasi, nga anketimi, ka rezultuar që pjesa më e madhe e tyre nuk kanë denoncuar ndonjë rast të krimit mjedisor në zonën e tyre të banimit.

- Përmirësimin e politikave për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në çështjet mjedisore, pasi nga anketimi ka rezultuar se pjesa më e madhe e tyre, janë për mbështetjen dhe promovimin e aktiviteteve që do të ndihmojnë në reduktimin e krimeve mjedisore dhe ruajtjen e mjedisit, janë të gatshme të sakrifikojnë duke ndryshuar stilin e jetesës për t'u përshtatur më mirë me mjedisin (78.67%) apo dhe për të blerë më shtrenjtë një produkt vetëm se është në të mirë të mjedisit.

- Intensifikimin e punës për informimin e qytetarëve me legjislacionin mjedisor, pasi pjesa më e madhe e tyre (69%) nuk kanë dijeni ose kanë deri diku dijeni, lidhur me ligjet në Shqipëri për sigurinë mjedisore dhe reduktimin e ndotjeve të mjedisit.

- Përmirësimin e politikave për rritjen e shkallës së besimit në komunitet, lidhur me mundësitë për sukses kur njerëzit bashkohen për të zgjidhur problemet e sigurisë mjedisore dhe ndotjes së mjedisit, pasi nga anketimi ka rezultuar se më shumë se gjysma janë pesimistë në mundësinë e suksesit.

- Përmirësimin dhe intensifikimin e punës për parandalimin dhe goditjen e krimeve mjedisore pasi, pjesa më e madhe e të anketuarve, i perceptojnë krimet mjedisore si

rrezik për jetën e tyre më shumë se sa vrasjet dhe vjedhjet. Ata e vlerësojnë dhe si çështja më e rëndësishme apo çështje të rëndësishme për t'u zgjidhur krahas të tjerave.

- Ngritjen e një strukture të veçantë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të specializuar për luftën kundër krimeve mjedisore.

- Lufta për parandalimin dhe goditjen e krimeve mjedisore, të jetë një nga prioritetet kryesore në punën e Policisë së Shtetit, pasi nga studimi, rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve e perceptojnë ndotjen e mjedisit, si kërcënim për shëndetin dhe sigurinë e tyre personale.

- Përmirësimin e kurrikulave për krimet dhe sigurinë mjedisore në Kolegjin e Lartë Policor dhe në Fakultetin e Hetimit e të Sigurisë, në Akademinë e Sigurisë, me qëllim përgatitjen e oficerëve të aftë të policisë për parandalimin, hetimin dhe goditjen e veprave penale në fushën e mjedisit.

- Intensifikimin e punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimit në Policinë e Shtetit në luftën kundër krimeve mjedisore, sidomos për veprat penale "Prerja e paligjshme e pyjeve" dhe "Ndotja e ajrit" si dy nga format më të përhapura të krimeve në fushën e mjedisit (të dyja bashkë zënë 80% të rasteve të evidentuara të krimeve mjedisore).

- Përmirësimin e punës së Policisë për rritjen e besueshmërisë së komunitetit në punën e saj për parandalimin dhe hetimin e krimeve mjedisore.

- Rritjen e bashkëpunimit mes strukturave policore dhe atyre të prokurorisë, për një punë më të kualifikuar në drejtim të dokumentimit të veprimtarisë kriminale të autorëve të veprave penale kundër mjedisit, pasi prokuroria ka regjistruar procedime penale rreth 1/3 më pak nga rastet e referuara nga Policia e Shtetit .

- Rritjen e nivelit profesional të punës së prokurorisë në hetimin e veprave penale, në fushën e mjedisit, pasi ka rezultuar se nga procedimet e regjistruara prej saj, janë dërguar për gjykim 3.46 herë më pak.

- Rritjen e nivelit profesional dhe të përgjegjshmërisë në gjykimin e veprave penale në fushën e mjedisit, pasi janë dënuar vetëm 77% e të pandehurve të dërguar për gjykim nga prokuroria dhe 6.7 herë më pak, nga numri i autorëve të referuar nga policia në prokurori.

 33. PMC Reporter, (2019), 'PNG and Solomon's governments call for changes to forestry', *Asia Pacific Report*, 14 June, [online], <https://asiapacificreport.nz/2019/06/14/png-and-solomons-governments-call-for-changes-to-forestry/>, (Accessed 8 September 2019).
 34. PNG Exposed, (2014a), 'Malaysian company to log forests on Bougainville', *Blog*, 17 November, [online], <https://pngexposed.wordpress.com/2014/11/17/malaysian-company-to-log-forests-on-bougainville/>, (Accessed 18 August 2019).
 35. PNG Exposed, (2014b), 'PNG company with license to log on Bougainville a Korean front', *Blog*, 18 November, [online], <https://pngexposed.wordpress.com/2014/11/18/png-company-with-licence-to-log-on-bougainville-a-korean-front/>, (Accessed 18 August 2019).
 36. PNG Exposed, (2014c), 'John Momis exposed as the man behind Bougainville logging deal', *Blog*, 21 November, [online], <https://pngexposed.wordpress.com/2014/11/21/john-momis-exposed-as-the-man-behind-bougainville-logging-deal/>, (Accessed 18 August 2019).
 37. Rosen, T. (2015), 'AEEA Recognizes Environmental Crime Fighters in Asia Pacific', *IISD*, 26 May, [online], <http://sdg.iisd.org/news/aeea-recognizes-environmental-crime-fighters-in-asia-pacific/>, (Accessed 21 August 2019).
 38. Sheffield, J., Korotayev, A. and Grinin, L. (2013), 'Globalization: Yesterday, Today and Tomorrow: Chapter 3: Continuities and Transformations in the Evolution of World-Systems' C. *Chase-Dunn*, Emergent Publications, USA.
 39. Waide, S. (2018), 'GovernorJuffa, police crackdown on PNG's Collingwood Bay illegal logging', *Pacific Media Centre*, 20 March, [online], <https://asiapacificreport.nz/2018/03/20/governor-juffa-police-crack-down-on-pngs-collingwood-bay-illegal-logging/>, (Accessed 10 August 2019).
 40. World Bank, (2008), 'Forests Sourcebook', [online], https://siteresources.worldbank.org/EXT/FORSOUBOOK/Resources/complete_forest_source_book_april2008.pdf, (Accessed 11 August 2019).
 41. Zender, L. (2009), 'Security', Routledge, Oxon.
 42. Zhilla, F. (2015), 'Controversies of Corruption', *Mediterranean Journal of Social Sciences Vol 6 No. 3*, May, [online], <http://www.mcser.org/journal/index.php/mjss/article/view/6272>, (Accessed 17 August 2015).
 43. Zhilla, F. and Lamallari, B. (2015), 'Organized Crime Threat Assessment in Albania', *Open Society Foundation for Albania*, Tirana.



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »**

Materialet e rrezikshme që kërcënojnë mjedisin dhe sigurinë kombëtare



■ **Dr. Artur BEU**
Policia e Shtetit
artur.bue@asp.gov.al



■ **Dr. Doc. Ariana NEPRAVISHTA**
Universiteti Bujqësor i Tiranës

Abstrakt

Pas sulmeve të fundit terroriste në Evropë, çdo shtet është i angazhuar në marrjen e masave përkatëse në fushën e antiterrorizmit, por jo vetëm. Bota është gjithnjë e më shumë e ekspozuar nga kërcënime të rrezikshme dhe siguria mjedisore, ajo fizike dhe kombëtare është akoma më shumë e prekur. Në këtë kontekst është e detyrueshme të bëjmë disa konsiderime. Si mund të ndikojnë materialet e rrezikshme mjedisin dhe sigurinë tone? Çfarë mund të themi për përdorimin e materialeve radioaktive, bërthamore e kimike dhe a ka të tilla të disponueshme në treg? Cilat janë problemet kryesore me të cilat përballemi në fushën e zbulimit të materialeve radioaktive bërthamore e kimike? A është vendi ynë i pajisur mirë teknologjikisht për të zbuluar materiale të rrezikshme? A është teknologjia zgjidhja e këtyre problemeve? Për të luftuar në mënyrë të efektshme terrorizmin bërthamor është i nevojshëm ngritja e një mekanizimi të zbulimit paraprak dhe të besueshëm. Çdo shtet ka arkitekturën e tij të zbulimit. Ajo ndryshon nga vendi në vend, por qëllimi është i njëjtë. Një rast studimor në Shqipëri do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë rreth këtyre sfidave.

Fjalëkyçe:

materiale të rrezikshme, teknologji e zbulimit, siguri kombëtare, siguri mjedisore.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Të gjitha vendet duhet të ndërtojnë një arkitekturë të posaçme, për detektimin dhe mbrojtjen nga materialet e rrezikshme që mund të dëmtojnë shëndetin e qytetarëve dhe në të njëjtën kohë, edhe të mund të përdoren për të terrorizuar apo edhe për të goditur sigurinë kombëtare. Në këtë punim do të mundohemi të japim një lexim tjetër të sigurisë mjedisore, krimeve që lidhen me të, por edhe të pjesës kur krimet mjedisore prekin jo vetëm shëndetin e qytetarëve, por edhe sigurinë në përgjithësi. Jo më kot, kemi përmendur qysh në fillim arkitekturën e posaçme të kontrollit e të parandalimit të kryerjes së akteve të rënda. Kemi parasysh këtu përdorimin e materialeve radioaktive, bërthamore dhe kimike që shpesh nuk merren në konsideratë ose më mirë nuk u jepet rëndësia e duhur. Ne kemi nevojë të njihemi me aftësitë e vendeve tona, të zbulimit të materiale të rrezikshme, që nëse kalojnë nëpër kufijtë tanë, shkaktojnë apo mund të shkaktojnë dëme të pariparueshme. Ne kemi nevojë të dimë më shumë, rreth aftësive të kriminelëve për disponuar materiale të tilla për trafikimet e tyre dhe në rastet më të rënda, për t'i aplikuar këto materiale edhe në ndërtimin e armëve të shkatërrimit në masë. Ne kemi nevojë të dimë më shumë rreth teknologjive që përdoren aktualisht, për të zbuluar dhe për të parandaluar rreziqe të tilla. Sipas Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Bërthamore, sasi të mëdha materialesh bërthamore janë të disponueshme në botë dhe nuk mund të përjashtojmë që këto material të përdoren për të ndërtuar armë terrori, duke dëmtuar në mënyrë të përhershme mjedisin dhe jetët e njerëzve. Në lidhje me disa materiale që mund të kenë përdorim të drejtpërdrejtë për pajisje eksplozive mund të përmendim:

Plutonium (Plutonium përmban $<80\%$ ^{238}Pu) me një sasi të konsiderueshme 8 kg Pu, ²³³;

Uranium, me një sasi të konsiderueshme 8 kg ²³³u,

Helium, heu (²³⁵u>20%) me sasi të konsiderueshme 25 kg ²³⁵u.

Si edhe material me përdorim jo të drejtpërdrejtë si:

Uranium i varfëruar u (²³⁵u>20%) me sasi të konsiderueshme 75 kg ²³⁵ u (ose 10 t uranium natyral u ose 20 t i varfëruar u) dhe Torium me sasi të konsiderueshme 20 t th.

Sasi të tilla materialesh bërthamore emetojnë qindra mijëra neutron dhe disa miliard gama-quanta per sekondë¹. Të tilla rrezatime në kushte normale me teknologji të thjeshta mund të zbulohen në një distancë prej 10-15 metrash, por në realitet ka shumë mënyra për t'i fshehur, ulur rrezatimin dhe në këtë mënyrë vështirësojnë zbulimin e tyre.

Morëm rastin e materialeve bërthamore në konsideratë për të pasur një ide sa më të qartë në lidhje me synimet e këtij punimi. Duke shqyrtuar më në detaj me anën e një rasti të studiuar mendojmë se rezultatet e këtij punimi do të jenë më të qarta.

2. Një rast studimor në Shqipëri²

Më datë 28 shkurt 2013, një nga portalet monitorë të llojit “YANTAR 2U” të montuara në kufirin e Qafë Thanës mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut lëshon një alarm në momentin e kalimit të një kamioni. Portali monitor tregon një lexim jashtë norme të rrezatimeve “900 counts per second”, e cila i tejkalon normat me rreth 20 herë të radioaktivitetit natyral në terren për këtë pikë. Ky alarm u mor nga Policia e Shtetit dhe nga oficerët e doganës të cilët menjëherë ndaluan kamionin në fjalë që kish aktivizuar alarmin. Menjëherë u krijua një zonë e sigurt dhe kamioni u shoqërua në një zonë të posaçme. Duke e izoluar kamionin e u ngrit një shërbim 24/7 për vëzhgimin e tij. Duke u bazuar në procedurat standarde të Policisë së Kufirit dhe Migracionit (kapitulli VII, pika 2) policia punon në bashkëpunim të ngushtë me doganën kështu që informacioni i dërgohet në mënyrë të menjëhershme autoriteteve më të larta të dy institucioneve, të cilët nga ana e tyre informojnë menjëherë Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet në Tiranë në lidhje me alarmin e ngritur dhe rastin në fjalë. Për shkak të distancës jo shumë të gjatë mes Tiranës dhe pikës së kalimit të kufirit në Qafë Thanë, oficerët e Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet u gjendën në PKK brenda ditës. Pas mbërritjes së ekspertëve ata matën edhe njëherë rrezatimet e kamionit dhe rezultoi se vlera e tyre ishte 3,5 microSievert per hour (iSv/h). Duke përdorur instrumentin “Inspector 100” në kontakt me pjesën e jashtme të kamionit burimi radioaktiv u zbulua t'i përkiste materialit të kobaltit, Cobalt-60 (Co-60).

“Në veçanti sipas procedurave standard të lartpërmendura në kapitullin VII, është parashikuar ngritja e një grupi praktik të përbërë nga anëtarë të agjencive të ndryshme. Në germën d, është parashikuar që në rast të dyshimeve të arsyeshme për substance të ndaluara apo toksike, grupi praktik duhet të marrë masat e nevojshme duke veshur veshjet e duhura dhe të presë derisa në vend të mbërrijë skuadra e specializuar. Organizohet një zonë e posaçme e sigurt në një distancë të përshtatshme (15-20 metra larg objekteve të tjera dhe nga personeli. Duhet njoftuar autoritetet rajonale dhe qendrore për rastin dhe specifikisht, autoritetet policore, doganore, Zyrën e Mbrojtjes nga Rrezatimet dhe Institutin e Fizikës Bërthamore të Aplikuar”.

Pas identifikimit të burimit, Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet, në bashkëpunim

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

¹ GICNT, Helsinki, January 2015.

² A. Beu, 2015

me organizatat e përfshira në parandalimin e trafikimeve të paligjshme të materialeve radioaktive, vendosën hetimin e rastit në detaj. Në përputhje me procedurat standarde, dokumentet e kamionit u morën dhe kamioni u lëviz për në një zonë special kontrolli. Sipas dokumenteve autoritete u informuan se ngarkesa ishte skrap metal i importuar nga Maqedonia e Veriut me destinacion fabrikën KURUM në Elbasan.

Ngarkesa u shkarkua nën masat e larta të sigurisë nga ana e ekspertëve të Komisionit të Mbrojtjes nga Rrezatimet deri sa u identifikua fizikisht burimi i rrezatimit. Burimi i kobaltit u identifikua në një bllok të përforcuar me 10cm shtresë plumbi me një dritare të vogël nga e cila dilnin edhe rrezatimet gama. Bazuar në ndërtimin dhe dizajnin e burimit të përforcuar me shtresë plumbi, u arrit në përfundimin se, si mbulesa ashtu edhe materiali brenda ishin materiale radioaktive. Doza e matur jashtë burimit ishte 12,6 iSv/h. Burimi u nda nga mbulesa dhe u fut në një kuti speciale të mbuluar me plumb.

Burimi i kobaltit pasi u sigurua në kutinë e posacme u dërgua në magazinat e Institutit të Fizikës Bërthamore të Aplikuar, i cili ka të gjitha burimet e nevojshme teknike dhe njerëzore për të vënë në siguri burimet e rrezikshme. Kjo godinë është nën survejimin e plotë të Policisë së Shtetit me shërbim 24/7 sipas një Urdhri të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Të gjitha procedurat dhe masat e marra ndjekin konceptin e mbrojtjes së thellë e cila parashikon të paktën tre barriera ndërmjet burimit radioaktiv dhe publikut.

Rasti tregon se një burim i tillë radioaktiv nëse do të kalonte pa problem në kontrollin kufitar dhe doganor do të shkrihej në fabrikën e Elbasanit dhe do të bëhej pjesë e materialeve për ndërtim që aplikohen në vendin tonë apo kudo tjetër qoftë, pa marrë në konsideratë shpërndarjen në mjedis të rrezatimeve radioaktive në momentin e shkrirjes.

2.1 Cilat janë sfidat kryesore që lidhen me materialet radioaktive, bërthamore e kimike në dëm të sigurisë fizike dhe asaj mjedisore e kombëtare?

Jemi shumë të vetëdijshëm se aftësitë e kriminelëve në përgjithësi dhe atyre me natyrë terroriste në veçanti për të krijuar pajisje që mund të dëmtojnë mjedisin dhe në këtë mënyrë edhe shëndetin e njerëzve në masë duke përdorur materiale radioaktive, bërthamore e kimike janë më se reale. Para se të përdoren për qëllime të këqija, këto pajisje duhet të kalojnë disa stadi të ciklit vital të tyre.

Së pari, ka nevojë për magazinim të materialeve RBK, të përgatitura për krijimin e pajisjeve eksplozive, ose për vetë pajisjet pasi janë përgatitur;

së dyti, transportimi i pajisjeve eksplozive me përdorimin e materialeve RBK në një skenë të sulmeve terroriste;

së treti përgatitja e pajisjeve eksplozive me përdorimin e materialeve RBK për vënien në zbatim të tyre dhe për t'i maskuar në vendin ku do të përdoren.

Në këto faza ka një shpërndarje të rrezatimit të jonizuar. Në këtë fazë kjo shpërndarje na ndihmon që ta zbulojmë me anën e pajisjeve teknologjike. Megjithatë edhe terroristët mund të marrin masa për të shmangur detektimin, apo të reduktojnë mundësinë e zbulimit të tyre.

Për magazinimin e materialeve RBK gati për krijimin e pajisjeve eksplozive, apo të pajisjeve që mund të përdoren për sulme kimike, terroristët mund të zgjedhin vende për magazinimin e materialeve ndërtuese, të mbledhjes së mbeturinave për

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

skrap, vende të mbeturinave të stacioneve të energjisë që punojnë me djegës të lëngshëm, si edhe vende të magazinimit të materialeve kimike apo vende të mbledhjes së mbetjeve industriale. Vende të mbledhjes së materialeve pranë fabrikave të çimentos, industrisë së rëndë apo të tjera industri mund të jenë të preferuara për magazinimin e pajisjeve apo materialeve RBK. Këto vende janë të përshtatshme, sepse vetë mbetjet dhe materialet që përdoren në këto site kanë fushë radioaktiviteti të tyre për shkak të përqendrimit me shumicë të radionuklidëve që gjenden aty dhe kjo, mund të zvogëlojë mundësinë e kapjes apo zbulimit. Në veçanti, tejkalimi i radioaktivitetit natyral në terren me 5-10 herë (që është tipike e këtyre materialeve në sitet e lartpërmendura) i zvogëlon aftësitë tona për të detektuar materialin RBK, nga 1.5 deri në 2 herë. Për më tepër, kriminelët mund të përdorin vende që rrallë vizitohen si bazamente, tunele, miniera, magazina të mbeturinave mjekësore dhe vende nën dhë.

Rezervuarë të ndryshëm uji mund të jenë edhe këto tërheqës për magazinimin e materialeve të rrezikshme, për shkak të aftësisë së madhe të ujit të thithë rrezatimet jonizuese. Një shtresë uji prej një metri e trashë mund të dobësojë më shumë se 4000 herë rrezatimet gama të Ceziumit 137, dhe për neutronet me 1 MeV energji - $5 \cdot 10^{23}$ (5 shumëzuar me 10 ngritur në fuqi 23) herë. Kështu që fshehja e materialeve RBK në veçanti në ujëra i bën ato të paidentifikueshme.

Në këtë mënyrë, një nga sfidat e institucioneve të përfshira në zbulimin e këtyre materialeve kaq të dëmshme për sigurinë fizike dhe kombëtare mbetet përzgjedhja nga ana e kriminelëve të vendeve dhe të mënyrave të magazinimit të materialeve të rrezikshme që në mënyrë natyrore komplikojnë detektimin e tyre nga pajisjet teknologjike në dispozicion.

Krahas këtyre, edhe përdorimi i materialeve të tjera nga ana e kriminelëve për të fshehur materialet e rrezikshme duke ulur fushën e jonizimit përbën një tjetër sfidë.

Transportimi i materialeve RBK që do të përdoren për krijimin e pajisjeve eksplozive është faza më e komplikuar në përgatitjen e një krimi mjedisor apo terrorist, për faktin se të gjithë lëvizjet e materialeve që kanë aftësi rrezatimi jonizuese duhet të kalojnë nëpër pikat e hyrjes apo daljes në doganat e vendeve të ndryshme. Kuptohet që transportimi i brenda vendit varet sipas aftësive të çdo shteti për të zbuluar, ndërsa transporti ndërkombëtar duhet t'i nënshtrohet aftësive të doganave dhe kufijve të vendeve kufitare.

Një tjetër sfidë ka të bëjë me transportin e materialeve të rrezikshme ligjrisht të aprovuara me kontejnerë ngarkesë me mbrojtje speciale. Në përgjithësi, përmes kategorive të objekteve, që lëvizin nëpërmjet kufijve të jashtëm dhe përbrenda territorit të një shteti, të cilat kanë nivele të larta të rrezatimeve jonizuese mund të jenë një maskim i mirë për të transportuar edhe material të paligjshme:

a) materiale RBK – objekte të drejtpërdrejta të aktiviteteve ekonomike të huaja ose përbërës të objekteve të aktiviteteve ekonomike të huaja;

b) mbetjet radioaktive;

c) mallra dhe ngarkesa me radioaktivitet të lartë.

Me shumë gjasa për maskimin e materialeve RBK mund të përdoren mallrat apo ngarkesat me radioaktivitet të lartë, për shkak të përqendrimit natyral të lartë të radionuklidëve në to.

Ndërmjet materialeve më të përhapura me përqendrim të lartë radionuklidësh natyralë i gjeni të listuara në tabelën më poshtë:

MATERIALE	Radionuklidë		
	K-40	RA-226	Th-232
FERTILIZUES	40-8000	20-1000	20-30
GRANIT	600-4000	30-500	40-70
ADOBE	300-2000	20-90	32-200
SHALE	500-1000	30-70	40-70
PEBBLE	40-1000	20-70	20-70
MARBLE	40-200	20-30	20
FELDSPAR	2000-3000	40-100	70-200
MONOCYTE RËRË	40-70	30-1000	50-3000
BETON	150-500	40	40

Tabela 1

Substanca të tjera që përmbajnë materiale radioaktive natyrale janë:

- elektodat e veshura me torium (“Wolfram welding rods alloyed by torium”);
- qeramikat dentare dhe ortopedike;
- gurë të çmuar të irridiuar;
- lentat e kamerave;
- pluhur (“Grinding polder”);
- xhama me shtesë toriumi;
- qeramikë e ngjyrosur (“Colored ceramic glaze”);
- mbulesat e llambave me gaz;
- bananet, marijuana (përmbajnë K-40).

Kështu që, materialet e rrezikshme mund të maskohen me substancat e lartpërmendura, gjë që përbën një sfidë tjetër për agjencitë e zbatimit të ligjit dhe institucionet e përfshira në detektimin e tyre.

Për kriminelët me përvojë mënyra më e thjeshtë për të vënë në zbatim aktet e tyre është marrja e qasjes në transportimin e mjeteve dhe mallrave që kanë nivele të larta radioaktiviteti duke pasur në këtë mënyrë edhe dokumentacionin e rregullt për të kryer këto transportime. Për shembull, nëse ka një autorizim për transportimin e një burimi (me qindra Curie) gama rrezatues (p.sh. Co-60 e energji 1,33 MeV), një sasi e konsiderueshme mund të shtohet në të njëjtin kontejner. Duke marrë në konsideratë nivelin e lartë të rrezatimit të burimit natyral dhe dobësimin që mund t'i bëjë kontejneri sasisë së shtuar që mund të jetë edhe ajo e mbuluar me material që dobësojnë rrezatimin e bëjnë praktikisht të padetektueshëm materialin e rrezikshëm shtesë.

Materialet e zbrërthyeshme (“fissile”) që kanë nivel të lartë rrezatimi neutronesh (plutoniumi p.sh.) mund të maskohen me mallra organike, përfshirë edhe ato të ngrira si mish apo në cisternë me likuide të ndryshme hidrogjeni etj. Në rastin e parë, ato mund të detektohen me ndihmën e spektrometrëve të cilësisë së lartë dhe në rastin e dytë, është pothuajse e pamundur të detektohen substancat radioaktive apo material bërthamore.

Një tjetër sfidë mbetet transportimi i materialeve të rrezikshme në kontejnerë standardë specialë. Të tillë kontejnerë mund të blihen lehtë nga kriminelët. Të tillë

kontejnerë është mirë që të kontrollohen gjithnjë, dhe në veçanti dokumentacioni shoqëruet i tyre. Dhe në rastet që dokumentet tregojnë se kontejneri është bosh, ka mundësi që një teknikë e tillë të përdoret për të mos kaluar kontrollet radioaktive të tyre. Nuk duhet të harrojmë se shpesh burimet radioaktive kanë madhësi të vogla.

Një tjetër sfidë akoma mund të jetë ajo e transportimit të materialeve të rrezikshme duke i maskuar mjetet transportuese me mburojë speciale apo duke i veshur me materiale mbrojtëse që mund të ngjajnë si mallra apo furnizime të zakonshme. Të tilla mbulesa janë të disponueshme në treg dhe nuk përbëjnë vështirësi për t'u gjetur.

Një nga mënyrat më efektive të transportimit të materialeve radioaktive, por edhe të materialeve të tjera të rrezikshme që dëmtojnë mjedisin është ajo e transportit ujor. Kjo ka të bëjë edhe me çfarë u përmend më lart për aftësinë e ujit për të mbuluar apo maskuar mirë rrezatimet jonizuese. Për këtë arsye shumica e kontejnerëve që mund të përmbajnë të tilla materiale të rrezikshme do të stivohen në pjesët e poshtme të anijeve transportuese në mënyrë që t'i kalojnë lehtë kontrollet nëpër hyrjet e porteve.

Nuk mund të mos kujtojmë një sfidë tjetër që mbetet për institucionet e zbatimit të ligjit në lidhje me përdorimin radio-farmaceutik për qëllime mjekësore si edhe aplikimi diagnostikues i radionuklidëve.

Duke folur për përhapjen e metodave diagnostikuese me radionuklidë në botë, është e nevojshme të njihemi me intensitetin e tyre (sasia për 1000 persona): në vendet e zhvilluara është 18.8% (në SHBA – deri në 30% ndërsa në Federatën Ruse deri në 11.8%), por shumë më e vogël se diagnozat me reze x (800-1000%). Në një përaftrim të rasteve të përbashkëta të diagnozave është 1.7 milion çdo vit, përfshirë edhe një milion rastesh kërkimi shkencor dhe 700 mijë raste skanimesh.

Sfida të shumta të teknologjive, në raste të veçanta lidhen me radio-farmaceutikët e ndryshëm (Fe-59, Ga-67, Tc-99m, I-123, I-131, Xe-133, Tl-201), që kanë linja gama, të cilat përputhen me ato të materialeve bërthamore. Linjat gama të këtyre radio-farmaceutikëve janë identike si me linjat gama të izotopeve të uraniumit ashtu edhe me të plutoniumit, dhe rrezatimi i të tilla linjave gama, është i krahasueshëm me të njëjtat linja gama të materialeve bërthamore (para së gjithash të plutoniumit).

Kjo kërkon zhvillimin e algoritmeve speciale për identifikimin e saktë të radio-farmaceutikëve në mënyrë që të mos i trazojmë me materialet bërthamore³.

3. Konkluzione dhe konsiderime

Globalizimi i sjell gjithnjë e më afër sfidat, qofshin ato të natyrës së brendshme apo të natyrës së jashtme apo transnacionale. Çdo shtet duhet të rrisë arkitekturën e zbulimit e të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm e të kontribuojë në sigurinë e qytetarëve dhe të vendeve të tyre, sepse duke rritur sigurinë kombëtare rritet edhe ajo kombëtare, por edhe ajo globale.

Materialet radioaktive, bërthamore e kimike janë gjithnjë e më shumë të qasshme dhe kjo përbën një rrezik të madh nëse ato bien në duart e atyre që duan t'i përdorin për qëllime të jashtëligjshme. Vlerësimi i rrezikut dhe i kërcënimit i bën shtetet të kontribuojnë në identifikimin më të qartë dhe të saktë të boshllëqeve dhe ja vështirëson jetën kriminelëve.

Teknologjia duhet të përdoret në mënyrë të efektshme për të luftuar, zbuluar dhe

³ Prof. Grigory T. Shevchenko, Helsinki 2015.

parandaluar sulmet e të gjitha natyrave, mjedisore, terroriste dhe sulmet ndaj sigurisë kombëtare. Kërkimi duhet të vazhdojë në këtë drejtim dhe të kontribuojë në ofrimin e mundësive të reja për një botë më të sigurt. Përdorimi i teknologjive në ndihmë të përmirësimit të kushteve mjedisore ndihmon në përmirësimin dhe arritjen e qëllimeve finale të së jetuarit në një botë më të pastër dhe më të sigurt.

Trajnimi dhe ndarja e njohurive ndërmjet të gjithë palëve të interesuara mund të parandalojë krimet mjedisore, ato terroriste dhe rreziqet e tjera që lidhen me to.

Bashkëpunimi ndërkombëtar është një mjet specifik dhe mbetet esencial për të luftuar në mënyrë efikase krimet mjedisore, që gjithsesi na prekin të gjithëve. Organizatat individuale nuk mund të mbajnë peshat e rënda të krimeve të natyrës mjedisore që i kalojnë lehtësisht kufijtë kombëtarë. Organizatat e ndryshme kanë edhe fokus të ndryshëm. Së bashku ato prodhojnë një zgjidhje gjithëpërfshirëse të problemeve.

Kurset trajnuese kanë një dobi të madhe në mirëkuptimin dhe rritjen e konceptit të operacionit lidhur me krimet mjedisore të materialeve radioaktive dhe jo vetëm.

Kryerja e aktiviteteve të përbashkëta mes organizatave të ndryshme të përfshira në luftën kundër të gjitha llojeve të krimeve mjedisore dhe trafikimit të materialeve radioaktive do të shërbejë në krijimin e një baze solide të zgjidhjes së problemeve.

Bibliografi

1. <https://global-initiative.info>
2. Guidelines for detection within a State's interior, GICNT, July 2014
3. "Northern Lights" exercise, GICNT, 26 January 2015
4. <http://www.interpol.int/News-and-media/Publications> National and European programmes (DGEN, FP5, FP6, FP7)
5. IAEA Nuclear Security Series No 13: Nuclear Security Recommendation on Physical Protection of Nuclear Material and Nuclear Facilities (INFCIRC/225/Revision 5)
6. International and European networks (HERCA, ENSREG, EURADOS, EUROMET, EAN)

Siguria mjedisore dhe politikat e Bashkimit Evropian



■ **Dr. Dhurata MILORI**
Fakulteti i Shkencave Sociale
Universiteti i Tiranës
dh.milori@dgca.gov.al

Abstrakt

Planeti gjatë dekadave të fundit ka përjetuar ndryshime të shpejta klimaterike të shkaktuara nga gazrat serë të emetuara nga aktivitetet njerëzore. Efektet janë të ndjeshme në të gjitha kontinentet dhe tashmë, ndryshimet klimatike dhe siguria mjedisore, janë shndërruar në çështje të politikave me rëndësi globale. Në të gjithë botën, kërcënimi që vjen nga siguria mjedisore po shkakton pasoja të krahasuara, e madje në raste të caktuara edhe më të rënda shëndetësore, sociale, ekonomike, se ato të shkaktuara prej konflikteve të ndryshme në shoqëri. Zhvendosjet e popullsisë si pasojë e këtij rreziku sa po vijnë dhe po rriten, dhe në ritme të tilla pritet që një prej sfidave më të mëdha me të cilat do të përballet shoqëria njerëzore në dekadat e ardhshme të jetë dhe fluksi i lartë i migruesve mjedisorë. Bashkimi Evropian mbetet një aktor i rëndësishëm i cili përmes politikave të tij ambicioze në vendet anëtare por edhe me bashkëpunimin e ngushtë me partnerët ndërkombëtarë synon të luftojë të gjitha aspektet të cilat kërcënojnë sigurinë mjedisore. Në këtë punim analizohen faktorët më të rëndësishëm të cilët përbëjnë kërcënim për sigurinë e mjedisit, kuadri ligjor, financimi ashtu edhe elementë të veçantë të politikave të cilat synojnë përmirësimin e tij në Bashkimin Evropian. Një pjesë të rëndësishme të analizës në këtë kuadër e zë edhe Marrëveshja e Parisit e vitit 2015, si një iniciativë e cila bashkon kombet në një synim të përbashkët dhe të vazhdueshëm për të luftuar ndryshimet e klimës. Në këtë punim paralelisht me Bashkimin Evropian analizohen dhe sfidat për të adresuar kërcënimet kryesore në këtë fushë.

Fjalëkyçe:

siguria mjedisore, ndryshimet klimatike, sfida globale, Marrëveshja e Parisit, Bashkimi Evropian.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Siguria mjedisore është shndërruar në kryefjalë të politikave ndërkombëtare për vet rëndësinë dhe rolin që ajo luan në standardin dhe cilësinë e jetesës së njerëzve, por edhe për konfliktin në rritje që ajo mbart. Punimi përpiqet të analizojë rëndësinë e mjedisit në garantimin e standardit dhe cilësisë së jetesës si një sfidë e politikave të Bashkimit Evropian.

Përmes metodave hulumtuese, krahasuese dhe analizuese punimi synon të evidentohen dhe analizohen aspektet më problematike të mjedisit, pasojat që kanë si në afatshkurtër ashtu dhe në afatgjatë në aspektin ekonomik, politik shëndetësor dhe social për Evropën, por jo vetëm.

Kur analizojmë mjedisin, në mënyrë të pazgjdhshme, marrim në konsideratë dhe analizojmë ndikimin që ndryshimet klimatike kanë në të. Referuar raporteve statistikore të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, evidentohen në punim fushat kryesore në të cilat ka ndikuar ngrohja globale si shëndetësi, ndotje e ajrit, e ujit të pijshëm, e ushqimit dhe pasojat që kanë shkaktuar thatësitrat, përmbytjet apo valët e të nxehtit si dhe ndikimin që, të gjitha sa më sipër, kanë në politikat dhe sigurinë e mjedisit.

Në punim, analizohet kuadri ligjor, iniciativat politike, ndikimi ekonomik, social dhe shëndetësor i ndryshimeve klimatike, roli i marrëveshjeve ndërkombëtare mjedisore dhe klimatike në reduktimin e emetimit të gazrave serë si dhe për të mbajtur një ngritje globale të temperaturës këtë shekull shumë më poshtë se 2 gradë Celsius mbi nivelet paraindustriale. Pjesë të rëndësishme të kësaj analize, merr edhe roli që Bashkimi Evropian ka luajtur që në fillimet e krijimit të tij, në çështjet mjedisore dhe klimatike, duke e krahasuar dhe me partnerin tjetër të rëndësishëm ndërkombëtar, Shtetet e Bashkuara

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

të Amerikës, deri në ditët e sotme, kur BE është shndërruar në një lider të mjedisit dhe klimës në botë.

Në analizën e kuadrit ligjor një vend të rëndësishëm merr Marrëveshja e Parisit, e cila ka një vlerë historike për sa i përket qëllimeve që ka vendosur në themel të funksionimit të saj, por edhe për masivitetin e përfshirjes dhe angazhimit të marrjes pjesë në të, me nënshkrimin e saj prej 196 shteteve.

Një aspekt tjetër i punimit, përqendrohet në rëndësinë dhe argumentet e përfshirjes dhe rritjen e rolit të politikave mjedisore në kuadrin e politikave të sigurisë si dhe shembuj apo mësim të marra nga vet Bashkimi Evropian për ta bërë këtë politikë më efektive. Literatura e konsultuar për këtë punim konsiston në dokumentet zyrtarë të institucioneve të Bashkimit Evropian (si Këshilli Evropian, Parlamenti Evropian, Parlamenti Evropian), në raporte zyrtare të Kombeve të Bashkuara, marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e klimës dhe mjedisit, deklaratat zyrtare, legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar për klimën dhe mjedisin, libra dhe artikuj shkencorë. Punimi i referohet gjithashtu raporteve statistikore të këtyre institucioneve si dhe atyre të Organizatës Botërore të Shëndetësisë

2. Ndryshimi i modelit të sigurisë

Natyrat e konflikteve dhe spektri i sigurisë kanë ndryshuar dekadat e fundit. Modeli i sigurisë i është përshtatur një lufte të re asimetrike të karakterizuar nga një qasje gjithmonë dhe më e lehtë për armatime gjithnjë e më të fuqishme si dhe rritja e shfaqjeve të ekstremizmit të dhunshëm. Diversifikimi i kërcënimeve dhe i aktorëve të përfshirë në to po gjeneron sfida të reja për bashkësitë e mbrojtjes dhe të sigurisë, si dhe për shoqërinë në tërësi. Globalizimi, migracioni, zhvendosjet gjeopolitike, ndryshimet e klimës dhe mjedisit, rritja e qasjes së individëve në burime teknologjike dhe sociale, e ka bërë botën më të brishtë në disa nivele të sigurisë¹.

Për këto arsye edhe siguria mjedisore po dominon gjithnjë e më shumë agjendat kombëtare dhe ndërkombëtare. Në të gjithë botën, numri i zhvendosjeve të lidhura me fatkeqësitë natyrore është dukshëm më i lartë se ai i atyre që lidhen me konfliktin. Përjashtime janë disa rajone të shkatërruara nga konflikti në Afrikë dhe Lindjen e Mesme. Kjo është një tendencë që vihet re prej vitit 2018. Rreth 971 milion banorë, – të cilët përbëjnë mbi 12% të popullsisë botërore, – jetojnë në zona me ekspozim të lartë ose shumë të lartë ndaj rreziqeve klimatike, 41% banojnë në vende me nivele të ulëta të paqes. Azia-Paqësori dhe Azia e Jugut mbeten rajonet me riskun më të madh për rreziqet natyrore dhe kapacitetet më të dobëta të përballimit të tyre. Ekspozimi ndaj gjashtë rreziqeve kryesore natyrore: tërmetet, vullkanet, cunami, përmbytjet, erërat e ciklonit tropikal dhe ngritja e nivelit të detit, është dyfishuar gjatë 40 viteve të fundit. Aktualisht, rreth 33% e popullsisë botërore është e ekspozuar ndaj tërmeteve, rreth 1 miliardë njerëz në 155 vende janë të ekspozuar nga përmbytjet dhe 414 milion jetojnë pranë një prej 220 vullkaneve më të rrezikshme. Kombet e Bashkuara vlerësojnë se 40% e konflikteve të brendshme gjatë 60 viteve të kaluara kishin të bënin me burimet natyrore. Meqenëse konflikti dhe degradimi i mjedisit përkeqësojnë njëri-tjetrin, spektri dhe problematika e tyre mund të zgjerohen nëse nuk adresohen së bashku. Këshillit i

¹ European Commission, Changing Security Paradigm, në https://ec.europa.eu/knowledge4policy/foresight/topic/changing-security-paradigm_en aksesuar në nëntor 2019.

Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është i fokusuar në zhvillimin e sigurisë së mjedisit dhe vëmendja e tij po rritet në lidhje me këtë problematikë.²

Çështjet e sigurisë mjedisore dhe ndryshimet klimatike variojnë dhe në ndryshimet e qasjeve që shtete të ndryshme kanë në raport me to: disa vende kërkojnë që ndryshimi i klimës të adresohet si një kërcënim global i sigurisë; duke filluar nga humbja e mundësisë së jetesës dhe shfrytëzimi i paligjshëm i mineraleve deri në ndikimet e ndryshimit të klimës në sovranitetin kombëtar. Efektet e ardhshme të ndryshimit të klimës mund të krijojnë 25 milion deri në 1 miliard migrues mjedisorë deri në vitin 2050, duke lëvizur brenda vendeve të tyre ose përtej kufijve, mbi baza të përhershme ose të përkohshme, dhe 1-2 miliardë deri në vitin 2100, të cilat mund të rrisin konfliktet ekzistuese ose madje të krijojnë konflikte të reja.³

3. Roli i Bashkimit Evropian në mbrojtjen dhe sigurinë mjedisore

Planeti ynë po përjeton ndryshime të rëndësishme dhe të përshpejtuara klimatike të shkaktuara nga gazrat serë të emetuara nga aktivitetet njerëzore. Efektet po ndjehen në të gjitha kontinentet dhe parashikohet të bëhen gjithnjë e më intensive, me pasoja të rënda për ekonominë dhe shoqërinë. Për të ndaluar ndryshimin e klimës nga përkeqësimi, duhet të ndërmerren veprime për të ulur ndjeshëm emetimet e gazrave serë që t'i përshtaten ndryshimeve që ndodhin tani dhe në të ardhmen, për të kufizuar dëmet. Veprimi ndaj klimës ka shumë përfitime: ndihmon në kursimin e energjisë, përmirësimin e cilësisë së ajrit, sigurimin e furnizimit me energji dhe krijimin e vendeve të punës. BE lufton ndryshimin e klimës përmes politikave ambicioze dhe bashkëpunimit të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë.⁴

Kur çështjet mjedisore u shfaqën në agjendën ndërkombëtare, nga fundi i viteve 1960 dhe fillimi i viteve 1970, Shtetet e Bashkuara ishin një nga mbështetëset më të fuqishme dhe më të qëndrueshëm të traktateve dhe marrëveshjeve mjedisore. Ato luajtën një rol udhëheqës në përgatitjet për *Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi mjedisin njerëzor* dhe përkrahën shumicën e traktateve mjedisore të adoptuara gjatë viteve '70, si *Konventën e Londrës mbi shkarkimin në det 1972*, *Konventën e trashëgimisë botërore 1972*, *Konventën mbi tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara 1973* dhe Protokollin MARPOL mbi ndotjen nga anijet. Vendet anëtare të Bashkimit Evropian më pas ratifikuan traktatet ndërkombëtare të krijuara në këtë periudhë, por lidershipi i SHBA-së ishte kryesor. Përsëri, në vitet 1980, Shtetet e Bashkuara luajtën një rol kryesor në negociatat që çuan drejt *Protokollit të Montrealit mbi substancat që shpëtojnë shtresën e ozonit 1987*, ndërkohë që vendet anëtare të BE-së (veçanërisht Mbretëria e Bashkuar, Franca dhe Italia) ishin mbështetëse ngurruese të këtij traktati të rëndësishëm ndërkombëtar.⁵

Për sa i përket Bashkimit Evropian, në Traktatin e Romës të vitit 1957, mbrojtja e

² European Commission, Environmental Security, në: https://ec.europa.eu/knowledge4policy/foresight/topic/changing-security-paradigm/environmental-security_en aksesuar në nëntor 2019.

³ Po aty.

⁴ European Commission, Climate change and you, në https://ec.europa.eu/clima/citizens/eu_en aksesuar në dhjetor 2019.

⁵ Daniel Klemen, David Vogel "Tregtimi i vendeve: Roli i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian në Politikën Ndërkombëtare të Mjedisit" në *Çështje Europiane dhe të sigurisë.*, (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim 2011) f. 57-58.

mjedisit nuk ka qenë e përmendur. Kjo situatë vazhdoi deri në vitin 1970 kur problemet mjedisore emergjente filluan të shfaqen në këtë fushë në nivelin e Komunitetit Evropian. Në Samitin e Parisit, në korrik 1972, u pranua që në kuadër të ekspansionit ekonomik dhe të përmirësimit të cilësisë së jetës, vëmendje e veçantë duhej t'i kushtohej mjedisit. Menjëherë në vitin 1973 u adoptua programi i parë i veprimit në mjedis (*Plani i Veprimit në Mjedis – PVM*) për periudhën 1973-1976. Ky program u pasua nga programe të tjera shumëvjeçare, të cilat çuan në adoptimin e një serie direktivash.

Hyrja në fuqi e Aktit Unik European (*Single European Act*) më 1987, duke shtuar një titull specifik për subjektin (neni 130) në traktat, konsiderohet në përgjithësi si pika e kthesës për mjedisin. Traktati gjithashtu prezantoi idenë e re që “Kërkesat për mbrojtjen e mjedisit duhet të jenë një komponent i politikave të tjera të Komunitetit”. Hyrja në fuqi e traktatit të Bashkimit Evropian, në nëntor 1993, solli progres në fronte të ndryshme. Ai shtoi konceptin e “rritjes së qëndrueshme dhe jo inflacioniste duke respektuar mjedisin” për detyrat e Komunitetit Evropian dhe shkroi parimin parandalues në nenin për mjedisin. *Traktati i Amsterdimit*, i cili hyri në fuqi në vitin 1999, përkufizoi parimin e zhvillimit të qëndrueshëm në nenin 2. Klauzola që kërkesat për mbrojtjen e mjedisit të integrohen në përkufizimin dhe zbatimin e politikave të tjera, e cila ishte në nenin 130 u vendos në nenin 6. Në *Traktatin e Nicës* nuk u bënë ndryshime të tjera thelbësore⁶.

Në vitet 1990, ekonomistët analizonin mënyrat më efikase për të përmirësuar bërjen e politikave mjedisore, për të vendosur një çmim për impaktin e ndotjes që nuk paguhej nga ndotësi. (“pricing environmental externalities”). Mënyra për ta bërë këtë ishte përmes taksimit, dhe BE u përpoq për gati një dekadë të adoptonte një taksë të energjisë së karbonit. Kjo dështoi për shkaqe politike, pasi nocioni i krijimit të taksave të reja ishte një mesazh jopopullor në një kohë kur shumë njerëz tashmë ndiheshin të taksuari së tepërmi nga politikat e përbashkëta të BE-së. Kjo gjithashtu dështoi për arsye institucionale, pasi taksat evropiane duhet të miratohen me marrëveshjen unanime të shteteve anëtare, e cila rezultoi të ishte e pamundur. Një metodë alternative e preferuar, për të kufizuar sasinë e ndotjes, ishte vendosja e një taksë fikse të ndotjes. Në mënyrë të ngjashme, politika e uljes së emetimeve për makinat e pasagjerëve fillimisht u bazua në *marrëveshjet vullnetare* me industrinë e makinave në fund të viteve 1990. Këto nuk funksionuan ashtu siç ishin parashikuar dhe kështu u vendosën me legjislacion, detyrues elastikë. Të mësuarit duke punuar (*learning by doing*) në bërjen e politikave është e rëndësishme; asnjë qasje e re e politikës nuk do të jetë e përsosur që në fillim, veçanërisht në një botë që ndryshon me shpejtësi⁷.

Një mësim i dytë i rëndësishëm është se nuk ka asnjë instrument të vetëm politikash, të përshtatshëm për të ulur emetimet e gazit serë në kaq shumë sektorë të ndryshëm ekonomik. Prandaj, zgjidhja më e mirë është të krijohet një “bashkim” i qasjes së politikës që është më koherente dhe me kosto efektive. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të shmangen rregullimi i dyfishtë ose mbivendosjet midis instrumenteve të ndryshëm, pasi këto mund të japin sinjale kontradiktore për operatorët ekonomik. Një mësim i tretë është se përgatitja e qëndrueshme ekonomike dhe teknike e politikës, si dhe konsultimi i gjerë i palëve të interesuara, është me shumë rëndësi. Kjo jo vetëm që është

⁶ Florian Xhafa, Thimaq Lako, Geron Kamberi, Efklo dia Leskaj, Enkeleda Suti, Ilir Qorri, “Politika e Mjedisit” në *Politikat e Përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe Shqipëria*, (Instituti AGENDA 2008) f. 20.

⁷ Jos Delbeke, Peter Vis, *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Jos Delbeke dhe PeterVis, (European Union 2016) f. 1.

e nevojshme për të fituar mbështetje në nivelin politik, për të pasur një kuptueshmëri më të mirë të saj, por edhe për të siguruar që politika në momentin që bihet dakord të jetë sa më e qëndrueshme. Shpesh ka interesa ekonomike të mëdha, dhe kryesisht në konflikt dhe kundërshti me qëllimin e politikës, dhe krijimi i transparencës maksimale ka qenë një parakusht i domosdoshëm për sukses. Përvoja ka treguar se politikëbërja në bazë të fakteve dhe shifrave, një analizë e qartë e kostove dhe përfitimeve për shoqërinë, dhe një angazhim aktiv me palët e interesuara ka qenë më e dobishme se sa përqendrimi i tepërt në atë që konsiderohet politikisht e favorshme në një plan afatshkurtër. Përpjekja për krijimin e një politike gjithëpërfshirëse të klimës, në BE filloi në vitet 1990, u zhvillua në mënyrë të drejtpërdrejtë rreth vitit 2000, me *Protokollin e Kiotos*⁸ dhe në vazhdim, me *Marrëveshjen e Parisit* të vitit 2015⁹

Që nga ndryshimi i *Traktatit* të vitit 1987, BE ka vendosur për ndryshimet e legjislacionit në fushën e mjedisit në bazë të një votimi me shumicë të cilësuar të shteteve anëtare me Parlamentin Evropian. Kjo ka lejuar zhvillimin e një grupi ligjesh si dhe zhvillimin e legjislacionit të ri mjedisor dhe ka krijuar një adresim të qetë të politikës evropiane ndaj ndryshimit të klimës¹⁰

Gjatë dy dekadave të fundit, Bashkimi Evropian është shfaqur si propozuesi më i fuqishëm për zgjerimin e ligjit mjedisor ndërkombëtar. Udhëheqësit politik të BE-së ishin aktivë në pjesën më të madhe të konferencave mjedisore të Kombeve të Bashkuara, në Rio de Janeiro, në 1992, dhe në Johanesburg, në 2002, ndërsa Shtetet e Bashkuara u kritikuan ashpër për pozicionin e tyre ndaj iniciativave të politikës mjedisore globale në të dyja mbledhjet ndërkombëtare. Gjithsesi, në lidhje me politikën ndërkombëtare mjedisore, ka ndodhur një ndryshim sistematik, nga lidhshipi i SHBA-së te ai i BE-së, që prej fillimit të viteve 1990. Bashkimi Evropian ka luajtur një rol kryesor në miratimin e *Konventës së Bazelit për hedhjen e mbetjeve të rrezikshme 1989* dhe *Konventës mbi shumëllojshmërinë biologjike 1992* (CBD), *Protokollin e Kyoto-s për ndryshimin klimaterik 1997*, *Protokollin e Kartagenës mbi biosigurinë 2000* dhe *Konventën e Stokholmit mbi ndotësit e qëndrueshëm organik 2001* si dhe në *Marrëveshjen historike të Parisit*.¹¹

“Marrëveshja e Parisit” u miratua në Paris, më 12 dhjetor 2015, nga 196 shtete palë në “Konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike” (KKKBNK)¹². Marrëveshja e Parisit bazuar në *Traktatin kornizë* të UNFCCC¹³ të vitit 1992, për herë të parë i afron të gjitha kombet në një kauzë të përbashkët për të

⁸ Protokollin e Kiotos është një marrëveshje ndërkombëtare e lidhur me Konventën Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimin e Klimës, e cila angazhon Palët e saj duke vendosur objektiva detyrues ndërkombëtar për uljen e emetimeve. Duke pranuar që vendet e zhvilluara janë kryesisht përgjegjëse për nivelet e larta aktuale të emetimeve të gazrave në atmosferë, si rezultat i më shumë se 150 viteve të veprimtarisë industriale, Protokollin vendos një barrë më të rëndë për vendet e zhvilluara nën parimin e “përgjegjësisë të zakonshme, por të diferencuara”. Protokollin e Kiotos u miratua në Kyoto, Japoni, më 11 dhjetor 1997 dhe hyri në fuqi më 16 shkurt 2005. Rregullat e detajuara për zbatimin e Protokollit u miratuan në Marrakesh, Marok, në 2001, dhe përmenden si “Marrëveshjet e Marrakeshit”. Periudha e parë e angazhimit filloi në vitin 2008 dhe përfundoi në 2012.

Protokollin e Kyoto-s shihet si një hap i parë i rëndësishëm drejt një regjimi global të reduktimit të emetimeve, i cili do të stabilizojë emetimet e gazrave globale dhe mund të sigurojë arkitekturën për marrëveshjen e ardhshme ndërkombëtare mbi ndryshimin e klimës. (marrë nga https://unfccc.int/kyoto_protocol, tetor 2019).

⁹ Jos Delbeke, Peter Vis, *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Jos Delbeke dhe Peter Vis, (European Union 2016) f. 2.

¹⁰ Jos Delbeke, Peter Vis, “EU climate leadership in a rapidly changing world” në *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Jos Delbeke dhe Peter Vis, (European Union 2016) f. 11.

¹¹ Klemen, “Tregtimi i vendeve: Roli i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian në Politikën Ndërkombëtare të Mjedisit” f. 57-58.

¹² Ambasada e Francës në Tiranë, “Dita e Tokës dhe Marrëveshja e Parisit”, në <https://al.ambafrance.org/Dita-e-Tokes-dhe-Marreveshja-e-Parisit>, aksesuar në tetor 2019.

ndërmarrë përpjekje ambicioze për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për t'u përshtatur me efektet e saj, me një mbështetje të shtuar për të ndihmuar vendet në zhvillim që ta bëjnë këtë. Si e tillë, ajo paraqet një kurs të ri në përpjekjet globale për klimën. Qëllimi kryesor i *Marrëveshjes së Parisit* është të forcojë reagimin dhe bashkëpunimin global ndaj kërcënimit të ndryshimit të klimës duke mbajtur një ngritje globale të temperaturës këtë shekull shumë më poshtë se 2 gradë Celsius mbi nivelet paraindustriale dhe të vazhdojë përpjekjet për të kufizuar rritjen e temperaturës edhe më tej në 1.5 gradë Celsius. Për më tepër, marrëveshja synon të forcojë aftësinë e vendeve për t'u përballur me ndikimet e ndryshimit të klimës. Për të arritur këto synime ambicioze, në konventë përcaktohet kontributi i duhur financiar, një kornizë e re teknologjike dhe një kornizë e ngritjes së kapaciteteve, duke mbështetur kështu veprimet nga vendet në zhvillim dhe vendet më delikate në çështjet klimaterike, në përputhje me objektivat e tyre kombëtare. *Marrëveshja e Parisit* kërkon që të gjitha palët të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira, përmes kontributeve të përcaktuara në shkallë vendi dhe t'i forcojnë këto përpjekje në vitet e ardhshme. Kjo përfshin kërkesën, që të gjitha palët të raportojnë rregullisht për emetimet e tyre dhe mbi përpjekjet e tyre të zbatimit të këtyre kërkesave. Do të ketë gjithashtu një vlerësim global, çdo 5 vjet, për të vlerësuar përparimin kolektiv drejt arritjes së qëllimit të marrëveshjes dhe për të informuar mbi veprimet e mëtejshme individuale nga palët. *Marrëveshja e Parisit* hyri në fuqi më 4 nëntor 2016.¹⁴

Në 4 nëntor 2019 Shtetet e Bashkuara të Amerikës filluan procesin për t'u tërhequr nga *Marrëveshja e Parisit*. Sipas kushteve të marrëveshjes, Shtetet e Bashkuara paraqitën njoftimin zyrtar për tërheqjen e saj në Kombet e Bashkuara. Tërheqja hyn në fuqi një vit nga dorëzimi i njoftimit. Siç është deklaruar në 1 qershor 2017, Presidenti Trump mori vendimin të tërhiqej nga *Marrëveshja e Parisit* për shkak të barrës së padrejtë ekonomike që u është imponuar punëtorëve, bizneseve dhe taksapaguesve amerikanë nga premtimet e bëra në bazë të marrëveshjes. Presidenti Trump, deklaroi se Shtetet e Bashkuara kanë ulur të gjitha llojet e emetimeve. Emetimet neto të gazrave serë në SHBA ranë 13% nga 2005-2017, ndërsa ekonomia amerikane u rrit mbi 19 përqind. SHBA përdor të gjitha burimet e energjisë dhe teknologjitë në mënyrë të pastër dhe efikase, përfshirë karburantet fosile, energjinë bërthamore dhe energjinë e rinovueshme. Megjithatë sipas qëndrimit të tij, në diskutimet ndërkombëtare për klimën SHBA do të vazhdojmë të ofrojmë një model realist dhe pragmatik duke treguar se inovacioni dhe tregjet e hapura çojnë në prosperitet më të madh, më pak emetime dhe burime më të sigurta të energjisë. Pavarësisht tërheqjes nga kjo marrëveshje SHBA zotohet se do të vazhdojë të punojë me partnerët globalë për të forcuar rezistencën ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës, t'u përgjigjen së bashku fatkeqësive natyrore përtërijnë dhe zhvillojnë ekonominë ndërsa zvogëlojnë emetimet dhe zgjerojnë një ndihmë për partnerët anëmbanë globit¹⁵

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

¹³ UNFCCC (United Nations Framework Convention on Climate Change) e vitit 1992 është një traktat kornizë me 195 palë - një anëtarësim i afërt universal i shteteve. UNFCCC përcakton një objektivi afatgjatë, të bazuar në shkencë, i cili kërkon stabilizimin e përqendrimeve të gazrave serë në atmosferë në nivele të sigurta. Palët kanë sqaruar që atëherë se kjo do të nënkuptojë kufizimin e rritjes së temperaturës mesatare globale në më pak se 2 ° C në krahasim me nivelet para-industriale. UNFCCC gjithashtu përcakton parime, krijon organe dhe procedura për të udhëhequr negociatat e ardhshme ndërkombëtare drejt këtij objektivi. UNFCCC ka arritur të sigurojë që ndryshimi i klimës të mbetet një çështje e rëndësishme në krye të axhendës së politikës ndërkombëtare. (Jacob Werksman, Jürgen Lefevere dhe Artur Runge-Metzger, "The EU and International Climate Change", *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Jos Delbeke dhe Peter Vis, (European Union 2016) f. 82.

¹⁴ United Nations Climate Change, The Paris Agreement, në <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement/the-paris-agreement>, aksesuar në Tetor 2019

¹⁵ Michael R. Pompeo, On the U.S. Withdrawal from the Paris Agreement, (U.S Department of State 2016), në <https://www.state.gov/on-the-u-s-withdrawal-from-the-paris-agreement>, aksesuar në nëntor 2019.

Tërheqja e SHBA nga kjo marrëveshje historike ka qenë jo pak e diskutuar duke marrë në konsideratë peshën e SHBA-së në marrëveshjet dhe skenën ndërkombëtare.

Ndërkohë Bashkimi Evropian vendos në prioritetet kryesore të Agjendës së tij politikat për mbrojtjen e mjedisit, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen e gjerë në iniciativat të cilat lidhen me të si dhe investime të larta në këtë fushë.

Referuar “Agjendës strategjike, të vitit 2019-2024”, të Bashkimit Evropian, parashikohet se Evropës i duhet gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri, duke përqafuar ndryshimet e sjella nga tranzicioni i gjelbër, evolucioni teknologjik dhe globalizimi. Sa më shumë që efektet e ndryshimit të klimës bëhen më të dukshme dhe të përhapura, Bashkimi Evropian angazhohet të forcojë veprimin për të menaxhuar këtë kërcënim ekzistencial. Për këtë arsye, BE, mund dhe duhet të udhëheqë rrugën e transformimit të thelluar të ekonomisë dhe shoqërisë së saj, për të arritur neutralitetin e klimës. Politikat e Bashkimit Evropian që prej hyrjes në fuqi janë në përputhje të plotë me Marrëveshjen e Parisit.¹⁶

Bashkimi Evropian nuk mund ta realizojë i vetëm këtë mision që ka rëndësi për gjithë globin ndaj të gjitha vendet duhet të ecin përpara dhe të rritin veprimet e tyre klimatike. Suksesi i tranzicionit të gjelbër do të varet dhe është i lidhur me ekonominë e efektshme dhe një treg të integruar, i ndërlidhur dhe funksional për të siguruar energji të qëndrueshme, të sigurt dhe të përballueshme. BE synon të përshpejtojë kalimin në energji të rinovueshme, të rrisë efikasitetin e energjisë, dhe të zvogëlojë varësinë nga burimet e jashtme, të diversifikojë furnizimet e saj dhe të investojë në zgjidhje më të mira për sfidat e së ardhmes. Në paralel me sa më sipër BE synon, të përmirësojmë cilësinë e ajrit dhe të ujërave të saj, dhe të promovojmë një bujqësi të qëndrueshme, e cila është jetike për të garantuar sigurinë e ushqimit dhe nxitur prodhimin e cilësisë, për të luftuar humbjen e biodiversitetit dhe për të ruajtur sistemet mjedisore, përfshirë oqeanet¹⁷.

Megjithatë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Evropian janë të vetmet entitete politike me kapacitetin për të ushtruar botërisht udhëheqjen në fushën e mjedisit. Koncepti i lidhshpimit global mjedisor është shumëdimensional dhe Shtetet e Bashkuara e kanë mbajtur lidhshpimin në disa fusha të rregullimeve mjedisore të brendshme¹⁸

Referuar statistikave mbi ndotjen e mjedisit rezulton se BE është emetuesi i tretë më i madh i gazrave serë në botë pas Kinës dhe Shteteve të Bashkuara i ndjekur nga India, Rusia dhe Japonia (2015). Brenda BE-së, gjashtë emetuesit kryesorë në 2017 ishin Gjermania, Mbretëria e Bashkuar, Franca, Italia, Polonia dhe Spanja. Sektori i energjisë ishte përgjegjës për 80.7% të emetimeve të gazrave serë në BE në vitin 2017, ndërsa industria për 8,7%, e ndjekur nga bujqësia (8.72%), industria (7.82%) dhe sektori i mbeturinave (2.75%). Në vitin 2008 BE vendosi një objektiv për të ulur emetimet e gazrave serë me 20% deri në vitin 2020 në krahasim me nivelet e 1990. Progres i madh është arritur në këtë drejtim ku në vitin 2015 kishte një rënie prej 22% të emetimit të gazrave serë në krahasim me nivelet e 1990. Në vitin 2014, BE vendosi një objektiv të ri për të zvogëluar emetimet e gazrave serë me të paktën 40% deri në vitin 2030, në krahasim me nivelet e 1990. Sipas Agjencisë Evropiane të Mjedisit, uljet e parashikuara

¹⁶ European Council, A new Strategic Agenda 2019-2024 në <https://www.consilium.europa.eu/media/39914/a-new-strategic-agenda-2019-2024.pdf>, aksesuar në nëntor 2019.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Klemen, “Tregtimi i vendeve: Roli i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian në Politikat Ndërkombëtare të Mjedisit” f. 57-58

bazuar në statistikat e vitit 2017 janë poshtë objektivit të vendosur. Kjo agjenci vlerëson se do të ketë një ulje prej rreth 30% të emetimit të gazrave serë në vitin 2030.¹⁹

3. Siguria mjedisore si një element i rëndësishëm i politikave të sigurisë në Bashkimin Evropian

Mjedisi global i sigurisë po ndryshon shpejt dhe në mënyrë të vazhdueshme. Këto tipare e bëjnë atë vështirësisht të parashikueshëm dhe i japin larmi gamës së rreziqeve mbizotëruese. Gjatë dekadës së ardhshme parashikohet që rreziqet do të kenë natyrë kryesisht asimetrike dhe hibride të gjeneruar nga aktorë shtetërorë, joshtetërorë apo nga shtete të dështuara.²⁰

Siguria mjedisore u shfaq si koncept dhe njëkohësisht si grup politikash si rrjedhojë e fundit të Luftës së Ftohtë. Për pasojë, njëherazi u hapën debate të reja rreth natyrës së kërcënimit, objektivit të sigurisë të referuar dhe gjithashtu kuptimit të vetë sigurisë. Siguria mjedisore u bë shpejt një nga çështjet më të njohura në këtë periudhë të re të studimeve të sigurisë. Megjithëse aktualisht është anashkaluar nga 'lufta mbi terrorin', lidhja e mundshme ndërmjet ngrohjes globale dhe sigurisë i jep një intensitet të ri debatit mbi sigurinë mjedisore²¹.

Emetimet e gazrave serë nuk kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut, ato nuk janë të dukshme dhe nuk kanë erë. Për më tepër, ndryshimi i klimës është një problem mjedisor me të vërtetë global, pasi nuk ka aspak rëndësi se ku emetohen gazrat serë - ato kanë të njëjtin ndikim në mjedis. Emetimet e tilla, të gazrave serë, lidhen kryesisht me përdorimin e karburanteve fosile që janë përdorur gjerësisht që nga revolucioni industrial që filloi në Evropë në fund të shekullit 18-të, kryesisht qymyr dhe më vonë naftë dhe gaz. Në dritën e pasigurive të shfaqura në fillim të viteve 1980, një nga vendimet më të rëndësishme në nivelin ndërkombëtar ishte të krijonte në 1988 Panelin Ndërqeveritar për Ndryshimin e Klimës (IPCC), si një forum për shkencëtarët në botë, për të dalë me konkluzione dhe pikëpamje konsensuale mbi atë që mund të thotë shkenca e klimës²².

Ideja që çështjet mjedisore mund të çojnë në konflikte të dhunshme ka marrë vëmendje të veçantë në literaturën e sigurisë mjedisore dhe sot ekzistojnë disa qasje konkurruese ndaj konfliktit mjedisor. Më e përhapura nga këto përqendrohet në rolin e pamjaftueshmërisë mjedisore si një variabël i pavarur në konflikt të dhunshëm. Kjo tezë është zhvilluar më shumë nga të ashtuquajturit "Grupi i Torontos" nën drejtimin e Thomas Homer-Dixon. Që nga viti 1989, ky grup ka ndërmarrë një seri rastesh studimore (duke përfshirë Meksikën, Pakistanin, Ruandën dhe Afrikën e Jugut) dhe zhvilluan tezën se kur mungesa e burimeve të rinovueshme (si tokat dhe uji i liqenit) ndërvepron me efekte të ashpra sociale (për shembull, zhvendosjen e popullsisë ose rënien ekonomike) mund të çojë në konflikt ndërshtetëror. Në këtë formulim, koncepti i pamjaftueshmërisë mjedisore është formuluar shumë gjerë. Kështu Homer-Dixon e

¹⁹ European Parliament, Climate change in Europe: facts and figures, 2018, në <https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/society/20180703ST007123/climate-change-in-europe-facts-and-figures>, aksesuar në tetor 2019.

²⁰ Republika e Shqipërisë, *Strategjia e sigurisë kombëtare*, Tiranë, korrik 2014, f. 23.

²¹ Rita Floyd, "Debatit për sigurinë mjedisore dhe rëndësia e tij për ndryshimet klimaterike" në *Çështje Europiane dhe të sigurisë*, (Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim 2011) f. 80

²² Jos Delbeke "EU climate leadership in a rapidly changing world" f. 4.

interpreton “të gjitha llojet e varfërimit ose dëmtimit mjedisor si forma të ndryshme të pamjaftueshmërisë së burimeve të rinovueshme. Shpyllëzimi rrit pamjaftueshmërisë e burimeve pyjore, ndotja e ujit rrit pamjaftueshmërisë e ujit të pastër, dhe ndryshimet klimaterike rrisin pamjaftueshmërinë e regjimit të reshjeve dhe temperaturës në të cilat mbështeten fermerët. Një koncept kryesor në punën e Homer-Dixon-it mbi pamjaftueshmërinë që nxit konflikt mjedisor, është ai i *kapjes së burimit*: ideja është që *pamjaftueshmëria mjedisore* inkurajon grupet e fuqishme për të kapur burimet e çmuara mjedisore dhe shtyn grupet marginale për të emigruar në zonat ekologjikisht të ndjeshme. Këto dy procese, nga ana tjetër, përforcojnë pamjaftueshmërinë mjedisore dhe rrisin potencialin për paqëndrueshmëri sociale.²³

Siguria njerëzore mund të thuhet se ka dy aspekte kryesore. Së pari, ajo nënkupton siguri nga kërcënime të tilla kronike si uria, sëmudjet dhe represioni. Dhe së dyti, ajo do të thotë mbrojtje nga trazirat e papritura dhe që dëmtojnë modelet e jetës së përditshme. Në këtë përkufizim pra, siguria njerëzore ka të bëjë me pasigurinë e përditshme të njerëzve e shkaktuar jo vetëm nga konflikti, por edhe nga kushtet e këqija të jetesës të atyre në pozita të pafavorshme. Në literaturën akademike, ekziston një debat i madh nëse siguria njerëzore duhet të lidhet vetëm me të parën më sipër, “liri nga frika”, apo nëse ajo duhet të përfshijë edhe “lirinë nga të dëshiruarit”. Raporti i UNDP-së identifikon shtatë “fusha” të ndryshme të sigurisë njerëzore – siguria mjedisore (shpesh, në formën e pasojave të katastrofave mjedisore) është një prej tyre. Këtu, qartazi, ekuacioni i sigurisë nuk përfshin çështje që lidhen me ushtrinë, por situata aq të vështira sa ato janë ekuivalente me luftën. Në literaturën e sigurisë mjedisore ka shumë autorë që përkrahin idenë se kërcënimet e mjedisit nuk njohin kufij territorialë, siguria e vërtetë e mjedisit mund të arrihet vetëm nëse siguria mjedisore largohet nga kërcënimi shtet-centrik dhe lidhja me mbrojtjen. Përkrahësit e qasjes së sigurisë njerëzore për sigurinë mjedisore, pra, fokusohen në çështje të tilla si ndërvarësia ekologjike, të drejtat e njeriut, ndikimi i globalizimit dhe efekti i modelit të konsumit të Veriut ndaj Jugut global. Për ata, natyra e kërcënimit rrjedh nga rreziqet e degradimit afatgjatë të mjedisit, të tilla si ngrohja globale, zmadhimi i shtresës së ozonit, zhdukja e specieve të rralla, ndotja e ajrit dhe ujit, dhe humbja e biodiversitetit të cilat janë nga natyra jo të dhunshme. Në këtë qasje, siguria mjedisore mund të përcaktohet më mirë si: “Procesi i reduktimit në mënyrë paqësore të vulnerabilitetit të njeriut në nxitjen prej tij të degradimit të mjedisit duke adresuar shkaqet e degradimit të mjedisit dhe pasigurisë njerëzore”.²⁴

Mund të identifikohen një sërë faktorësh kyç që mund të ndihmojnë në integrimin e mjedisit në politikat e sigurisë në një nivel më operacional: rritja e bazës së njohurive, kapaciteteve dhe ndërgjegjësimiti. Të kuptuarit e rolit që luan mjedisi në konflikte, nga parandalimi deri në situatat pas konfliktit, po rritet vazhdimisht. Për shembull, janë duke u realizuar studime të mëtejshme për të kuptuar më mirë bashkëveprimin midis faktorëve të ndryshëm që qëndrojnë pas migrimit (ndryshimi i klimës, situata socioekonomike). Në mënyrë të ngjashme, njohuritë mbi “mekanizmat” e ekosistemeve për ruajtjen e kushteve të favorshme mjedisore dhe sigurimin e stabilitetit duke u bërë gjithnjë e më konkrete, lejojnë zhvillimin e zgjidhjeve më të mira për të mbështetur sigurinë njerëzore dhe kombëtare.²⁵

²³ Rita Floyd “Debati për sigurinë mjedisore dhe rëndësia e tij për ndryshimet klimaterike”, f. 84.

²⁴ Po aty, f. 87-88.

²⁵ Marianne Kettunen, Dominique Noome, Johanna Nyman, Ronald A. Kingham, “Changing the paradigm: drivers, barriers and windows of opportunity”, në *Draft Reinforcing the Environmental Dimensions of the European Foreign and Security Policy*, (Institute European Environmental Policy 2018) f. 6.

BE-ja ka një kornizë të dedikuar politikash për bashkëpunim me vendet e saj fqinje (politika e fqinjësisë së BE) e cila mund të sigurojë një pikënisje tjetër të mundshme për bashkëpunim të përkushtuar për çështje të lidhura me sigurinë mjedisore. Një varg projektesh të orientuara ndaj mjedisit janë zbatuar nën kujdesin e kornizës së politikave të fqinjësisë, për shembull politikat e lidhura me sigurinë e energjisë dhe ujit. BE-ja ka ndërtuar dhe ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në fushën e diplomacisë së ujit, duke përmendur këtu fillimin e *Iniciativës së BE-së për ujin*, në 2002, që ka çuar në një numër të sukseseve konkrete në promovimin e politikave të qëndrueshme të ujit, veçanërisht në vendet fqinje të BE-së.²⁶

4. Rëndësia e klimës në sigurinë mjedisore e shprehur në statistika

Referuar studimeve dhe të dhënave statistikore të Organizatës Botërore të Shëndetit, zyra rajonale për Evropën, vërejmë se ndryshimet klimatike janë të lidhura ngushtësisht me sigurinë e mjedisit. Ndryshimet e klimës sjellin pasoja të rënda sociale, ekonomike shëndetësore për individët, por edhe politike për vende të ndryshme duke marrë në konsideratë numrin e lartë të migruesve të cilët braktisin zonat ku këto ndryshime rrezikojnë jetën e tyre në formën e epidemive, ndotjes së ujit të pijshëm apo problematikave me ushqimet. Në vende të tjera, ndryshimet klimatike janë shoqëruar me ndotjen e ajrit, duke ulur kështu cilësinë e jetesës së njerëzve në rajonet më të prekura apo duke u shndërruar dhe në një kërcënim për të kur marrim në konsideratë faktin se ndryshimet klimatike ndikojnë dhe në ndryshimet ekstreme të motit shoqëruara me përmbytje apo valë të larta të së nxehtit.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit, nisur nga parashikimet e deritanishme, thatësisht do të rriten fuqimisht në frekuencë dhe intensitet dekadat e ardhshme në zona të mëdha të Evropës Jugore dhe Juglindore (të gjitha vendet mesdhetare, Bullgaria, Hungaria, Portugalia, Republika e Moldavisë, Rumania, Ukraina dhe pjesa jugore e Federatës Ruse). Nëse nuk ndërmerret asnjë veprim, produktiviteti ushqimor parashikohet të ulet në zonën e Mesdheut, Evropën Juglindore dhe Azinë Qendrore, duke kërcënuar sigurinë ushqimore në këto zona. Rendimentet e të korrave mund të ulen deri në 30% në Azinë Qendrore deri në mesin e shekullit XXI. Kjo mund të çojë në përkeqësim të kequshqyerjes, veçanërisht në mesin e të varfërve në zonat rurale.²⁷

Ndryshimi i klimës gjithashtu rrit frekuencën dhe intensitetin e ndryshimeve ekstreme të motit duke sjellë pasoja të shumta. Përmbytjet në rajonin evropian preken 3.4 milion njerëz dhe më shumë se 1000 persona humbën jetën në periudhën 2000 deri në 2011. Ndryshimet klimatike parashikohet të rritin shfaqjen dhe shpeshtësinë e përmbytjeve në zona të ndryshme të Evropës. Pa marrjen e masave në përshtatje me këtë problematikë, statistika e numrit të njerëzve të prekur potencialisht nga përmbytjet, çdo vit, deri në vitin 2085 mund të rritet nga 775 000 në 5.5 milion.

Intensiteti i stuhive të shiut është rritur në të gjithë Evropën gjatë 50 viteve të fundit dhe vlerësohet se reshjet e dendura do të rriten në frekuencë dhe intensitet në dekadat e ardhshme. Reshjet e mëdha rritin erozionin dhe mundësinë e përmbytjes. Në vitin 2003, rajoni evropian pësoi valën e tij më të fortë të nxehtit. Mbi 70 000 vdekje u

²⁶ Po aty, f. 7

²⁷ World Health Organization Regional Office for Europe, Data and Statistics, në <http://www.euro.who.int/en/health-topics/environment-and-health/Climate-change/data-and-statistics>, aksesuar në nëntor 2019.

raportuan nga 12 vende evropiane. Pa marrjen e masave, vdekshmëria në lidhje me nxehtësinë parashikohet të rritet në të gjithë Evropën, veçanërisht në Jugun e saj.²⁸

Ndryshimi i klimës ndikon drejtpërdrejtë në ndotjen e ajrit. Ndotja e ajrit shkakton dhe përkeqësohet nga ndryshimi i klimës. Përveç dyoksidit të karbonit (CO₂), djegia e karburanteve fosile prodhon një gamë të gjerë ndotësish ajri të cilat kanë efekte si në ngrohjen dhe në ftohjen globale. Disa nga këta ndotës përbëjnë pjesën më të madhe të dëmeve të drejtpërdrejta për shëndetin e njeriut të cilat vijnë si rezultat i përdorimit të energjisë në rang global. Mbi 80% e evropianëve janë të ekspozuar ndaj përqendrimeve të grimcave të këtyre lëndëve që tejkalojnë *Udhëzimet e cilësisë së ajrit* të OBSH-së, duke zvogëluar jetëgjatësinë e secilit qytetar me një mesatare prej gati 9 muajsh.²⁹

Ngrohja globale mund të rrisë sëmundjet që mbarten me ushqimin dhe ujin. Disa patogjenë lulëzojnë në temperatura të ngrohta, të cilat mund të kontribuojnë në një rritje të sëmundjeve të cilat transmetohen nga ushqimi dhe nga uji. Për shembull, deri në periudhën 2071-2100, ndryshimi i klimës mund të shkaktojë 50% raste shtesë të lidhura me temperaturën e infeksionit “salmonela” sesa mund të pritej pa qenë prezent problematika e ndryshimeve klimatike.³⁰

Pra, nuk mund të flasim për sigurinë mjedisore pa marrë në konsideratë dhe atë klimatike. Pjesa më e madhe e problematikave që shoqërojnë mjedisin vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike. Për këtë arsye këto ndryshime shihen me shumë shqetësim jo vetëm nga organizata të ndryshme ndërkombëtare, por janë shndërruar dhe në prioritet të agjendave politike të vendeve të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të saj më të ngushtë.

5. Konkluzione

BE me politikat e saj ambicioze është angazhuar për të zvogëluar emetimet e gazrave serë. Por problematikën e ndryshimit të klimës BE nuk mund ta zgjidhë e vetme³¹ ndaj bashkëpunimi është një element vendimtar për të arritur suksesin në këtë fushë.

Modeli i sigurisë dekadat e fundit ka ndryshuar duke marrë në konsideratë ndryshimet klimatike, karakterin e konflikteve, migracionin, zhvillimet teknologjike. Njëkohësisht dhe qasja dhe përballja me këto ndryshime parashtron kërkesën për zgjidhje dhe iniciativa të reja gjithëpërfshirëse për të adresuar sfidat që burojnë prej tyre.

Roli i BE-së bëhet i ndjeshëm në arenën ndërkombëtare pas viteve 1980, më veçanërisht me hyrjen në fuqi të Aktit Unik Evropian (“Single European Act”) 1987 duke parashkuar një titull specifik në këtë traktat për mjedisin. Këto parime dhe iniciativa do të shihen të zhvilluara më tej në “Traktatin e Mastrohitit” (1993) dhe të atë të Amsterdimit, në vitin 1999. Në vitet në vijim, janë analizuar mënyrat më të mira për t’i bërë sa më efektive iniciativat në fushën dhe mbrojtjen e mjedisit në BE, ndonjëherë duke dështuar por gjithmonë duke nxjerrë mësim të vlefshme ku transparenca në bërjen e politikave, konsultimi i gjerë i palëve të interesuara, shmangia e mbivendosjes së instrumenteve politikë, janë përdorur si shembull dhe për vendet e tjera, duke parë intensitetin dhe peshën që kjo çështje ka marrë ndër vite dhe në politikat e momentit themi me bindje se Bashkimi Evropian është shndërruar në një lider botëror të mbrojtjes

²⁸ Po aty.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

³¹ Miguel Arias Cañete, *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Jos Delbeke dhe PeterVis, (European Union 2016)

së mjedisit dhe klimës.

Që nga vitet 1990, BE ka luajtur një rol kryesor në zhvillimin e politikës ndërkombëtare të ndryshimit të klimës. Politika ndërkombëtare e ndryshimit të klimës, gjatë njëzet viteve të fundit, ka formësuar politikën e brendshme të BE-së. Kjo dinamikë pasqyron angazhimin e fortë të BE-së për një përgjigje shumëpalëshe ndaj ndryshimeve klimatike. Ajo gjithashtu pasqyron mirëkuptimin e BE-së, se nuk mund të luftojë me sukses vetë ndryshimet klimatike. Prandaj, është e nevojshme që të inkurajojë shtetet e tjera dhe të krijojë partneritete me to. Politika ambicioze e klimës evropiane, do të varet gjithnjë e më shumë, nga pjesa tjetër e botës që vepron kolektivisht dhe me ambicie të krahasueshme, për zvogëlimin e emetimeve të gazrave serë. Në fazat kryesore të zhvillimit të politikës ndërkombëtare të ndryshimit të klimës, veçojmë *Konventën kornizë të Kombeve të Bashkuara për ndryshimin e klimës e 1992* (UNFCCC), *Protokollin e Kyoto-s 1997*, dhe *Marrëveshjen e Parisit*, të vitit 2015. Gjatë gjithë këtyre negociatave, BE-ja, së bashku me vendet e tjera progresive, ka bërë thirrje për marrëveshje ndërkombëtare që janë: (i) ambicioze dhe gjithëpërfshirëse, duke siguruar që të gjitha vendet të luajnë një rol në zvogëlimin e emetimeve të gazrave serë në përputhje me ato që shkencën dëshmon se është e nevojshme; (ii) të drejta, duke marrë parasysh përgjegjësitë, aftësitë dhe dobësitë e ndryshme të vendeve në nivele të ndryshme të zhvillimit ekonomik; dhe (iii) të qëndrueshme, duke siguruar një bazë të fortë ligjore për t'i mbajtur përgjegjës të gjitha vendet për angazhimet që ata bëjnë³².

Politikat mjedisore marrin një peshë të rëndësishme në kontekstin e politikave të sigurisë, pas viteve 1990. Ekzistojnë qasje dhe pikëpamje të ndryshme në lidhje me mënyrën se si ndryshimet klimatike dhe çështjet mjedisore mund të çojnë në konflikte të dhunshme e ndonjëherë ndërshtetërore, duke u bazuar te pamjaftueshmëria e burimeve.

Prioritetet për politikën e sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së përfshijnë rritjen e reagimit të Bashkimit ndaj konflikteve dhe krizave të jashtme përmes përgjegjësisë në të gjitha fazat e ciklit të konfliktit, ndërsa kontribuojnë sistematikisht në aftësinë e qëndrueshmërisë dhe stabilizimin e vendeve partnere. Për më tepër, mbrojtja civile dhe reagimi ndaj fatkeqësive natyrore brenda BE-së gjithashtu mbeten një përparësi kryesore e kësaj politike. Këto përparësi shtrihen dhe me operacione të ndryshme jashtë kufijve të BE-së, në mënyrë direkte ose indirekte, duke adresuar shkaqet rrënjësore të konflikteve dhe parandalimin e efekteve “spill-over” në BE. BE-ja kontribuon gjithashtu në zbutjen e konflikteve dhe të krizave, duke u përqendruar në adresimin e të gjitha dimensioneve dhe fazave të një konflikti, veçanërisht në fazat e tij të hershme, duke njohur në mënyrë të qartë ndërlidhjet midis ndryshimit të klimës, katastrofave natyrore, degradimit të mjedisit dhe problematikat shoqërore e politike. Sa i përket elementit më të rëndësishëm të politikës së jashtme, ndërsa siguria dhe mbrojtja janë përbërës thelbësorë të saj, është e njohur që këto politika mund të japin rezultate të suksesshme vetëm kur vendosen përkrah politikave të tjera të rëndësishme (p.sh. zgjerimi, zhvillimi, tregtia, migracioni, energjia, klima dhe mjedisi).³³

Identifikimi i suksesshëm i partnerëve kryesorë me të cilët do të çohet përpara

³²Jacob Werksman, Jürgen Lefevere dhe Artur Runge-Metzger “ The EU and International Climate Change” *Eu Policy Explained* , Redaktuar nga Jos Delbeke and PeterVis, (European Union 2016) f. 81.

³³Marianne Kettunen, Dominique Noome, Johanna Nyman, Ronald A. Kingham, “Changing the paradigm: drivers, barriers and windows of opportunity”, në *Draft Reinforcing the Environmental Dimensions of the European Foreign and Security Policy*, (Institute European Environmental Policy 2018).

³⁴Po aty, f. 7-8.

agjenda e politikës mjedisore luan një rol vendimtar për BE-në, si në arenën ndërkombëtare, ashtu edhe në vendet anëtare. Një numër i shteteve anëtare kanë integruar tashmë ndryshimin e klimës në agjendën e tyre të sigurisë kombëtare. Në kontekstin e jashtëm, diplomacia mjedisore mund të përdoret për të identifikuar partnerët dhe forume të përshtatshme për të ndërmarrë veprime politike në këtë fushë. Instrumenti i partneritetit të BE-së mund të sigurojë një rrugë të mirë për bashkëpunimin në terma afatgjatë, për të mbështetur politikën e sigurisë mjedisore dhe për ta shndërruar atë në një përparësi në agjendën e vendit partner (p.sh. duke e paraqitur si një zonë mbështetëse për zhvillimin e bashkëpunimit me BE-në)³⁴.

Bashkëpunimi mjedisor mes shteteve shihet si një opsion i rëndësishëm i zgjidhjes paqësore të problematikave duke qenë se interesat e përbashkëta mjedisore mund ta zgjerojnë këtë bashkëpunim edhe në fusha të tjera.

Bibliografi

1. Ambasada e Francës në Tiranë, Dita e Tokës dhe Marrëveshja e Parisit , në <https://al.ambafrance.org/Dita-e-Tokes-dhe-Marreveshja-e-Parisit>.
2. Miguel Arias Cañete, *Eu Policy Explained*, Redaktuar nga Delbeke, Jos dhe Vis, Peter, European Union 2016.
3. Delbeke, Jos dhe Vis, Peter “ EU climate leadership in a rapidly changing world” në *Eu Policy Explained* , Redaktuar nga Delbeke, Jos dhe Vis, Peter, European Union 2016.
4. Delbeke, Jos dhe Vis, Peter *Eu Policy Explained* , Redaktuar nga Delbeke , Jos dhe Vis, Peter , European Union 2016.
5. Dixon, T. Homer Environment, Scarcity, and Violence. Princeton: Princeton University Press, 1999.
6. Dixon, T. Homer, The Project on Environment, Population and Security: Key Findings of Research , Environmental Change and Security Project Report no. 2.
7. Washington DC: Woodrow Wilson Center, 1996.
8. European Commission, Changing Security Paradigm, në https://ec.europa.eu/knowledge4policy/foresight/topic/changing-security-paradigm_en
9. European Commission, Environmental Security, në https://ec.europa.eu/knowledge4policy/foresight/topic/changing-security-paradigm/environmental-security_en.
10. European Commission, Climate change and you, në https://ec.europa.eu/clima/citizens/eu_en.
11. European Council, A neë Strategic Agenda 2019-2024 në <https://www.consilium.europa.eu/media/39914/a-neë-strategic-agenda-2019-2024.pdf>.
12. European Parliament, Climate change in Europe: facts and figures, 2018 në <https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/society/20180703ST007123/climate-change-in-europe-facts-and-figures>
13. Floyd, Rita” Debati për sigurinë mjedisore dhe rëndësia e tij për ndryshimet klimaterike” në *Çështje Europiane dhe të sigurisë*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim 2011.
14. Klemen, Daniel dhe Vogel, David “Tregtimi i vendeve: Roli i Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian në Politikën Ndërkombëtare të Mjedisit” në *Çështje Europiane dhe të sigurisë*, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim 2011
15. Kettunen, Marianne , Noome, Dominique ,Nyman, Johanna, A. Kingham, Ronald “Changing the paradigm: drivers, barriers and windows of opportunity”, në *Draft Reinforcing the Environmental Dimensions of the European Foreign and Security Policy*, Institute European Environmental Policy 2018.
16. R. Pompeo, Michael, On the U.S. withdrawal from the Paris Agreement, U.S Department of State 2016 , në <https://www.state.gov/on-the-u-s-withdrawal-from-the-paris-agreement>.
17. Republika e Shqipërisë, *Strategjia e Sigurisë Kombëtare*, Tiranë, korrik 2014.
18. United Nations Climate Change, What is the Kyoto Protocol, në https://unfccc.int/kyoto_protocol
19. United Nations Climate Change, The Paris Agreement, në <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement/the-paris-agreement>.
20. Xhafa, Florian , Lako , Thimaq, Kamberi, Geron , Leskaj, Efklo dia , Suti, Enkeleda dhe Qorri, Ilir “Politika e Mjedisit” në *Politikat e Përbashkëta të Bashkimit Europian dhe Shqipëria*, , Instituti AGENDA 2008.
21. Werksman, Jacob , Lefevere , Jürgen dhe Runge-Metzger, Artur “The EU and International Climate Change”, *Eu Policy Explained* , Redaktuar nga Delbeke , Jos dhe Vis, Peter , European Union 2016.
22. World Health Organization Regional Office for Europe, Data and Statistics, në <http://www.euro.who.int/en/health-topics/environment-and-health/Climate-change/data-and-statistics>

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

Mjedisi dhe siguria, parë nga këndvështrimi i NATO-s



■Dr. (proc.) Gjon VORFI
Akademia e Sigurisë
Qendra Kërkimore Shkencore
gjon.vorfi@asp.gov.al

Abstrakt

Traktati i Atlantikut të Veriut (NATO) luan rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare paqësore, në promovimin e stabilitetit, të mirëqenies, si dhe në forcimin e sigurisë. Këtë rol e ka ndjekur që nga viti 1969 përmes Programit shkencor civil të NATO-s. Në vitin 2006 "Programi shkencor" u bashkua në "Programin për një shkencë të re për paqen dhe sigurinë" (SPS). Programi SPS bazohet në aktivitetet bashkëpunuese në shkencë që mund të shërbejnë për të promovuar dialogun paqësor, shkëmbimin e teknologjisë, mirëkuptimin kulturor, në të njëjtën kohë duke kontribuar për paqen përmes kundërveprimit ndaj kërcënimeve të ndryshme për sigurinë në një kuptim të gjerë. Një kërcënim i tillë i adresuar nga programi SPS është ai i ndikimeve të pafavorshme mjedisore që ndodhin në rrethana kur ato mund të kërcënojnë jetesën njerëzore dhe të kontribuojnë në nivelin social dhe pabarazisë ekonomike, paqëndrueshmërisë social-politike, pra të jenë shkak ose shërbejnë për të krijuar tensione dhe konflikte. Duke ndjekur me vëmendje gjendjen ndërkombëtare, Aleanca po i kushton një rëndësi primare, rolin të energjisë dhe përdorimit të saj në operacionet ushtarake, si dhe ndikimit të energjisë në sigurinë e mjedisit dhe më gjerë.

Fjalëkyçe:

NATO, mjedisi, siguria, energjia, ushtria, shkenca.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Në këtë punim do të mundohem të përshkruaj rolin e NATO-s në mbrojtjen dhe promovimin e sigurisë mjedisore në kuadrin e gjerë të sigurisë ndërkombëtare. Megjithëse dihet, prapë duhet theksuar që në hyrje se janë 28 vendet anëtare përfshi Shqipërinë, të cilët përbejnë NATO-n. Në vijim do të ndalem të politikat dhe standardet e NATO-s në lidhje me mjedisin. Në vazhdim do të flas për aktorët, organizmat dhe grupet e punës të krijuara nga vendet anëtare të Aleancës, grupe të cilët kanë funksionuar në vazhdimësi, duke u përshtatur me zhvillimet dhe ndryshimet e reja në arenën ndërkombëtare që nga krijimi i NATO-s.

Të gjithë vendet anëtare kontribuojnë me burime financiare dhe njerëzore, duke venë në dispozicion dhe bashkëpunuar me kapacitete, forca dhe mjete ushtarake, duke ofruar dhe territoret e vendit të tyre për përdorim nga Aleanca. Do të nënvizojmë se Aleanca e Atlantikut të Veriut e ka shtrirë bashkëpunimin më gjerë me shumë vende partnere dhe aleate përtej Atlantikut, duke rritur kështu rolin dhe rëndësinë e saj në arenën ndërkombëtare. Në këtë punim një vend të konsiderueshëm zë edhe energjia si faktor shumë i rëndësishëm jo vetëm për NATO-n, por dhe për ekonominë e secilit vend në veçanti, mbi rolin e energjisë në aktivitetet ushtarake të Aleancës, mbi ndikimet në e saj në sigurinë në përgjithësi, si dhe në sigurinë e mjedisit në veçanti. Në mbyllje të punimit do të ofrojmë në formë rekomandimesh disa mendime lidhur me mjedisin dhe sigurinë parë nga këndvështrimi i NATO-s.

Sot, zona Euroatlantike është në paqe dhe kërcënimi me sulm konvencional kundër territorit të NATO-s është i ulët, megjithatë ky kërcënim konvencional nuk mund të shpërfilllet.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg i ftuar në Qendrën për Studime

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

Strategjike dhe Ndërkombëtare (CSIS) në Uashington D. C., në nëntor 2019, flet për: “Mjedisin tonë të ndryshuar të sigurisë dhe atë që ne si bashkësi transatlantike duhet të bëjmë në lidhje me ndryshimin e mjedisit të sigurisë, për sfidat në rritje me të cilat po përballemi, si një pikë kthese për sigurinë euro-atlantike”.¹

Kurse në raportin vjetor 2018-2019 “NATO: Gati për të ardhmen”, ai deklaron: “Në vitin 2019, ne festuam shtatëdhjetë vjet të Aleancës sonë. Për shtatë dekadat e fundit Aleanca Transatlantike, të cilën e mishëron NATO-ja, ka sjellë paqe dhe prosperitet të paparë në zonën euro-atlantike. Sot, ne përballemi me mjedisin më të ndërlikuar dhe të paparashikueshëm të sigurisë që nga fundi i Luftës së Ftohtë: me konkurrencë në rritje gjeopolitike, kërcënime kibernetike dhe hibride më të sofistikuar dhe përçarëse, dhe ndryshimi eksponencial teknologjik duke shndërruar me shpejtësi mënyrën se si luftohen dhe fitohen luftërat.”²

Në fakt, përhapja e armëve bërthamore dhe armëve të tjera të shkatërrimit në masë, terrorizmi, paqëndrueshmëria dhe konfliktet përtej kufijve të NATO-s, sulmet pirate kompjuterike, teknologjitë e reja, rreziqet për shëndetin, ndryshimet klimaterike, mungesat e ujit dhe rritja e nevojës për energji do të formojnë mjedisin e ardhshëm të sigurisë në zonat me interes për NATO-n. Këto natyrisht pritet të kenë efekte të mëdha globale, të cilat do të ndikojnë në zhvillimet e ardhshme të marrëdhënieve ndërkombëtare, në rolin politik të NATO-s, si dhe në planifikimin e operacioneve të ardhshme ushtarake të saj.

Në “Konceptin strategjik” të vitit 1999 shkruhet se: “NATO luan një rol kryesor në identifikimin dhe adresimin e sfidave të sigurisë aktuale dhe në zhvillim duke pranuar se bota përballlet me shumë sfida mjedisore.”³ Aleanca zyrtarisht njohu sfidat natyrore mjedisore me të cilat përballlet bashkësi ndërkombëtare në vitin 1969, kur themeloi Komitetin për Sfidat e Shoqërisë Moderne (CCMS). Ky komitet, në vitin 2006 u bashkua me “Programin e shkencës për paqe dhe siguri” të NATO-s (SPS), bashkim që siguroi një forum unik për NATO-n dhe vendet partnere të saj, duke shkëmbyer njohuri dhe përvojë për çështje sociale, shëndetësore dhe mjedisore, si në sektorin civil ashtu edhe atë ushtarak.

NATO-ja, aktualisht po shikon nga afër se si t’i adresojë më mirë rreziqet mjedisore ndaj sigurisë në përgjithësi, si dhe ato që ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetet ushtarake. Aleanca po i zbaton këto nisma përmes programit të saj “Shkencë për paqe dhe siguri” (SPS), Qendrës Koordinuese Euro-Atlantike për Reagimin e Fatkeqësive (EADRCC) dhe projekteve e “Fondit të partneritetit për paqe”. Aleanca po shqyrton forcimin e përpjekjeve në këtë fushë, me një fokus në emergjencat civile, efikasitetin e energjisë dhe fuqinë e rinovueshme, si dhe konsultimin me organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe ekspertët e NATO-s mbi ndryshimin e klimës. Në veçanti, Aleanca është duke punuar për të zvogëluar efektet mjedisore të aktiviteteve ushtarake dhe t’i përgjigjet sfidave të sigurisë që burojnë nga mjedisi.

Me kalimin e viteve, vendet aleate kanë krijuar disa grupe pune të NATO-s për të

¹ By NATO Secretary General Jens Stoltenberg, *Keynote address at the NATO Industry Forum*, Washington D.C. NATO Webpage 14 Nov 2019

Link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_170786.htm?selectedLocale=en

² Jens Stoltenberg NATO Secretary General, “NATO: READY FOR THE FUTURE Adapting the Alliance” Progress Report (2018-2019), Published at NATO webpage, 29 Nov 2019

Link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_171337.htm

³ “The Alliance’s Strategic Concept” Approved by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. 24 Apr 1999, published at NATO Homepage at link: (https://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_27433.htm)

adresuar sfidat mjedisore përmes aktiviteteve dhe këndvështrimesh të ndryshme. Në lidhje me mjedisin natyror, aktivitetet aktuale të NATO-s përfshijnë: mbrojtjen e mjedisit nga efektet e dëmshme të operacioneve ushtarake, promovimin e praktikave të menaxhimit miqësor të mjedisit në fushat e trajnimit dhe gjatë operacioneve, edukimin e oficerëve të NATO-s për të gjitha aspektet e sfidave mjedisore si dhe adaptimi i pasurive ushtarake në një mjedis fizik miqësor. Po kështu, NATO-ja përgatitet për të reaguar ndaj fatkeqësive natyrore dhe ato të bëra nga njeriu, për adresimin e ndikimit që rrjedh nga ndryshimi klimës, mbështetjen e vendeve partnere në ndërtimin e aftësive lokale, rritjen e efikasitetit të energjisë dhe pavarësisë më karburante fosile si dhe ndërtimin e infrastrukturave miqësore me mjedisin.⁴ Të gjitha këto aktivitete përfshihen në dy kategori të gjera:

- mbrojtja e mjedisit: mbrojtja fizike dhe natyrore nga ndikimi i dëmshëm i aktiviteteve ushtarake;
- siguria mjedisore: trajtimi i sfidave të sigurisë që burojnë nga mjedisi fizik dhe natyror.

2. NATO dhe mbrojtja e mjedisit

Aktivitetet ushtarake shpesh mund të kenë efekt negativ në mjediset në të cilat zhvillohen. Dëmtimi i mjedisit nga këto aktivitete mund të kërcënojë jetesën dhe kushtet natyrore dhe të krijojë paqëndrueshmëri, pakënaqësi të popullata si dhe rrezik për konflikte. Që në vitet '60 ekspertët e mjedisit kanë argumentuar dhe kërkuar që forcat ushtarake të marrin masa për të mbrojtur mjedisin fizik dhe natyror nga efektet e dëmshme të veprimtarive të tyre. Degradimi i mjedisit mund të shkaktojë paqëndrueshmëri sociale dhe ekonomike dhe tensione të reja, ndërsa ruajtja e mjedisit gjatë një operacioni ushtarak mund të përmirësojë stabilizimin dhe të nxisë sigurinë e qëndrueshme. Prandaj, minimizimi i dëmit mjedisor gjatë stërvitjes dhe operacioneve ushtarake është me rëndësi të madhe për suksesin e përgjithshëm të misionit. Për shembull, faktorët mjedisorë mund të ndikojnë në furnizimin me energji si për popullsinë ashtu edhe për operacionet ushtarake, dhe kjo e bën sigurinë e energjisë një temë kryesore e shqetësuese për Aleancën.

Vendet anëtare të NATO-s janë të vetëdijshme për sfidat mjedisore gjatë operacioneve ushtarake dhe ato kanë miratuar rregulla dhe rregullore për të mbrojtur mjedisin. Megjithatë secili vend anëtar mban përgjegjësi për forcat e veta, një pjesë e përgjegjësisë është e NATO-s që të mbrojtë mjediset fizike dhe natyrore ku zhvillohen operacione dhe trajnime.

Gjatë aktiviteteve të drejtuara nga NATO-ja, masat në mbrojtje të mjedisit ku veprojnë, përfshijnë: mbrojtjen nga materialet e rrezikshme (përfshirë karburantet dhe vajrat), trajtimin e ujërave të zeza, zvogëlimin e konsumit të lëndëve djegëse fosile dhe menaxhimin e mbeturinave deri në vendosjen e sistemeve të menaxhimit mjedisor. Në përputhje me këto objektiva, NATO-ja ka lehtësuar integrimin e masave të mbrojtjes së mjedisit në të gjitha aktivitetet ushtarake të drejtuara nga NATO-ja duke hartuar politika dhe standarde për mbrojtjen e mjedisit.

⁴ NATO Homepage: "Environment – NATO's stake". Last updated 09 Dec 2014 link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_91048.htm

3. Politikat dhe standardet e NATO-s për mbrojtjen e mjedisit

NATO-ja filloi të zhvillojë politikën e saj për mbrojtjen e mjedisit në fund të viteve 1970 kur u krijuan grupet e ekspertëve të NATO-s për të adresuar sfidat mjedisore, duke rezultuar në një numër procesesh, udhëzimesh dhe standardesh. Politika e NATO-s kërkon që forcat e drejtuara nga NATO-ja “duhet të përipiqen të respektojnë parimet dhe politikat mjedisore në të gjitha kushtet”.⁵ Aktualisht, dy grupe të dedikuara të NATO-s po trajtojnë mbrojtjen e mjedisit ndërsa promovojnë bashkëpunimin dhe standardizimin midis NATO-s dhe vendeve partnere, si dhe midis organeve të ndryshme të NATO-s dhe organizatave ndërkombëtare, të cilët marrin pjesë rregullisht si vëzhgues.

Grupi i punës për mbrojtjen e mjedisit (nën varësinë e bordit të përbashkët të standardizimit të Komitetit Ushtarak që raporton te Komiteti Ushtarak), synon të zvogëlojë ndikimet e mundshme të dëmshme të aktiviteteve ushtarake në mjedis, duke zhvilluar politikat e NATO-s, dokumentet e standardizimit, udhëzimet dhe praktikat më të mira në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve dhe stërvitjeve. Ndërsa ekipi specialistëve për efikasitetin e energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit (që raporton përmes Grupit të Armatimit të Forcës Detare të NATO-s në “Konferencën e drejtorëve kombëtarë të armatimit”), synon të integrojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit dhe efikasitetit të energjisë më kërkesat teknike dhe specifikimet për armatime, pajisje dhe materiale në anije, duke kërkuar që anijet të pajisën për ndërveprim më forcat detare të Aleatëve dhe vendeve partnere.

Dy dekada aktiviteteve nga grupet e ekspertëve i kanë hapur rrugën dokumentit gjithëpërfshirës (MC – 469) mbi parimet ushtarake të NATO-s dhe politikave për mbrojtjen e mjedisit. Versioni i parë u miratua nga Komiteti Ushtarak i NATO-s në 2003, dhe një version i azhurnuar është aprovuar në tetor 2011. Ky dokument përshkruan përgjegjësitë e komandantëve ushtarakë për mbrojtjen e mjedisit gjatë përgatitjes dhe ekzekutimit të veprimtarive ushtarake. Më tej, dokumenti njih nevojën për “një harmonizim të parimeve dhe politikave mjedisore për të gjitha aktivitetet ushtarake të udhëhequra nga NATO-s”,⁶ dhe udhëzon komandantët e NATO-s që të zbatojnë “masat më të mira praktike dhe të mundshme për mbrojtjen e mjedisit”,⁷ duke synuar në këtë mënyrë të zvogëlojnë ndikimin mjedisor të shkaktuar nga veprimtaria ushtarake.

Dokumentit (MC – 469) është plotësuar me disa dokumente të tjera të standardizimit të NATO-s (STANAG-e) dhe publikime të përbashkëta të mbrojtjes së mjedisit, të gjitha të orientuara në mbrojtjen e mjedisit gjatë aktiviteteve ushtarake të drejtuara nga NATO-ja, të cilat përfshijnë: mbrojtjen e mjedisit gjatë veprimtarive ushtarake të udhëhequra nga NATO-ja, kërkesat për menaxhimin e mbeturinave gjatë aktiviteteve ushtarake të drejtuara nga NATO-ja si dhe sistemin e menaxhimit të mjedisit në operacionet e NATO-s. Gjithashtu në dokument përshkruhen: dosjet mjedisore gjatë operacioneve të drejtuara nga NATO-ja, praktikat më të mira për mbrojtjen e mjedisit

⁵ NATO Homepage: “Environment – NATO’s stake”. Updated 09 Dec 2014 link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_91048.htm#

⁶ NATO/SPS Short Term Project: “Environmental aspects of military compounds”: https://www.nato.int/science/topical_ws/eamc/283-final_report_Compounds_phasel1.pdf

⁷ Po Aty.... “Environmental aspects of military compounds”

për qëndrueshmërinë e zonave të trajnimit ushtarak si dhe standardet për fushimet ushtarake gjatë aktiviteteve ushtarake të udhëhequra nga NATO-ja.

4. Stërvitjet e NATO-s për mjedisin

Për të siguruar përputhjen me këto standarde, forcat duhet t'u nënshtrohen trajnimeve të përshtatshme për mbrojtjen e mjedisit. Megjithëse një trajnim i tillë është kryesisht një përgjegjësi kombëtare, ambicia e NATO-s është për të siguruar mbrojtjen e përbashkët të mjedisit dhe edukimin e efikasitetit të energjisë për forcat e aleatëve. Është e nevojshme që të futet vetëdija për mbrojtjen e mjedisit në rutinën e përditshme të personelit ushtarak dhe të rritet përgjegjësia e tyre personale në këtë fushë.

Për të përparuar me këtë objektiv, NATO-ja ka caktuar zyrtarë të stafit për zbatimin e mbrojtjes së mjedisit në nivele strategjike, operacionale dhe taktike. Po ashtu, Shkolla e NATO-s në Oberammergau dhe Qendra Inxhinierike Ushtarake e Ekselencës (COE) në Ingolstadt, në Gjermani, ofrojnë kurse dhe udhëzime për mbrojtjen e mjedisit, si pjesë e kurrikulës së tyre.

5. Kërkimi dhe zhvillimi në NATO

Për kërkimin dhe zhvillimin shkencor, NATO-ja ka krijuar "Strukturën organizative të shkencës dhe teknologjisë" të NATO-s (STO), e cila promovon dhe zhvillon kërkime shkencore mbi sfidat teknike specifike ushtarake, disa prej të cilave kanë të bëjnë me çështje mjedisore. Për këtë qëllim, nënkomitetet teknike/shkencore të STO-së, të përbërë nga ekspertë të NATO-s dhe vendeve anëtare, kërkojnë dhe punojnë për "zgjidhje më të gjelbra" duke kryer studime dhe hulumtime që rezultojnë në raporte shkencore në interes të Aleancës.

Një veprimtari e avancuar kërkimore e STO-së është bërë në zhvillimin e *Manualit të mbylljes së kampit të NATO-s* dhe një *Modeli të qëndrueshëm të kampit*.⁸ Modeli u mundëson planifikuesve operacionalë që të kuptojnë më mirë ndikimin e operacioneve në konsumin e ujit, mbeturinave dhe energjisë, si dhe ofron zgjidhje teknike që synojnë uljen e gjurmës mjedisore dhe energjetike të operacioneve. Aktivitetet e STO-së përfshijnë uljen e zhurmës dhe "municione të gjelbra".

Qendra për Kërkimin dhe Eksperimentimin Detar (CMRE) e vendosur në La Spezia, Itali, kryen hulumtime për të matur ndikimin e operacioneve ushtarake në mjedis si dhe të mjedisit në operacione. Një studim i gjerë i CMRE rezultoi në një kuptim më të mirë të faktit se si gjitarët detarë mund të preken nga sistemet e sonarit. Bazuar në rezultatet e këtij studimi, NATO-ja hartoi "Kodin e sjelljes për përdorimin e sonarit aktiv" për të siguruar mbrojtjen e gjitarëve detarë në kuadrin e aktiviteteve detare të Aleancës. Rrjeti bashkëpunues i STO-së është mbështetur nga zyra e mbështetjes së bashkëpunimit, me vendndodhje në Paris, Francë.

6. Siguria mjedisore, përshtatja e Aleancës në një mjedis të ndryshuar të sigurisë

Që nga viti 1969, "Programi i shkencës për paqen dhe sigurinë" (SPS) i NATO-s, ka

⁸ Po aty.

mbështetur aktivitetet bashkëpunuese që trajtojnë çështjet e sigurisë mjedisore, përfshirë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen, në vendet e NATO-s. Meqenëse programi SPS u hap për vendet partnere në vitet 1990, partnerët e renditën sigurinë mjedisore si përparësi kryesore, duke kërkuar ndihmën e NATO-s për aktivitetet bashkëpunuese për të trajtuar ato çështje që kërcënojnë sigurinë e vendit të tyre dhe më gjerë.

Për të koordinuar më mirë aktivitetet e saj, NATO-ja iu bashkua në vitin 2004 pesë agjencive të tjera ndërkombëtare, nën *Iniciativën e mjedisit dhe sigurisë* (ENVSEC). Iniciativa ENVSEC është themeluar në vitin 2003 nga *Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin* (UNEP), *Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim* (UNDP) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE). NATO u bë një anëtar i asociuar në 2004, përmes divizionit të saj të "Diplomacisë publike". Kohët e fundit, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) dhe Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC), u bashkuan, për të trajtuar çështjet mjedisore që kërcënojnë sigurinë në katër rajone të prekshme. Rajonet janë Evropa Juglindore, Evropa Lindore, Kaukazi i Jugut dhe Azia Qendrore. Si hap i parë, ENVSEC lehtësoi takimet rajonale me palët e interesuara përkatëse (ekspertë, autoritete të organizatave joqeveritare, autoritete qeveritare dhe donatorë ndërkombëtarë) për t'u konsultuar dhe për të rënë dakord për hartat rajonale që nënvizojnë çështje prioritare që janë një kërcënim për sigurinë. Në një hap të dytë, ENVSEC mblodhi fondin për të adresuar çështjet e identifikuara.

Në kontekstin e "Programit të shkencës për paqen dhe sigurinë" (SPS) të NATO-s, ekspertët e mbrojtjes së mjedisit në të gjithë vendet anëtarë të NATO-s dhe vendet partnere kanë qenë aktive në zhvillimin e politikave dhe zgjidhjeve teknike për uljen e gjurmës mjedisore (hapësirës fizike që forcat ushtarake zënë në terren), si dhe të marrjes në konsideratë të konsumit të energjisë në aktivitetet e drejtuara nga NATO. Sidomos në një kohë kur siguria mjedisore dhe zhvillimi njerëzor lidhen drejtpërdrejt me çështjet themelore të ushqimit dhe shëndetit, programi SPS adreson këto çështje duke financuar projekte që mbulojnë një gamë të gjerë aktivitetesh.

Programi SPS nxit bashkëpunimin midis vendeve të NATO-s dhe partnerëve, si dhe vendeve të Dialogut Mesdhetar për të ndihmuar në adresimin e çështjeve të tyre të sigurisë dhe ofrimin e zgjidhjeve, duke mbështetur kryesisht ndërtimin e aftësive përmes projekteve, si dhe duke ndihmuar vendet partnere me pajisje, harxhime, udhëtime, trajnime dhe aftësi.

Një fushë tjetër e punës së NATO-s është ndihma ndaj vendeve partnere për të pastruar rezervat e vjetruara dhe të rrezikshme të armëve, municioneve dhe mbetjeve të pashpërthyerë të luftës, të cilat paraqesin rrezik për njerëzit dhe mjedisin.

Nënelementët e zonës së sigurisë mjedisore përfshijnë menaxhimin e burimeve ujore, modelimin e konsumit të qëndrueshëm (p.sh. ushqim, energji, materiale), parandalimin e konflikteve në lidhje me mungesën e burimeve dhe zvogëlimin e ndikimit mjedisor të aktiviteteve ushtarake. Në të njëjtën kohë, një bashkëpunim i tillë rrit besimin dhe përmirëson ndërtimin e kapaciteteve, me qëllimin kryesor për të evituar konfliktet dhe kontribuar në paqen dhe stabilitetin e qëndrueshëm në rajonin euro-atlantik.

Përmes "Programit shkencë për paqe dhe siguri" (SPS), vendet e NATO-s po ndihmojnë vendet partnere dhe vendet e Dialogut Mesdhetar të merren me çështjen e sigurisë mjedisore përmes bashkëpunimit shkencor që po jep rezultate konkrete. Duke punuar me një rrjet të gjerë ekspertësh brenda vendeve të NATO-s, partnerët dhe vendet e Dialogut Mesdhetar, Programi SPS e shtrin këtë bashkëpunim përmes

bashkëpunimit të vazhdueshëm me organe të tjera ndërkombëtare, siç janë Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe Iniciativa e Sigurisë së Mjedisit. NATO-ja kontribuon duke mbështetur projekte të shumta të sigurisë mjedisore që lidhen me çështje të tilla si administrimi i ujit, ngjarjet sizmike, format e ndryshme të ndotjes, asgjësimi i mbeturinave radiologjike dhe rreziqet e tjera të mundshme, si dhe jep informacion mbi agjendën e saj të sigurisë mjedisore si sfondin e mbështetjes së NATO-s.

7. Nxitja e reagimit të urgjencës

Aleanca është gjithashtu e angazhuar në mënyrë aktive në koordinimin e planifikimit të emergjencave civile dhe përgjigjen ndaj katastrofave mjedisore. Këtë e bën kryesisht përmes Qendrës Koordinuese Euro-Atlantike për Reagimin ndaj Fatkeqësive (EARDCC) që u krijua pas katastrofës së tërmetit në Turqi dhe Greqi në fund të viteve 1990. Duke folur në “Konferencën e Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike” në Kopenhagë, ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, theksoi se: “Me ndikimin në rritje të ndryshimit të klimës, kërkesa ndaj ushtrisë si përgjigje e parë e katastrofave natyrore ka të ngjarë të rritet”.⁹

Ai u bëri thirrje aleatëve të marrin në konsideratë se si të optimizojnë kontributin e Aleancës në atë zonë. Me qëllim të rritjes së mirëkuptimit, NATO-ja organizoi konsultime dhe stërvitje për ndërtimin e skenarëve, duke përfshirë ekspertë ushtarakë dhe civilë, të mbështetur pjesërisht nga programi SPS. Si rezultat, nën drejtimin e sekretarit të përgjithshëm aktual të NATO-s, Jens Stoltenberg, dialogu me organizatat e tjera ndërkombëtare është përmirësuar me një fokus në atë se si NATO-ja dhe forcat e saj të armatosura mund të përshtaten më mirë me sfidën e një numri në rritje të katastrofave natyrore.

8. NATO dhe bashkëpunimi ndërkombëtar për sigurinë mjedisore

Përgjatë viteve 1990, NATO-ja si dhe ushtarakët e Shteteve të Bashkuara, Australisë dhe vendeve të tjera organizuan shumë *workshop*-e dhe konferenca mbi temën e sigurisë mjedisore. Këto konferenca mblodhën përfaqësues të shumë organizatave të mbrojtjes për diskutime mbi nevojën për të krijuar besim, për të inkurajuar dialogun dhe për të shkëmbyer informacione. Komuniteti i Mjedisit i NATO-s ka qenë aktiv në përpjekjet e tyre bashkëpunuese me organizata të tjera ndërkombëtare, për të përfshirë Kombet e Bashkuara (KB) dhe Bashkimit Evropian. Kjo qasje bashkëpunuese përfshin gjithashtu diskutime me industrinë, akademinë dhe agjencitë qeveritare.

“I gjithë nocioni i sigurisë siç kuptohet tradicionalisht - në drejtim të kërcënimeve politike dhe ushtarake ndaj sovranitetit kombëtar - duhet të zgjerohet për të përfshirë ndikimin në rritje të stresit mjedisor - në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe global” - deklaroi Komisioni Botëror i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin (1987).¹⁰

⁹ NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen, UN “Climate Change” Conference, 15 December 2009, Copenhagen: NATO Homepage : https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_60163.htm.

¹⁰ Report of the World Commission on Environment and Development: “Our Common Future”: <https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5987our-common-future.pdf>

NATO-ja ndihmon partnerët të zvogëlojnë rreziqet mjedisore përmes çarmatimit. Përmes projekteve të “Fondit të partneritetit për mirëbesimin e paqe”, Aleanca ndihmon vendet partnere të zvogëlojnë rezervat e tyre të vjetruara, të pastrojnë karburantet e përkeqësuar të raketave, tokën e pastër të kontaminuar nga mbetjet e pashpërthyer të luftës dhe të ruajnë municionet e sigurta. Ndërsa qëllimi kryesor është të ndihmojë vendet post-sovjetike të çarmatosin dhe të reformojnë forcat ushtarake të tyre, këto projekte gjithashtu zvogëlojnë rreziqet që paraqesin këto materiale të rrezikshme për mjedisin dhe njerëzit në zonat përreth.

Po kështu Aleanca punon për ndërgjegjësimin dhe shkëmbimi i informacionit me vendet anëtare dhe ato partnere. Komunikimi i implikimeve të sigurisë së çështjeve mjedisore për udhëheqësit politikë dhe vendimmarrësit është një fushë tjetër ku Aleanca luan një rol të madh. Për shembull, sigurohet që anëtarët dhe partnerët të kenë njohuri dhe aftësi të nevojshme për të zbutur ndryshimet klimatike dhe për t’u përshtatur me efektet e tij. Si organizatë kryesore e sigurisë së Amerikës së Veriut dhe Evropës, NATO-ja po merr një rol gjithnjë e më aktiv në përshtatjen ndaj këtyre zhvillimeve.

9. Siguria e energjisë: mbrojtja e infrastrukturës kritike të energjisë

Në *Samitin e Strasburgut/Kehlit*, në prill 2009, aleatët thanë se: “Do të konsultohen për rreziqet më të menjëhershme në fushën e sigurisë së energjisë”.¹¹ Ata deklaruan se do të vazhdojnë të zbatojnë rekomandimet e propozuara në *Samitin e Bukureshtit* të vitit 2008, përkatësisht për të shkëmbyer informacione, për të çuar përpara bashkëpunimin ndërkombëtar dhe rajonal, për të zhvilluar menaxhimin e pasojave dhe për të ndihmuar në mbrojtjen e infrastrukturës kritike. NATO-ja gjithnjë e më shumë po e konsideron sigurinë e energjisë si një sfidë, duke u përqendruar në energjinë bashkë me rreziqet mjedisore më të cilat përballet Aleanca. Mungesa e ushqimit, katastrofat natyrore, administrimi dhe shpërndarja e burimeve të pakta ujore dhe ndërprerja e furnizimeve me energji jetësore janë shembuj të faktorëve në dukje të palidhur, por që mund të kenë efekt mbi sigurinë. NATO-ja ka analizuar se si bashkëveprojnë faktorë dhe dobësi të tilla, si ato mund të ndikojnë në vendet anëtare të NATO-s dhe mënyrat me të cilat Aleanca mund të përgjigjet ndaj këtyre rreziqeve të sigurisë. Në një botë ndërvepruese, NATO-ja duhet të jetë e gatshme të reagojë ndaj sfidave të sigurisë të shkaktuara nga burime të kufizuara dhe faktorë mjedisorë. Sigurimi i një furnizimi të qëndrueshëm të energjisë është më shumë sesa thjesht një shqetësim i burimeve, ai gjithashtu është i ndërthurur me sigurinë ndërkombëtare.

Katastrofa natyrore gjithnjë e të paparashikueshme të tilla si tërmetet, përmytjet e mëdha dhe stuhitë që shkaktojnë ndërprerje të infrastrukturës, bëjnë që faktorët mjedisorë kanë një potencial në rritje për të ndikuar në sigurinë e energjisë. Shumica e anëtarëve dhe partnerëve të NATO-s mbështeten në furnizimin me energji nga jashtë, të dërguara përmes tubacioneve dhe kabllave që kalojnë shumë kufij. Prandaj, aleatët dhe partnerët duhet të punojnë së bashku për të zhvilluar mënyra për të zvogëluar kërcënimin e ndërprerjeve, përfshirë ato të shkaktuara nga ngjarjet mjedisore. Projektet që përqendrohen në lidhjen midis infrastrukturës energjetike dhe sigurisë mjedisore

¹¹ Declaration, Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Strasbourg / Kehl, Issued 4 Apr 2009: https://www.nato.int/cps/en/natolive/news_52837.htm

janë mbështetur nga Programi SPS që nga fillimi i vitit 2000. Një shembull është projekti shumëvjeçar “Chernobyl Dust Model” që po ndihmon Ukrainën të zhvillojë një model realist 3D të pluhurit radioaktiv që rrjedh nga sarkofagu i dëmtuar në sitin e energjisë bërthamore të Çernobilit. Kjo jo vetëm që do të rrisë sigurinë e punëtorëve të sigurisë, por gjithashtu ndihmon ekspertët ndërkombëtarë të kuptojnë sfidat e matjeve dhe monitorimin e zonave të ndotura.

10. Ekipi i energjisë smart (“Smart Energy Team – SENT”)

Duke njohur nevojën në rritje për karburantet në operacione, të cilat kanë shkaktuar çështje të sigurisë për karburantet dhe forcat e armatosura, në vitin 2011, NATO-ja filloi një iniciativë të Energjisë “smart” duke bashkuar aktorët e NATO-s dhe ekspertët kombëtarë nga sektori publik dhe privat. Në “Samitin e NATO-s në Wells” (2014) krerët e shteteve, deklaruan se NATO “do të vazhdojë të punojë drejt përmirësimit të ndjeshëm të efikasitetit energjetik të forcave tona ushtarake, dhe në këtë drejtim ne shënojmë *Kornizën e mbrojtjes së gjelbër*.”¹² NATO-ja po kërkon të rrisë vetëdijen për sfidën e energjisë dhe të identifikojë praktikatat më të mira midis projekteve nacionale për përdorim të zgjuar të energjisë përmes “Ekipit të energjisë smart” (Smart Energy Team – SENT). “Unë besoj se energjia po bëhet gjithnjë e më shumë një çështje për marrëdhëniet ndërkombëtare, përfshirë marrëdhëniet ndërkombëtare të sigurisë. Në kontekstin e ekipit të saj të energjisë smart, NATO-ja ka filluar të eksplorojë zgjidhje më efikase të energjisë për çadrat e ftohjes dhe ngrohjes, përfshirë gjeneratorët e ngarkueshëm të rregullueshëm, pompat e nxehtësisë, ngrohjen e dyshemesë dhe materialet për izolim dhe për ruajtjen e energjisë së gjeneruar dhe energjisë diellore”, - thotë Michael Ruhle, shefi i seksionit të sigurisë së energjisë në divizionin e “Sfidave të sigurisë në zhvillim”, të NATO-s¹³.

Themeluar pas *Samitit të Çikagos* të majit 2012 dhe i financuar përmes *Programit të shkencës për paqen dhe sigurinë*, SPS, të NATO-s, SENT-i, drejtohet bashkërisht nga Qendra e Përsosmërisë së Energjisë së NATO-s me seli në Lituani dhe nga departamenti i mjedisit të përbashkët, i Forcave të Armatosura Suedeze. Ajo është e përbërë nga ekspertë nga tetë kombe, përfshirë gjashtë aleatët (Kanada, Gjermani, Lituani, Holandë, Mbretëri e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara) dhe dy partnerët (Australi dhe Suedi). Misioni dhe qëllimi i SENT-it është që të rekomandojë dhe të fillojë projekte shumëkombëshe nën iniciativën e *Mbrojtjes së zgjuar (Smart Defence)* të NATO-s.

11. Ushtritë investojnë në energji smart, për një ushtri me efikasitet energjetik

Kostot e energjisë janë një rrjedhje e konsiderueshme në buxhetet e mbrojtjes të çdo

¹² Declaration Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Wales: https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_112964.htm?mode=pressrelease

¹³ Article topics: “*Armies get smart on energy*”: Last updated: 30 Jul 2013: NATO Homepage, link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101902.htm?selectedLocale=en

vendi anëtar. Kjo mund të ndikojë në burimet e mundshme për aleatët për të fituar dhe mirëmbajtur aftësi mbrojtëse, si dhe të kufizojë aftësinë e tyre për të ndërmarrë operacione ushtarake. Një varësi në rritje ndaj naftës dhe gazit, rraskapitja progresive e karburanteve fosile, rritja e vazhdueshme e çmimit të lëndëve të para, kërcënimet për sigurinë e furnizimeve të energjisë dhe shqetësimet për pasojat e ndryshimit të klimës e bëjnë sigurinë e energjisë një çështje madhore. Prandaj, ulja e gjurmës energjetike të operacioneve është një përparësi. NATO-ja si e tërë, si dhe aleatët individualisht, janë duke punuar në burime alternative të energjisë dhe duke zhvilluar projekte shumëkombëshe në energjinë *smart*.

Ekspertë të klimës dhe energjisë, përfaqësues nga qendrat e mendimit, civilë dhe ushtarakë nga NATO-ja mbledhen periodikisht për të trajtuar këto sfida, për të diskutuar dhe krijuar skenarë të botës reale, që merren me implikimet kritike të sigurisë për energjinë dhe çështjet e mjedisit. Ata përpiqen të kuptojnë krizat në të ardhmen, duke u përqendruar në kuptimin më të mirë të faktorëve të ndryshëm që mund të çojnë në paqëndrueshmëri. Duke kuptuar këta faktorë, synohet që ata të zgjerojnë horizontin e tyre strategjik dhe të ndihmojnë Aleancën të identifikojë dobësitë kryesore të sigurisë që mund të lindin nga këto çështje, duke lejuar përfshirjen e tyre në procesin e planifikimit paraprak të NATO-s.

“Një nga qëllimet e këtyre veprimtarive është të mendojmë te paimagjinueshmen, të presim të papriturën,” - thotë Farshad Mohammad-Avvali, këshilltar në seksionin e sigurisë së energjisë të divizionit të “Sfidave të sigurisë në zhvillim”, të NATO-s.¹⁴

Pavarësisht nga kostoja, varësia energjetike e forcave të armatosura ka një ndikim në efektivitetin operacional. Operacionet e Aleancës përfshijnë një organizim logjistik gjithnjë e më komplekse dhe të kushtueshme. Transportimi i sasive të mëdha të karburantit gjithashtu krijon rreziqe për sigurinë e ushtarëve. Shqetësimet mjedisore janë një faktor tjetër i rëndësishëm. Aleatët duhet të kenë kujdes për pasojat mjedisore të veprimtarive ushtarake dhe të minimizojnë shtrirjen logjistike të operacioneve. Kështu ambasadori Gábor Iklódy, ndihmësekretari i përgjithshëm i NATO-s për “Sfidat e sigurisë në zhvillim”, thotë: “Në përgjithësi, në aspektin financiar, si dhe të sigurisë, varësia jonë e karburantit krijon një situatë: *lose-lose* (humbje-humbje). Sa më shumë të shikohet kjo dilemë, aq më shumë kupton pse Aleksandri i Madh ishte aq i fiksuar me logjistikën. Ai dikur tha se, nëse fushata e tij do të dështonte, njerëzit e parë që ai do të vriste do të ishin ata të logjistikës së tij.”¹⁵

Vendet anëtare të NATO-s kanë të qartë tashmë se burimet e energjisë nga të cilat varen aktualisht nuk do të jenë kështu përherë. “Ne kemi ndërtuar infrastrukturën tonë energjetike duke supozuar se ajo që kemi nuk do të ndryshojë, - në fakt po ndryshon në mënyrë dramatike, dhe ne mund ta shohim këtë në të gjithë botën,”¹⁶ - nënvizon Cleo Paskal, një bashkëpunëtor i asociuar në departamentin e energjisë dhe mjedisit, në “Chatham House, London”.

Një numër aleatësh, individualisht, po eksplorojnë alternativa dhe mënyra për të zvogëluar varësinë e forcave të armatosura të Aleancës nga karburantet fosile. “Për të zvogëluar varësinë e tyre nga burimet fosile, kryesisht nafta, Forcat e Mbrojtjes Italiane, veçanërisht ato të Marinës, kanë vendosur të financojnë një projekt për të vërtetuar

¹⁴ NATO Homepage, “Alternatives to fossil fuels” last updated 30 Jul 2013: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101902.htm?selectedLocale=en

¹⁵ Po aty.

¹⁶ Po aty, NATO webpage Topics: “Reducing energy use in military camps”.

përdorimin e biokarburantit për sektorin detar i cili është në përputhje me pajisjet aktuale”,¹⁷ - thotë komandanti Pasquale Tripodi, shefi i zyrës së bimëve propulsion, Shtabi i Përgjithshëm i Marinës Italiane.

Forcat e Marinës Italiane aktualisht po testojnë biokarburantet e gjeneratës së re të prodhuar nga biomasa joushqimore si algat, mbetjet bujqësore dhe mbeturinat e përgjithshme. Produkti do të testohet duke nxitur një anije lufte për karburantet biokale këtë vit. Ai ishte ideuar që të jetë në përputhje me karburantin detar ekzistues të NATO-s për të shmangur punën e kushtueshme për të modifikuar pajisjet dhe sistemet. Në fund të fundit, objektivi është të zhvillohet një karburant i vetëm për t’u përdorur nga të gjitha forcat e armatosura.

Një tjetër iniciativë, e përqendruar në karburantin për sektorin e aviacionit, po zbatohet nga Këshilli Kombëtar i Kërkimit, i Kanadasë. Një sukses i madh u arrit në tetor 2012 me fluturimin e parë në botë, të një aeroplani civil që mundësohej 100 për qind nga biokarburanti i pastër, i patrazuar. “Ky fluturim historik paraqet një përparim për industrinë e karburanteve të rinovueshëm”, - thotë nënkoloneli Geoffrey Carter, i forcave kanadeze. “Ai simbolizon një prag të rëndësishëm, jo vetëm për hapësirën ajrore, por edhe në zhvillimin e burimeve të qëndrueshme të energjisë së rinovueshme”.¹⁸ Disa kombe aleate kanë demonstruar tashmë mënyra për të zvogëluar konsumin e energjisë duke ulur nivelin e përdorimit të energjisë në kampe ushtarake: për shembull, mikrorrjetet dhe rinovimet janë duke forcuar kampet ushtarake, e njëkohësisht duke zvogëluar sasinë e naftës që kërkohet për gjeneruesit tradicional.

Nën titullin e “energjisë së zgjuar” NATO-s po i bashkon këto përpjekje kombëtare. Për shembull, NATO-ja po mbështet harmonizimin e mënyrës së matjes së konsumit të energjisë në kampe, gjithashtu po promovon standarde që do ta bëjnë pajisjet e saj më të ndërveprueshme. Kosto më e ulët, rreziku më i ulët dhe një gjurmë e vogël mjedisore: një rezultat i qartë “win-win”, duke rezultuar në siguri të zgjeruar për të gjithë. Ekziston gjithashtu një hapësirë e konsiderueshme për të përmirësuar efikasitetin e energjisë të forcave të stacionuara në fushime. Vendosja dhe drejtimi i një kampi ushtarak është një ndërmarrje komplekse dhe e kushtueshme, që paraqet një sfidë të madhe për sa i përket energjisë së prodhuar dhe të konsumuar. Çuditërisht, matjet e fundit të disa kampeve të zgjedhura në Afganistan sugjerojnë që rreth 70 për qind e karburantit të konsumuar përdoret për ftohjen ose ngrohjen e tendave dhe ujit të dushit. Tendat janë izoluar dhe ftohur dobët duke përdorur kondicionerë dhe generatorë joefikas, të cilat shpesh lihen të punojnë gjatë gjithë ditës, pavarësisht nga kërkesa aktuale.

Eksperimentet kanë treguar që kursime të konsiderueshme të energjisë mund të bëhen duke përdorur materiale të reja për izolimin e tendave dhe ekranet e diellit; duke centralizuar dhe menaxhuar më mirë kondicionimin dhe ngrohjen e ajrit; dhe duke ndryshuar sjelljen e ushtarëve. Vartësia e karburantit fosil mund të zvogëlohet duke investuar në energji të rinovueshme siç janë energjia diellore dhe sistemet e mbeturinave në energji. Për shembull: Ushtria Mbretërore Holandeze instaloi në tetor 2012 panele diellore në Mazar-e-Sharif. Një fushë prej 480 m² e këtyre paneleve diellore aktualisht prodhon 200 kwh në ditë. Kthimi i investimit u arrit brenda 9 muajsh.

“Mësimet nga biznesi dhe shkenca do të ndihmojnë NATO-n të angazhohet më mirë në tranzicionin e energjisë dhe të krijojë një ushtri elastike dhe me efikasitet

¹⁷ NATO Homepage topics: “Armies get smart on energy”: Last updated: 30 Jul 2013: link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101902.htm?selectedLocale=en

¹⁸ Po aty.

energetik. Transformimi i energjisë është biznesi i gjithkujt, përfshirë atë të ushtrisë”,¹⁹ - shpjegojnë Antonio Missiroli dhe Michael Rühle, pjesëtarë të seksionit të sigurisë së energjisë në divizionin e “Sfidave të sigurisë në zhvillim” të NATO-s. Ata tregojnë pse rinovimet dhe efikasiteti i energjisë janë të larta në agjendën e tyre dhe pse organizata e sigurisë po punon me sektorin civil dhe komunitetin shkencor për të rritur përparimin në këto çështje. “Është detyrë e çdo planifikuesi serioz politik ose ushtarak - dhe çdo aleancë serioze politiko-ushtarake - të marrë një kontroll të fortë të mjedisit të sigurisë, të parashikojë tendencat e ardhshme dhe të analizojë pasojat e tyre operacionale. Injorimi i faktorëve të caktuar, qoftë nga pakujdesia ose për shkak të një nocioni të rremë të “korrektësisë politike”, do të ishte heqje përgjegjësie. Duke pasur parasysh ndërveprimin kompleks të sfidave të sotme të sigurisë, askush nuk mund të qëndrojë i verbër”²⁰ - theksojnë Missiroli dhe Rühle.

Kjo logjikë sigurisht që shtrihet në implikimet e sigurisë së ndryshimit të klimës dhe të tranzicionit të energjisë. Të dy këto zhvillime janë ndërthurur dhe po transformojnë rrënjësisht mjedisin tonë të sigurisë me implikime të mëdha për planifikimin ushtarak. Në fund të fundit, ushtria është një përdorues kryesor i energjisë dhe shpesh konsiderohet si reaguesi i parë i katastrofave humanitare që mund të jenë shkaktuar nga ndryshimet klimatike.

13. Përfundime dhe rekomandime

Shqipëria është vend anëtar i NATO-s nga viti 2008. Forcat tona të Armatosura kontribuojnë qoftë me trupa në operacionet e NATO-s si dhe marrin pjesë në stërvitjet dhe aktivitetet e tjera të saj. Gjithsesi ashtu sikurse është përmendur më lart në këtë punim, vendi ynë është i përfshirë në të gjitha angazhimet e NATO-s. Pra, politikat, standardet dhe rekomandimet e NATO-s janë të detyrueshme dhe aplikueshme edhe nga vendi ynë.

Në planetin tokë duket se po jetojmë në një kohë të ngjarjeve më ekstreme. Uraganet, ciklonet, zjarret, tërmetet dhe çdo lloj tjetër i katastrofës natyrore, kanë një varg pasojash njerëzore dhe burimore natyrore. Është diçka për të cilën duhet të përgatitemi. Aspekti i gatishmërisë ka disa komponentë të ngjashëm. Duhet të ketë shumë më shumë integrim të planifikimit dhe gatishmërisë për lloje të ndryshme të ngjarjeve ekstreme. Kjo mund të përfshijë gjithashtu sulmet në internet dhe ngjarje të tjera të dëmtimit të infrastrukturës që mund të sjellin pasoja të rëndësishme.

Ushtria duke pasur ekspertizën e nevojshme për planifikim është ndoshta organizata më e sofistikuar e planifikimit për operacione ushtarake. Por, përfshirja e konsideratave mjedisore dhe energjisë në planifikim, ka efekte të dobishme si për strategjinë e sigurisë kombëtare ashtu edhe për komunitetet në përgjithësi. Puna me komunitetet për një planifikim më të mirë lokal të përdorimit të tokës do të zgjerojë atë ekspertizë, e cila në të ardhmen, mund të jetë pjesë e planifikimit të adaptimit ndaj ndryshimit të klimës. Qasja e ushtrisë është bërë shumë disiplinore pasi ato mbështesin ekspertizën nga hidrologjia, biologjia, kimia, fusha të ndryshme të inxhinierisë dhe fushat e reja që zhvillohen në shkencat e sjelljes, si dhe analizat tradicionale të sigurisë kombëtare. Duke

¹⁹ Antonio Missiroli, Michael Rühle: The Planetary Security Initiative Homepage: “The Planetary Security Conference 2019”, 20 Feb 2019, Hague: <https://www.planetarysecurityinitiative.org/conference-2019>,

²⁰ Po aty.

parë nevojën për një ushtri elastike dhe me efikasitet energjetik, NATO-ja me politikat, standardet dhe mekanizmat e saj po punon në fushat kryesore si:

Së pari, ndërgjegjësimi. Në vitin 2010, “Koncepti strategjik i NATO-s” i dha një rëndësi të paparë ndryshimit të klimës dhe sigurisë së energjisë dhe e karakterizoi ndryshimin e klimës si një sfidë të dyfishtë me potencialin për të formuar mjedisin e sigurisë, dhe i cili ndikon gjithashtu në planifikimin dhe operacionet e NATO-s. “Koncepti strategjik” i dha Aleancës një mandat për të konsideruar zhvillimet e klimës dhe energjisë shumë më thellësisht.

Së dyti, një përqendrim më i madh në sfidat e sigurisë jotradicionale. Implikimet e sigurisë së ndryshimit të klimës dhe zhvillimeve të caktuara të energjisë tani janë objekt i diskutimeve të rregullta në nivele të ndryshme brenda Aleancës. Këto diskutime janë mbështetur nga analizat e dhëna nga ekspertë civilë dhe ushtarak të NATO-s.

Së treti, standardet mjedisore. Politikat e para të NATO-s për mbrojtjen e mjedisit fillojnë në vitet '70. Kurset e trajnimit sigurojnë që ushtria e NATO-s është e vetëdijshme për rregulloret e duhura. NATO gjithashtu është njohës i rëndësisë politike të mbrojtjes së mjedisit, pasi është një faktor kryesor në përcaktimin se si popullsia e vendit pritës do ta shikojë praninë ushtarake të NATO-s. Një ushtri që ndot, do të humbasë shpejt mbështetjen që kërkon për të pasur sukses në misionin e saj.

Së katërti, efikasiteti i energjisë në ushtri. Kostot e furnizimit të trupave me energji në vende të largëta janë befasuese, dhe po kështu janë rreziqet për ushtarët që transportojnë karburantin. Për shembull, me kohën që një litër naftë arrin një bazë operative përpara, në Afganistan, do të kushtojë 100 herë çmimi i tij origjinal vetëm për të arritur atje, nga ana tjetër ato janë një objektiv kryesor për sulmet. Për më tepër, forcat shpesh vendosen në zona pa energji elektrike, karburant ose ujë. Në të kaluarën, përparimi teknologjik shpesh do të shfaqej përmes kërkimeve ushtarake dhe më vonë do të hynte në tregun civil. Sot përkundrazi, rritja e efikasitetit të energjisë në ushtri mund të bazohet në shumë ide të krijuara nga sektori civil dhe komuniteti shkencor. NATO-ja po u afrohet këtyre palëve të interesuara dhe i inkurajon ata të shfaqin punën e tyre.

Së fundmi, operacionet e ndihmës humanitare. Ndryshimi i klimës mund të rrisë numrin dhe intensitetin e katastrofave humanitare, të cilave ushtria duhet të jetë në gjendje t’iu përgjigjet. NATO-ja nuk e konsideron veten si një organizatë humanitare ndihme, megjithatë ajo është angazhuar në operacione të tilla në disa raste. Është e qartë se parandalimi, ndërgjegjësimi për një politikë klimatike të ardhshme, është më e mirë se sa kurimi.

Bibliografi

1. Commission of the European Communities (2007) "An energy policy for Europe", COM (2007)1 final, Brussels, 10 January.
2. Dalby, Simon. 1999. "Threats from the South? Geopolitics, equity, and environmental security". In "Contested grounds: security and conflict in the new environmental politics", Edited by: Deudney, Daniel and Matthew, Richard. 187–219. Albany: SUNY Press.
3. Dilemmas of Transition: "The Environment, Democracy and Economic Reform in East Central Europe". ENVIRONMENTAL POLITICS, vol. 7, no. 1, Spring 1998, Special Issue.
4. Homer-Dixon, Thomas, 1994: "Environmental Scarcities and Violent Conflict. Evidence from Cases", in: International Security, 19,1: 5–40.
5. Gonzalez Pliego, Mario, "Caveat consules ne quidres publica detrimenti capiat": NATO's Interdisciplinary Approach to the New Threats, Brussels: NATO, 2003.
6. Libiszewski, Stephan, 1992: "What Is an Environmental Conflict?", in: Occasional Paper, no. 1, July (Bern: Swiss Peace Foundation & Zürich: Center for Security Studies and Conflict Research, Swiss Federal Institute of Technology).
7. Reichberg, Gregory S., Henrik: "Protecting the Natural Environment in Wartime": Ethical Considerations from the Just War Tradition. JOURNAL OF PEACE RESEARCH, vol. 37, no. 4, July 2000, p. 449-468.
8. Shea, Jamie (2006) 'Energy security: NATO's potential role', NATO Review, 2006:3, < <http://www.nato.int/docu/review/2006/issue3/english/special1.html> >, accessed 5 March 2008.

"ONLINE LINKS"

9. By NATO Secretary General Jens Stoltenberg, *Keynote address at the NATO Industry Forum*, Washington D.C. NATO Webpage 14 Nov 2019
Link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/opinions_170786.htm_selectedLocale=en
10. Jens Stoltenberg NATO Secretary General, "NATO: READY FOR THE FUTURE Adapting the Alliance" Progress Report (2018-2019), Published at NATO webpage, 29 Nov 2019
Link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_171337.htm
11. The Alliance's Strategic Concept Approved by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Washington D.C. 24 Apr 1999, published at NATO Homepage: Link: (https://www.nato.int/cps/en/natolive/official_texts_27433.htm)
12. NATO Homepage: "Environment – NATO's stake". Last updated 09 Dec 2014
link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/topics_91048.htm
13. NATO/SPS Short Term Project: "Environmental aspects of military compounds":
https://www.nato.int/science/topical_ws/eamc/283-final_report_Compounds_phasell.pdf
14. NATO Secretary General Anders Fogh Rasmussen, UN "Climate Change" Conference, 15 December 2009, Copenhagen: NATO Homepage link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_60163.htm.
15. Report of the World Commission on Environment and Development: "Our Common Future":
<https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/5987our-common-future.pdf>
16. Declaration, Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Strasbourg / Kehl, Issued 4 Apr 2009:
https://www.nato.int/cps/en/natolive/news_52837.htm
17. Declaration Issued by the Heads of State and Government participating in the meeting of the North Atlantic Council in Wales:
https://www.nato.int/cps/en/natohq/official_texts_112964.htm?mode=pressrelease
18. NATO Homepage, Article topics: "Armies get smart on energy": Last updated: 30 Jul 2013,
link: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101902.htm?selectedLocale=en
19. NATO Homepage, Article topics: "Alternatives to fossil fuels" last updated 30 Jul 2013:
https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_101902.htm?selectedLocale=en
20. Antonio Missiroli, Michael Rühle: The Planetary Security Initiative Homepage: "The Planetary Security Conference 2019", 20 Feb 2019, Hague: <https://www.planetarysecurityinitiative.org/conference-2019>.



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »**

Siguria mjedisore, si pjesë përbërëse e sigurisë kombëtare



■ **MSc. Silvana JAKAJ**
Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë
silvana.jakaj@asp.gov.al

Abstrakt

Ndryshimi i klimës si shkak i efekteve të ngrohjes globale, është bërë pjesë e diskutimit më të madh, që lidhet me çështjet e sigurisë mjedisore. Debatet fillestare mbi klimën nisën duke iu referuar asaj që u bë ligjërata e sigurisë së mjedisit, ndikimit të njeriut në biosferë dhe mjedis, dhe u "ankoruan" në supozimin se mungesat e burimeve të rinovueshme, do të mund të përkeqësoheshin nga lloje të ndryshme të degradimit mjedisor. E frikshme, sesi efektet e ngrohjes globale po ndikojnë kaq intensivisht planetin tonë. Zjarret masive, përmytjet dhe vërshimet me pasojë të konsiderueshme apo tërmetet të regjistruara nga shërbimet sizmologjike, janë vetëm disa tregues faktikë të gjendjes emergjente që po kalon planeti. "Kuari Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore", me komponentët përkatës, mund të quhet i dështuar në detyrat që u përcaktoi shteteve anëtare të OKB-së. Investimet e pamjaftueshme, ndërjegjësimi publik në nivele deri qesharake dhe mbi të gjitha, gjithë kontributi njerëzor që çdo ditë e japim në dëm të natyrës, po na kthehet mbrapsht. Objekti i studimit dhe hulumtimit në këtë punim është trajtimi i fenomeneve që ndikojnë në ndryshimet klimatike jo vetëm në aspektin konceptor, por edhe një analizë e detajuar e ndikimit të tyre në çështjet e sigurisë kombëtare, duke u bazuar edhe në rolin që luajnë politikat për sigurinë kombëtare nëse aplikohen efektivisht. Gjithashtu, synimi tjetër është të shohim pozitën e Shqipërisë, në raport me shtetet e tjera të rajonit, për sa i përket pjesës së implementimit dhe zbatimit të politikave, direktivave dhe instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me reduktimin e rrezikut dhe rimëkëmbjen mjedisore. Kjo, duke vënë theksin mbi faktin se, institucionet shtetërore janë institucionet më të përshtatshme për të informuar qeverinë dhe publikun për nevojën e trajtimit të çështjeve që lidhen me ndryshimin e klimës, por gjithashtu edhe nëpërmjet përfundimit të qasjeve mbi bashkëpunimin e koordinimin me struktura dhe agjenci kombëtare e ndërkombëtare. E gjitha kjo, do shërbente për të trajtuar, zbutur dhe ku është e mundur për të reduktuar ndikimet dhe pasojat në mjedis, të cilat nëpërmjet mekanizmit "domino" ndikojnë në ngrohjen globale dhe si pasojë dhe në sigurinë njerëzore. Prandaj, është e rëndësishme që të mendojmë me shumë kujdes edhe në lidhje me kontekstet e përshtatshme gjeopolitike në të cilat duhet trajtuar marrëdhënia ndërmjet sigurisë kombëtare dhe ndryshimeve klimatike.

Fjalëkyçe:

ngrohja globale, burime të rinovueshme, "Kuadri Sendai për reduktimin e rrezikut", rimëkëmbje, siguri mjedisore, siguri kombëtare, ndërjegjësimi.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

«Ne po i përdorim burimet natyrore si të kishim dy planetë, jo një.
Nuk mund të ketë *Plan B* sepse nuk ka *Planet B*»
Ban Ki-Moon

1. Hyrje

Kërcënimet mjedisore gjithnjë e në rritje në tre dekadat e fundit, kanë vënë në lëvizje qeveritë në shumicën e shteteve të globit, në marrjen e masave për zbutjen dhe reduktimin e efekteve të ngrohjes globale dhe njëkohësisht reagimin nëpërmjet mekanizmave teknikë dhe ligjorë ndaj krimeve mjedisore. Rritja e ekspozimit ndaj efekteve të ngrohjes globale, keqmenaxhimi i burimeve natyrore, rritja dhe sofistikimi i krimeve ndaj mjedisit, janë vetëm disa nga fenomenet që kërcënojnë aktualisht sigurinë mjedisore dhe si rrjedhojë dhe sigurinë kombëtare në mjaft vende.

Parandalimi i degradimit mjedisor dhe reduktimi i pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit, është renditur si një ndër objektivat e “Strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.¹

Mbi bazën e politikave të hartuara nga BE-ja, Shqipëria ka filluar të përshtatë instrumentet ligjore dhe institucionale. Politikat e BE-së bazohen në parimet e kujdesit dhe veprimit parandalues, mbi parimin e korrigjimit të cenimeve ndaj mjedisit dhe mbi parimin e ndotësit-pagues².

¹ Strategjia e sigurisë kombëtare, Objektiva të tjerë, f. 15.

² Shih neni 12, ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.

2. Rëndësia e politikave të sigurisë kombëtare dhe sigurisë mjedisore

Politikat e sigurisë kombëtare kanë për objekt të identifikojnë tërësinë e kërcënimeve dhe të rreziqeve që mund t'i vijnë një vendi, sidomos ato që kanë lidhje me mbrojtjen e popullsisë, integritetin e territorit dhe qëndrueshmërinë e institucioneve të shtetit, dhe të përcaktojnë kundërveprimet që pushtetet publike duhet të bëjnë. Tërësia e politikave publike përfshihen në synimin për arritjen e qëllimeve të politikës së sigurisë kombëtare. Në mjaft vende, politika e sigurisë kombëtare autorizohet me legjislacion të veçantë; në këtë rast quhet “dokument i politikës së sigurisë kombëtare”, por mund të quhet gjithashtu plan, strategji, koncept ose doktrinë. Janë pesë arsye, pse shtetet duhet të kenë një politikë gjithëpërfshirëse të sigurisë kombëtare:

- që të sigurojë që qeveria do t'i trajtojë të gjithë rreziqet në mënyrë gjithëpërfshirëse,
- që të rritet efikasiteti i sektorit të sigurisë duke përmirësuar kontributet e të gjithë aktorëve të sigurisë,
- që të drejtojnë zbatimin e politikës,
- që të ndërtojnë konsensusin e brendshëm të vendit,
- që të rrisin besimin dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar.

Politikat mjedisore synojnë të ndihmojnë në formulimin dhe zbatimin e objektivave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet përcaktimit të masave të nevojshme dhe vendosjes së një legjislacioni të përshtatshëm, në përputhje me atë të BE-së. Për këtë, politikat mjedisore synojnë³:

- të krijojnë një kuadër ligjor të plotë, në përputhje me atë të BE-së,
- krijimin e mekanizmave dhe instrumenteve efektive për zbatimin dhe imponimin e politikave dhe të ligjit, përfshirë proceset e imponimit, instrumentet ekonomike dhe planifikimin financiar.
- mbështetjen e vazhdueshme të edukimit, trajnimit dhe informimit mjedisor,
- gjetjen dhe përdorimin e mjeteve të vlerësimit, të ndikimeve negative në mjedisin e vendit, prej projekteve të propozuara, private apo publike, si dhe të masave të nevojshme parandaluese nëpërmjet monitorimit dhe raportimit.

3. Garancitë tekniko-ligjore, kombëtare, që ndihmojnë në realizimin e sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore

a. Zhvillimi i qëndrueshëm⁴

³ Shih Direktivën 2012/18/EU, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 4.7.2012, “Mbi kontrollin e rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme, duke ndryshuar dhe më pas duke shfuqizuar direktivën e Këshillit 96/82 / EC” (Direktiva Seveso), numri CELEX 32012L0018, “Fletorja zyrtare” e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 197/1, datë 24.7.2012.

Instrumentet e politikës mjedisore janë masat institucionale dhe klasifikohen në dy kategori: instrumentet rregulluese dhe instrumentet ekonomike.

Instrumentet rregulluese synojnë të detyrojnë sjelljen e ndotësve me sanksione administrative ose juridike. Për shembull: norma të emetimit, norma teknike, norma të produkteve, autorizimet administrative.

Instrumentet ekonomike synojnë të ndryshojnë mjedisin ekonomik të ndotësit (përfitimet dhe kostot) për të nxitur pranimin vullnetar të sjelljeve më pak ndotëse. Ideja është që ndotja të bëhet më e kushtueshme për ndotësin nëpërmjet pagesës prej tij të një takse, vlefte e së cilës është në raport me ndotjen e shkaktuar. Për shembull: eko-taksat, subvencionet, rregullat juridike të përgjegjësisë. Janë edhe disa instrumente të tjerë, që vendosen jashtë këtij klasifikimi, si instrumentet informuese apo marrëveshjet negociuese.

⁴ Në Asambleenë e Përgjithshme e OKB-së mbajtur në vitin 2015 u përcaktuan 17 objektivat globale për zhvillim të qëndrueshëm.

Autoritetet publike, përmes hartimit, miratimit dhe zbatimit të akteve normative, strategjive, planeve, programeve, projekteve apo iniciativave nxitin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror, duke përdorur burimet natyrore në atë mënyrë që të plotësohen nevojat aktuale të popullatave por duke ruajtur mjedisin, pa cenuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

b. Parandalimi dhe marrja e masave paraprake

Kjo gjë, nënkupton që masat për mbrojtjen e mjedisit duhet të merren në një fazë të hershme të zhvillimit të çdo veprimtarie, në mënyrë që të parandalojnë apo, në rast se nuk është e mundur, të minimizojnë efektet negative të asaj veprimtarie në mjedis⁵.

c. Ruajtja e burimeve natyrore

Mbrojtja e mjedisit realizohet duke ruajtur njëkohësisht burimet natyrore, përmes kursimit, përdorimit të efektshëm apo zëvendësimit të lëndëve të para natyrore e të materialeve të përfutuara prej tyre dhe ripërdorimit, riciklimit e rikuperimit të mbetjeve⁶.

d. Zëvendësimi dhe/ose kompensimi

Masat dhe veprimtaritë e mbrojtjes së mjedisit merren për të zëvendësuar ndërhyrjet që mund të sjellin efekte të dëmshme mbi mjedisin me ndërhyrje të tjera që paraqesin një rrezik apo kërcënim më të vogël apo kompensojnë efektet e dëmshme të pashmangshme dhe për të siguruar përdorimin e praktikave më të mira mjedisore, përdorimin e produkteve, të pajisjeve e të aparaturave, si dhe për zbatimin e proceseve të prodhimit, që janë më pak të dëmshme apo të padëmshme për mjedisin.

e. Qasja e integruar

Qëllimi i parimit të qasjes së integruar është parandalimi dhe/ose reduktimi i rrezikut ndaj mjedisit, në tërësinë e tij⁷. Autoritetet publike, gjatë hartimit dhe miratimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, brenda kompetencave të tyre, marrin parasysh, në mënyrë të veçantë, cenimin e mjedisit, lidhjen ndërmjet ekuilibrit dhe vlerave të peizazhit natyror, lidhjen ndërmjet burimeve natyrore të përtëritshme dhe jo të përtëritshme, trashëgiminë kulturore dhe të pasurive materiale, tërësinë e ndërveprimeve të tyre të ndërsjella, si dhe ndërveprimin ndërmjet projekteve ekzistuese dhe atyre të planifikuara.

f. Përgjegjësi e ndërsjellë dhe bashkëpunimi

Bashkëpunimi dhe veprimet e përbashkëta ndërmjet autoriteteve publike gjatë hartimit e miratimit të strategjisë për mbrojtjen e mjedisit, programeve, planeve dhe rregullave të ndërhyrjes, dhënies së lejeve të mjedisit apo gjatë zbatimit të politikës, kontrollit dhe masave të tjera mjedisore është i domosdoshëm.

f. "Ndotësi paguan"

Personi fizik apo juridik, veprimet ose mosveprimet e të cilit ndikojnë në ndotjen e mjedisit, mban përgjegjësi financiare, duke përballuar kostot e shkaktuara nga ky dëmtim apo rrezik për dëmtimin e mjedisit. Kosto të tilla përfshijnë kostot e vlerësimit të dëmtimit

⁵ Fazat e hershme përfshihen në ngjarjet që lidhen me procesin e përgatitjes ose të reduktimit të riskut (SFDRR).

⁶ 6 Shih ligjin "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve".

⁷ Konkluzionet e raportit të hartuar nga Bashkimi Evropian, Banka Botërore dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara pas përmblytjeve të fillimit të shkurtit 2015, në jug të vendit, "Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësisë/ Post Disaster Risk Assessment". Nga ky raport citojmë, si më poshtë vijon:

"Për të qenë në gjendje që të organizojë zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe menaxhimin e tyre në një mënyrë efektive, qeveria duhet të disponojë një sistem, i cili të mund të koordinojë aktivitetet për parandalimin dhe përgatitjen ndaj fatkeqësive dhe ku të rregullohet e drejta për të marrë masat e nevojshme në fazat e paralajmërimit të hershëm dhe përgjigjes ndaj një përmblytjeje. Në sistemin e tanishëm, e drejta, kapaciteti dhe financimi i organizatave përkatëse është i kufizuar (faqe 74).

të mjedisit, vlerësimit të masave të nevojshme, si dhe kostot e shmangies së dëmtimit të mjedisit, përfshirë kostot e rehabilitimit e të kompensimit të personave fizikë apo juridikë të dëmtuar.

g. Informimi dhe pjesëmarrja e publikut

Çdo person ka të drejtë t'i jepet në kohë informacion për gjendjen e mjedisit, ndotjen e tij dhe masat e marra⁸.

Gjatë zgjidhjes institucionale të problemeve të mbrojtjes së mjedisit, autoritetet publike përkatëse sigurojnë që publiku dhe palët e interesuara të kenë mundësi reale për të marrë pjesë në procedurat për identifikimin e gjendjes së mjedisit, hartimin dhe miratimin e strategjive, planeve e të programeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe përbërësit e mjedisit, si dhe në hartimin dhe miratimin e rregulloreve e të akteve me karakter të përgjithshëm, që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, vendimmarrjen për dhënien e lejeve përkatëse të mjedisit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe me legjislacionin, të cilit ai i referohet.

h. Nxitja e veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Autoritetet publike, brenda kompetencave të tyre:

a) nxitin veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit⁹, që parandalojnë apo reduktojnë ndotjen e tij, si dhe projekte, që ulin përdorimin e substancave të caktuara, të lëndëve të para e të energjisë, apo që e ndotin më pak mjedisin;

b) mund të lidhin marrëveshje me subjektet ndotëse dhe shoqatat e tyre për masat vullnetare që ato mund të ndër marrin, me qëllim reduktimin e mëtejshëm të ndikimit në mjedis.

4. Situata aktuale e mbrojtjes civile në Shqipëri

Pasojat negative të rreziqeve natyrore, si: tërmetet, cunamet, rrëshqitjet e tokës, ortekët, stuhitë e erës, shirat e rrëmbyeshëm, përmbytjet, valët e nxehta dhe të ftohta, thatësitë e zgjatura dhe, si pasojë, mungesa e ujit, janë rritur vitet e fundit dhe kanë pasur si rezultat katastrofa të mëdha anembanë globit. Sipas Bankës Botërore, Shqipëria ka humbje mesatare vjetore nga tërmetet, që vlerësohet të jetë 6.23% të PPB-së dhe humbje mesatare vjetore nga përmbytjet 1.56% e PBB-së, ku humbjet nga një tërmet i madh me periudhë rikthimi 250-vjeçare do të ishin 60% e PBB-së, ndërsa nga një tërmet me periudhë rikthimi 100-vjeçare 30% e PBB-së¹⁰.

Ndikimi i këtyre ngjarjeve mund të përkeqësohet nga aktivitetet njerëzore, duke përfshirë zhvillimet e pakontrolluara urbane dhe rurale, infrastrukturat dhe ndërtesat e modifikuara keq, apo nga faktorë të tjerë social-ekonomikë dhe njerëzorë, si rritja e shpejtë e popullsisë, rritja e dendësisë së popullsisë në zonat ku rreziku pritet të ndikojë dhe ndryshimet drastike në praktikën e përdorimit të tokës. Si shkak i kësaj, shumë qytete dhe popullata janë më të ekspozuara se më parë. Kjo është veçanërisht e dukshme në vendet në zhvillim, të cilat, nuk kanë aftësitë e duhura ripërtëritëse për t'u përballur me fatkeqësitë, veçanërisht kur i nënshtrohen ngjarjeve me probabilitet të ulët, por

⁸ 8 Shih ligjin nr. 8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit në lidhje me dokumentet zyrtare".

⁹ Sipas Raportit të IPA PRO NEWS PROJECT mbi implementimin e komponentit mbi ndërgjegjësimin publik ndaj përmbytjeve: "Tek veprimtaria për mbrojtjen e mjedisit, peshën kryesore e zënë aktivitetet me karakter ndërgjegjësues. Shqipëria nuk ka aktualisht një strategji për ndërgjegjësimin publik, as në nivelin kombëtar e as në atë lokal. Ndaj, për këtë, shihet e arsyeshme bashkëpunimi midis strukturave shtetërore dhe NGO-ve që operojnë në fushën e çështjeve mjedisore".

¹⁰ 10 Raporti i BB për Shqipërinë, 2018.

ndikim të madh (rasti i Shqipërisë me tërmetet e shatorit 2019).

Mbrojtja civile synon krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të përballuar fatkeqësitë e ndryshme dhe për t'u rimëkëmbur, nëpërmjet ngritjes së një sistemi të integruar dhe efikas të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë. Sistemi i mbrojtjes civile në Shqipëri përbëhet nga:

- a) institucione dhe struktura qendrore të mbrojtjes civile;
- b) institucione dhe struktura vendore të mbrojtjes civile;
- c) struktura operacionale të mbrojtjes civile.

Është e domosdoshme që të zhvillohen strategji të mbrojtjes civile, për zvogëlimin e rreziqeve të fatkeqësive para ndodhjes së ngjarjeve, të menaxhohen emergjencat ndërsa ndodhin, të sigurohet rikuperimi pas fatkeqësive dhe të rritet aftësia ripërtëritëse. Në Shqipëri nuk ka strategji të mbrojtjes civile dhe ekziston një kapacitet i kufizuar administrativ¹¹.

Miratimi i “Strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile” është një detyrim ligjor, pasi përbën njërin prej objektivave të parashikuar në ligjin nr. 103/2014, “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”¹². Mungesa e strategjisë, është në kundërshtim me objektivin e pestë të “Kwadrit Sendai” të reduktimit të rrezikut të fatkeqësive: “Rritja në mënyrë thelbësore e numrit të vendeve me strategji të reduktimit të rrezikut kombëtar dhe lokal të fatkeqësive deri në vitin 2020”¹³.

Përveç këtyre të sipërpërmendurave, evidentohet edhe nevoja për forcimin e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të sistemit të mbrojtjes civile, e cila është tashmë një kërkesë urgjente dhe kritike e kohës.

5. “Kwadri Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë” dhe shkalla e zbatimit të tij në Shqipëri

Në vitin 2015, bashkësia ndërkombëtare ra dakord për tri marrëveshje të mëdha: “Korniza Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030”; “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm” dhe “Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimet klimatike”.

Kwadri Sendai për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030, është miratuar në konferencën e 3-të botërore të OKB-së për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, më 18.3.2015 në Japoni, si dhe miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 3.6.2015.

Qëllimi i KSPRR-së, është ulja e konsiderueshme e rrezikut nga fatkeqësitë dhe humbjet në jetë, banesa, dëme në shëndet si dhe në pasuri ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore të personave, bizneseve, komuniteteve dhe vendeve deri në vitin 2030¹⁴.

Sipas raportit të rrezikshmërisë botërore të 2017-s, të botuar nga Universiteti i Kombeve të Bashkuara, Instituti për Mjedisin dhe Sigurinë Njerëzore, që ka përllogaritur indeksin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore për vitin 2017, në 171 vende të botës,

¹¹ Raporti i progresit i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018.

Miratimi i strategjisë kombëtare për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile është një detyrim ligjor, pasi përbën njërin prej objektivave të parashikuar në ligjin nr. 103/2014, “Për miratimin e strategjisë së sigurisë kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

¹² Shih *Strategjinë kombëtare të sigurisë*, korrik 2014.

¹³ Shih “Objektivin e pestë” të *Kwadrit Sendai*.

¹⁴ Shih “Pjesën hyrëse” të *Kwadrit Sendai për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë*, tek www.unisdr.org.

bazuar në ekspozimin, prekshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe atyre përshtatëse, Shqipëria renditet në vendin e parë në Evropë (për të 4 vite me radhë) dhe në vendin e 40-të në botë, gjë që vjen si pasojë e rritjes vit pas viti të prekshmërisë së saj nga fatkeqësitë natyrore, rritjes së ndjeshmërisë ndaj tyre, pamjaftueshmërisë së kapaciteteve përballuese dhe atyre përshtatëse¹⁵.

Edhe pse “Kuatrid Sendai” nuk ka karakter detyrues për shtetet, rekomandimet e tij janë përqaftuar deri në implementim të plotë nga 187 shteteve anëtare të OKB-së (nga 195). Referuar “Kuatrid Sendai” për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030, “Çdo shtet duhet të parashikojë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve, pjesë e sistemit të mbrojtjes civile, subjekteve private, organizatave dhe shoqatave të shoqërisë civile, të shtetasve në tërësi dhe të detyrimeve specifike që lidhen me zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë”, ky objektivi nuk është pasqyruar në asnjë nga aktet ligjore apo nënligjorë të miratuara në Shqipëri pas vitit 2015. Nëse kjo do realizohej, do ndikonte drejtpërdrejt në rritjen e eficiencës, sikurse te niveli i bashkëpunimit të të gjitha institucioneve dhe strukturave në nivel qendror e vendor, shtetasve, subjekteve private, organizatave dhe shoqatave e shoqërisë civile, institucioneve kërkimore-shkencore, universiteteve, organizatave vullnetare, organizmave ndërkombëtare dhe organizatave homologe për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në të gjithë vendin, nëpërmjet përcaktimit në ligj të së drejtave dhe detyrave të qarta për secilin prej tyre.

Çdo dollar i vetëm i investuar gjatë fazës së parandalimit, na ndihmon të kursejmë 4 deri në 7 dollar investim gjatë fazës së rimëkëmbjes!

6. Rekomandime

Çdo ngjarje, përfaqëson në të njëjtën kohë një mundësi, për të analizuar problemet në sistemin e planifikimit strategjik, menaxhimit të situatës, kapaciteteve reaguese, aftësive rikuperuese si dhe mundësisë për të rindërtuar më mirë ato çfarë shkatërrohen nga ngjarjet mjedisore, qofshin ato, të karakterit natyror, apo të provokuara nga veprimtaria e njeriut.

Që kjo të realizohet, duhet angazhim serioz nga qeveria, dhe kjo duhet të mbështetet në:

- krijimin e agjencisë kombëtare të mbrojtjes civile;
- ndërtimin hap pas hapi të një qasje shumëdisiplinore për trajtimin e problematikave mjedisore; shkëmbim më të madh të informacionit nëpër sektorë; përqendrimin e shtuar të zbatimit të politikës mjedisore; një mbështetje më të fortë financiare;
- përafrimin e legjislacionit mjedisor me aktet ndërkombëtare dhe të drejtën komunitare;
- ngritjen një sistem monitorimi, që të jetë gjithëpërfshirës, me cilësi të lartë dhe të qëndrueshme, me mbështetjen e vëzhgimit të tokës nga hapësira, kur është e përshtatshme, ku të përfshihet një gamë sa më e gjerë burimesh;
- promovimin, forcimin dhe zhvillimin e një platforme të përbashkët në nivel kombëtar, nëpërmjet së cilës të gjithë aktorët të kenë dialog të vazhdueshëm dhe të ndihmohen përprojekjet e qeverive dhe qytetarëve, në zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe në aftësinë ripërtëritëse, duke krijuar marrëdhënie më të forta

përtejdisiplinore dhe ndërdisiplinore;

- modernizimin e sistemit të mbrojtjes civile, i cili do të duhet të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha sfidat me të cilat Shqipëria përballet, si një anëtar i NATO-s dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë dhe një aspirant për anëtarësim në Bashkimin Evropian;

- përmirësimin thelbësor të edukimit dhe trajnimit;

- rritjen e rolit të paralajmërimit të hershëm, monitorimit, njoftimit, alarmit, krijimit dhe të ruajtjes së bazës të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, në menaxhimin e fatkeqësive;

- planifikimin e fondeve financiare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile nga ana e ministrive dhe bashkive;

- përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga platformat globale, strategjitë, konventat, iniciativat, marrëveshjet dhe dokumente të tjera të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes civile, zvogëlimin të rrezikut nga fatkeqësitë, përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike etj;

- rritjen e angazhimit të institucionit lider në Shqipëri në planifikimin dhe koordinimin e mbrojtjes civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, në përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në “Mekanizmin evropian të mbrojtjes civile”.

Bibliografi

1. Korniza Sendai “Për Reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë 2015-2030”.
2. *Strategjia e sigurisë kombëtare*, korrik 2014.
3. Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”.
4. Worrall and Little, 2011.
5. G. Zurlini, F. Müller, *Encyclopedia of Ecology*, 2008.
6. S. Dalby, *Environmental Security*, Minneapolis: University of Minnesota Press (2002).
7. Sendai Conference Version, “Guide to Developing Disaster Recovery Frameworks”, GFDRR, World Bank, UNDP, mars 2015.
8. Direktiva 2004/35/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, “Mbi përgjegjësitë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin”, prill 2004.
9. Objektivat e OKB mbi “Zhvillimin e Qëndrueshëm”.
10. *Marrëveshja e Parisit mbi ndryshimet klimatike*.
11. “Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm 2030”.
12. “Agjenda e re urbane”.
13. *Plani kombëtar për emergjencat civile*, 2004.
14. Dokumenti “Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë”, 2003.
15. Konventa e Vjenës “Për mbrojtjen e shtresës së ozonit”.
16. *Plani i veprimit i Komisionit Evropian mbi implementimin SFDR*.
17. UNISDR, *Science and Technology Conference on the implementation of the Sendai Framework for Disaster Risk Reduction 2015-2030*. 27-29, Geneva, Switzerland, January 2016. <http://www.unisdr.org/partners/academia-research/conference/2016/>

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

Gjeopolitika dhe ekologjia: kontekstet e sigurisë mjedisore



■ **Dr. (proc.) Anisa HYESANI**
Akademia e Sigurisë
Qendra Kërkimor e Shkencore
anisa.hysesani@asp.gov.al

Abstrakt

Zërat kritikë, kanë paralajmëruar prej kohësh se supozimet e thjeshtëzuara të ndryshimeve mjedisore që çojnë drejtpërdrejt në konflikt, çojnë në një gjykim jo të saktë, më së paku, dhe të rezikshëm, më së shumti. Dhuna, shpesh shoqërohet me bollëkun e burimeve sesa me mungesat e tyre, kështu që është bërë kujdes i madh për të lidhur ndryshimin e mjedisit me konfliktin dhe më pas për të krijuar politika të dobishme sipas kontekstit të vendeve. Shfaqja e diskutimeve për sigurinë e klimës ka komplikuar si pamjen akademike ashtu edhe atë të politikave në mënyrë të konsiderueshme. Ndërsa disa nga mësimet e nxjerra nga diskutimet e mëparshme kanë vazhduar të jenë kuptimplota, dhe veçanërisht, në përgjigje të ngjarjeve ekstreme, temat e sigurisë klimatike duhet të përfshihen drejtpërdrejt në ndryshimin mjedisor global dhe në veçanti, në sistemet e shkencës së tokës. Kjo gjë kërkon zhvendosjen e përqendrimit nga disa nga formulime të hershme të sigurisë mjedisore. Tani, duket se siguria e klimës në planin afatgjatë nuk është më vetëm çështje e ndryshimit mjedisor duke shkaktuar vështirësi politike, por më tepër, një çështje e vështirësive politike bashkëkohore që shkaktojnë përshpejtimin e ndryshimit të klimës. Kjo ka implikime të mëdha, për mënyrën se si ne e kuptojmë sigurinë globale dhe rolin e ushtrisë në veçanti, në këto rrethana të reja. Por, urgjenca e trajtimit të ndryshimeve klimatike, do të thotë që këto çështje, kanë nevojë për vëmendje më të kujdesshme nga ana e analistëve akademikë dhe të sigurisë.

Fjalëkyçe:

gjeopolitike mjedisore, siguri mjedisore, politikat mjedisore, politikë bashkëkohore, ushtri, resurse.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Gjeopolitika mjedisore

“Hartat tona dominuese janë shumë të hollësishme dhe në përgjithësi të mjaftueshme për të parandaluar marramendjen midis më të privilegjuarve, por “dragonjtë” e botës së panjohur nuk janë më vetëm motive dekorative të marginalizuara. Në fakt, ata gjithnjë e më shumë na sugjerojnë që është po aq e kotë të kërkojmë politikë, atje ku supozohet të jetë, njësoj si të kërkojmë burime të autoritetit të qëndrueshëm poshtë fuçisë së një arme.”
(R. B. J. Walker. “*After the Globe, Before the World*”, f. 87.)

Gjeopolitika ka të bëjë në një shkallë të madhe me fuqinë, për mënyrën sesi bota është e organizuar politikisht, e ndarë në shtete, blloqe, aleanca, territore, juridiksione dhe rajone administrative. Termi përfshin pyetjet e mëdha se kush sundon si dhe çështjet politike në shkallë botërore. Padyshim që nënkupton edhe autoritetin, dhe siç e bëjnë të qartë gjenerata e tanishme e gjeografëve, që shkruajnë për këto tema, edhe për mënyrën se si përfaqësohet bota, si njihet, hartohet dhe shkruhet për të. Diskurset gjeopolitike, presupozojnë një sistem të vetëm botëror, të caktuar në praktikatat e njohurive që rrjedhin nga pushtimi evropian i pjesës më të madhe të planetit, në shekujt e fundit (Agnew 2003).

Në mënyrë thelbësore, këto ligjërime zakonisht presupozojnë pashmangshmërinë e rivaliteteve midis fuqive të mëdha dhe domosdoshmërinë e pashmangshme nga ana e drejtuesve të shtetit për të komplotuar dhe planifikuar strategji për të “luajtur mirë lojën”, ose do të duhet të vuajnë të gjitha pasojat fatkeqe. Kultura popullore riprodhon këto tema në lojëra të shumta kompjuterike simuluese dhe filma, romane si dhe programe televizive; temat gjeopolitike janë të lidhura me identitetet dhe me të gjitha llojet e praktikave botërore të kulturës, që thërrasin për sens të përbashkët (Dittmer 2010).

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

Këto formulime shpesh kanë të bëjnë me rreziqet dhe kërcënimet për shumë identitete kombëtare dhe shtetërore. Me sa duket, është një botë e rrezikshme, ku një ndryshim mund të sjellë sulme ose rreziqe të shumë llojeve; siguria është gjithmonë në rrezik, përveç nëse praktikohet vigjilencë e përrjetshme, dhe madje edhe atëherë nuk ka garanci në një botë të gjeopolitikës tabloide, ku përrallat morale të virtytit lidhen drejtpërdrejt me specififikimin e kërcënimeve të shumta ndaj rendit shoqëror (Debrix 2008). Ndryshimi, në vetvete mund të jetë i rrezikshëm, siç sugjerojnë shumë nga alarmet rreth globalizmit, gjithashtu dhe doktrinën e pas 11 shtatorit, të luftës globale, e kanë theksuar në mënyrë të përsëritur. Tani, globalizimi dhe frika e nënkuptuar nga e reja, i janë shtuar botëkuptimit të ri se keqfunksionimi dhe shkëputja në një shkallë të gjerë të sistemit klimatik të botës, aktualisht po ndodhin.

Ndryshimi i modeleve të motit, që prodhon ngrohja globale, po sjell shumë më tepër ndryshime në rendin njerëzor të gjërave, nëse jo edhe kërcënimin përfundimtar për të gjithë ne siç na thuhet ndonjëherë, atëherë ai që ka potencialin të paktën për luftëra të reja klimatike, disa prej të cilave mund dhe të dështojnë në planifikimin e kujdesshëm dhe bashkëpunimin politik, atëherë rrezikojmë të kthehet dekada bërthamore (Dyer 2008). Paralajmërimet se pasiguritë mjedisore mund të sjellin katastrofë, luftë, një turmë të pastrehë e njerëzimit duke rrezikuar rendin shoqëror dhe duke sjellë kaos dhe përçarje në zgjimin e tyre, përveç nëse ndodh që elitat politike të kohës sonë të ndryshojnë shpejt rrugën (Welzer 2012).

Me sa duket, për shumë analistë, ky është një fenomen i ri gjeopolitik që kërkon mobilizimin e aparateve të sigurisë së shumë shteteve dhe arenave krejt të reja për siguri dhe qeverisje, nëse jo konfrontim të hapur (Webersik 2010). Pjesërisht, ky është një reflektim se sa aspekte të jetës metropolitane tani janë sjellë nën ambicien e sigurisë si një mënyrë qeverisjeje. Pjesërisht, është gjithashtu një strategji retorike si dhe përpjekje për të tërhequr vëmendjen e politikëbërësve të cilët shpesh kanë dështuar të jenë në nivelin e seriozitetit të situatës që është vënë në lëvizje. Por, siç paralajmëroi Daniel Deudney (1990) kohë më parë, alarme të tilla mund të mos gjenerojnë përgjigjen e duhur të politikës, nëse institucionet ushtarake janë ato që mobilizohen për t'iu përgjigjur simptomave që krijojnë rrethanat e reja. Tani, me njohjen në rritje të shkallës së ndryshimit mjedisor, që është në lëvizje, është e qartë se rivlerësimi i sigurisë duhet të përfshijë rindikimin e pozicionit të njerëzimit në rendin më të madh të gjërave. Kjo gjë, kërkon që referencat e marra për bazë, në mendimin tradicional gjeopolitik të rimendohen, pikërisht sepse ne po ndryshojmë rrethanat që krijojnë mendimin gjeopolitik.

2. Ekopolitika e imagjinuar

Ambientalistët kanë argumentuar shpesh se ekziston një mospërputhje themelore ontologjike midis shteteve, praktikave të tyre të sovranitetit dhe krizës ekologjike (Conca, 1994). Ky nuk është një argument i ri, por pikat thelbësore në lidhje me dimensionet historike të ndryshimit mjedisor si një praktikë dhune dhe të kuptuarit gjeografik të lëvizjes historike të njerëzve si anatëmë ndaj kontejnerëve politikë të supozuar të sistemit ndërkombëtar bashkëkohor, sugjerojnë që debati aktual për mjedisin dhe konflikti është kapur në një seri kufizimesh disiplinore dhe institucionale që nuk arrijnë të trajtohen as me shkallën e problemit, as me trajektoren e tij historike.

Vështirësitë e të kuptuarit si të politikës ashtu edhe ekologjisë si procese në lëvizje dhe jo si subjekte të qëndrueshme që kanë nevojë për tu siguruar përballë ndryshimit,

janë shumë të konsiderueshme. Por, çdo angazhim thelbësor me diskutimet e problematikës së sigurisë mjedisore, duhet t'i marrë seriozisht këto çështje (Dalby, 1998b). Konkretisht, rreziqet e determinizmit të mjedisit, dhe supozimet neo-Malthusiane në lidhje me kufijtë e prodhimit në mjedis të veçanta, duhet të kundërshtohen nga një ekologji politike më e sofistikuar, që kupton ndryshimin mjedisor si një seri procesesh të ndërlikuara shoqërore, në kontekste gjeografike specifike. Në proces, supozimet e thjeshtuara për efikasitetin e shteteve, tregjet, shoqëritë civile ose projektet e modernizimit ekologjik, për të ofruar zgjidhje për vështirësitë mjedisore vihen në dyshim (Muldivin, 1997).

Thjesht, ndryshimi mjedisor nuk mund të jetë më variabël më i rëndësishëm me të cilën fillohet një analizë e sigurisë mjedisore. Nëse mjedisi kuptohet si një proces kulturor në planin afatgjatë, siguria bëhet një term shumë më i vështirë, si një objektiv i politikës gjithëpërfshirëse. Përqendrimi te migracioni dhe përçarja ekologjike si gjendje njerëzore dhe në disponimin e popujve më pak të fuqishëm si një proces afatgjatë i përsheptuar dhe i shtrirë në historinë e ekspansionit evropian, industrializimin karbonifer dhe së fundmi në globalizimin bashkëkohor, ofron një histori shumë të ndryshme, për të kuptuar pasigurinë e mjedisit. Së pari, çështjet e sigurisë mjedisore janë të reja vetëm në kuptimin që situata politike e pas luftës së ftohtë lejon që ato të diskutohen në një mënyrë që pengonte rivalitetin gjeopolitik. Çështjet ekopolitike janë në rendin e ditës, por konflikti dhe ndryshimi i mjedisit kanë qenë të lidhura ngushtë në zgjerimin e modernizimit për shekuj.

Së dyti, paqja demokratike beninje për mjedisin, sado e dëshirueshme për t'u konsideruar si një qëllim politik, është transformuar në një ekologji (gjeo)politike, modeli i së cilës duhet të punohet në mënyrë të qartë. Pyetjet mbi prodhimin, përdorimin dhe tregtinë e burimeve si dhe gjeografitë specifike të degradimit të mjedisit, komplikojnë kornizën shtetërore të territorit, të këtij teorizimi. Përfshirja e këtyre çështjeve në analizë sugjeron gjithashtu së treti, që lidhjet midis konfliktit ndër-shtetëror, në analizën e sigurisë mjedisore kanë nevojë për përpunime të mëtejshme në mënyra që përfshijnë ndryshimin e mjedisit direkt në modele të tilla.

Së katërti, e gjithë çështja e hapësirave gjeopolitike, në analiza të tilla, nuk mund të injorohet nëse analiza teorike do të jetë mjaft e fortë për të përfshirë të dy çështjet e ndryshimit mjedisor, dhe politikën e sigurisë, në mënyrë që të merremi me burimet e ndryshimit mjedisor në shkallë të përshtatshme dhe në kompleksitetin e duhur. Rrethanat ekopolitike kërkojnë që ekologjia dhe historia e mjedisit të merren seriozisht (Dalby, 1998b). Ndërsa vendimet për të ardhmen e njerëzimit janë qartësisht çështje politike, konteksti në të cilat ato mendohen, debatohen dhe vendosen, ka nevojë për një vëmendje më të kujdesshme sesa i është kushtuar deri më tani në shumicën e diskutimeve për sigurinë mjedisore.

3. Siguria mjedisore

Në të vërtetë, është pikërisht rreziku që të menduarit konvencional gjeopolitik mbi rivalitetet, përparësitë shtetërore për "siguri", mbikëqyrja e territorit dhe dhuna e përjashtimit hapësinor, do të jenë kriteret që do merren për bazë, lidhur me ndryshimet mjedisore dhe katastrofat e mundshme që stimuluan disa zëra kritikë, të hershëm, të argumenteve të sigurisë mjedisore në fillim të viteve 1990 (Deudney, 1990). Papërshtatshmëria e ushtrisë si institucion për trajtimin e çështjeve mjedisore

është e dukshme, por edhe ushtria si institucion përdor sasi të mëdha burimesh, toke dhe karburantesh duke lënë një trashëgimi masive mbeturinash toksike dhe radioaktive nga periudha e Luftës së Ftohtë. Por, tani, diskutimi për sigurinë klimatike zvarrit luftën globale mbi gjeografitë e rrezikut të terrorizmit në skenarin e sigurisë, duke e shtuar në diskutimin e mëparshëm të sigurisë mjedisore. Frika nga luftërat mbi burimet e pakta ishin një temë në raportin e *Komisionit Brundtland* të vitit 1987, por hulumtimet empirike në vitet 1990, që u përpoqën të ngacmonin lidhjet midis pamjaftueshmërisë së mjedisit dhe dhunës politike kishin vështirësi të mëdha për të vërtetuar supozimin fillestar Malthusian (Kahl 2006), (megjithatë, pasiguria ushqimore në zonat urbane është çështje që mund të shkaktojë paqëndrueshmëri politike; dhe diskutimet për pasojat e mungesës së ushqimit si rezultat i ndërprerjeve të motit në vitin 2012 u bënë tituj të shpeshtë, disa prej të cilave bënë lidhjen me ndryshimin e klimës). Evidencat sugjeruan, që dhuna lidhej më shpesh me kontrollin mbi burimet e vlefshme të burimeve në zonat e varfra, sesa me mangësitë mjedisore (Le Billon 2012). Frikësimet e përhershme të luftërave për ujë, kanë rezultuar se janë më shumë fantazi gazetareske sesa çështje e të dhënave historike. Megjithatë, ndërsa dhuna në shkallë të vogël dhe grindjet politike kanë të bëjnë me çështjet e tokës dhe ushqimit, njerëzit e uritur rrallë janë të aftë për të organizuar veprime të mëdha ushtarake. Frika e luftërave midis Veriut dhe Jugut global mbi ndryshimin e klimës ose faktorë të tjerë mjedisorë, doli të mos ketë bazë argumentuese në realitetin gjeopolitik.

Sidoqoftë, kjo nuk do të thotë që agjencitë ushtarake mund të mos kthehen në objekt, për migruesit pa strehë që kërkojnë strehim nga përmytjet, thatësitat dhe uraganet nëse konteksti portretizohet në atë mënyrë që refugjatët e dëshpëruar të paraqiten si një kërcënim për rendin shoqëror ose sigurinë kombëtare. Publikimet në revistat studiuëse kanë sugjeruar pikërisht këtë si logjikë që kërkon që agjencitë ushtarake t'i kushtojnë vëmendje çështjeve të ndryshimit të klimës (Smith 2007; Busby 2009). Qendrat e ekspertëve në vende të ndryshme kanë përpunuar skenarë të dënimit që lidhin ndryshimin e mjedisit me një epokë pasojash dhe madje edhe kataklizëm klimatik (Campbell 2007, 2008). Por, për aq sa këto mbeten të lidhura me specifikimin tradicional gjeopolitik, të virtytit metropolitane të kërcënuar nga rreziqe të jashtme në drejtim të migruesve ose paqëndrueshmërisë së shkaktuar nga shtetet e dështuara dhe rreziqet e terrorizmit, nuk do të arrijmë në implikimet e duhura të politikës. Në shkallë të madhe, duke marrë parasysh ndryshimin e klimës është e qartë se shkaku i problemit nuk janë popujt periferikë që kërcënojnë metropolet paqësore, por pasojat e konsumit metropolitane që prodhohen në ato periferi (Dalby 2009). Tendencat në dekadat e ardhshme, sugjerojnë një riformulim të kontekstit brenda të cilit ndodh politika në këtë drejtim, ndonëse inovacionet e dekadës së fundit zhvendosin fokusin se si kuptohet politika, te politika e justifikuar. Përndryshe, korniza e politikave që ka funksionuar deri më tani për të mbrojtur marrëveshjet ndërkombëtare financiare dhe politike që kanë shkaktuar ndryshimin e klimës, mund të përjetësohet si në politizimin e ndryshimit të klimës ashtu edhe politikën joefektive të zbutjes që kanë shkaktuar krizat aktuale (Wallbott 2012).

4. Gjeopolitika ose ekopolitika

Studimet mbi politikën dhe shkencën e ndryshimit të klimës, kanë tendencën të ndjekin logjikën e të hulumtuarit sesi ndryshimi i klimës mund të shkaktojë probleme të

sigurisë, dhe veçanërisht nëse ndryshimi i mjedisit do të shkaktojë konflikt. Kjo u debatua gjerësisht në vitet 1990 dhe kohët e fundit është rishikuar gjerësisht dhe përgjigja është kryesisht se ajo nuk do të ndikojë (Thiesen et. al 2011. Thjesht, duke vazhduar të supozojmë se mungesat e zonave periferike do të sjellin kërcënime për sigurinë metropolitane është empirikisht i pasaktë si dhe mashtrim politik. Pyetja më e rëndësishme është në të vërtetë e kundërta: Si ndikon gjeopolitika në ndryshimin e klimës? Çfarë vendimesh marrin elitat, si mendojnë për vendin e tyre dhe si duhet të veprojnë? Pika kyçe, tani, nuk është ajo që ndryshimet klimatike do të bëjnë për gjeopolitikën, por ajo që bën gjeopolitika për ndryshimin e klimës!

Për dy dekadat e fundit gjeopolitika kritike ka shtruar pyetje në lidhje me mënyrën e shkrimit dhe leximit të tokës, dhe se si politika bëhet dhe justifikohet në bazë të supozimeve të thjeshta që janë thellësisht të rëndësishme (Dalby 2010). Më i rëndësishmi nga të gjithë, është supozimi se toka është konteksti i dhënë për luftërat njerëzore. Por, shkenca, në dekadën e fundit e ka bërë të qartë se ky supozim i vjetër është kapërcyer nga ngjarjet e faktuara. Njerëzimi tani është një agjent i ri gjeomorfik në planet dhe ndërsa ne jemi një forcë relativisht e vogël në krahasim me forcat e natyrës, veprimet njerëzore janë mjaft të mëdha për të riformuar mënyrën e organizimit të biosferës, dhe gjatë procesit, të vendosim çfarë të bëjmë, si do të jetë klima dhe sa acidë do të jenë oqeanet në shekujt e ardhshëm. Dy dekadat e ardhshme do të vendosin se si do të duket ky skenar, sepse nivelet e rritura me shpejtësi të dyoksidit të karbonit në atmosferë, mund të shkaktojnë që sistemi i klimës dhe jeta në oqeanë gjithashtu të rikonfigurohen në mënyra të reja dhe të paparashikueshme. Gjeopolitika, ka vepruar rreth mënyrës se si luajnë rivalitetet e mëdha të pushtetit. Tani bëhet fjalë, edhe për të shkruar rregullat, që do na sjellin parametrat e ardhshëm të sistemit planetar. Shtimi i kësaj pike kyçe në gjeopolitikën tradicionale, është ajo që për dy dekadat e ardhshme na kërkohet të bëjmë. Sigurisht që nuk ka asnjë garanci që elitat politike dhe as strukturat qeverisëse do të evoluojnë në nivelin që të merren me këto çështje, por duket sikur shumë tendenca po ecin në këtë drejtim.

Thelbi i gjeopolitikës në gjeneratën e ardhshme nuk janë planet e luftës së fuqive të mëdha, por planet e tyre të konsumit të energjisë dhe strategjitë që ata përdorin për të planifikuar konfigurimin e ardhshëm të qyteteve, sistemeve ushqimore dhe infrastrukturës. Kjo mund të duket e çuditshme dhe larg nga tradicionalja e politikës së lartë, por është pikërisht në këto vendime që po bëhet konfigurimi i ardhshëm i politikës globale, pavarësisht nëse kjo është e qartë për vendimmarrësit apo jo. Politikanët evropianë, dhe mbase homologët e tyre kinezë, duket se e kuptojnë këtë, - megjithëse në Amerikën e Veriut ekzistojnë interesa të fuqishme të vendosura të rezistojnë ndaj këtyre ndryshimeve, - dhe të interesuar, që të dy mohojnë sa më gjatë që të jetë e mundur rëndësinë e ndryshimit të klimës, ndërsa theksojnë dobinë e forcës në trajtimin e vështirësive politike në vendet periferike.

Por, për sa kohë që janë ndërmarrë përpjekjet për t'u marrë me ndryshimin e klimës, tani është e qartë se në një masë shumë të konsiderueshme përpjekjet për qeverisje po i shpëtojnë mekanizmave tradicionalë të kontrollit territorial të shteteve. Përpjekje të shumta nga ana e subjekteve nënshtetërore, bashkive, korporatave dhe komuniteteve janë duke ndërmarrë iniciativën të mendojnë se si të menaxhojnë çlirimin e karbonit ose si të veprojnë në mënyra të qëndrueshme (Newell dhe Paterson 2010). Tani ekzistojnë tregje të konsiderueshme të lidhura me karbonin, dhe ndërsa qartazi skepticizmi është i madh, për sa i përket ndikimit afatshkurtër që këto mund të kenë,

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

megjithatë ato sugjerojnë mënyra të qeverisjes që kanë të bëjnë me praktikat e ekologjisë, shumë më tepër sesa me rivalitetet tradicionale të shteteve territoriale. Edhe mënyrat tradicionale ushtarake të luftimeve, janë të padobishme përballë shumë fatkeqësive të ndërlikuara humanitare; siguria njerëzore nuk ka të bëjë me mbizotërimin ushtarak, ka të bëjë me sigurimin praktik të infrastrukturës dhe përshtatjen ndaj modeleve të paparashikueshme (Beebe dhe Kaldor 2010). Siguria në këto terma ka të bëjë me lidhjen, praninë në tokë dhe parashikimin, jo veprimin e dhunshëm pas këtij fakti.

Fleksibiliteti dhe lidhjet horizontale midis njësive ekonomike, kryesore për shumicën e kuptimeve të ekologjisë, janë në të vërtetë pjesë e arkitekturës së disa prej mënyrave për zhvillimin e qeverisjes klimatike pasi ato janë në përpjekje të reja për të menduar për sigurinë njerëzore. Si të tilla, këto mënyra të shkrimit dhe monitorimit të rregullave mund të jenë më të përshtatshme sesa sistemet e centralizuara të mbikëqyrjes së shteteve. Nëse këto modele forcohen dhe fillojnë të formojnë vendimet e prodhimit, në dekadat e ardhshme, kjo ka rëndësi të madhe, pasi ne kalojmë në fazën e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Mosarritja e një inovacioni të tillë mund të ketë pasoja kundërproduktive dhe të lejojë elitat politike të kërkojnë gjeopolitikë të modës së vjetër për të lehtësuar përkohësisht, disa nga simptomat e ndryshimit të klimës. Por, nëse kjo do të ndodhë, ajo do të jetë duke përsëritur historinë si farsë, por njëkohësisht edhe si tragjedi globale.

Bibliografi

1. Agnew, John (2003) *Geopolitics: Re-Visioning World Politics* London: Routledge.
2. Barnett, Thomas (2009) *Great Powers: America and the World After Bush* New York: Putnam's.
3. Beebe, Shannon D. and Mary Kaldor (2010) *The Ultimate Weapon is No Weapon: Human Security and the New Rules of War and Peace* New York: Public Affairs.
4. Campbell, Kurt, M. ed. (2008) *Climatic Cataclysm: The Foreign Policy and National Security Implications of Climate Change* Washington: Brookings Institution.
5. Campbell, Kurt, M. et.al (2007) *The Age of Consequences: The Foreign Policy and National Security Implications of Global Climate Change* Washington: Center for Strategic and International Studies and Center for a New American Security.
6. Dalby, Simon (2009) *Security and Environmental Change* Cambridge: Polity.
7. Dalby, Simon (2010) "Recontextualising Violence, Power and Nature: The Next Twenty Years of Critical Geopolitics?" *Political Geography* 29(5). 280-88.
8. Debrix, François (2008) *Tabloid Terror: War, Culture and Geopolitics* New York, Routledge.
9. Deudney, Daniel (1990) "The Case against Linking Environmental Degradation and National Security," *Millennium* 19. 461-76.
10. Dittmer, Jason (2010) *Popular Culture, Geopolitics, and Identity* Lanham MD: Rowman and Littlefield.
11. Dyer, Gwynne (2008) *Climate Wars* Toronto: Random House.
12. Kaplan, Robert (2012) *The Revenge of Geography: What the Map Tells us about Coming Conflicts and the Battle Against Fate* New York: Random House.
13. Le Billon, Philippe. (2012) *Wars of Plunder: Conflicts, Profits and the Politics of Resources* London: Hurst
14. United Nations Environment Program (2007) *GEO4 Global Environmental Outlook: Environment for Development*. Nairobi: United Nations Environment Program.
15. United Nations Environment Program (2012) *GEO5 Global Environmental Outlook: Environment for the Future we Want*. Nairobi: United Nations Environment Program. (<http://www.unep.org/geo/geo5.asp>)
16. Vasquez, John (1993) *The War Puzzle* Cambridge: Cambridge University Press.
17. Vasquez, John A. and Marie T. Henehan (2011). *Territory, War and Peace* (London: Routledge).
18. Wagner, Philip (1996) *Showing Off: The Geltung Hypothesis* Austin: University of Texas Press.
19. Walker, R.B.J. (2010) *After the Globe, Before the World* New York: Routledge.
20. Webersik, Christian. 2010. *Climate Change and Security: A Gathering Storm of Global Challenges*. Santa Barbara: Praeger.
21. Welzer, Harald (2012) *Climate Wars: What People will be Killed for in the Twenty First Century* Cambridge: Polity.
22. Zizek, Slavoj (2010) *Living in the End Times* London: Verso.

Siguria mjedisore në fokus të sigurisë kombëtare



■ **MSc. Tonin PRENDI**
Inspektor mjedisi, ISHMPUT Lezhë
tprendi64@gmail.com

Abstrakt

Sfidat mjedisore me të cilat po përballlet sot mbarë njerëzimi, janë vendosur në fokus të politikave mjedisore anë e mbanë botës, duke tërhequr vëmendjen dhe angazhimin e gjithë aktorëve, me qëllim trajtimin e tyre me vëmendje dhe përkushtim maksimal. Kjo frymë ka përfshirë edhe institucionet mjedisore shqiptare, të cilat gjithnjë e më shumë i janë afruar kësaj qasjeje dhe kanë përqaftuar frymën e trajtimit të çështjeve mjedisore, si një çështje me rëndësi madhore, veçanërisht lidhur me cilësinë e jetës dhe shëndetin e qytetarëve. Kështu në këtë punim do të përpiqem të trajtoj dhe hedh dritë mbi këto çështje, duke i parë në konceptin e sigurisë në përgjithësi e të asaj mjedisore në veçanti si një temë e re, por jo e panjohur në strukturat politike dhe vendimmarrëse në vend. Trajtimi i çështjeve mjedisore në dukje është i thjeshtë, por nga ana tjetër është mjaft kompleks, siç është edhe vetë mjedisi kompleks, me karakteristika të dukshme dhe të padukshme, me zhvillimin, degradimin, duke u shtuar këtu edhe ndikimin njerëzor. Ky trajtim në vetvete mbështet në analizën e dokumenteve strategjike të vendit tonë, si “Strategjia e sigurisë kombëtare”, “Strategjia ndërsektoriale e mjedisit”, “Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim” etj.

Fjalëkyçe:

siguri, siguri mjedisore, siguri kombëtare, mjedis, strategji kombëtare për mjedis.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

“Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare”

1. Hyrje

Siguria është një term i ri dhe shumëdimensional. Ndonëse ka një ndjeshmëri të madhe të publikut ndaj sigurisë dhe pavarësisht se është një nga termat më të përdorur akoma nuk ka një konsensus mbi gjerësinë dhe kuptimin e këtij koncepti. Në mes të viteve '80 në pik të debateve mbi sigurinë u krijua ajo që tashmë njihet si “Shkolla e Kopenhagës”. Ajo u krijua si shkollë e mendimit akademik dhe fillimet i pati me botimin e teoricienit Barry Buzan “Populli, shteti dhe frika”, problemi i sigurisë kombëtare në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke përqafuar konceptin jotradicional. Sot siguria kombëtare është një e mirë publike dhe e zbatuar si e drejtë themelore e njeriut në një shtet demokratik-liberal duke u përsosur me përfshirjen në të edhe të sigurisë njerëzore (“human security”). Kështu disa nga drejtimet apo detyrimet ndaj sigurisë njerëzore janë siguria ekonomike, ushqimore, shëndetësore dhe padyshim siguria mjedisore, e cila nënkupton mbrojtjen e njerëzve nga abuzimi dhe shkatërrimi i natyrës, apo nga ndotja e mjedisit, etj. Pikërisht për sigurinë mjedisore si koncept dhe si fushë gjithëpërfshirëse: si ka lindur, pse është e rëndësishme, si është trajtuar në vendin tone, kush janë kërcënimet ndaj saj etj., – do të mundohem t’i trajtoj si çështje në vijim.

2. Problemet mjedisore: zanafilla

Siguria mjedisore është një term i ri politik dhe shkencor, që ka evoluar vetëm gjatë 20 viteve të fundit, si pasojë e ndikimit të madh që faktorët natyrorë kanë në sigurinë kombëtare. Vitet '60-'70 shënojnë fillimin e shqetësimit të gjerë publik, mbi degradimin e mjedisit në vendet e zhvilluara të Perëndimit kur ndotja, para së ashtuquajturës “krizë mjedisore”, u njoh zyrtarisht si një shqetësim lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar. E

AKADEMIA
E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

ndërsa kemi pasur një konsensus mbi termin ‘mjedis’, për sa i përket ‘sigurisë’, për një kohë të gjatë ajo është konceptuar ngushtësisht si siguri territoriale nga rreziqet e jashtme, ose si mbrojtje e interesave kombëtare. Siguria ka qenë tradicionalisht e lidhur me shtet-kombin si territor, se sa si popull. “Ajo (siguria) nënkupton të qenit jashtë çdo rreziku dhe të papriture, gjendje pa ndonjë rrezik a të keqe të papritur... siguria mund të përcaktohet edhe si liri që pasqyron vlerat apo si një mungesë kërcënimi ndaj vlerave të fituara”¹.

Në dekadën e fundit, kërcënimet mjedisore në agjendat e sigurisë (ndër) kombëtare njohën “disfatë” pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit. Shumica e vendeve perëndimore, përqendruan vëmendjen dhe energjitë, edhe një herë, në masat që do të ndërmerren për të luftuar terrorizmin, çka la tërësisht të eklipsuar konceptin e sigurisë njerëzore, në të cilën faktori “mjedis” luan një rol kyç. Besohet se terrorizmi mund të lulëzojë vetëm në një botë ku shumica e popullsisë nuk është e aftë të përmbushë nevojat minimale të jetesës: ujë i pastër, ushqim i mjaftueshëm, toka bujqësore, pyje etj. Ndërkohë, në anën tjetër, një ushtri sado e madhe dhe e sofistikuar, është e pafuqishme për të parandaluar emergjencat natyrore, ngrohjen globale, shkretëtirëzimin, rritjen e nivelit të deteve etj. Si rrjedhim, me kalimin e viteve është bërë gjithmonë e më e qartë se kërcënimet ushtarake nuk janë reale për vendet e zhvilluara apo edhe ato në zhvillim. Janë faktorët mjedisorë, ekonomikë, socialë e politikë që drejtpërdrejt ndikojnë në kushtet e jetesës së njerëzve, duke shkaktuar pasiguri dhe ngjarje ekstreme. E megjithëse këto fakte janë pranuar gjerësisht, mbrojtja ushtarake vazhdon të shpenzojë shumë herë më tepër se mbrojtja mjedisore.

2. Problemet mjedisore në Shqipëri

Gjatë viteve të tranzicionit, i cili ndoqi rënien e regjimit totalitar në Shqipëri, zbatimi i dobët i ligjeve rezultoi në shpyllëzime të gjëra dhe ndotje të niveleve të larta në rajonet urbane. Keqmenaxhimi dhe shfrytëzimi pa kriter i burimeve dhe pasurive natyrore rezultoi në degradimin e shpejtë të mjedisit, duke shkaktuar deri edhe emergjenca kombëtare. Si rrjedhojë, çështjet mjedisore nisën të konsideroheshin rrezik për sigurinë dhe stabilitetin e vendit. Por, pavarësisht kërcënimit real, mjedisi vazhdon të mos shënojë prioritet në agjendën e sigurisë kombëtare, ku disa probleme, në dukje më të prekshme, si papunësia, korrupsioni, apo terrorizmi, paraqiten si kërcënuesit primar të interesave kombëtare. Aktualisht në Shqipëri, “mbrojtja e mjedisit është njohur si një ndër prioritetet kombëtare dhe një detyrim për të gjithë aktorët, qofshin këta institucione shtetërore, organizata jofitimprurëse, kompani private apo qytetarë të thjeshtë”².

Por, siguria mjedisore del në plan të parë vetëm në rastet e situatave ekstreme, që mund të shkaktohen nga përmytjet, thatësira apo tërmetet, duke i dhënë karakter rastësor masave dhe politikave të mbrojtjes dhe shmangies së rreziqeve mjedisore. Ndërkohë që në një plan afatgjatë, përgjigja ndaj kërcënimeve mjedisore nuk është në nivelin e dëshiruar. Aktualisht situatat emergjente përsëriten, duke mos shkuar më tej se reagimi ndaj pasojave, në një kohë që parandalimi i pasojave tragjike të katastrofave natyrore, në kohë me shi apo me diell, mbetet një vizion ende i paarritshëm për strukturat shtetërore në vend.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

¹ Xhavit Shala. *Siguria, kuptimi mbi sigurinë*. Kolegji Universitar “Luarasi”. Leksion 1.

² Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, *Për mbrojtjen e mjedisit*.

3. Siguria mjedisore, njohja me një koncept të ri

Termi “siguri mjedisore” u përdor për herë të parë nga PNUD-i në vitin 1994, duke përfshirë kërcënimet madhore që mund të prishin ekuilibrat delikatë në tokë. Raporti i PNUD-it identifikon: “Shtatë fusha të ndryshme të sigurisë njerëzore – siguria mjedisore (shpesh në formën e pasojave të katastrofës mjedisore) është një prej tyre. Këtu, qartazi, ekuacioni i sigurisë nuk përfshin çështje që lidhen me ushtrinë, por më tepër situata që të vështira sa ato janë ekuivalente me luftën”.³

Siguria mjedisore hyri në agjendën e “zhvillimit të qëndrueshëm” që ka si qëllim përmbushjen e nevojave aktuale të brezave të sotëm, pa kompromentuar brezat që do të vijnë. Nën këtë qasje, siguria mjedisore mund të përcaktohet më mirë si procesi i reduktimit në mënyrë paqësore të vulnerabilitetit të njeriut, në nxitjen prej tij të degradimit të mjedisit duke adresuar shkaqet e degradimit dhe pasigurisë njerëzore. Kërcënimi i çështjeve mjedisore, përgjatë periudhës së Luftës së Ftohtë ishte në fokus në shumë vende të botës. Duke qenë se këto shqetësime ekzistonin për një kohë të gjatë mes mjedisorëve, një shtresë ushtarakësh dhe institucionesh filluan të mendonin dhe të shpreheshin mbi këto shqetësime që ishin serioze. Për rrjedhojë natyrshëm lindi pyetja: a duhet të përbëjnë shqetësim për sigurinë kombëtare?

Shqetësimet mjedisore shpesh herë i kalojnë kufijtë gjeografikë, duke u konsideruar si një nga çështjet më transnacionale në studimet e paqes, sigurisë rajonale dhe të drejtave të njeriut. Për shkak të kësaj domosdoshmërie të bashkëpunimit global, çështje si shtresa e ozonit, shterimi dhe keqpërdorimi i burimeve natyrore, prerja dhe degradimi pyjeve, zunë një vend të rëndësishëm në agjendën publike ndërkombëtare. Dhe pikërisht këtu fillon debati për sigurinë mjedisore. Çfarë lloj kërcënimesh? Sa serioze janë? Kush është përgjigja institucionale, dhe a ka një përgjigje të tillë? Këto pyetje morën shkas nga *Raporti Brundland*, i autorizuar nga Kombet e Bashkuara për studimin mbi pamjaftueshmërinë e burimeve natyrore. “Ky raport më tepër u fokusua në pamjaftueshmërinë e ujit të pijshëm, burimeve natyrore (naftës, mineraleve, pyjeve) në shumë territore dhe potencialet për konflikt që do të lindnin nga këto mungesa”⁴.

“Samiti i Rios” i vitit 1992 ose siç njihet “Samiti i Tokës” në mbledhjen e tij diskutoi mbi gjetjet e “Raportit Brundland”. Por ky samit siç dihet nuk u mor me çështjen e sigurisë mjedisore. Kjo sepse në atë kohë mjedisi shikohej vetëm në kontekstin e parimit *zhvillim i qëndrueshëm* (ekonomik-social-mjedisor). Ky lloj emërtimi iu lejoji shteteve të Jugut të përfitonin investime të mëdha nga shtetet e Veriut, duke krijuar kështu dhe ndarjen Veri-Jug në çështjet mjedisore, për dekadat që do të vinin. Në nivel institucional, një moment i rëndësishëm në përpjekjet e vazhdueshme ndërkombëtare për të zvogëluar ndryshimin klimaterik ishte viti 1992 kur shtetet anëtare të OKB-së themeluan “Konventën kuadër të Kombeve të Bashkuara mbi ndryshimin klimaterik” (UNFCCC), e cila hyri në fuqi dy vjet më vonë. Ky është kuadri mbi bazën e së cilit u nënshkrua më pas edhe marrëveshja e parë ndërkombëtare ndërmjet shteteve anëtare të OKB-së në vitin 1997, siç njihet, *Protokolli i Kyoto-s*. Ky protokoll thekson: “Akullnaja që shkrijnë, sa vjen e më shumë katastrofa prej thatësisë dhe përmytjeve: këto janë pasojat e ndjeshme të ngrohjes së Tokës, mendojnë mbrojtësit e mjedisit. Arsyeya, është

³ Raporti i PNUD, viti 1994

⁴ Brundland report 1987.

qlirimi ende në rritje i dyoksidit të karbonit. Pakësimi i emetimit të gazrave të tilla që shkaktojnë efektin serë është synimi që kanë vendet nënshkruese.”⁵

Në përpjekjet për të kontribuar sadopak në uljen e efektit të ngrohjes globale Shqipëria është anëtarësuar në *Konventën e OKB-së për ndryshimet klimatike* që në vitin 1995, kur dhe parlamenti shqiptar e ratifikoi “Protokollin e Kyoto-s”. Njohja e sigurisë mjedisore si një subjekt kryesor në çështjet kombëtare dhe ndërkombëtare u zhvillua ngadalë. Në fillim të vitit 1983, “Shkolla e Kopenhagës” e studimeve të sigurisë, e prezantoi sigurinë mjedisore si një nga pesë sektorët kryesorë të sigurisë kombëtare: *ushtarake, ekonomike, sociale, politike dhe mjedisore*. Por, çfarë është siguria mjedisore? A është çështje sigurie kombëtare? A është çështje sigurie globale? A është çështje sigurie njerëzore? Siguria mjedisore është pak nga të gjitha. Siguria mjedisore është një ndryshim i konceptit të sigurisë kombëtare (nga koncepti konvencional). Kur flasim për sigurinë në konceptin tradicional, njerëzit kanë parasysh kërcënimin që ndodh diku atje në kufi, ose brenda tij që shkaktohet nga armiku ose aktorë të jashtëm. Ndërsa siguria mjedisore shkaktohet diku brenda dhe jo jashtë, nga vetë ne. Prandaj, siguria mjedisore duhet parë dhe konceptuar në një mënyrë krejt të re dhe kështu duhet të jetë dhe reagimi ndaj saj, krejt i ri nga mënyra konvencionale.

“Siguria mjedisore nënkupton mbrojtjen e njerëzve nga abuzimi e shkatërrimi i natyrës, ndotja e mjedisit, keqpërdorimi i tokës dhe ujit, nga përdorimi i teknologjive të prapambetura, makinave të vjetra etj.”⁶ Pra, siç thamë më lart siguria mjedisore është një koncept i ri dhe si i tillë është i panjohur dhe i pa adresuar në nivelet dhe strukturat e duhura. Nisur nga kjo nevojë, në vitin 2002 është krijuar iniciativa pilot e përbërë nga pesë organizata rajonale: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim (OSCE), Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara (UNEP), Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) dhe më vonë iu bashkua dhe NATO-ja duke formuar bashkëpunimin e parë të quajtur ENVSEC – *environmental security*.⁷ Kjo platformë bashkëpunimi kishte si mision “kontributin për reduktimin e rreziqeve mjedisore dhe sigurisë përmes forcimit të bashkëpunimit ndërmjet shteteve në katër rajone: Azinë Qendrore, Evropën Lindore, Kaukazin Jugor dhe Evropën Juglindore. Pra, jo pa qëllim kjo iniciativë përfshin institucione kryesore që merren me problemet e sigurisë në dimensione të ndryshme, ashtu siç paraqitet vetë koncepti siguri.

4. Siguria mjedisore në dokumentet strategjike të Shqipërisë

Nëse do të kryenim një analizë mbi dokumentet bazë të shtetit shqiptar siç janë: *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI)*, *Strategjia ndërsektoriale e mjedisit (SNM)* si dhe *Strategjia e sigurisë kombëtare (SSK)*, për të nxjerrë trajtimin e konceptit të sigurisë mjedisore në Shqipëri, ajo që do të vërejmë është mungesa jo vetëm e trajtimit të konceptit “siguri mjedisore”, por edhe fakti që “siguria mjedisore” trajtohet vetëm në rastet e faktorëve të jashtëm, apo kur kemi fatkeqësi natyrore. Në fakt, siguria mjedisore duhet të shikohet si element ose faktor i brendshëm. Dhe ajo që vërejmë është se, siguria mjedisore nuk është trajtuar në dokumentet kryesorë shtetërorë,

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

⁵ Protokollin e Kyotos, viti 1997

⁶ Xhavit Shala. *Siguria, kuptimi mbi sigurinë*. Kolegji Universitar “Luarasi”. Leksion 1.

⁷ ENVSEC *Siguria Mjedisore* <http://www.envsec.org>.

megjithëse siguria mjedisore është një komponent shumë i rëndësishëm për Shqipërinë dhe sigurinë e saj kombëtare. Strategjia energjetike e vendit është 90% e bazuar mbi burime natyrore dhe si e tillë, çdo kërcënim ndaj sigurisë mjedisore është kërcënim ndaj sigurisë energjetike dhe rrjedhimisht asaj kombëtare (këtu mund të përmendim si arritje atë që po hartohet strategjia kombëtare e sektorit energjetik për periudhën 2015-2030). Në rastin më të mirë flitet për një “siguri” të qëndrueshme ekonomike (zhvillim ekonomik i qëndrueshëm) që përfshin dhe mjedisin por natyrisht kjo është jashtë natyrës së sigurisë mjedisore si përbërës i sigurisë kombëtare.

Duke ju referuar Kushtetutës së Shqipërisë ndër të tjera citohet: “Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: d) një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm; dh) shfrytëzimin racional të pyjeve, ujërave, kullotave dhe burimeve të tjera natyrore mbi bazën e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm”.⁸ Dokumenti kryesor i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, është *Strategjia ndërsektoriale e mjedisit 2015-2020* dhe planet përkatëse për zbatimin e kësaj strategjie. Megjithëse SNM është e integruar me *Strategjinë kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, trajtimi ndaj sigurisë mjedisore shikohet vetëm në kontekstin e “dëmit mjedisor”, pra dëm mjedisor në fushën e nxjerrjes së mineraleve, ndotjes së kores së tokës, krijimi i pikave të nxehta mjedisore si pasojë e mbetjeve nga minierat etj. Megjithatë, dokumenti është përgjithësisht pozitiv dhe mbulon një tematikë të gjerë në fushën e mbrojtjes së mjedisit ku, në vend të parë të strategjisë qëndron prioriteti i qeverisë që është integrimi në Bashkimin Evropian dhe zhvillimi i qëndrueshëm në funksion të zhvillimit ekonomik të vendit.

Referuar SNM-së, vizioni i saj është: “Shqipëria, vend me një zhvillim të qëndrueshëm social dhe ekonomik, duke mbrojtur burimet natyrore nga ndotja dhe degradimi, nëpërmjet menaxhimit të integruar të tyre dhe duke promovuar vlerat mjedisore e duke i vendosur ato në përfitim të prosperitetit ekonomik.”⁹ Dokumenti bazë që lidhet me vizionin dhe prioritetet kundrejt së ardhmes është *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim (SKZHI) 2015-2020*, e hartuar si nevojë e përshtatjes së objektivave dhe prioritetëve tona kundrejt zhvillimit ekonomik dhe integritimit Evropian të vendit tonë. Mund të themi që, SKZHI është kolona kryesore pas kushtetutës së vendit. Dhe vizioni i saj është: “Shqipëria – një demokraci në forcim, në rrugën drejt integritimit të saj në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme, që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut.”¹⁰ Në vështrim të përgjithshëm Dokumenti SKZHI është organizuar në katër pjesë kryesore. Në pjesën e katërt krahas mekanizmave për zbatimin e strategjisë jepen edhe disa faktorë risku që mund të pengojnë zbatimin e saj.

Dhe, duke trajtuar mjedisin theksohet se: “Në Shqipëri mbrojtja e mjedisit është përgjegjësi e përbashkët. Në gamën e mjedisit, si sektor përfshihen çështje që kanë të bëjnë me cilësinë e ajrit, ndryshimet klimaterike, menaxhimin e kimikateve dhe mbetjeve, ndotjen industriale, mjedisin natyror dhe zonat e mbrojtura, pyjet dhe kullotat, si edhe burimet ujore”¹¹, e më tej: “Rrjedhimisht, sektori ka kërkuar një qasje strategjike, të integruar dhe komplekse, ku trajtimi i aspekteve mjedisore kërkon angazhim serioz si

⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenin 59 paragrafi 1 pika d) dhe dh).

⁹ *Strategjia ndërsektoriale e mjedisit, 2015-2020*, f. 12.

¹⁰ *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim*, f. 2.

¹¹ *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim*, f. 183.

për sa i takon aspekteve rregullatore dhe legislative, ashtu edhe për sa i takon investimeve në infrastrukturë.”¹² Ndërsa në lidhje me ndryshimet klimaterike ndër të tjera theksohet: “Adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike është një sfidë për vendin. Deri tani përshtatjet kanë ndodhur deri në një farë mase vetëm për planifikimin në bujqësi dhe pyje. Çështja më urgjente për sa i përket adaptimit ka të bëjë me erozionin bregdetar që po kanos dhe po shkakton humbje të tokave më me vlerë në zonat bregdetare”.¹³

Referuar këtyre dy fakteve të pranuar në SKZHI, vëmë re shqetësimin deri në “kërcënim të mjedisit”, por vetëm kaq. Në dokument mungon trajtimi i konceptit të sigurisë mjedisore, duke e trajtuar në kontekstin e dëmit mjedisor dhe elementëve të lidhura me mjedisin si, mbetjet, cilësia e ajrit, pyjet, biodiversiteti, kanalizimet dhe erozioni. Askund nuk trajtohet se kush janë implikimet për sigurinë si pasojë e problematikave mjedisore, duke vënë theksin tek “qasja strategjike” pa adresim të ndikimeve të sigurisë mjedisore në sigurinë kombëtare.

5. Siguria mjedisore dhe strategjia e sigurisë kombëtare

Në *Strategjinë e sigurisë kombëtare* ndër të tjera theksohet:

“Brezi ynë mban përgjegjësi historike për krijimin e një mjedisi që do t’i shërbejë mirëqenies dhe sigurisë së gjeneratave të ardhshme. Veprimet tona sot përcaktojnë trashëgiminë që do t’u lëmë brezave të ardhshëm”,¹⁴ e kjo është përgjegjësi strategjike.

Në SSK, vërehet se “kërcënimet mjedisore” janë të pranishme, por paraqiten të fundit në listën e “interesave kombëtare”. Kjo mund të dëshmojë shkallën e prioriteteve në fushën e sigurisë kombëtare, ku natyrisht kërcënimet kryesore që i kanosen Shqipërisë e që lakohen më tepër në debatin publik, janë krimi i organizuar, destabiliteti politik, varfëria, emigracioni etj. Duke vlerësuar faktorin mjedisor në sigurinë e vendit SSK cilëson:

“Mbrojtja dhe rigjenerimi i natyrës shqiptare do të sigurojnë një mjedis ekologjik e kushte të favorshme për jetesë për qytetarët dhe shoqërinë. Interesat kombëtare kërkojnë marrjen e masave për shfrytëzimin racional të burimeve të natyrës nëpërmjet zhvillimit të një strategjie të balancuar sektoriale për mbrojtjen e mjedisit natyror në interes të zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë.”¹⁵

“Pavarësisht burimeve të shumta natyrore të tokës, nëntokës dhe mbi tokës, Strategjia nxit një shfrytëzim të balancuar, të kursyer dhe të kujdesshëm të burimeve natyrore duke mbajtur në konsideratë karakterin e fundmë të tyre dhe interesat e ligjshëm të brezave të ardhshëm.”¹⁶

SSK e trajton mjedisin si një ndër objektivat mbështetës të strategjisë në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, dhe si detyrim i përshpejtimin të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian të vendit. SSK në lidhje me mjedisin thekson: “Parandalimin e degradimit mjedisor dhe reduktimin e pasojave të ndryshimeve klimatike, duke menaxhuar me efektivitet basenet ujore, shtuar sipërfaqet pyjore, trajtuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane, si dhe duke bashkëpunuar me shoqërinë civile

¹² *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim*, f. 183.

¹³ *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim*, f. 184.

¹⁴ *Strategjia e sigurisë kombëtare*, f. 4.

¹⁵ *Strategjia e sigurisë kombëtare*, f. 5.

¹⁶ *Strategjia e sigurisë kombëtare*, f. 8.

për ndërgjegjësimin e opinionit publik për ruajtjen e mjedisit¹⁷. Por, pa arritur të shkohet më tej në trajtimin të sigurisë mjedisore. Mjedisi strategjik karakterizohet nga një kompleksitet në rritje dhe një nivel parashikueshmërie në ulje. Me gjithë tendencën e qartë pozitive, siguria e vendit vijon ende të jetë e varur ndjeshëm edhe nga rreziqe me natyrë të brendshme. Kështu ndër rreziqet që kërcënojnë sigurinë kombëtare SSK vë në dukje: “Degradimi mjedisor dhe fatkeqësitë natyrore, shkatërrimi i mjedisit, shpyllëzimi, ndotja e lumenjve dhe fatkeqësitë natyrore, industriale apo të shkaktuara nga ndikimi i njeriut”, por edhe “Kriza energjetike, që kërcënon sigurinë e furnizimit të RSH-së dhe cenon rritjen ekonomike.”¹⁸

Shpesh ndodh që shumica e rreziqeve natyrore (përmytjet, zjarret, etj.) pretendohet se lidhen me fenomenin madhor të ngrohjes globale. Por, kjo është e diskutueshme pasi në pjesën më të madhe rreziqet natyrore lidhen ngushtë me aktivitetin njerëzor dhe aktivitetin industrial në natyrë. Megjithëse SSK përcakton se burimet natyrore dhe mjedisi janë elementë të pashtershme të sigurisë, në përbërjen e Këshillit të Lartë të Sigurisë Kombëtare, ministri i Mjedisit dhe Turizmit nuk bën pjesë. Paradoksalisht, në SKK-në e vendit tonë mungon komponenti kryesor që ka të bëjë me mirëqenien dhe sigurinë njerëzore siç është siguria mjedisore, kur kjo e fundit është një nga sfidat dhe dimensionet kryesore të sigurisë shtetërore, rajonale dhe globale.

Arritje që mund të cilësohet e suksesshme në dekadën e fundit, është korniza ligjore e përmirësuar ndjeshëm, bazuar në rekomandimet e Bashkimit Evropian. Kjo ka sjellë progres të ngadaltë, por të qëndrueshëm. E megjithatë, zbatimi i ligjit dhe strategjive kombëtare përbën edhe sfidën më të vështirë për Shqipërinë e tranzicionit të stërzgatur. Kjo reflektohet në fondin modest të buxhetit të shtetit drejtuar mbrojtjes mjedisore. Të dhënat nga INSTAT-i tregojnë se investimet publike në dobi të një mjedisi të qëndrueshëm në vendin tonë, janë disa herë më të ulëta, nëse e krahasojmë me shtetet e BE-së. Edhe në nivel kombëtar, “kërcënimet ushtarake” lënë totalisht në hije kërcënimet mjedisore. Pas hyrjes së Shqipërisë në NATO, buxheti për shpenzime ushtarake vazhdon të jetë i lartë. Në vitin 2019 buxheti për mbrojtjen është rreth 21.7 miliardë lekë të rinj, ndërkohë që për Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, buxheti për vitin 2019 është planifikuar në shifrën e 2.6 miliardë lekë të rinj, ose me pak se 1% e buxhetit total.¹⁹ Dokumenti i strategjisë kombëtare, në momentin e rishikimit, duke parë krizat me faktorë mjedisorë, të shfaqur gjatë viteve të fundit në Shqipëri, besohet dhe duhet të reflektojë një vëmendje më të madhe ndaj sigurisë mjedisore në vendin tonë.

6. Siguria mjedisore, pse duhet të jetë pjesë e sigurisë kombëtare

“Sovraniteti i komunitetit, i rajonit, i vendit, i shtetit ka kuptim vetëm nëse ai buron nga i vetmi sovranitet i vërtetë, domethënë, nga sovraniteti i qenies njerëzore.” - *Vaslav Havel*²⁰.

Siguria mjedisore është një koncept i ri dhe i dobishëm që zgjeron përkufizimin kombëtar të sigurisë duke shtyrë vizionet përtej kufijve dhe mbrojtjes së tyre. Parë në këtë kontekst, siguria mjedisore është e lidhur ngushtë me sigurinë njerëzore e cila filloi

¹⁷ Strategjia e sigurisë kombëtare, f. 15.

¹⁸ Strategjia e sigurisë kombëtare, f. 25.

¹⁹ Referuar: *Buxheti i shtetit viti 2019*.

²⁰ Vaslav Havel, president i Çekisë, 1989 - 1992.

të zhvillohet pas Luftës së Ftohtë, duke përfshirë, krahas marrëdhënieve ndërkombëtare, problemeve të zhvillimit politik e social-ekonomik dhe fusha të tjera si ato të lirive dhe të drejtave të njeriut, të mbrojtjes së mjedisit, edukimit të gjithanshëm dhe më cilësor të popullsisë. Siç është shprehur Oskar Arias: “Siguria njerëzore përfaqëson shkallën e mbrojtjes së qenieve njerëzore nga injoranca, sëmundjet, uria, shpërfillja dhe keqtrajtimi. Standardi i jep dinjitet jetës njerëzore”, kurse në një trajtim më njerëzor, ajo “është një fëmijë që shpëtohet, një sëmundje që kurohet, një tension etnik që zbutet, një disident i cili arrin të flasë lirshëm, një shpirt njerëzor që ka shpresë.”²¹

Siguria njerëzore lidhet me jetën dhe dinjitetin e njeriut, ajo përfshin sigurinë e individit në mjedisin dhe bashkësinë ku jeton, duke nënkuptuar përpjekjet për mosshpërdorimin e tokës dhe të burimeve natyrore, qëndrueshmërinë mjedisore dhe pakësimin e ndotjes, etj. Pra, lidhja në mes sigurisë njerëzore dhe asaj mjedisore është e ngushtë, e pse jo, edhe në funksion të njëra-tjetrës. Njerëzimi ka ndryshuar natyrën dhe jetën e tij. Njerëzimi është bërë urban. Statistikat janë kolosale, shembujt janë të panumërt në rang global, rajonal, lokal dhe individual. Mund të flasim për zhvendosjen në Shqipëri dhe ndryshime të mëdha demografike, dhe ndikimin që kanë mbi mjedis dhe natyrë në të dy drejtimet: si në zonat e zhvendosjes edhe në zonat e zhvendosura. Njerëzimi dhe mjedisi janë të lidhur ngushtë bashkë që nga lindja e njerëzimit, duke bashkëjetuar herë si miq të mirë e shpesh herë me konflikte mjedisore me natyrë njerëzore dhe me shkaqe natyrore. Në këtë linjë shkojnë dhe vargjet e poetit Nikoll Loka, ku ndër të tjera shkruan:

*«Dheun
e shkelim gjithë jetën
pa i kërkuar ndjesë,
gjurmë mbi gjurmë
e dhembje mbi dhembje
kalojmë sipër tij
si hije e si njerëz...
...e kroi i rrugës së madhe
s'është më!»*

Po kush janë disa nga kërcënimet e sigurisë mjedisore që cenojnë sigurinë kombëtare? Infrastruktura dhe kërcënimi ndaj saj përbën një sfidë për shtetin dhe sigurinë e tij. Si pasojë e përmbytjeve të mëdha që kanë ndodhur, shpesh jemi përballur me mungesën e rrugëve të komunikimit dhe si pasojë, mungesën e furnizimit me ushqime për mijëra banorë. Në këtë aspekt vendi ynë në vitet e fundit ka qenë i rrezikuar ndjeshëm nga goditjet natyrore siç janë përmbytjet në zona të ndryshme.

Nga ana tjetër kërcënimi infrastrukturor (dëmtimi i linjave të komunikimit, apo linjave të furnizimit) është i lidhur ngushtë me kërcënimin njerëzor (sigurinë njerëzore). Siguria energjetike e vendit tonë është e lidhur me hidrocentralet të cilat janë burimi kryesor i furnizimit me energji, por në rast të menaxhimit të gabuar ato mund të kthehen në një kërcënim serioz për sigurinë mjedisore e për rrjedhojë edhe për sigurinë kombëtare. Në këtë kontekst SSK vlerëson: “Elementë kritikë të infrastrukturës, të natyrës energjetike, informatike, e telekomunikimit, rrugore apo aeroportuale mbeten të cenueshme. Mbrojtja e inventarit aktual të kësaj infrastrukture dhe përgatitja për

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare»

²¹ Oscar Arias, *Globalizimi dhe sfidat e sigurisë mjedisore*, Universiteti San Diego, 1998.

mbrojtjen e infrastrukturës së re nga aktet e vandalizmit, sabotazhit, terrorizmit dhe të pakujdesisë njerëzore përbën investim të domosdoshëm për sigurinë e vendit.”²²

SSK përcakton qartë se burimet natyrore janë pasuri kombëtare dhe si e tillë ato duhet të mbrohen dhe të përdoren me eficiencë pasi janë të pakta. Keqpërdorimi dhe mungesa e burimeve natyrore përbën një nga elementët kryesorë të sigurisë mjedisore. Megjithëse Shqipëria radhitet si vendi që ka burimet hidrokarbure më të pasura “on-shore”, potencialet e saj nuk janë të shfrytëzuara siç duhet dhe kjo pasuri është kthyer në një bumerang mjedisor duke krijuar një nga pikat e nxehta mjedisore më problematike në vend, duke shtuar këtu keqmenaxhimin e tokës e sidomos asaj bujqësore, shfrytëzimin jashtë funksionit të saj natyror, përdorimin e kimikateve apo helmeve bujqësore pa kriter etj. “Vendi ynë është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve me origjinë natyrore të karakterit gjeologjik, hidrologjik, atmosferik dhe biofizike, si dhe atyre me origjinë njerëzore, teknologjike dhe industriale.”²³, - theksohet në SSK. Klima e ndryshueshme është një dukuri globale, që ndikon negativisht në ekuilibrat natyrorë të RSH. Për këtë shkak vendi mund të përballet me fenomene të skajshme më të shpeshta si temperatura të larta, thatësira të zgjatura dhe përmbytje të mëdha.

“Degradimi i mjedisit në Republikën e Shqipërisë është një dukuri shumë shqetësuese. Ai shfaqet në forma të ndryshme si shtrirja kaotike qendrave urbane, prerja masive e pyjeve, dëmtimi i tokave bujqësore, ndotja e lartë e baseneve hidrike dhe gërryerja e lumenjve. Këto dukuri kanë prodhuar pasoja domethënëse në territor, peizazhin urban, në shëndetësi dhe në ekonominë e vendit”²⁴, ky është konstatimi i dukshëm i SSK, por pa arritur më tej në përfundime. Shqipëria është e prekur dhe rrezikohet nga erozioni. Zonat më problematike janë Ultësira Perëndimore, luginat e lumenjve të mëdhenj dhe bregdeti i Adriatikut, ku vija bazë e detit po tërhiqet. Në brendësi të territorit, erozioni parashikohet të shkaktojë reduktim të tokës së punueshme dhe burimeve ujore. Rastet e shumta të protestave në Fier dhe Ballsh për ndotjen nga nafta dhe gazi apo protestat kundër ndërtimit të HEC-e në Valbonë apo në Kanionet e Osumit etj., janë disa problematika mjedisore që nuk duhet të jenë shqetësim vetëm i medieeve dhe shtypit të shkruar. Minierat shqiptare janë trajtuar si burime që duhen shfrytëzuar pambarimisht duke krijuar kërcënime të reja mjedisore në shumë zona të vendit. Nëse neglizhohet me sjelljen dhe menaxhimin e këtyre problematikave dhe kërcënimeve mjedisore, brezat e sotëm dhe të ardhshëm do të ballafaqohen gjithnjë e më shumë me rastet e rënda të ndryshimeve dhe kërcënimeve mjedisore. Prandaj, siguria mjedisore ndikon në jetën tonë dhe jetën e institucioneve tona në çdo kohë dhe kurdo. Pikërisht për këtë arsye, siguria mjedisore shtrihet jashtë çdo qëllimi të diplomacisë apo marrëdhënieve ndërkombëtare. Ajo duhet të paraqitet si një ndryshim i madh i konceptit tradicional të shtetit-komb.

Duke qenë se të gjithë janë të prekur nga kërcënimet mjedisore dhe përgjigja duhet shtetërore, rajonale dhe natyrisht globale. Kush dëshiron të thithë ajër të pastër? Kush dëshiron të jetojë me të drejtën për ujë të freskët dhe të pastër? Kush dëshiron të ketë furnizim me ushqime të përshtatshme? Kush dëshiron të jetojë aty ku natyra ka siguruar një peizazh të bukur? Kush dëshiron të provojë gëzimin e një klime të përshtatshme? Çdokush! E kjo arrihet falë mjedisit dhe masave që sa nuk është vonë do të duhet të marrim për mbrojtjen e tij. Më 30 nëntor 2016, në Tiranë, bashkëorganizuar nga

²² Strategjia e sigurisë kombëtare, f. 21.

²³ Strategjia e sigurisë kombëtare, f. 21.

²⁴ Strategjia e sigurisë kombëtare, f. 21.

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në Shqipëri, në bashkëpunim me të gjitha organizatat partnere të ENVSEC dhe mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim dhe njësisë operative të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim, u mbajt takimi rajonal “Nisma për sigurinë mjedisore” (ENVSEC). Aktivitetet aktuale ENVSEC në Shqipëri konsistojnë në: menaxhimin dhe zvogëlimin e rreziqeve ndërkufitare nga aktivitetet e rrezikshme; menaxhimin e burimeve të përbashkëta natyrore; forcimin e bashkëpunimit rajonal për qeverisjen e mjedisit përmes marrjes së vendimeve dhe të informimit gjatë proceseve të zbatimit; adaptimin ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike për zvogëlimin e rreziqeve të sigurisë në Evropë, si dhe bashkëpunimin rajonal.

Në këtë kuadër, qeveria shqiptare ka marrë iniciativa të rëndësishme ku si pjesë e programit të Qeverisë 2017-2021, Ministria e Mjedisit e konsideron sigurinë të lidhur ngushtë me çështjet e mjedisit, ku prioritete janë: Parandalimi dhe kufizimi i erozionit, përmirësimi i cilësisë së ajrit, pyllëzimet etj.” Mjedi si është jo vetëm pasuri e shumëllojshme ekosistemesh, por edhe një burim ekonomie që duhet përdorur me kujdes e strategjikisht dhe ne jemi të vetëdijshëm për detyrimin institucional, social dhe moral që të mirëmenaxhojmë dhe mbrojmë këtë pasuri kombëtare në interes të qytetarëve dhe të brezave që vijnë.” Ndryshimet e fundit në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë ku, ndotja e ajrit, e ujërave dhe e tokës; menaxhimi dhe transportimi i mbetjeve; dëmtimi i habitateve në zonat e mbrojtura mjedisore etj., tashmë përbëjnë vepër penale, përforcojnë faktin e kërcënimeve të mjedisit, si dhe shkojnë në favor të sigurisë mjedisore.

Në të njëjtën linjë për kërcënimet mjedisore, vijon analizën dhe autori i njohur Robert Kapllan në veprën e tij “Anarkia që po na troket”. Ka ardhur koha të kuptojmë mjedisin për atë që është në të vërtetë: Çështje e sigurisë kombëtare e fillim shekullit XXI²⁵. Presidenti i SHBA-së, Truman, rreth 70 vjet me parë, duke ju referuar mjedisit është shprehur: “Jemi larg të menduarit se njerëzimi do të përballet një ditë me kufizimin e burimeve natyrore.” Referuar nga sa thamë më sipër dhe në ato që trajton SSK, problemet dhe kërcënimet mjedisore janë trajtuar dhe pranuar në dokumentet bazë strategjike të vendit tonë, por natyrisht jo nën termin e “sigurisë mjedisore”. Natyrshëm lind pyetja: çfarë rruge duhet të ndjekim për ta plotësuar dhe për ta përballuar këtë sfidë dhe këtë boshllëk? Si fillim është njohja, pranimi dhe trajtimi i “sigurisë mjedisore” si një kategori e veçantë prej asaj që njihet deri tani dhe si një nga prioritetet e sigurisë kombëtare.

7. Përfundime

- Çështja e sigurisë mjedisore është një problem rajonal, shtetëror e global dhe pranimi, trajtimi si dhe implementimi në strategjinë e sigurisë kombëtare është domosdoshmëri.
- Me ndryshimin e konceptit të shtetit, ku *siguria njerëzore* është parësore dhe *siguria mjedisore* në funksion të saj duhet të jetë pjesë e *sigurisë kombëtare* (krahas *sigurisë ushqimore* apo asaj *shëndetësore*).
- “Nisma për sigurinë mjedisore në Shqipëri”, mbajtur më 30 nëntor 2016 në Tiranë dhe programet e qeverise për mjedisin, ndryshimet e fundit në Kodin Penal, janë shkëndija shprese që siguria mjedisore do të jetë pjesë e sigurisë kombëtare.

²⁵ Kapllan Robert, *Anarkia që po na troket*, f. 17.

Bibliografi

1. Barnett, *Kuptimi i sigurisë mjedisore* (The Meaning of Environmental Security)
2. Brunland, H. (1987). "Raporti i Komisionit Botëror për mjedisin dhe zhvillimin" ENVSEC. *Siguria Mjedisore*. <http://www.envsec.org>
3. Kaplan, R., *Anarkia që po na troket*, Biblioteka e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Historia, Tiranë: 2008.
4. *Konventa mbi Mbrojtjen e Mjedisit*, Strasburg më 4 nëntor 1998.
5. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*. Ligji nr. 8417 dt 21/10/1998.
6. Ligji 10431 datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit."
7. *Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit të BE-së*.
8. Mejdani, R. *Konferenca ndërkombëtare mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare*. 21 shtator 2007.
9. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. *Informacione nga dokumentet, buletinet mjedisore*. [<http://www.moe.gov.al>].
10. *Raport i gjendjes në mjedis*. 2016-2017. Agjencia Kombëtare e Mjedisit.
11. *Raport i PNUD*, viti 1994
12. *Revista Mjedisit sot*.
13. *Strategjia e sigurisë kombëtare e Republikës së Shqipërisë* 2004.
14. *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim*. 2015-2020
15. *Strategjia ndërsektorale e mjedisit* 2015-2020.
16. *Vlerësimi dhe përmirësimi i zbatimit të politikave mjedisore në shqipëri*.
17. *Mjedisit dhe shoqëria*, (<https://www.scribd.com>)
18. <https://shendeti.com.al/>

Mjedisi si armë gjeopolitike



■ **Dr. Albert HITOALIAJ**
Akademia e Sigurisë,
Qendra Kërkimore Shkencore
albert.hitoaliaj@asp.gov.al

Abstrakt

Fokusi botëror te ndryshimet klimaterike, dhe nevoja që ndihet për të pasur politika botërore për uljen e nivelit të ndotjes dhe për ruajtjen e ekuilibrit mjedisor në planet, duket se i ka hapur rrugën “gjeoinxhinierisë”, ose ndryshimit të klimës nga njeriu. Epoka që jetojmë tashmë po konsiderohet shkencërisht si “epoka e antropocenit”, epoka e njeriut, dhe ka si tipar ndikimin njerëzor mbi natyrën. Kjo mund të jetë edhe era e një gjeopolitike të padëgjuar ndonjëherë: gjeopolitika e epokës antropocene dhe gjeoinxhinierisë. Krahas ndërhyrjes së shkencës te natyra apo modifikimit të kushteve që shkenca bën në mjedis për përmirësimin e këtij të fundit, ekziston një pasiguri dhe frikë lidhur me efektet që ka ndërhyrja e njeriut te natyra. Nuk mungojnë referencat, që tregojnë se shtetet e fuqishme, e shohin natyrën dhe manipulimin e saj si armë apo si mundësi të përdorimit të shkencës për interesa shtetërore. Gjeoinxhinieria mund të jetë e domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm global, por kemi të bëjmë me një erë të re të gjeopolitikës, ku etja e pandryshuar për fuqi dhe ndikim, do të sjellin një garë mes fuqive kryesore, të cilat do të mësyjnë drejt manipulimit të mjedisit për qëllime shtetërore. Ky punim përpiqet të trajtojë disa argumente të cilët synojnë të tregojnë se modifikimi i mjedisit mund të përdoret si armë, për interesa gjeopolitike.

Fjalëkyçe:

mjedis, epokë antropocene, modifikim i mjedisit, gjeopolitikë, gjeoinxhinieri.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Në shumë vende të botës, goditjet nga fatkeqësitë natyrore kanë shkaktuar pasoja të rënda sociale, ekonomike, njerëzore, infrastrukturore etj., e deri edhe psikologjike. Epoka që jetojmë, për shumë arsye po shfaq gjithnjë e më tepër lidhjen e njeriut me natyrën. Pavarësisht se gjeopolitika i ka fillësat e saja si disiplinë studimore pikërisht te raporti dhe ndikimi i natyrës te njeriu dhe ai i gjeografisë te zhvillimi i shtetit, sot, ngjan se kemi çelur një epokë të re. Njeriu, po ndikon te natyra, te mjedisi, si në shkallë të vogël, ashtu edhe në shkallë mbarëbotërore. Epoka që jetojmë ka siguruar dije shkencore, të cilat mund të prodhojnë ndërhyje te mjedisi, ashtu siç ka prodhuar edhe kërcënimin më të madh që i vjen planetit tonë: kërcënim që vjen nga aktiviteti shkatërrues njerëzor.

Gjeoinxhinieria është ajo inxhinieri mjedisore e cila ka të bëjë kryesisht me ndërhyrjen në sistemin klimaterik të Tokës, me qëllim ndryshimin e efekteve të ngrohjes globale. Por, aktiviteti njerëzor në tërësi, përmes shekujve, dhe shkenca akoma më shumë në dy shekujt e fundit, kanë krijuar atë term të njohur në botën shkencore, që sot është popullarizuar shumë me emrin “Antropocene”: epoka e njeriut. Kemi të bëjmë me një epokë gjeologjike e cila ka si tipar dallues “njeriun” dhe aktivitetin e tij mbi mjedisin. Njeriu po ndikon te klima, biogjeografia dhe mbijetesa e specieve që jetojnë në planetin Tokë.

Kërcënimi që vjen nga degradimi mjedisor mendohet se mund të riparohet përmes ndërhyrjes shkencore në sistemin planetar mjedisor. Krahas kësaj, mundësia e ndërhyrjes te mjedisi u hap shteteve të ndryshme perspektivën e zhvillimit. Gjeoinxhinieria dhe ndërhyrja te mjedisi ka mbështetësit dhe kundërshtuesit e saj. Ka studiues që mendojnë se kjo ndërhyrje do e shpjerë njerëzimin përpara, në një kohë të re ndryshimesh dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

drejt një zhvillimi të qëndrueshëm botëror. Nga ana tjetër, qëndron frika se mos këto ndërhyrje do të hapnin erën e katastrofave të tmerrshme e të pariparueshme për njerëzimin dhe jetën në tokë.

Ndërkaq, duhet përmendur fakti se shtetet e kanë përdorur manipulimin e kushteve atmosferike dhe të mjedisit në rajone të caktuara edhe për qëllime lufte. Projektet sekrete ushtarake apo edhe të inteligjencës, qysh pas LIIB kanë pasur në fokus klimën globale dhe mjedisin e tokës në tërësi, duke angazhuar shkencëtarë në projekte që synojnë kontrollin dhe ndikimin te klima dhe mjedisi. Ditët e sotme kjo gjë është akoma më e zhvilluar, për shkak të përparimit të teknologjisë.

Për të ilustruar këtë interes të theksuar që kanë shtetet e fuqishme ndaj klimës, mjafton të përmendim se CIA (Agjencia Qendrore e Inteligjencës, SHBA) në vitin 2009 hapi Qendrën për Ndryshimet Klimaterike dhe Sigurinë Kombëtare (“The Center on Climate Change and National Security”). Megjithatë, në dokumentin publikuar nga Agjencia, është theksuar qartë se misioni i saj “nuk është shkencë e ndryshimit të klimës”, por ka të bëjë me “. . . ndikimin te siguria kombëtare e fenomeneve të tilla si krijimi i shkretëtirave, ngritja e nivelit të detit, zhvendosjet e popullsisë dhe konkurrenca në rritje për burimet natyrore. Qendra do t’u sigurojë mbështetje politikëbërësve amerikanë teksa negociojnë, zbatojnë dhe verifikojnë marrëveshjet ndërkombëtare për çështjet mjedisore. Kjo është diçka që CIA e ka bërë me vite. “Vendimmarrësit kanë nevojë për informacion dhe analiza mbi efektet që ndryshimi i klimës mund të ketë mbi sigurinë. CIA është e pozicionuar mirë për të ofruar atë lloj inteligjence”, - tha drejtori Leon Panetta. Kjo qendër do jetë shumë energjike në shtrirjen drejt botës akademike dhe qendrave studimore që lidhen me këtë çështje. Qëllimi është shndërrimi në një pasuri të vlefshme, të njohur nga qeveria amerikane e më gjerë, për dijen dhe për mprehtësinë”.¹

Përtej kësaj qasje kaq premtuese ndaj botës akademike, qëndronte në të vërtetë një tisi i thujtë i padepërtueshëm për të dhënat e përpunuara nga kjo qendër apo projekte të ngjashme. Federata e Shkencëtarëve Amerikanë (Federation of American Scientists (FAS))² ka tentuar të marrë informacione lidhur me “raporte apo analiza të kësaj qendre mbi ngrohjen globale, por i është refuzuar kjo gjë për shkak se qendra përpunon material të klasifikuar”³.

Qendra qëndroi e hapur deri në vitin 2012 dhe u mbyll pas debateve të forta me republikanët dhe, sepse drejtorët e CIA-s që erdhën pas Panetas, nuk e mbajtën në fokus. Megjithatë, Joe Romm, një ekspert amerikan i klimës dhe kërkues me eksperiencë i *Center for American Progress*, teksa zhvilloheshin asokohe në Katar bisedimet vjetoret të OKB-së mbi krizën klimatike botërore, do të shprehej se sektori i Mbrojtjes dhe ai i Inteligjencës vitet e fundit i kishin kushtuar vëmendje të madhe klimës. Kjo gjë kishte ndodhur pasi klima dhe ngrohja globale ishin të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë kombëtare dhe atë botërore⁴. Kjo gjë dallohej qartë, pasi informacionet e CIA-s që

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

¹ CIA, “CIA Opens Center on Climate Change and National Security”, *Historical Document* (CIA, 25 shtator 2009, rifreskuar, 29 prill 2013).

Burimi elektronik: <https://www.cia.gov/news-information/press-releases-statements/center-on-climate-change-and-national-security.html>

² FAS u themelua fillimisht në nëntor 1945, si Federata e Shkencëtarëve Atomikë (Federation of Atomic Scientists), nga shkencëtarët që ndëruan bombat e para atomike gjatë Projektit Manhattan. Anëtarët e bordit të sponsorëve, përfshijnë mbi 60 laureatë të çmimit Nobel dhe janë figura me ndikim pjesë komunitetesh shkencore ndërkombëtare të cilat mbështesin misionin e FAS-it.

³ Steven Aftergood, “At CIA, Climate Change is a Secret”, (FAS, 2011).

Burimi elektronik: https://fas.org/blogs/secretcy/2011/09/cia_climate/

⁴ PRI, “CIA closes down intelligence center focused on climate change”, *Public Radio International*, December 06, 2012. <https://www.pri.org/stories/2012-12-06/cia-closes-down-intelligence-center-focused-climate-change>

siguroheshin përmes satelitëve dhe sensorëve sekretë të inteligjencës ishin shumë të vlefshme për botën akademike.

“Shkencëtarët dhe agjentët/spiunët më të mirë të vendit janë duke bashkëpunuar, duke u përpjekur që të përdorin pajisjet e inteligjencës së qeverisë federale, përfshirë këtu edhe satelitët spiunues dhe sensorë të tjerë të klasifikuar, me qëllim që të vlerësojnë tërësinë e ndërlikuar të ndryshimeve klimatike. Ata kërkojnë njohuri nga fenomenet natyrore si retë, akujt, shkretëtirat dhe pyjet tropikale”⁵. Por, edhe ky informacion i pasur që sigurohej përmes “Programit MEDEA” të CIA-s, u ndalua që të shpërndahej për botën akademike për shkak të natyrës së klasifikuar që kishte. Qendra për Ndryshimet Klimaterike dhe Sigurinë Kombëtare nuk ishte e vetmja në SHBA pasi ka projekte të tjera të cilat kanë pasur ecuri në këtë drejtim.

Natyrisht që ka edhe shtete të tjera të zhvilluara që kanë këtë interes të theksuar të klima, si p.sh. Rusia apo Kina e që kanë vepruar për arritjen e modifikimit dhe kontrollit të mjedisit. Klima dhe mjedisi ndikojnë te siguria kombëtare, pasi mund të cenojnë fuqinë kombëtare të shteteve. Thënë kjo, kuptohet më qartë interesi i lartë që shfaqin shtetet për çështjet mjedisore dhe për mundësinë e ndikimit të klimës dhe kontrollit të natyrës. Këto çështje kanë ngjallur ndërkohë edhe debate të pafundmë të cilët shpeshherë prodhojnë edhe dezinformim apo keqinformim. Ekzistojnë faqe të shumta interneti, ku diskutohet për armë mjedisore në zotërim të shteteve të fuqishme, të cilat kanë potencial shumë të madh dhe mund të vinin në rrezik njerëzimin. Krahas informacioneve të pasakta, ekzistojnë të dhëna që tregojnë se modifikimi dhe kontrolli i mjedisit nga shtetet është diçka që duhet trajtuar seriozisht dhe nuk është “teori konspirative”. E përditshmja britanike “The Guardian”, pak vite më parë, do të nxirrte si titull të madh shqetësimin e klimatologut amerikan prof. Alan Robock, i cili ngrinte shqetësimin se agjencitë e inteligjencës po lakmonin krijimin e armëve klimaterike për kontrollin e mjedisit. “Shkencëtarët besojnë se shërbimet e inteligjencës, po marrin në konsideratë që t’i përdorin sistemet që ndryshojnë klimën, si armë”.

Robock, tha se ai u bë dyshues në lidhje me përfshirjen e agjencive të inteligjencës te shkencat për ndryshimin e klimës, pasi mori një telefonatë nga dy burra që deklaruan se ishin këshilltarë të CIA-s: “Ata më thanë: Ne punojmë për CIA-n dhe do të donim të dinim, nëse do të ishim në gjendje të zbulonim po qe se ndonjë vend tjetër kontrollon klimën tonë. Mendoj se kishin gjithashtu në mend edhe pyetjen: Nëse ne do të donim të kontrollonim klimën e dikujt tjetër, a mund ta zbulojnë ata këtë gjë?”⁶. Në fakt, kontrolli i klimës ka qenë një dëshirë e hershme e njerëzimit.

1.1. Metodologjia

Në këtë punim është zbatuar një metodologji cilësore. Përmes analizës dhe zhvillimit të argumenteve e literaturës ekzistuese, duke përdorur kryesisht metodën deduktive, bëhet një përpjekje që të shpjegohen shkaqet e mundshme të zhvillimit të një gjeopolitike të re globale. Kjo gjeopolitike mund të ndikohet nga epoka e antropocenit dhe nga gjeoinxhineria. Hipoteza që punimi synon të shpjegojë është se: “Modifikimi i mjedisit

⁵ William J. Broad, “C.I.A. Is Sharing Data With Climate Scientists”, *The New York Times*, Jan. 4, 2010.

<https://www.nytimes.com/2010/01/05/science/earth/05satellite.html>

⁶ Ian Sample, “Spy agencies fund climate research in hunt for weather weapon, scientist fears”, *The Guardian*, (15 Feb. 2005).

Burimi elektronik: <https://www.theguardian.com/environment/2015/feb/15/spy-agencies-fund-climate-research-weather-weapon-claim>

mund të përdoret si armë dhe për interesa gjeopolitike”. Vëzhgimet mbështeten nga një literaturë dytësore e pasur dhe shtjellohen në rrafshin e analizës krahasuese. Duhet pasur parasysh se këto zhvillime shkencore dhe gjeopolitike, janë ende në gjenezë dhe nuk mund të krijohet një teori e mirëfilltë shkencore. Pyetja kryesore që ngrihet në punim është: “A mund të përdoret mjedisi dhe natyra si armë ose në mënyrë gjeopolitike?”. Për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje, tentohet të bëhet lidhja shkak-pasojë mes zhvillimit të shkencës që mund të modifikojë klimën dhe mjedisin, me interesat që kanë shtetet, për ta përdorur shkencën në favor të tyre dhe kundër njëri-tjetrit. Në shërbim të pyetjes kryesore janë shtjelluar disa argumente, bazuar në pyetje të ndihmëse, si: A mund të modifikohet mjedisi? A ka rrezik nga modifikimi mjedisor? A është gjeoinxhinieria e domosdoshme për një zhvillim të qëndrueshëm global? A kemi të bëjmë me një erë të re të gjeopolitikës? Literatura e hulumtuar dhe analiza interpretuese do të shfaqin marrëdhënien që ekziston ndërmjet interesave gjeopolitike dhe modifikimit të mjedisit.

2. Përpjekja për të ndikuar klimën, në lashtësi dhe te shoqëritë e pazhvilluara

Klima dhe mjedisi natyror ka luajtur një rol kryesor në zhvillimin e jetës së njeriut. Qysh në kohët parahistorike e deri në kohën tonë, varësia jonë ndaj kushteve klimatike dhe mjedisit natyror është e dukshme dhe e theksuar. Që nga gjetja e territoreve të duhura për kultivim, strehim, gueti, peshkim në lashtësi e deri sot, ku rrugëkalimet e ngushticat janë shndërruar në pasuri strategjike për shtetet, shoqëria njerëzore e sheh jetën e saj të pandashme nga cilësia e biogeografisë dhe e mjedisit global në tërësi. Nëse shohim lashtësinë, një nga dëshirat kryesore të njeriut të hershëm, ka qenë ndikimi i klimës, me qëllim që ajo t’i shërbente për rritjen e mirëqenies apo për qëllime të tjera. Ashtu si të gjitha vendet e botës, as Shqipëria nuk bën përjashtim nga kjo dukuri.

“Hamondi në librin e tij *Epiri* (1967) thotë se himarjotët ngjiteshin në malet e Akrokerauneve për t’i bërë fli Zeusit kaon. Ky vend ku banorët e të dy krahëve të maleve të Vetëtimës nderonin zotin, nuk mund të ketë qenë tjetër veçse Bogonica, pasi maja e Çikës është e thiktë dhe e paarritshme. Në Bogonicë janë edhe dy objekte me vlerë kulturore: Guri i Hijes dhe Lëmi i Lejlerëve [gjithashtu edhe Sofra e Zotit apo Guri me Qjell]. Lëmi i Lejlerëve, është i rumbullakët, shtruar me pllaka guri, me sipërfaqe 40-50 m². Sipas gojëdhënave, emrin e mori ngaqë në këtë vend kërcenin shenjtorët dhe *besohej se, në kohë thatësirash, po të bëje kurban, zoti jepte shi*. Banorët ngjiteshin këtu në fillim të muajit qershor, kur bagëtia dilnin në male. Ata thernin si kurban desh të zinj, këndonin dhe hidhnin valle, bisedonin me njëri-tjetrin dhe i uronin njëri-tjetrit mbarësi. Uronin që gjatë verës të kishte lagështirë, që të rriteshin prodhimet bujqësore dhe bari për bagëtitë, që mali të kishte ujë për të pirë tufat e bagëtive, që viti të kishte qumësht dhe bletët të bënin mjaltë”.⁷

Në Kinë, dragonj të mëdhenj letre ishin pjesë e festivaleve religjioze që sillnin shiun. Nëse do të kishte thatësira, dragoi ishte i mllefosur dhe kafshonte bishtin e tij⁸. Indianët e Amerikës së Veriut kryenin kërcimet e tyre rituale, për të sjellë shiun dhe këtë e bënin

⁷ Enver Strati, *Historiku i Kallarait*, red. Rami Memushaj (Tiranë: 2010).

⁸ Daniel Stephen Halacy, *The Weather Changers* (Harper & Row, 1968), 62.

me seriozitetin më të madh pasi kishte diçka religjioze në të. Kërcimtarët “Zuni” të indianëve të fisit Pueblo ishin klan më vete dhe vetëm ata mund ta kryenin ritualin e shenjtë. Një ritual i tillë, që sillte shiun, ndodhte në gusht dhe në shtator. Sipas dëshmimeve të fisit, ata kishin arritur të sillnin gjithmonë shiun⁹. Aq e rëndësishme ishte lidhja e ritualeve të indianëve të Amerikës së Veriut me shiun, sa që sakrifikonin edhe njerëz për të sjellë shirat¹⁰.

Një nga aftësitë më të veçanta të shtrigave mesjetare evropiane, ka qenë kontrolli i klimës. Shembujt e legendave, rrëfenjave, librave që i përmendin janë të shumtë, kryq e tërthor kontinentit. Sipas folklorit, shtrigat kishin aftësi të shkaktonin stuhi, erëra, shira, vetëtimat, tufane detare etj. Ato përdornin formulat magjike dhe instrumente magjike e përzjerje të bëra me mënyra misterioze. Për shembull, në vitet 700, kisha i dënonte me vdekje magjistarët, për shkak se ata shkaktonin stuhitë¹¹.

Në Guinenë e Re, popullsia vendase besonte te “gurët e erës” të cilët po t’i godisje fort me një shkop mund të shkaktohej erë dhe stuhi. Në Grinlandë, mendohej se një grua shtatzënë apo lehonë, po të dilte jashtë në stuhi, të mbushte gojën me ajër e ta shfrynte atë brenda në shtëpi, stuhia do të ndalej. Madje edhe në kohërat e krishtera (d.m.th. jo me besime pagane) nën mbretërimin e Konstantinit, njëfarë Sopateri, u dënua me vdekje në Kostandinopojë pasi u akuzua se kishte lidhur erërat përmes magjisë¹².

Nëse shikojmë të gjitha kulturat e lashta, që nga shoqëritë më të pazhvilluar e deri te ato të që ndëruan qytetërimet antike, do të gjejmë shembuj të shumtë të ritualeve që synonin sjelljen e reshjeve për të mbjellat apo qoftë edhe të erërave detare për të kryer udhëtime. Aty ku pati qytetërim më të zhvilluar si p.sh. Egjipti, Roma, Athina, Iliria etj., edhe perëndive u visheshin fuqi që kishin lidhje me klimën, mjedisin, tokën, diellin e hënën. Ndërkohë, shumë shoqëri fisnore e të pazhvilluara i ruajtën gjatë e vazhdojnë t’i ruajnë edhe sot, të izoluara, ritet, besimet e praktikatat e tyre që synojnë të ndryshojnë klimën në favor të jetesës që ata kryejnë. Në thelb, kemi të bëjmë me një “gjeoinxhinieri” primitive. Njeriu përpiqet të ndërhyjë te klima që ajo të bëhet ndihmëse e qëllimeve të tij, që t’i mundësojë jetesën e mbijetesën.

Nëse deri dje njeriu i lutej perëndisë apo perëndive, për shiun ose erën, sot ai nuk ka se përse ta bëjë më një gjë të tillë. Sot, njeriu mund ta shkaktojë vetë shiun, përmes teknologjisë. Madje ka shkuar shumë më përtej se sa pritshmëria e shoqërive të dikurshme primitive. Nëse do të përdornim një term jo të miratuar shkencërisht, një imazh të së nesërme për njeriun e ardhshëm, mund ta quanim “Homo deus”, sipas asaj që përshkruan historiani dhe filozofi Yuval Noah Harari, autori i librave shumë të shitur *Sapiens* dhe *Homo Deus*: “Kjo është faza tjetër e evolucionit. Është *Homo Deus*. . . ne nuk mund ta frenojmë rrjedhën e historisë, por mund të ndikojmë drejtimin e saj”¹³. Një nga ndikimet më të fuqishme që njeriu po bën në këtë ndryshim të rrjedhës së historisë së njerëzimit, dhe të jetës në tërësi në planetin Tokë, ka lidhje me klimën dhe ndikimin njerëzor te ajo. Për këtë arsye, epoka që jetojmë quhet në mjedisin shkencor si “Epoka e antropocenit”.

⁹ Reginald Laubin dhe Gladys Laubin, *Indian Dances of North America: Their Importance to Indian Life* (Oklahoma: University of Oklahoma Press, 1989) 419.

¹⁰ Halacy, *Weather Changers*, 61.

¹¹ Rosemary Ellen Guiley, *The Encyclopedia of Witches, Witchcraft & Wicca, Volume 1* (Infobase Publishing, 2008), 335.

¹² James George Frazer, *The Golden Bough: A Study in Magic and Religion*, reprint (Cosimo, Inc., 2009), 80-81.

¹³ Yuval Noah Harari, *Homo Deus: A Brief History of Tomorrow* (Harper, 2017).

3. Epoka e antropocentit dhe gjeoinxhinieria

3.1 Antropoceni, ndikimi i njeriut mbi klimën dhe mjedisin e planetit

Epoka e antropocentit është një njësi matjeje jozyrtare e kohës gjeologjike, e përdorur për të përshkruar periudhën më të fundit në historinë e Tokës, kur veprimtaria njerëzore filloi të ketë një ndikim të rëndësishëm në klimën e planetit dhe te ekosistemet¹⁴. Megjithatë, ky term përdoret në botën shkencore edhe pse nuk është njohur në mënyrë zyrtare. Termi “antropocen”, i përdorur për të përshkruar ndryshimet *antropogjene* (shënim A.H.: ndotje mjedisi/ndikim me bazë aktivitetin e njeriut) globale dhe pasojat e tyre sociopolitike dhe filozofike ka fituar popullaritet gjatë viteve të fundit. Megjithëse lindi si një term shkencor për të përcaktuar epokën gjeologjike në të cilën jetojmë, e cila karakterizohet nga ndikimi global i veprimtarive njerëzore mbi planetin Tokë, “antropoceni” ka përvetësuar një larmi kuptimesh në shumë fusha të tjera si filozofi, sociologji, komunikim, politikë apo jurisprudencë. Në filozofi, “antropoceni” është shndërruar në një shprehje të modernitetit, si një sulm ndaj Tokës dhe biosferës, ose si një imperativ biologjik që është i natyrshëm për ekzistencën njerëzore. Në një kontekst politik, ai mendohet si pasojë logjike e kapitalizmit global ose si hendeku ndërmjet mirëqenies së mjedisit dhe mirëqenies njerëzore¹⁵.

Më shumë se një dekadë më parë, shkencëtari Paul Crutzen, i cili fitoi “Çmimin Nobel” në kimi në viti 1995, për kërkimet e tij mbi shkatërrimin e ozonit stratosferik, popullarizoi termin “antropoceni” për gjendjen e tanishme gjeologjike të Tokës. Një nga zgjerimet më radikale të idesë së tij, se veprimtaria njerëzore tanimë dominon pyjet e planetit, oqeanet, rrjetet e ujërave të ëmbla dhe ekosistemet, është koncepti i diskutueshëm i gjeoinxhinierisë, i ndërthurur qëllimisht me klimën, për të kundërvepruar ndaj ngrohjes globale. Logjika është e thjeshtë: nëse njerëzit kontrollojnë fatin e sistemeve natyrore, a nuk duhet ta përdorim teknologjinë tonë për t’i ndihmuar ata që të shpëtojnë nga rreziqet e ndryshimit të klimës, duke pasur parasysh këtu, se ka pak shpresë për uljen e emetimeve, në masën që do të duhej për të ndaluar prirjen e ngrohjes globale?¹⁶

Këtu fillon diskutimi në lidhje me të mirat e rreziqet të mund të ketë njerëzimi nëse përdor teknologjinë, për të modifikuar klimën dhe mjedisin. Para se të japim disa argumente lidhur më këtë gjë, vlen të shohim në mënyrë të përmbledhur, se “antropoceni” nuk lindi nga ideja e përdorimit të gjeoinxhinierisë, por fillesat e veta i ka më të hershme.

Emri “holocene”, që ka kuptim “e gjithë e tashmja”, për periudhën pasakullnajore të dhjetë ose dymbëdhjetëmijë viteve të fundit, u propozua për herë të parë nga Sir Charles Lyell në vitin 1833 dhe u pranua si propozim në “Kongresin ndërkombëtar të gjeologjisë në Bolonja” në vitin 1885¹⁷.

George Perkins Marsh, në vitin 1864 shkroi veprën *Njeriu dhe natyra (Man and Nature)* e cila më pas u ribotua si *Njeriu dhe natyra: ose gjeografia fizike, e shndërruar*

¹⁴ National Geographic, “Anthropocene”, *Resource Library, Encyclopedic Entry*.

Burimi elektronik:

<https://www.nationalgeographic.org/encyclopedia/anthropocene/>

¹⁵ Valentí Rull, “The ‘Anthropocene’: neglects, misconceptions, and possible futures”, *EMBO Reports*, 18/7, (Jul. 2017): 1056–1060.

doi: 10.15252/embr.201744231

¹⁶ Eli Kintisch, “The Geopolitics of Geoengineering”, *MIT Technology Review* (Dec 17, 2013)

<https://www.technologyreview.com/s/522676/the-geopolitics-of-geoengineering/>

¹⁷ Paul Dukes, *Minutes to Midnight: History and the Anthropocene Era from 1763* (Anthem Press, 2011), 2.

nga veprimi njerëzor (*Man and Nature: Or, Physical Geography as Modified by Human Action*). Marsh pa rëndësinë që kishte veprimi njerëzor në transformimin historik të tokës dhe përgjegjësitë që dëlnin nga ai transformim¹⁸.

Antonio Stoppani (1873) shpiku termin “Era antropozoike”, duke theksuar se ardhja e njerëzve kishte sjellë në Tokë një “forcë të re telurike (tokësore), e cila për nga fuqia dhe përbotshmëria mund të krahasohej me forcat më të mëdha të tokës”, një fenomen i përshkruar gjithashtu edhe si “psikozoik” nga Joseph la Conte (1879); ndërsa Marsh (1864), dha në mënyrë të detajuar shkallën e madhe të fuqisë ndryshuese njerëzore (antropogjenike) anembanë botës. Shkencëtarë të tjerë që kontribuuan në këtë drejtim ishin edhe Edouard Le Roy (1927), që u influencua nga Vladimir Vernadsky dhe Teilhard de Chardin, duke zhvilluar konceptin e “noosphere”-ës, koncept që u zhvillua më pas edhe nga vetë Vernadsky¹⁹.

“Duke marrë në konsideratë gjithë ndikimin e veprimtarisë njerëzore mbi tokë e atmosferë dhe në tërësi, përfshirë hapësirën globale, na duket shumë më e përshtatshme që ta theksojmë rolin qendror të njeriut në gjeologji dhe në ekologji, duke propozuar për përdorim, për epokën gjeologjike që po jetojmë, termin *antropocene*. Ndikimi i aktivitetit të tanishëm njerëzor do të vazhdojë për periudha të gjata. Sipas një studimi nga Berger dhe Loutre, për shkak të emetimeve njerëzore (“antropogjenike”) të CO₂, klima mund të shmanget dukshëm prej zhvillimit të saj natyral, përgjatë 50 000 viteve të ardhshme”²⁰.

Propozimi i Crutzen dhe Stoermer për përdorimin e emrit “antropocene” për epokën gjeologjike të tanishme, shoqërohet edhe me një ide lidhur me kohën në të cilën kjo epokë mendohet të ketë filluar. Ata propozojnë që fillimi të jetë nga fundi i shekullit të 18-të, pavarësisht se ka dhe ide të tjera e madje, disa duan të përfshijnë tërë periudhën e holocenit. “E kemi zgjedhur këtë datë pasi përgjatë dy shekujve të fundit, ndikimet botërore të aktivitetit njerëzor janë bërë qartësisht të dukshme. Kjo është periudha kur të dhënat e grumbulluara nga shtresa e akullnajave, tregojnë fillimin e një rritjeje të përqendrimit atmosferik, të gazrave serë, në veçanti të CO₂ dhe të CO₄. Një fillim i tillë, përkon po ashtu, me shpikjen e motorit me avull nga James Watts, në vitin 1784”²¹. Tashmë është e qartë se njeriu do të jetë për mijëra vjet një forcë e madhe transformuese e planetit. Zhvillimi i një strategjie botërore për zhvillimin e qëndrueshëm të ekosistemeve shfaqet si një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit, në të ardhmen. “Një detyrë emocionuese, por gjithashtu e vështirë dhe marramendëse, qëndron ballas me komunitetin [gjeo]inxhinierik, për udhëheqjen e njerëzimit drejt një menaxhimi botëror, të qëndrueshëm, mjedisor”²². Gjeoinxhinieria përbën sfidën kryesore për ekuilibrin e jetës në tokë, po që se do të zbatohet në mënyrë tërësore e të vazhdueshme mbi planet.

3.2 Gjeoinxhinieria, modifikimi teknologjik i klimës dhe mjedisit të planetit, nga njeriu

Përballë problemit të ngrohjes globale dhe mosarritjes së pakësimit të gazrave serrë,

¹⁸ Jason M. Kelly, et. al. (red.), *Rivers of the Anthropocene* (California: University of California Press, 2018), 114.

¹⁹ Jan Zalasiewicz, Paul Jozef Crutzen dhe Will Steffen, “The Anthropocene”, në *The Geologic Time Scale 2012*, red. F. M. Gradstein et. al (Elsevier, 2012), 1033.

²⁰ Paul J. Crutzen dhe Eugene F. Stoermer, “The ‘Anthropocene’”, në *News Letter, The International Geosphere-Biosphere Programme (IGBP): A Study of Global Change of the International Council for Science (ICSU)*, nr. 41 (2000): 17.

²¹ Ibid.

²² Crutzen dhe Stoermer, “The Anthropocene”, 18.

është propozuar si mundësi zgjidhjeje ndërhyrja rregulluese njerëzore te sistemi klimatik dhe mjedisi. Kjo ndërhyrje njerëzore shkencore, si kundërvënie ndaj ngrohjes globale, njihet përgjithësisht me emrin gjeoinxhinieri. Sipas Akademisë Mbretërore, e cila është akademia e shkencave më e vjetër në botë²³, gjeoinxhinieria përkufizohet kështu: “Gjeoinxhinieria, ose manipulimi i qëllimshëm në shkallë të gjerë i mjedisit planetar, për të neutralizuar ndryshimet klimatike të prodhuara nga ndotja mjedisore e aktivitetit njerëzor”²⁴.

Kjo mënyrë, edhe pse është në fazë eksperimentale, është sugjeruar si mënyra e nevojshme për të rregulluar problemet klimatike botërore. Ka një informim të bollshëm botëror në lidhje me përpjekjet që janë bërë për të ulur sasinë e prodhimit të gazrave që ndikojnë te ngrohja globale, të cilat vazhdojnë të rezultojnë të pasuksesshme. Duke qenë se shfrytëzimi i pakursyer i burimeve, energjia, industria dhe ndotja e mjedisit, lidhen drejtpërdrejt me fuqinë kombëtare të shteteve, atëherë edhe mundësia që të ketë një mirëkuptim botëror lidhur me çështjet mjedisore zvogëlohet në kulm. Shtetet e fuqishme në arenën globale, duhet të ndjekin një politikë e cila të ketë në qendër sigurinë mjedisore dhe çështjet klimatike të planetit, por kjo nuk mund të ndodhë përderisa këto shtete, do të detyroheshin të sakrifikonin mirëqenien e tyre, ndikimin politik dhe pozicionin në hierarkinë e sistemit ndërkombëtar. Megjithatë, kërcënimi që vjen nga degradimi mjedisore e kapërcen ambicien për fuqi dhe është një kërcënim i vërtetët për çdo popull në botë, qoftë i zhvilluar apo i varfër. Në këto kushte, gjeoinxhinieria përmendet si “plan b” me qëllim që të arrijë e të korrigjojë problemin, duke mos u marrë me vatrën e problemit, por me efektet që sjell ai problem. Por, as ky plan nuk është aq i thjeshtë, madje, ka ngjallur debate të vazhdueshme që nga nivelet më të thjeshta publike e deri te bota shkencore e akademike. Qëndrimet jenë “pro”, “kundër” dhe “pro, por me kushte”.

Sipas “Oxford Martin School”, shkollë e cila drejton programe të ndryshme shkencore lidhur me gjeoinxhinierinë, duke deklaruar një qëndrim neutral lidhur zbatimin e gjeoinxhinierisë, këto janë teknikat kryesore të kësaj të fundit:

“Gjeoinxhinieria është ndërhyrja e qëllimshme, në shkallë të gjerë, te sistemet natyrore të tokës për të kundërvepruar ndaj ndryshimit të klimës. Ekziston një varg i gjatë teknikash të propozuara për gjeoinxhinierinë. Në përgjithësi, ato mund të grupohen në dy kategori:

menaxhimi i rrezatimit diellor (“Solar Radiation Management”, SRM) ose gjeoinxhinieria diellore dhe, *largimi i gazrave serrë* (Greenhouse Gas Removal, GGR) ose gjeoinxhinieria e karbonit.

Teknikat SRM synojnë të pasqyrojnë një pjesë të vogël të energjisë së diellit në hapësirë, duke luftuar rritjen e temperaturës së shkaktuar nga nivelet e shtuara të gazrave serë në atmosferë, të cilët thithin energji dhe rritin temperaturat. Disa teknika të propozuara përfshijnë:

Shtimin e “Albedo”-s [bardhësisë reflektuese]. Rritja e reflektimit të reve dhe të sipërfaqes së tokës në mënyrë që të pasqyrohet përsëri në hapësirë, më shumë

²³ “Royal Society”, është një shoqëri e përbërë nga shumë prej shkencëtarëve më në zë të botës dhe është edhe akademia më e vjetër e shkencave në botë, me aktivitet të pandërprerë.”

<https://royalsociety.org/about-us/>

²⁴ The Royal Society, *Geoengineering the climate: science, governance and uncertainty* (London: The Royal Society, 2009), 1.

Burimi elektronik:

https://royalsociety.org/~media/royal_society_content/policy/publications/2009/8693.pdf

nxehtësi dielli.

Reflektuesit e hapësirës. Bllokimi i një pjese të vogël të dritës së diellit para se të arrijë në Tokë. *Aerosolë në stratosferë.* “Aerosolët” janë grimca të ngurta ose pika të lëngshme, pezull në ajër ose në një gaz tjetër. Mund të jenë natyralë ose të krijuar nga njeriu. Shembuj të aerosolëve natyrorë janë: mjegulla, pluhuri, retë etj. Shembuj të atyre që krijojnë njeriu, janë: tymi, ndotja, pluhuri etj. Futja e këtyre grimcave të vogla reflektuese në atmosferën e sipërme për të reflektuar disa nga rrezet e diellit përpara se ato të arrijnë në sipërfaqen e tokës²⁵.

Në lidhje me gjeoinxhinierinë e karbonit, teknikat GGR synojnë largimin e dyoksidit të karbonit, apo gazrave të tjera të efektit serrë, nga atmosfera, duke kundërshtuar drejtpërdrejt rritjen e efektit serrë si dhe acidifikimin e oqeanëve. Pavarësisht se duket si term jo i dëgjuar shpesh, krahasuar me “ngrohjen globale”, acidifikimi i oqeanëve është një kërcënim po aq serioz dhe në rritje për jetën në ujë e atë në tokë. Oqeanet kanë ndryshuar pH e tyre për shkak të thithjes së tepruar të dyoksidit të karbonit. Me pak fjalë, sistemi jetësor i organizmave ujorë oqeanikë ka pësuar ndryshime serioze dëmtuese. Gjeoinxhinieria që synon përmirësimin përmes teknikave të lartpërmendura GGR, propozon përgjithësisht këto ndërhyrje:

“Pyllëzimi: angazhimi në një përpjekje në shkallë globale për mbjelljen e pemëve.

Groposja e karbonit: djegia e biomasës dhe groposja e saj në mënyrë që karboni që përmban të mbyllet nën tokë.

Bioenergji me kapje dhe izolim karboni: rritja e biomasës, djegia e saj për të krijuar energji duke kapur e izoluar i dyoksidin e karbonit që krijohet nga ky proces.

Kapja nga ajri i ambientit: ndërtimi i pajisjeve të mëdha që mund të largojnë dyoksidin e karbonit direkt nga ajri i ambientit dhe ta ruajnë atë diku tjetër.

Fekondimi oqeanor: shtimi i lëndëve ushqyese në oqean, në vende të zgjedhura, për të rritur prodhimin kryesor, që tërheq dyoksidin e karbonit nga atmosfera.

Përmirësimi i klimës: ekspozimi i sasive të mëdha të mineraleve që do të reagonin me dyoksidin e karbonit, në atmosferë, dhe ruajtja e përbërjes së përfutur në oqean ose në tokë.

Shtimi i alkalinitetit të oqeanëve: grimcimi dhe shpërndarja e shkëmbinjve të tillë si, gur gëlqeror, silikate apo hidroksid kalciumi, në oqean, për të rritur aftësinë e tyre për ruajtjen e karbonit dhe për të përmirësuar drejtpërdrejt acidifikimin e oqeanëve²⁶.

E thënë në mënyrë të përmbledhur, qëllimi i gjeoinxhinierisë sipas metodave, është ky:

Qëllimi përmes metodave CDR është heqja e CO₂ nga atmosfera përmes:

- përmirësimi të marrjes dhe ruajtjes me sisteme biologjike tokësore;
- përmirësimi të marrjes dhe ruajtjes nga sisteme biologjike oqeanike; ose
- përdorimi të sistemeve të inxhinierisë (fizike, kimike, biokimike).

Metodat SRM mund të jenë të tilla:

- të bazuara në sipërfaqe (modifikim i “albedo”-s tokësor ose oqeanik);
- të bazuara në troposferë (metodat e modifikimit të reve, etj.);
- të bazuara në atmosferën e sipërme (tropopauza dhe më lart, d.m.th., stratosfera,

²⁵ Oxford Martin School, “What Is Geoengineering?”, *Oxford Geoengineering Programme*, (University of Oxford).
Burimi elektronik:
<http://www.geoengineering.ox.ac.uk/www.geoengineering.ox.ac.uk/what-is-geoengineering/what-is-geoengineering/>

²⁶ Ibid.

mezosfera);

- të bazuara në hapësirë²⁷.

Megjithatë, çështjet që duhet të trajtohen lidhur me ndryshimet klimatike, janë globale dhe nuk mund të zgjidhen po qe se nuk ka një angazhim global. Emetimi i gazrave nuk po pakësohet dhe nëse shihet si zgjidhje gjeoinxhinieria, duhet thënë se edhe kjo nuk po vendoset në një plan strategjie veprimi global. Në një raport të disa viteve më parë, të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë së Parlamentit Britanik, lidhur me vendosjen e rregullave për kryerjen e gjeoinxhinierisë, thuhet se: “Arritëm në përfundimin se teknikat e gjeoinxhinierisë duhet të vlerësohen në bazë të faktorëve të tillë si, efekti ndërkuftar, shpërndarja e materialeve tejet të rrezikshme në mjedis dhe efektit të drejtpërdrejtë në ekosisteme. Regjimet rregullatorë për gjeoinxhinierinë duhet të përshtaten në përputhje me rrethanat”²⁸. Duke vënë theksin te kontrolli i rreptë i teknikave, ata pohojnë se “shkenca e gjeoinxhinierisë nuk është e përparuar aq sa duhet, sa për ta bërë teknologjinë të parashikueshme, por kjo në vetvete nuk është bazë për refuzimin e një kornize rregulluese apo për përjashtimin e saj”²⁹. Ky raport, shprehet se “mbjellja, ose krijimi i reve” nuk cilësohet si formë e gjeoinxhinierisë, e cila ka synim, ndryshimin global të klimës³⁰.

Megjithatë, edhe pse krijimi i reve nuk konsiderohet këtu pjesë e të ashtuquajturës gjeoinxhinieri, ai është një modifikim i mjedisit. Teknologjinë e krijimit të reve, provokimit të shirave, frenimit apo kontrollit të breshrit etj., e kanë dhe e përdorin shumë shtete tashmë. Pavarësisht qëllimeve dhe efektit të kufizuar, edhe kjo është një ndërhyrje në sistemin e tokës, pasi është modifikim njerëzor. Shembujt nuk mungojnë as nga shtetet pranë nesh.

Projekti DAPHNE 2013-2015, është përqendruar te zhvillimi i instrumenteve të nevojshme shkencore, për të mbështetur potencialin dhe zbatimin e një programi të dizajnuar mirë, të përmirësimit të reshjeve të shiut, duke aplikuar mjete modelimi shkencore, duke kryer fushata matëse dhe eksperimente të “mbjelljes” (krijimit) së reve, dhe duke hetuar ndikimin e zbatimit të tij në mjedis. Zbatohet mbi fushën e Thesalisë, e cila njihet si zona më jetësore bujqësore në Greqi, dhe në këtë mënyrë, moti dhe klima luajnë një rol shumë të rëndësishëm në statusin socio-ekonomik të kombit. Projekti synonte të zgjidhte problemin e thatësisë në Thesali, përmes “modifikimit të klimës”. Si rezultat, kompania 3D s.a., siguron reshje shiu apo bore në zonat e dëshiruara, si pyje, rezervuare, liqene etj., duke luftuar thatësinë dhe për qëllime të mbrojtjes së të mbjellave, përmirësimit të tyre duke transformuar breshrin në shi³¹. Veprimtaria e saj kryhet që nga viti 1981 në Greqi.

Turqia ka eksperimentuar në dimër dhe në pranverë të vitit 2008, teknika të krijimit të reve dhe të shpërndarjes së aerosolëve sipas programit shkencor “Kërkime shkencore për retë dhe aerosolët”. Kërkimet u bënë kryesisht në zonën e Stambollit, u mbledhën të dhëna e u bënë ndërhyrje me instrumente te retë, duke kryer 92 fluturime përgjatë projektit. Puna u bë në bashkëpunim me shkencëtarë të fushës, nga Universiteti i Teksasit (“Seeding Operations and Atmospheric Research”, “Texas A&M University”)³².

²⁷ The Royal Society, *Geoengineering*, 1.

²⁸ Great Britain Parliament, *House of Commons, Science and Technology Committee, The regulation of Geoengineering: fifth report of session 2009-10, report, together with formal minutes, oral and written evidence*, red. Phil Willis (London: The Stationery Office, 2010), 49.

²⁹ Ibid.

³⁰ Ibid.

³¹ 3D s.a., *Weather Modification*, Burimi elektronik: <https://www.3ds.gr/en/activities-en/weather-modification>

³² NCAR, Research Applications Laboratory, “Turkey, Cloud And Aerosol Research In Istanbul” <https://ral.ucar.edu/projects/turkey-cloud-and-aerosol-research-in-istanbul>

Serbia po ashtu ka një traditë të gjatë në krijimin e reve dhe manipulimin e reshjeve përmes teknologjisë dhe kryesisht të frenimi i breshrit. Një grup profesorësh gjeografë, nga Fakulteti i Shkencave i Universitetit të Novi Sadit, Serbi, e kritikojnë këtë prirje në rritje në Serbi: “Pas 46 vitesh eksperiencë në këtë drejtim, hedhjes së 400 000 raketave [stimuluese për retë] dhe spërkatjes së reve me 160 000 kg jodur argjendi, sipas të dhënave 1967-2010, breshëri është shtuar në Serbi”³³. Por, ka studiues të tjerë serbë që mendojnë se është e kundërta: që është shumë ekonomike investimi të teknologjia e modifikimit të reve se sa të përballësh me dëmet nga breshëri apo shiu. Gordana Vukelić (2018)³⁴ madje ia sugjeron një teknologji të tillë moderne, qytetit të Beogradit, si zgjidhje shumë ekonomike për problemet me breshrin dhe dëmet.

Megjithatë, problemet dhe ndërhyrja të klima e kapërcejnë këtë nivel teknologjie. Nga ana tjetër, duhet përmendur fakti se sot, nuk ka një organizim botëror të detajuar për manipulimin e klimës apo mjedisit, qoftë në nivele të tilla të ulëta, qoftë edhe për problemin kryesor të ngrohjes globale. Ka shumë skepticizëm për angazhimin e shteteve në këtë drejtim. Disa konkluzione nga “Royal Academy” të nxjerra një dekadë më parë si pjesë e diskutimit shkencor botëror mbi gjeoinxhinierinë, janë të pandryshueshme edhe sot: “Duket se ekzistojnë tre këndvështrime të veçanta rreth rolit të mundshëm të gjeoinxhinierisë:

1. ajo është një rrugë për të fituar një pjesë të kohës së humbur në negociatat për zbutje ndërkombëtare [të dëmeve klimatike];

2. ajo paraqet një manipulim të rrezikshëm të sistemeve të tokës dhe mund të jetë thelbësisht joetike;

3. ajo është rreptësisht një politikë sigurimesh kundër dështimit madhor të zbutjes [së dëmeve klimatike]”³⁵.

Përdorimi i gjeonxhinierisë, të vendos përballë disa çështjesh: efektiviteti i saj, kohështrirja e zbatimit, siguria, kostoja. Nëse do të kishte keqlllogaritje dhe dëmtime të ekosistemeve të tokës, ato mund të ishin shumë të rënda pasi pasojat janë globale. Ndërkohë, ekziston edhe një element tjetër i cili mund të rezultojë shumë shqetësues me kalimin e kohës ose në rrethana konfliktesh ndërkombëtare. Krahas komuniteti të shkencës, kanë investuar edhe shtetet projekte të ndryshme kërkimore mbi klimën dhe mjedisin, me qëllim që të këto të shfrytëzohen që nga lufta e deri te plotësimi i interesave kombëtare, ruajtja e sigurisë dhe shtimi i fuqisë kombëtare. Ky detaj e komplikon më shumë çështjen e arritjes së një ekuilibri transparent global, që ka lidhje me një mjedis të sigurt.

4. Lufta mjedisore, shtetet dhe modifikimi i klimës e mjedisit

“Arritja e këtij ekuilibri është duke u bërë më e vështirë për shkak të përparimit shkencor dhe teknologjik të armëve. Është ironike që të kujtojmë, se në vitin 1878, Friedrich Engels, duke komentuar luftën franko-prusiane, thoshte se ‘armët e përdorura kanë arritur një fazë të tillë përsosmërie, sa që përparime të mëtejshme me ndikim

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

³³ Milivoj B. Gavrilov, et al. “Is hail suppression useful in Serbia? General review and new results”, në *Acta geographica Slovenica*, (53-1, 2013): 165-179.

³⁴ Gordana Vukelić et al. “Anti-Hail Protection-Assessment of Financial Effects on the Territory of Belgrade” në *Sustainability* (2018, 10, 1239), 2. doi:10.3390/su10041239.

³⁵ The Royal Society, *Geoengineering*, 45.

revolucionarizues nuk do të mund të ndodhin më'. Jo vetëm që janë zhvilluar armë të reja, por disa nga konceptet themelore të gjeografisë dhe të strategjisë janë ndryshuar rrënjësisht; hapësira dhe kontrolli i klimës kanë zëvendësuar Suezin ose Gjibraltarin, si elementë kryesorë të strategjisë. Përveç raketave të përmirësuara, raketave shumëfishme dhe bombave më të fuqishme e më të sakta, zhvillimet e ardhshme mund të përfshijnë fare mirë, anije luftarake hapësinore të automatizuara ose të drejtuara, instalime në thellësi të deteve, armë kimike dhe biologjike, rreze vdekjeprurëse e madje edhe forma të tjera luftimi – madje edhe klima të jetë e manipuluar prej tyre.”³⁶

Brzezinski e konsideron manipulimin e klimës si një armë ose si një gërshetim me strategjitë e luftës të së nesërme. Këtë ai e thoshte në vitin 1970; e nesërmyja ka ardhur dhe ajo është e sotmja.

“Teknikat alternative të modifikimit të klimës mund të zbatohen për periudha të zgjatura duke shkaktuar thatësi apo stuhi, duke e dobësuar kështu kapacitetin e një kombi dhe duke e shtrënguar atë që pranojë kërkesat e konkurrentit”³⁷, – parashikonte Gordon J. F. MacDonald, në vitin 1968 në një libër që jepte parashikimin e botës së vitit 2018. Brzezinski e citon, dhe në fakt, ky botim i “Foreign Policy Association”, çuditërisht, ka parashikuar shumë zhvillime si interneti, rrjetet sociale etj.

4.1 Ndryshimet e klimës në fokus të inteligjencës dhe mbrojtjes, si çështje sigurie të rëndësishme së veçantë

Ekziston ideja sikur siguria mjedisore, klima dhe kërcënimet mjedisore janë terma moderne dhe të shoqërisë civile apo të organizatave mjedisore. Faktet flasin për të kundërtën. Shtetet e fuqishme e kanë pasur gjithmonë në fokus mjedisin dhe klimën, duke e konsideruar të lidhur ngushtë me çështjet e sigurisë. Inteligjenca dhe ushtria kanë qenë të lidhur qysh herët me këto çështje. Duhet të kemi parasysh se nga njëra anë është trajtimi i tyre dhe nga ana tjetër mund të flasim për ndikimin “antropogjenik”, i cili është prodhuar si pasojë e aktiviteteve me sfond ushtarak apo të projekteve shtetërore që kanë të bëjnë me sigurinë në tërësi, e në raste të caktuara, me mbrojtjen apo luftën.

Asnjë nuk mund ta monitorojë planetin më mirë se sa ushtria. Satelitët e US Air Force e vëzhgojnë planetin për shtëllungat e nxehta të raketave balistike; një shtresë tjetër satelitësh vëzhgojnë më poshtë; disa të tjerë mund të vëzhgojnë një pushkë që nga hapësira; vëzhgohet përmes reve për instalime ushtarake; më poshtë akoma dronët dhe avionët mbledhin inteligjencë nëpër zona konfliktesh dhe sizmologjia dëgjon për çdo lëkundje të mundshme që mund të vijë nga testet e nëndheshme nukleare; madje edhe thellësitë oqeanike vëzhgohen nga nëndetëset ushtarake në kërkim të aktiviteteve të kundërshtarëve të huaj. I gjithë informacioni i mbledhur është i pamarsë dhe i pakrahasueshëm. Shkencëtarët, kur kanë mundësinë të përdorin këto të dhëna shumë vlefshme, shikojnë ndrysh nga gjeneralët dhe bëjnë zbulime shkencore, jo vëzhgime ushtarake.³⁸

Megjithatë, të dhënat klimatike të këtyre satelitëve janë shumë të avancuara. MEDEA ishte një projekt që gërshetonte aktivitetin e shkencëtarëve me ata të inteligjencës, që

³⁶ Zbigniew Brzezinski, *Between two Ages, America's Role in the Technetronic Era* (New York: The Viking Press, 1970), 28.

³⁷ Gordon J. F. MacDonald, “Space”, në *Toward the Year 2018*, (Cowles Education Corp., 1968): 34.

³⁸ Geoff Brumfiel, Shared Intelligence, “The military has a vast array of scientifically valuable data – some more accessible than you think”, *Nature*, vol. 477, 22 (September 2011), 388.

përdornin këto të dhëna satelitore, për të studiuar ndryshimet klimatike. Që nga viti 1942, me “Projektin Manhatan”, Pentagoni ka pasur një bashkëpunim të gjerë me shkencëtarët anembanë vendit. Ekziston një rrjet i tërë me shkencëtarë civilë, kërkues të pavarur, laboratorë universitetesh etj., të cilët kanë punuar për ngritjen e kapaciteteve të mbrojtjes, armët nukleare apo detektimin e nëndetëseve. Ky komunitet njihet me emrin JASONS. Klima dhe studimi i saj është pikërisht nën këtë mënyrë zhvillimi ku shkenca dhe siguria kombëtare bashkëpunojnë ngushtë³⁹.

Këto të dhëna kaq të gjera dhe të rëndësishme rrokin çdo hapësirë të planetit dhe madje edhe jashtë tij. Janë më të avancuara se të botës civile, ushqejnë zhvillimin e projekteve shkencore sekrete të mbrojtjes, inteligjencës dhe sigurisë në tërësi dhe klasifikimi i tyre ruhet rreptësisht.

Në vitet 1950, *US Navy* (Marina e SHBA-së) i kushtoi burime pamasa kuptimit dhe krijimit të hartës së shtretërve të deteve, përfshirë edhe kreshtat e mesit të oqeaneve, çelësit të teorive të pllakave tektonike, - sipas Raymond Jeanloz, një shkencëtar që merret me çështjet e Tokës, i Universitetit Berkeley të Kalifornisë, anëtar i hershëm i komunitetit JASONS. Rrjetet sizmike për matjen e testeve nukleare, krijuan harta të tërmeteve. Madje edhe një sinjal radioje i kapur nga një yll i largët, u kap muaj më parë se sa u kap prej astronomëve⁴⁰.

Kemi të bëjmë me teknologji të avancuar e cila për çështje shtetërore, të sigurisë, e ka pasur dhe e ka në vëzhgim të vazhdueshëm mjedisin. Nga ana tjetër, ndryshimet klimatike lidhen në mënyrë të pandashme me sigurinë dhe këtë e shohim në një mori institucionesh dhe veprimtarish shtetërore të SHBA-së, përgjatë dekadash të tëra, qysh pas LIIB.

4.2 Modifikimi i klimës dhe projektet shtetërore

Krijimi i hartave sizmike, ka qenë pjesë e aktiviteteve shkencore të mbrojtjes, si në SHBA edhe në ish-BRSS. Aktiviteti sizmik lidhej me eksperimentet dhe testimet nukleare. Këto eksperimente, sipas studiuesve të ndryshëm mund të shkaktonin një efekt zinxhir në koren e tokës, duke prodhuar tërmete në vende të ndryshme. Një botim i klasifikuar amerikan, i vitit 1974 është edhe përkthimi voluminoz i një botimi rus për tërmetet në Rusi; botimet këtij karakteri, të përkthyer janë të shumta dhe shfaqin interesin që kishte institucioni. Inteligjenca dhe mbrojtja e mblidhte të gjithin si informacion sizmik⁴¹.

Si SHBA edhe BRSS kishin në fokus klimën, por edhe mundësinë e modifikimit të saj dhe përdorimit të saj për arsye mbrojtje apo lufte. Në vitin 1957, *Washington Post*, dhe *Times Herald*, dy të përditshme kryesor në SHBA kishin një artikull në faqen e parë që shfaqte shqetësimin se Lufta e Ftohtë mund të krijonte një garë të luftës për kontrollin e klimës dhe se SHBA kërcënohej seriozisht nga kjo gjë.⁴²

Pak vite më pas, siç shihet në disa dokumente të deklasifikuara të CIA-s, përpjekjet për kontrollin e klimës dhe modifikimin e saj ishin në rritje e sipër dhe kishin mbështetje

³⁹ Ibid.

⁴⁰ Ibid

⁴¹ JPRS ID: 8492 *Earthquakes in the USSR in 1974*. Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP82-00850R000100060003-1.

Gorbunova, *Zemletryasenia v SSSR v 1973*. Godu, I. Gorbunova, N. Kondorskay, N. Shebalin, Eds. (Nauka, Moscow, 1976).

⁴² Nate Heseltine, “U.S. Seriously Concerned; Cold War May Spawn Weather Control Race”, *Washington Post*, dhe *Times Herald*, titull kryesor, (December 23, 1957), 1.

Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP33-02415A000200350078-5.

të gjerë. Shtëpia e Bardhë dhe Presidenti L. Johnson e mbështesnin modifikimin e klimës. Buxheti për këtë gjë do shumëfishohej brenda pak vitesh. Pjesa kryesore e këtij buxheti i shkonte ushtrisë dhe Forcave Ajrore. Mbështetja e inteligjencës në këtë drejtim ishte e pareshtur dhe modifikimi që i bënin sovjetikët klimës ndiqej në mënyrë të pandërprerë. Sovjetikët po zgjerorin këtë program në mënyrë të shpejtë dhe informacioni lidhur me të ishte shumë i vështirë për t'u marrë⁴³.

“Raporti Juaj për klimën ishte fantastik. Kjo është një fushë, në të cilën dëshiroj që ne të përparojmë, të bëjmë zbulimet mëdha. Jam i bindur që mundemi” - shkruante Presidenti Lyndon Johnson më 14 shtator 1965, lidhur me raportimet që i bëheshin për programet e modifikimit të klimës⁴⁴.

Po në këtë përmbledhje dokumentesh, jepen disa memorandume. Në njërin prej tyre, drejtuar Presidentit Johnson, në pjesën ku flitet për modifikimin klimatik, thuhet: “Është e qartë që ka ardhur koha për ne, që të ecim përpara dhe të hulumtojmë mundësitë e modifikimit dhe të kontrollit benignj të klimës. . . Përfitimet që mund të vijnë nga modifikimi klimës janë të paimagjinueshme. Ka një bindje në rritje mes komunitetit shkencor se kërkimet në një program modifikimi të klimës janë të garantuara; kjo për shkak të eksperimenteve që janë bërë dhe për shkak të përmirësimit teknologjik”⁴⁵. Në këtë memorandum flitet edhe për krijimin e një programi vëzhgimi të klimës globale, i cili do të mbledhë të dhëna nga i gjithë planeti. Një rëndësi e veçantë i kushtohet mbledhjes së të dhënave, për herë të parë, nga sateliti meteorologjik⁴⁶.

Pavarësisht përfitimeve në fushën e emergjencave, agrikulturës etj., modifikimi i klimës do të shërbente edhe si armë. Nënadmirali William F. Raborn, i cili kishte shërbyer 39 vjet në Marinë (“US Navy”), dhe pasi e kishte lënë atë, shërbeu në vitet 1965-1966 edhe si drejtor i CIA-s, në një deklaratë të tijen të vitit 1963, shprehet qartë mbi përdorimin e modifikimit të klimës nga ushtria dhe modifikimin e mjedisit si armë. Në atë kohë ai mbante pozicionin e zëvendëssefit operacioneve detare, përgjegjës për kërkimin shkencor dhe zhvillimin [drejtori i “U.S. Navy Special Projects Office”]. Artikulli i *National Observer*, i referohet shkrimit të tij në revistën e Marinës, *Naval Institute Proceedings*. Admirali flet për zhvendosjen e stuhive dhe dërgimin drejt armikut; shkaktimin e fenomeneve shkatërruese klimatike; kontrollin e klimës për sulmet ushtarake; teknikat e kontrollit në shkallë të gjerë të mjedisit; përdorimit të rrufeve artificiale nga jonosfera; krijim përmbytjesh dhe modifikime temperaturash; përdorim valësh elektromagnetike etj. Efektin e modifikimit të klimës te lufta, ai e konsideron më të madh se sa përdorimi i armës nukleare. “Mundësitë për përdorimin ushtarak të ‘armëve mjedisore’ . . . mundësia e kontrollit të klimës, mund të sjellë ndryshime më të mëdha se sa ato që ndodhën në 1945, me shpërthimin e armëve të para nukleare.”⁴⁷ Admirali nuk vendos një datë apo kohë të caktuar për arritjen e këtyre kapaciteteve, por siç pamë më lartë, kishte një program kombëtar që punonte në këtë drejtim. “Tashmë kemi ndër marrë

⁴³ Chief, Astro-Geophysics Branch, GSD/SI, *Memorandum to: Chief, General Sciences Division. Subject: Weather Modification.* (7 October 1965). Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.

⁴⁴ Lyndon B. Johnson. White House, Washington, September 14, 1965. Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.

⁴⁵ *Memorandum for the President, The weather services...*, (September 13, 1965), 4. Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.

⁴⁶ *Ibid.*

⁴⁷ William F. Raborn, “Weather: Warfare’s Next Weapon? Admiral Predicts Arsenal of Storms, Icebergs, and Fog”, *National Observer*, (January 21, 1963). Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP75-00001R000100070096-5.

hapat e parë drejt zhvillimit të kapaciteteve të luftës mjedisore. Po përdorim të dhënat klimatike satelitore nga Tiors II për operacionet taktike të tanishme dhe nisur nga përparimet tona shkencore jemi duke planifikuar një studim 10-vjeçar gjithëpërfshirës të atmosferës”⁴⁸.

Në diskutimet e kongresistëve amerikanë, në Senatën e vitit 1966, zë një vend të rëndësishëm modifikimi i klimës dhe efektet që do mund të ketë te siguria. Lufta e të ardhmes do të ndikohet shumë nga kontrolli dhe modifikimi i klimës. Presidenti Lyndon B. Johnson, ka deklaruar: “Nga hapësira, padronët e pafundësisë mund të kenë fuqinë për të kontrolluar klimën e tokës, për të shkaktuar thatësi dhe përmbajtje, për të ndryshuar baticat dhe për të ngritur nivelin e detit, për të devijuar Rrjedhën e Gjirit dhe për të ndryshuar klimën e buta në të acarta”⁴⁹.

B. Dr. Edward Teller, para Komitetit të Senatit të Përgatitjes Ushtarake, deklaronte: “Imagjinoni një botë ku rusët të kontrollojnë pjesën më të madhe të klimës, të kontrollojnë shirat dhe të ndikojnë në mënyrë të pafavorshme reshjet në vendin tonë. . . Çfarë do të thoshte të ishim një fuqi e klasit të dytë?”⁵⁰

Ndërsa citohet edhe i ndjeri Dr. John von Neumann i cili kishte deklaruar se: “Ndërhyrja e mundshme në çështjet atmosferike dhe klimatike do të bëhet realitet pas pak dekadash, dhe do të shpalojë në një shkallë që vështirë të imagjinohet për momentin”. Kërkesa e Marinës (Navy) e vitit 1973, për mbështetje dhe aprovim për “eksperimentet e modifikimit të klimës”, tregon se ushtria amerikane kishte kohë që i zhvillonte këto kërkime⁵¹.

Një raport i vitit 1959, i inteligjencës amerikane jep informacione edhe në lidhje me punën e hershme të shkencëtarëve sovjetikë lidhur me kontrollin e klimës. Që nga viti 1946 shkencëtarët sovjetikë kanë kryer kërkime bazë për të gjitha aspektet fizike të reve dhe kontrollit të klimës. Në vitin 1958 BRSS filloi përdorimin e teknikave të krijimit të reve e të pastronte aeroportet që mbulonte një lloj mjegulle dimërore. Literatura shkencore sovjetike tregonte se në 10 vitet e fundit, 200 shkencëtarë në 23 institute dhe universitete kishin kryer studime të lidhura me kontrollin e klimës – kërkime relativisht të gjera. Një pjesë e madhe e tyre, u bënë për fizikën e reve. Në këtë drejtim janë bërë kërkime paralele përgjatë 10 viteve të fundit, mes sovjetikëve dhe Perëndimorëve, por ka mangësi informacioni për punën e BRSS-së, sidomos për sa i përket eksperimenteve të kontrollit të klimës, pasi sovjetikët i klasifikojnë këto materiale. BRSS ka kuptuar se zgjidhja e kontrollit të klimës qëndron te njohuria në shkallë të gjerë e proceseve klimatike. Ata kanë programe në fusha të tilla si: gjeofizika, qarkullimi i madh atmosferik dhe oqeanografia. Oqeanografët sovjetikë janë interesuar për klimën dhe modifikimet mjedisore dhe kanë kryer studime rreth efekteve termike dhe dinamike të oqeanëve mbi atmosferë. Ndikimi i Oqeanit të Atlantikut Verior mbi klimën, ka qenë një drejtim kryesor për ta⁵².

I gjithë ky interes ushtarak lidhur me klimën dhe kontrollin apo modifikimin e saj,

⁴⁸ Ibid.

⁴⁹ United States Congress, Senate, Committee on Commerce, *Weather Modification: Hearings, Eighty-ninth Congress, First and Second Sessions, on S. 23 and S. 2916, Parts 1-2* (Washington: U.S. Government Printing Office, 1966), 422.

⁵⁰ Ibid.

⁵¹ Memorandum For: Chief, Collection Branch Reconnaissance Group, IRS. *U-2 Support for Weather Modification Experiments*. Memorandum from Recon Group, IRS to DSA (18 January 1973). Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP33-02415A000400240028-0.

⁵² *Soviet Weather Control*, (24 February 1959). Document Number (FOIA) /ESDN (CREST): CIA-RDP79R00890A001100020012-0.

që në vitet '50, duket shumë i ngjashëm me ato drejtime në të cilat duhet të zbatohet sot gjeoinxhinieria. Dallimi është se nëse gjeoinxhinieria e ofruar sot, synon riparimin e klimës dhe të mjedisit, eksperimentet e kryera nga ushtria dhe sektori i sigurisë, kanë synuar historikisht që ta shndërrojnë mjedisin në një armë në favor të shtetit që e përdor atë.

4.2.1 Mbi mundësinë e përdorimit të tërmeteve si armë

Çështjen hipotetike mbi përdorimin e tërmeteve si armë, do e ngrinte senatori Pell në vitin 1972, gjatë diskutimeve që bëheshin në Komitetin e Marrëdhënieve me Jashtë, në Senatën e SHBA-së: “. . .mundemi në që të zhvillojmë një teknikë për krijimin e një tërmeti në zonën e armikut, pa e kuptuar ky i fundit?”. Z. MacDonald përgjigjet: “Ashtu si kam shkruar, sigurisht që kjo gjë qëndron si mundësi. Ne nuk zotërojmë sot njohurinë, kuptimin shkencor të mekanizmit të tërmeteve, si prodhohen tërmetet, që të ndërmarrim në mënyrë sekrete një operacion të tillë; nuk mendoj se e bën dot ndonjë shtet tjetër. Dua të vë në dukje se marrëveshja e firmosur së fundi mes SHBA-së dhe BRSS-së, ka një pikë që trajton fushën e parashikimit të tërmeteve. Sovjetikët kanë një program shumë aktiv për parashikimin e tërmeteve. . .” Senatori Pell vijon me argumentin e tij: “Pra, për hir të argumentit, nëse kemi një luftë tjetër me Japoninë, pas 50 apo 100 vjetësh. . . a do i duhet të kërkojë shumë secilit prej nesh, që të arrijë krijimin e tërmeteve në zonën jetike të kundërshtarit?”. Z. MacDonald përgjigjet: “Mendoj se ka një mundësi; sigurisht që ekziston një mundësi, me të cilën spekulova, por duhet të theksoj se sot për sot, as ne as japonezët nuk kemi kapacitete në dorë dhe nuk do t'i kemi as për një dy dekada”⁵³. Senatori Pell: “Ka edhe një subjekt tjetër për të cilin do doja të dija disa mendime tuaja: mundësia e ndikimit të sjelljes njerëzore”.

Kjo seancë dëgjimore e vitit 1972 dhe diskutimet që kryhen kishin si objekt diskutimi “Ndalimin e modifikimit të klimës nga ushtria”. Gjashtë vjet më vonë miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, me rezolutën 31/721 të 10 dhjetorit 1976, “Konventa për ndalimin e përdorimit të teknikave modifikuese të klimës, për qëllime ushtarake apo të çdo natyre tjetër armiqësore”. Si SHBA-ja edhe Rusia (ish-BRSS i asokohe) e kanë firmosur këtë konventë. Megjithatë, duket se as kjo konventë e as marrëveshje të tjera që synojnë të ruajnë klimën nuk janë frenuese për aktivitetin e shteteve të ndryshme në drejtim të modifikimit të klimës.

Neni 1 i kësaj konvente thotë: “Secili shtet apo palë e kësaj konvente, zotohet të mos angazhohet në përdorimin e teknikave të modifikimit të mjedisit për qëllime ushtarake apo të çdo natyre tjetër armiqësore, të cilat kanë efekte të gjera, me kohëzgjatje ose efekte si mjete shkatërrimi, dëmtimi apo lëndimi të secilit shtet”⁵⁴.

Termi “teknika të modifikimit të mjedisit”, sqarohet në nenin 2 se çfarë nënkupton: “Çdo teknikë për ndryshimin përmes manipulimit të qëllimshëm të procesit natyror, dinamikës, përbërjes së strukturës së tokës, përfshirë biosferën e saj, litosferën, hidrosferën dhe atmosferën apo hapësirën e jashtme”⁵⁵.

Natyrisht, që projektet e klasifikuara të ushtrive, kudo nëpër botë, nuk mund të

⁵³ United States, Congress, Senate, Foreign Relations, *Prohibiting Military Weather Modification: Hearings Before the Subcommittee on Oceans and International Environment of the Committee on Foreign Relations United States Senate, 92-2, on S. Res. 281, July 26 and 27, 1972* (Washington: U.S. Government Printing Office 1972), 74.

⁵⁴ United Nations, “Convention on the prohibition of military or any other hostile use of environmental modification techniques” *Treaty Series*, vol. 1108, and *depository notification C.N.263.1978.TREATIES-12 of 27 October 1978*, (New York: United Nations), 153.

⁵⁵ Ibid.

hetohen për shkelje të kësaj konvente pasi nuk ka transparencë lidhur me to. Dëshmia e Stanislav Lunev, është një shembull për këtë gjë; ashtu dhe eksperimentet e kryera nga ushtria e SHBA-së, e cila ka pasur në fokus kontrollin e klimës, sipas dokumenteve të referuara më sipër.

“Përmes syve të armikut (“Through the Eyes of the Enemy”) është më shumë se sa autobiografia e një operativi dhe sabotuesi shumë të aftë të inteligjencës. Lunev portretizon krimin e organizuar si autoritetin e vetëm në Rusinë moderne dhe pohon, se ky element është infiltruar në çdo nivel të jetës private dhe korporative amerikane. Ai siguron detaje tronditëse për armët sizmike, spiunazhin e korporatave në shkallë masive dhe skuadrat e vdekjes me mbulim të fortë”⁵⁶. Ky libër është botuar nga Stanislav Lunev, një ish-pjesëtar i shërbimit inteligjent ushtarak rus, GRU, i cili ka shërbyer fillimisht në Singapor, Kinë e mandej në SHBA. Në vitin 1992 dezerton dhe futet në “Programin e FBI-së për mbrojtjen e dëshmitarëve”. Ai ka rrëfyer në intervista audio dhe libra realitetin e shërbimeve inteligjente ruse, sekrete, strategjitë sovjetike, planet etj. Dëshmitë e tij janë vërtetuar edhe përmes autorëve të tjerë rus. Krahas të tjerave, Lunev pohon ekzistencën e armëve sizmike të cilat i ka zhvilluar ish-BRSS.

“Instrumente të tjera të shkatërrimit të cilat rusët kanë pasur sukses, janë armët sizmike. Spitak dhe qytete të tjera të vogla në malet Transkaukaze, pothuajse u shkatërruan gjatë testeve të armëve sizmike të cilat shkaktuan një tërmet. Kjo do të kishte zbatime të dukshme në Bregun Perëndimor të SHBA-së dhe në zona të tjera të botës, të prira ndaj tërmeteve. Rusia ka qenë gjithashtu një lider, në zhvillimin e “Armëve me impuls elektromagnetik” (EMP). Këto armë u zbuluan gjatë testeve nukleare. Shkencëtarët zbuluan se impulse me energji të lartë shkatërronin qarqet elektronike. Armë të bazuar në një teknologji të tillë, u përdorën nga SHBA gjatë operacionit “Stuhia e shkretëtirës”, në Irak.”⁵⁷.

Në rrëfimin e tij, Lunev flet gjithashtu për krijimin e armëve që përdorin frekuenca shumë, shumë të ulëta valësh radioje; energji e cila përdoret për shkatërrimin e trurit të njeriut dhe për ndikimin e trurit njerëzor e deri për “shpëlarje” truri⁵⁸. Në vitet ’70, siç e pamë më lart senatori Pell, gjatë seancës dëgjimore, pyeti për të dyja këto çështje: modifikimin e mjedisit për shkaktimin e tërmeteve dhe ndikimin e mendjes njerëzore, sjelljes, përmes armëve me valë të caktuara, që përdorin po ashtu mjedisin. Informacioni që jep ish-koloneli Lunev, është i 30 viteve më pas – aq kohë sa thoshte MacDonald, se këto arritje shkencore mund të ndodhnin.

Qëndrimet në lidhje me aktivitetin sizmik të tokës dhe testet nukleare përgjatë historisë janë të ndryshme. Ka mendime se testimet nukleare kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në një zinxhir tërmetesh, pasi energjia është përcjellë përmes pllakave, të cilat janë të lidhura. Sipas klimatologut dhe gjeofizikanit të njohur të viteve ‘60, Gordon MacDonald: “Çelësi për luftën gjeofizike, është identifikimi i paqëndrueshmërive mjedisore, të cilat shtimi i një shume të vogël energjie, do t’i bënte të çlirojnë sasi shumë të mëdha energjie”⁵⁹. MacDonald është një prej shkencëtarëve të komunitetit JASON’s, emër shumë i njohur i shkencës që në vitin 1968 përshkruante konceptet e luftës moderne dhe përdorimit të mjedisit.

⁵⁶ Brendan J. LaSalle, “Editorial Reviews”, në Stanislav Lunev, *Through the Eyes of the Enemy* (Regnery Publishing, Inc. 1998).

⁵⁷ Stanislav Lunev, *Through the Eyes of the Enemy* (Regnery Publishing, Inc. 1998), 30-31.

⁵⁸ Ibid.

⁵⁹ Gordon J. F. MacDonald, “How to Wreck the Environment,” in Nigel Calder (red.), *Unless Peace Comes* (New York: Viking, 1968), 181-205.

“Armët gjeofizike mund të jenë pjesë e armaturës së çdo kombi. Siç do të argumentoj, këto armë janë të përshtatshme në mënyrë të veçantë për luftëra të kamufluara ose të fshehta”⁶⁰. Ai sheh si të vetmen barrierë për kohën, vetëm nivelin e ulët të teknologjisë, por parashikon se shkencë mund ta kapërcejë këtë gjë. Problemi kryesor që ai vë në dukje, është pasoja që mund të ketë modifikimi i klimës: “Nocioni ynë për shkencën themelore të mjedisit dhe teknologjinë është primitiv, por akoma më primitive janë nocionet tona për format dhe procedurat e duhura politike për t’u marrë me pasojat e modifikimit”⁶¹. Ky mosbesim qëndron ende pezull edhe sot, kur flitet për modifikimin e mjedisit përmes gjeoinxhinierisë.

Teknologjia eksperimentale që ka lidhje me mjedisin dhe modifikimin e tij, sot ka bërë përparime të dukshme, por një prej emrave më të komentuar për vizionin e ri të shkencës, i përket të shkuarës: Nikola Tesla (1856-1943).

Në laboratorin e tij në New York, Tesla eksperimentoi fizikën e vibrimeve, duke testuar rezonancën harmonike. Me anë të eksperimenteve të tij, ai shkaktoi tërmete artificiale dhe njëri prej tyre atij i doli eksperimenti nga duart dhe për pak shembi ndërtesën ku jetonte. Vibrimet përçoheshin deri në tokë dhe dridhnin ndërtesën dhe tokën, madje erdhi edhe policia për të parë se ç’kishte ndodhur. Vibrimet ai i prodhonte dhe eksperimentonte me pajisje modeste. Parimet shkencore që zbulonte ishin thelbi⁶².

Një artikull që titullohej “Tërmetet e kontrolluara të Teslës” (“Tesla’s Controlled Earthquakes”), në qershor 1935, në New York Amerikan, citon Teslën që thotë: “Vibrimet ritmike kalojnë përmes Tokës pothuajse pa asnjë humbje energjie. . . kjo bën të mundur që të barten efekte mekanike në distancat më të mëdha tokësore dhe të prodhohet çdo lloj efekti unik. . . Shpikja mund të përdoret me efekt shkatërrues në luftë. . .”. Tesla mbështeste teorinë se duhej vetëm një sasi e vogël energjie fillestare, e cila shumohej përmes vibrimit dhe valët, do të prodhonin më shumë energji se sa ajo që u përdor fillimisht.

4.2.2 Shkenca dhe mjedisi mund të jenë “arma” e së ardhmes

Sekretari i amerikan i Mbrojtjes, William S. Cohen, në fjalimin e tij në konferencën *Terrorizmi, armët e shkatërrimit në masë dhe strategjia e SHBA-së* (“Terrorism, Weapons of Mass Destruction, and U.S. Strategy, Georgia Center, Mahler Auditorium, University of Georgia, Athens, Ga.”), do të deklaronte mes të tjerave:

“Ekzistojnë raporte, për disa vende që janë përpjekur të ndërtojnë një virus si Ebola, dhe ky do të ishte një fenomen shumë i rrezikshëm, për të thënë më të paktën. . . disa shkencëtarë në laboratorët e tyre janë përpjekur që të krijojnë lloje patogjenësh që do të ishin me veprim specifik etnik, në mënyrë që ata thjesht të eliminonin grupe etnike apo raca të caktuara; dhe të tjerë janë duke dizajnuar një lloj inxhinierie, lloje insektesh që mund të shkatërrojnë prodhime specifike. Të tjerë, janë të përfshirë madje në një lloj ekoterrorizmi, përmes të cilit mund të ndryshojnë klimën, të shkaktojnë tërmete e vullkane që nga distanca të largëta, përmes përdorimit të valëve elektromagnetike. Pra, ka plot mendje gjeniale atje jashtë, që punojnë për të shkaktojnë terror mbi kombet e tjera”⁶³.

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Ibid.

⁶² Jason Jeffrey, “Earthquakes: Natural or Man-made?” *New Dawn* No. 57, (November-December 1999).

⁶³ William S. Cohen, “DoD News Briefing: Secretary of Defense William S. Cohen”, April 28, (U.S. Department of Defense, 1997).

Burimi elektronik:

<https://archive.defense.gov/Transcripts/Transcript.aspx?TranscriptID=674>

Një vit më pas, në Parlamentin Europian do të zhvillohej një diskutim lidhur me këtë teknologji, të përmendur nga Sekretari Cohen. Ka vite që përfillet shumë në internet, rrjete sociale e ngado, aktiviteti i “Projektit HAARP”. Duke lënë mënjanë atë që rëndom quhet “konspiraci”, shembulli i sjellë këtu i referohet shqetësimeve të europarlamentarëve lidhur me të ashtuquajturat armë jovdekjeprurëse dhe projektit HAARP.

4.2.2.1 Raporti i diskutimit të “Projektit HAARP”, në PE⁶⁴

Tom Spencer (EPP, Britani e Madhe), kryetari i Komitetit të Punëve të Jashtme, tha që Shtetet e Bashkuara ishin ftuar në seancë që të jepnin pikëpamjen e tyre për këtë çështje. Megjithëse SHBA e kishte refuzuar ftesën fillestare, z. Spencer, e përsëriti ofertën e tij, duke thënë se amerikanët mund të dërgonin një përfaqësues për t’u drejtuar komitetit në të ardhmen, nëse do të dëshironin.

*Zonja Rosalie Bertell, nga Toronto (Kanada)*⁶⁵, është një nga ekspertet më të informuara në lidhje me HAARP (Programi i Kërkimeve Aurorale me Frekuencë të Lartë Aktive/”High Frequency Active Auroral Research Programme”), një program i cili është zhvilluar nga ushtria amerikane. Ajo përshkroi shkurt HAARP-in. Jonosfera është një shtresë e lartë e atmosferës, me grimca të cilat janë tejet të ngarkuara me energji. Nëse projektohet rrezatim në jonosferë, mund të gjenerohen sasi të mëdha energjie dhe të përdoren për të asgjësuar një rajon të caktuar.

Projekti HAARP është i përfshirë në manipulimin e jonosferës së tokës, roli natyror i së cilës është që të moderojë transferimin e energjisë nga dielli në tokë, dhe që përdoret si një trajektore raketash e si një reflektuese për komunikimin radio. Qëllimi i HAARP-it është që të kontrollojë dhe manipulojë jonosferën, në mënyrë që t’i mundësojë manipuluesit, fshirjen e komunikimeve sipas dëshirës, në një shkallë globale, ose t’i bëjë ato elastike, në rast të një lufte bërthamore.

Ai mundëson gjithashtu që të zhvillohen komunikime me nëndetëset e zhytura dhe, në teori, mund të krijojë korridore geomagnetike për orientimin e fashave të grimcave, të cilat, më pas, mund të depozitohen sasi të mëdha energjie kudo në botë. Në terma më të thjeshtë, HAARP-i, me fuqinë e tij frikësuese, të shpërndarjes ose heqjes së energjisë elektrike në një shkallë globale dhe të kontrollit të tij të komunikimit, është elementi i një sistemi, që mund të kontrollojë “fshatin global” në disa mënyra të frikshme.

Sipas doktor Nick Begich, një ekspert nga Alaska dhe autor i një prej botimeve kryesore për këtë temë, programi HAARP, do të lejonte që të arriheshin përqendrime të tilla energjie sa që një rajon i tërë i planetit, të mund të privohej nga uji. Valët elektromagnetike mund të shkaktojnë tërmete ose dallgë baticë. Z. Spencer theksoi se, sipas konventave ndërkombëtare, çdo veprim që çonte në ndryshimin e klimës ishte i ndaluar. Z. Begich tha se, në sytë e tij projekti ishte qartë dhe thjesht “teknologji e *Star Wars*”. Për më tepër, ishte një projekt sekret, pasi Kongresi Amerikan kishte refuzuar të financonte “Luftën e Yjeve” (*Star Wars*). . . Sekretet shtetërore janë të pranueshme në vetvete, por nëse ato sjellin pasoja të tilla të mëdha për qeniet njerëzore dhe mjedisin, ato duhet të bëhen publike. Sipas mendimit të tij, komunitetit ndërkombëtar duhet t’i

⁶⁴ European Parliament, “The HAARP Project and non-lethal weapons. Experts alarmed - public debate needed”. (Brussels, 9th February 1998)

Burimi elektronik:

<https://www.europarl.europa.eu/press/sdp/backg/en/1998/b980209.htm#1>

⁶⁵ Dr. Rosalie Bertell, një nga ekspertet më të mira botërore në fushën e rrezatimit; kundërshtuese e njohur ndërkombëtare e projekteve industrisë nukleare dhe politikave ushtarake që ndotin mjedisin.

lejoheq që të bëjë një vlerësim të rreziqeve të programit HAARP.

Euuro De Mel (EPP, Portugali) tha se ai i konsideronte zbulimet si të tmerrshme dhe se ishte e nevojshme një fushatë informuese për publikun.

4.2.2.2 Modifikimi i jonosferës dhe projektet ruso-kineze

Projekti HAARP, nuk është i vetmi që synon modifikimin e jonosferës. SURA është një projekt rus që vepron njëlloj si HAARP-i, i vendosur në qytetin Vasilsursk, 100 km në lindje të Nizhniy Novgorod, në Rusi. Qëllimi i tij është kërkimi shkencor lidhur me jonosferën. Në qershor të vitit 2018, për herë të parë SURA, bashkë me satelitin sizmo-elektromagnetik kinez (China Seismo-Electromagnetic Satellite, (CSES)), zhvilloi një seri eksperimentesh emetimi valësh radio me frekuencë të lartë, për të ndikuar jonosferën⁶⁶.

Profesori i fizikës, Dennis Papadopoulos, kryetar i komitetit shkencor të “Air Force Research Laboratory”, “Office of Naval Research”, dhe “Science Center of the University of Maryland”, është një nga pionierët e HAARP⁶⁷. Lidhur me këto eksperimente të kryera nga rusët dhe kinezët, ai është shprehur për mediet se “ajo që është bërë nuk ka ndonjë gjë emocionuese përveç faktit se Kina dhe Rusia kanë interes në këtë hapësirë”⁶⁸.

Të gjitha këto synime e projekte të përmendura deri këtu, kanë të përbashkët faktin se bëjnë ndërhyrje e modifikime të mjedisit. Lista e këtyre ndërhyrjeve dhe projekteve është e gjatë. *Epoka antropocene*, duket e përmes këtyre aktiviteteve njerëzore mbi mjedisin, e meriton plotësisht emrin. Në rastin konkret, ndërhyrjet që janë bërë e vazhdojnë të bëhen te klima e te mjedisi, shohin të angazhuara strukturat shtetërore, ushtarake e të inteligjencës, duke synuar që të shtojnë sigurinë kombëtare, të ruajnë interesat dhe të zgjerojnë ndikimin. Ky nuk është ndikim te klima, por është synim që të ruhet ndikimi mbi sistemin gjeopolitik. I vetmi dallim që shihet sot, është se hapësira gjeopolitike e ka kapërcyer atë tradicionale: toka dhe deti. Hapësira, jonosfera dhe çdo shtresë tjetër, janë që të gjitha pjesë të një skeme të re ku po zhvillohet një tjetër konkurrencë: lufta për zotërimin e mjedisit përmes shkencës.

5. Gjeopolitika, antropoceni dhe gjeoinxhinieria

Duke qenë se gjeopolitika tradicionale është kundërshtuar vazhdimisht e madje shpeshherë për shkak të determinizmit etj., në epokën që jetojmë rikthehet vëmendja nga lidhja e pandashme e njeriut me mjedisin. Ndikimi i njeriut mbi mjedisin ka si kundërvënje ndikimin e mjedisit mbi njeriun. Në këtë rast, pasojat mund të jenë të mëdha. Mjedisin mund të ndikojë një zhvillim tjetër të njerëzimit, zhvendosje popullesish, probleme globale dhe pse jo edhe një rrezik fatal për njerëzimin. Diskutimet për mbrojtjen e mjedisit, për sigurinë mjedisore dhe për ruajtjen e ekosistemeve, kanë fituar terren për shkak se kërcënimi që sjell dëmtimi i tyre, ka fituar terren po ashtu. Një dilemë e madhe është vënë përballë kësaj ruajtje të mjedisit nga shoqëritë e ndryshme

⁶⁶ Zhang; et al. “The first joint experimental results between SURA and CSES”. *Earth and Planetary Physics*. 2, 6, (December 2018) 1-8.

⁶⁷ Naval Research Laboratory (U.S.), *HAARP, Research and Applications: A Joint Program of Phillips Laboratory and the Office of Naval Research*, (Washington: Technical Information Division, Naval Research Laboratory, 1995)

⁶⁸ Dennis Papadopoulos, “Selections from interview with Dr. Dennis Papadopoulos, Senior Science Advisor, H.A.A.R.P.

Burimi elektronik:

<https://www.pbs.org/tesla/dis/papad.html>

në botë: të ruajnë metodat e deritanishme të prodhimit, zhvillimit, përdorimit të energjisë, apo t'i revolucionarizojnë të gjitha këto të fundit?

Në shkallën që ndihet sot ndikimi “antropogjenik” mbi natyrën, mund të themi se krahas faktorit njeri është edhe faktori i “kulturës së sigurisë” që ndikon. Një strategji botërore për t'u përballur me këto probleme klimatike mungon; mungon edhe një gjeopolitikë mjedisore globale e qartë; e vetmja qartësi që funksionon është zgjerimi i fuqisë dhe i ndikimit në arenën ndërkombëtare.

Stabilizimi i rregullave të reja gjeopolitike nuk mund të bëhet me mirëkuptim, vetëm nëse përballë globit vihet një kërcënim i përbashkët siç është kërcënimi klimatik dhe degradimi mjedisor botëror. Nëse ka ndërgjegjësim nga fuqitë kryesore mund të arrihet në një kompromis përmes sakrificës, mirëbesimit dhe mirëkuptimit ndërkombëtar. Por, nëse këto mungojnë, siç edhe eksperienca na ka treguar se ndodh zakonisht, atëherë kërcënimit global i duhet gjetur një “plan b”, që të mund të zëvendësojë “planin a” të një strategjie globale për ruajtjen e tokës nga njeriu. “Plani b” do të ishte gjeoinxhinieria. Një gjeopolitikë e shtetit, që nuk do të lëshonte për fuqinë kombëtare dhe pozicionin në arenën ndërkombëtare, a do të mund të kishte besim që ta linte trajtimin e kërcënimit global klimatik, në duart e shkencëtarëve apo në duart e shteteve të tjera? A mund të sjellë gjeoinxhinieria një garë tjetër mes fuqive kryesore si SHBA, Kinë, Rusi dhe BE?

Dikur, disa fise të indianëve të Amerikës së Veriut, pengjet gra që i kapnin në luftë me fiset e tjera, pasi i digjnin, ua merrnin eshtrat dhe i shpërndanin në tokat ku shpresonin të binin reshje, si një ritual⁶⁹. Atyre, nuk u dhimbsej jeta e fisit tjetër më shumë se sa reshjet e shiut. Për mbijetesë, cili do të ishte mekanizmi frenues sot, në botën moderne, që të mos kishte “sakrifica” për hir të fuqisë kombëtare, apo gjeopolitike? A ka mekanizëm që të mund të frenojë një shtet apo një grup shtetesh, të cilët synojnë të zhvillojnë modifikime mjedisore për interes të tyre? Pyetjet janë të shumta dhe lidhen të gjitha me sigurinë dhe gjeopolitikën, por mbi të gjitha me mjedisin. A po ndryshon gjeopolitika apo nuk është trajtuar akoma në gjerësinë e saj të plotë? Dikur, Friedrich Ratzel, në veprën e tij “Antropogjeografia” fliste për një trajtim shkencor të gjithë sistemeve jetike të globit, për një shkencë të shkencave, që të shihte të tëra sistemet të ndërlidhura dhe njeriun si pjesë e kësaj tërësie. Sot, duket sikur kjo gjë po rikthehet, pasi njeriu po shfaq interes që nga grimcat e karbonit, pjesëzat e jonosferës e deri te mikroorganizmat e oqeanëve.

Jemi në një udhëkryq të madh dhe ka pak kohë që të vendosim se cili do të jetë zhvillimi i të ardhmes për njeriun në planetin tonë, pasi degradimi i biosferës nuk të jep shanse shumë që të vetëriparohesh shpejt. Si do jetë rendi i ri që na pret? Një rend i sforcuar, me kontroll të rreptë dhe dhunë, apo do jetë një rend i ndërgjegjes, i humanizmit dhe teknologjisë, që do të lehtësojë jetën dhe do të emancipojë njerëzimin? Një gjë është e qartë: njeriu po lëviz drejt një ndërgjegjeje planetare, për shkak të kërcënimeve mjedisore dhe shndërrimit përfundimtar të gjeopolitikës në një sistem të mbyllur, i cili po e dëshmon këtë gjë me interesin për mjedisin.

6. Përfundime dhe rekomandime

Si vend i vogël dhe me problemet që kemi, nisur nga emergjenca e atyre që

⁶⁹ Halacy, *Weather Changers*, 61.

përmendëm më sipër, si proces shndërrues e transformues i globit, na lind nevoja që të kemi një strategji të zbatuar të sigurisë kombëtare, të saktë. Me qëllim përshtatjen me këto ndryshime, lind si nevojë që të avancohet në atë drejtim që mund të shtojë sigurinë dhe të pakësojë problematikat e mundshme të së ardhmes: në drejtim të shkencës.

- Reforma kryesore që nevojitet të kryhet në Shqipëri, është reforma e kërkimit shkencor, e cila duhet të trajtohet si çështje sigurie kombëtare.

- Kërcënimet mjedisore kanë një gamë të gjerë e cila duhet trajtuar nga shkencëtarë dhe ekspertë të cilët duhet të kultivohen në kohë.

- Studimet e sigurisë duhet të ngrihen në nivel shkencor pasi rrezja e gjerë e kërcënimeve të larmishme prek sot çdo individ.

- Ndërtimi dhe zbatimi serioz i një strategjie të sigurisë mjedisore, e gërshtuar me ngushtë me strategjinë e sigurisë kombëtare.

- Ndërtimi i një komuniteti shkencor në formë rrjeti, me universitetet e institutet e vendit, që të trajtojë çështjet e sigurisë, në planin e tyre më të gjerë.

- Të fuqizohen institutet shkencore që kanë lidhje me studimet sizmike, meteorologjike dhe të tërë gjeohapësirës shqiptare.

- Të krijohen strategji të përbashkëta të menaxhimit të emergjencave natyrore me Republikën e Kosovës.

- Të planifikohen burime të përbashkëta të menaxhimit të katastrofave natyrore, së bashku me Republikën e Kosovës.

- Të ndërtohet një projekt ku të përzgjidhet një bërthamë shkencëtarësh apo kërkuesish të rinj, të cilët të arsimohen e specializohen në institucione të mirënjohura botërore, me qëllim thithjen e eksperiencës dhe të vihet themeli i një politike që synon zhvillimin e qëndrueshëm me kryefjalë mjedisin dhe geografinë njerëzore.

- Të krijohet dhe të zbatohet, një strategji afatgjatë e shfrytëzimit të burimeve në Shqipëri duke pasur parasysh degradimin mjedisor dhe raportin me përfitimin nga shfrytëzimi i këtyre burimeve.

- Të ndërtohet një gjeopolitikë shqiptare.

Bibliografi

LITERATURË

1. Strati, Enver. *Historiku i Kallararit*, red. Rami Memushaj. Tiranë: 2010.
2. Halacy, Daniel Stephen. *The Weather Changers*. New York: Harper & Row, 1968.
3. Laubin, Reginald dhe Gladys Laubin. *Indian Dances of North America: Their Importance to Indian Life*. Oklahoma: University of Oklahoma Press, 1989.
4. Guiley, Rosemary Ellen. *The Encyclopedia of Witches, Witchcraft & Wicca, Volume 1*. New York: Infobase Publishing, 2008.
5. Frazer, James George. *The Golden Bough: A Study in Magic and Religion*, reprint. New York: Cosimo, Inc., 2009.
6. Harari, Yuval Noah. *Homo Deus: A Brief History of Tomorrow*. New York : Harper, 2017.
7. Rull, Valentí. "The 'Anthropocene': neglects, misconceptions, and possible futures", *EMBO Reports*, 18/7, (Jul. 2017): 1056-1060.
8. Dukes, Paul. *Minutes to Midnight: History and the Anthropocene Era from 1763* (Anthem Press, 2011), 2.
9. Kelly, Jason M. et. al. (red.). *Rivers of the Anthropocene*. California: University of California Press, 2018.
10. Zalasiewicz, Jan dhe Paul Jozef Crutzen, Will Steffen. "The Anthropocene", në *The Geologic Time Scale 2012*, red. F. M. Gradstein et. al. Amsterdam: Elsevier, 2012.
11. Crutzen Paul J. dhe Eugene F. Stoermer. "The 'Anthropocene'", në *News Letter, The International Geosphere-Biosphere Programme (IGBP): A Study of Global Change of the International Council for Science (ICSU)*, nr. 41 (2000).
12. Great Britain Parliament. *House of Commons, Science and Technology Committee, The regulation of Geoengineering: fifth report of session 2009-10, report, together with formal minutes, oral and written evidence*, red. Phil Willis. London: The Stationery Office, 2010.
13. Gavrilov, Milivoj B. et al. "Is hail suppression useful in Serbia? General review and new results", në *Acta geographica Slovenica*, (53-1, 2013):165-179.
14. Vukelic, Gordana et al. "Anti-Hail Protection-Assessment of Financial Effects on the Territory of Belgrade" në *Sustainability* (2018, 10, 1239).
15. Brzezinski, Zbigniew. *Between two Ages, America's Role in the Technetronic Era*. New York: The Viking Press, 1970.
16. MacDonald, Gordon J. F. "Space", në *Toward the Year 2018*. Chicago: Cowles Education Corp., 1968.
17. Brumfiel, Geoff. "Shared Intelligence, The military has a vast array of scientifically valuable data – some more accessible than you think", *Nature*, vol. 477, 22 (September 2011).
18. United States Congress, Senate, Committee on Commerce. *Weather Modification: Hearings, Eighty-ninth Congress, First and Second Sessions, on S. 23 and S. 2916, Parts 1-2*. Washington: U.S. Government Printing Office, 1966.
19. United States, Congress, Senate. Foreign Relations, *Prohibiting Military Weather Modification: Hearings Before the Subcommittee on Oceans and International Environment of the Committee on Foreign Relations United States Senate, 92-2, on S. Res. 281, July 26 and 27, 1972*. Washington: U.S. Government Printing Office 1972.
20. United Nations. "Convention on the prohibition of military or any other hostile use of environmental modification techniques" *Treaty Series*, vol. 1108, and depositary notification C.N.263.1978.TREATIES-12 of 27 October 1978. New York: United Nations.
21. LaSalle, Brendan J. "Editorial Reviews", në Stanislav Lunev, *Through the Eyes of the Enemy*. Washington: Regnery Publishing, Inc. 1998.
22. Lunev, Stanislav. *Through the Eyes of the Enemy*. Washington: Regnery Publishing, Inc. 1998.
23. MacDonald, Gordon J. F. "How to Wreck the Environment," in Nigel Calder (red.), *Unless Peace Comes* New York: Viking, 1968.
24. Jeffrey, Jason. "Earthquakes: Natural or Man-made?" në *New Dawn No. 57*, November-December 1999.
25. Zhang; et al. "The first joint experimental results between SURA and CSES". *Earth and Planetary Physics*. 2, 6, December 2018:1-8.
26. Naval Research Laboratory, U.S. *HAARP, Research and Applications: A Joint Program of Phillips Laboratory and the Office of Naval Research*. Washington: Technical Information Division, Naval Research Laboratory, 1995.

BURIME ELEKTRONIKE

27. CIA, "CIA Opens Center on Climate Change and National Security", *Historical Document* (CIA, 25 shtator 2009, rifreskuar, 29 prill 2013).
Burimi elektronik: <https://www.cia.gov/news-information/press-releases-statements/center-on-climate-change-and-national-security.html>
28. Aftergood, Steven. "At CIA, Climate Change is a Secret", (FAS, 2011).
Burimi elektronik: https://fas.org/blogs/secrecy/2011/09/cia_climate/
PRI, "CIA closes down intelligence center focused on climate change", *Public Radio International*, December 06, 2012.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

- <https://www.pri.org/stories/2012-12-06/cia-closes-down-intelligence-center-focused-climate-change>
29. Broad, William J. "C.I.A. Is Sharing Data With Climate Scientists", *The New York Times*, Jan. 4, 2010.
<https://www.nytimes.com/2010/01/05/science/earth/05satellite.html>
30. Sample, Ian. "Spy agencies fund climate research in hunt for weather weapon, scientist fears", *The Guardian*, (15 Feb. 2005).
Burimi elektronik:
<https://www.theguardian.com/environment/2015/feb/15/spy-agencies-fund-climate-research-weather-weapon-claim>
31. National Geographic, "Anthropocene", *Resource Library, Encyclopedic Entry*.
Burimi elektronik:
<https://www.nationalgeographic.org/encyclopedia/anthropocene/>
32. Kintisch, Eli. "The Geopolitics of Geoengineering", *MIT Technology Review* (Dec 17, 2013)
<https://www.technologyreview.com/s/522676/the-geopolitics-of-geoengineering/>
33. The Royal Society. *Geoengineering the climate: science, governance and uncertainty*. London: The Royal Society, 2009.
Burimi elektronik:
https://royalsociety.org/~media/royal_society_content/policy/publications/2009/8693.pdf
34. Oxford Martin School, "What Is Geoengineering?", *Oxford Geoengineering Programme*, (University of Oxford).
Burimi elektronik:
<http://www.geoengineering.ox.ac.uk/www.geoengineering.ox.ac.uk/what-is-geoengineering/what-is-geoengineering/>
35. 3D s.a. *Weather Modification*.
Burimi elektronik: <https://www.3dsa.gr/en/activities-en/weather-modification>.
36. NCAR, Research Applications Laboratory. "Turkey, Cloud And Aerosol Research In Istanbul. Burimi elektronik: <https://ral.ucar.edu/projects/turkey-cloud-and-aerosol-research-in-istanbul>
37. Cohen, William S. "DoD News Briefing: Secretary of Defense William S. Cohen", April 28. U.S. Department of Defense, 1997.
Burimi elektronik:
<https://archive.defense.gov/Transcripts/Transcript.aspx?TranscriptID=674>
38. European Parliament. "The HAARP Project and non-lethal weapons. Experts alarmed - public debate needed". Brussels, 9th February 1998.
Burimi elektronik:
<https://www.europarl.europa.eu/press/sdp/backg/en/1998/b980209.htm#1>
39. Papadopoulos, Dennis. "Selections from interview with Dr. Dennis Papadopoulos, Senior Science Advisor, H.A.A.R.P.
Burimi elektronik:
<https://www.pbs.org/tesla/dis/papad.html>

ARKIVA, CIA, (NGA: FOIA, WWW.CIA.GOV)

40. JPRS. *Earthquakes in the USSR in 1974*.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP82-00850R000100060003-1.
41. Godu, I. Gorbunova, N. Kondorskay, N. Shebalin, red. *Zemletryasenia v SSSR v 1973*. Moscow: Nauka, 1976.
42. Heseltine, Nate. "U.S. Seriously Concerned; Cold War May Spawn Weather Control Race". *Washington Post*, dhe *Times Herald*, December 23, 1957.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP33-02415A000200350078-5.
43. Chief, Astro-Geophysics Branch, GSD/Sl. *Memorandum to: Chief, General Sciences Division. Subject: Weather Modification. (7 October 1965)*.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.
44. Johnson, Lyndon B. "White House, Washington, September 14, 1965".
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.
45. *Memorandum for the President*, "The weather services...", September 13, 1965.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP68R00530A000200110020-2.
46. Raborn, William F. "Weather: Warfare's Next Weapon? Admiral Predicts Arsenal of Storms, Icebergs, and Fog", National Observer, January 21, 1963.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP75-00001R000100070096-5.
47. Collection Branch Reconnaissance Group, IRS. *U-2 Support for Weather Modification Experiments. Memorandum from Recon Group, IRS to DSA*. 18 January 1973.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP33-02415A000400240028-0.
48. *Soviet Weather Control*, 24 February 1959.
Document Number (FOIA) / ESDN (CREST): CIA-RDP79R00890A001100020012-0.



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »**



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

~ *Sesioni II* ~

Krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri:
kuadri ligjor dhe institucional, eksperiencia
ndërkombëtare në këtë fushë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

219

Legjislacioni mjedisor dhe llojet e veprave penale kundër mjedisit.

Faktorët që krijojnë terren për zhvillimin e dukurisë së krimit mjedisor, në nivel vendor.



■ **Inxh. MSc. Petrit IMERAJ**

Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bunë,
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
pimeraj@yahoo.com

Abstrakt

Karakteristikat e legjislacionit mjedisor shqiptar janë se ai është kryesisht një legjislacion krejt i ri, i hartuar në këto 15 vitet e fundit; është në përputhje me kushtetutën dhe i harmonizuar me ligjet e fushave të tjera; i përgjigjet deri diku problemeve që i ka ngritur praktika; ka përthithur kërkesat e konventave ku ne jemi pale; është përgjithësisht i përfaqësuar dhe i harmonizuar me kërkesat e BE-së; është i te njëjtit nivel me zhvillimin e fqinjët me vendete rajonit dhe është në proces plotësimi e përafrimi. Krimet mjedisore fusin një perspektivë krejt tjetër në sistemin penal në Shqipëri, ndërsa krimet e tjera përbëjnë shkak për prishje të stabilitetit social. Krimet mjedisore janë një rrezik për vete qeniet njerëzore duke nxjerrë në pah elementet e mbijetesës. Pavarësisht veprimeve apo mosveprimeve në Shqipëri, ndihet se ka veprime që sjellin pasoja të rënda në shoqëri, dhe është koha ku krimet në mjedis kërkojnë një përgjigje të fortë institucionale dhe reagim të shoqërisë civile dhe të mbarë shoqërisë. Kjo ka qenë një nga arsytet që disa vende kanë ashpërsuar politikën penale për krimet kundër mjedisit dhe reflektim në formimin dhe krijimin e strukturave në përgjigje të tij. Artikulli trajton pikërisht qasjen që legjislacioni mjedisor ka ndaj llojeve të veprave penale kundër mjedisit duke u fokusuar në mënyrë specifike te faktorët që krijojnë terren për zhvillimin e dukurisë së krimit mjedisor, në nivel vendor.

Fjalëkyçe:

legjislacioni mjedisor, veprave penale kundër mjedisit, krimi mjedisor, pushteti vendor

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Kuadri ligjor për mjedisin është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe përbëhet nga ligje dhe akte normative, si vendimet e Këshillit të Ministrave, aktet ministrore, rregulloret, udhëzimet, standardet, konventat etj¹. Misioni kryesor është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit për brezat e sotme dhe të ardhshëm. Përbërja e legjislacionit konsiston në: Kushtetutën e Shqipërisë, kreu V “Objektivat socialë”, neni 59, pika 1 germa “d”, dhe “dh”, ligje, vkm, koventa, *aquis* i BE-së. Karakteri kombëtar i ligjit lidhet kryesisht me strukturën vertikale, e cila rregullon marrëdhëniet ndërinstitucionale: Parlamenti, qeveria dhe sistemi gjyqësor². Ai përcakton rregulla detyruese për të gjithë; rregullon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe qytetareve të tij, personave fizikë dhe juridikë si dhe përcakton formën e zbatimit, përcakton sistemin e monitorimit, gjykatat dhe detyrimet/sanksionet. Përbërja dhe principet e legjislacionit mjedisor të BE-së, detyrimet që na dalin neve si vend janë të renditura si në vijim: legjislacioni horizontal (7 direktiva, 1 rekomandim); cilësia e ajrit (6 direktiva); menaxhimi i mbetjeve (10 direktiva, 2 rregullore); cilësia e ujit (11 direktiva, 1 vendim); mbrojtja e natyrës (3 direktiva, 4 rregullore); kontrolli i ndotjes industriale (3 direktiva, 3 rregullore); kimikatet (2 direktiva, 5 rregullore); zhurmat (1 direktivë); ndryshimet klimatike (4 direktiva, 5 rregullore, 2 vendime).

Principet bazë janë: zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi, mbrojtja në nivel të lartë, principi i përkujdesjes, principi i masave parandaluese. Dëmi duhet ndreqet në burim sipas parimit “ndotësi paguan”. Krahas parimeve, të cilat janë orientuese, janë edhe

¹ <https://qbz.gov.al/eli/bnjz>

² <http://www.ligjet.org/>

detyrimet. Në kuadër të MSA-së Shqipëria ka detyrimin që të përafrohet me standardet e BE-së (*acquis*) edhe në fushën e mjedisit. Një sërë ligjesh mjedisore janë përafuar. Mbeten mangësi veçanërisht në fushën e mbetjeve; fushën e shfrytëzimit të burimeve natyrore; fushën e miratimit të legjislacionit penal të përshtatshëm dhe fusha të tjera specifike. Megjithatë, problem kryesor shqiptar nuk është mangësia e legjislacionit, por zbatimi. Ka plot raste kur ekzistojnë dhe ligjet dhe aktet nënligjore/procedurat, por shkeljet nuk ndiqen. Në fazën e hapjes së negociatave do të analizohet jo thjesht përafrimi i legjislacionit, por zbatimi real i tij; ndaj Shqipëria duhet ta nisë këtë proces sa më shpejt³.

Përafrimi është një term që shpesh ngatërrohet me termin "transpozim". Përafrimi i legjislacionit parashikon tre hapa: "transpozim" (shqip: "zhvendosje, ndërrim vendesh"), zbatim, forcim. Pjesa kryesore që monitorohet është "transpozimi" dhe zbatimi i legjislacionit. Transpozimi matet me tabela përputhshmërie, ndërsa zbatimi me pyetësorë zbatueshmërie.

Karakteristikat e legjislacionit mjedisor shqiptar janë se ai është kryesisht një legjislacion krejt i ri, i hartuar në këto 15 vitet e fundit; është në përputhje me kushtetutën dhe i harmonizuar me ligjet e fushave të tjera; i përgjigjet deri diku problemeve që i ka ngritur praktika; ka përthithur kërkesat e konventave ku ne jemi pale; është përgjithësisht i përfaqësuar dhe i harmonizuar me kërkesat e BE-së; është i te njëjtit nivel me zhvillimin e fqinjët me vendete rajonit dhe është ne proces plotësimi e përafrimi.

2. Kriminaliteti mjedisor dhe veprat penale kundër mjedisit

2.1 Kriminaliteti mjedisor në Shqipëri

Kriminaliteti mjedisor është forma më e lartë, një shqetësim që arrihet me marrëdhëniet ndërmjet mjedisit, rrezikut të korrupsionit, duke i hapur krah trafikimit të burimeve natyrore deri në shterimin e tyre. Kjo gjenerohet nga politika jo e drejtë për mjedisin, zhvillimin e praktikave dhe politikave të dëmshme për mjedisin duke i shpërndare jo në mënyrë të drejtë te burimet mjedisore. Parandalimi (minimizimi dhe ndëshkimi) krimeve kundër mjedisit i mbyll rrugën degradimit të mjedisit dhe inkurajon përpjekjet më të gjera duke u përfshirë në aktivitete mjedisore, për të kuptuar më mirë ndikimin që kanë krimet dhe korrupsioni në mjedis, dhe për të kontribuar në zvogëlimin e këtij problemi shoqëror". Qasja në nivel rajonal dhe lokal ndaj këtij problemi do të thotë të njohësh më mirë situatën, duke shmangur rreziqet në vlerësimin real në sektorin e mjedisit në Shqipëri dhe përpjekjet për të kapur pikëpamjet e palëve të interesuara, për implikimet kryesore të politikave mjedisore dhe shkallën e zbatimit të masave antikorrupsion e antikrim mjedisor. Nevoja për ndërmjetësim sa vjen dhe bëhet më shumë e rëndësishme, pasi shumë komunitete po shmangen nga procesi i vendimmarrjes, dhe vendimet e marra, janë burim konflikti mes palëve. Kjo sfidë e përbashkët e të gjithë aktorëve është shumë e rëndësishme për të shmangur problemet të cilat mund të çojnë në shterimin e mjedisit dhe në mungesë të financimeve dhe ulje të intensitetit bashkëpunues nga ana e organizmave ndërkombëtar, dhe shtimin e konfliktit mes palëve.

Krimet mjedisore fusin një perspektivë krejt tjetër në sistemin penal në Shqipëri,

³ <https://qbz.gov.al/eli/bnjz>

ndërsa krimet e tjera përbëjnë shkak për prishje të stabilitetit social. Krimet mjedisore janë një rrezik për vete qeniet njerëzore duke nxjerrë në pah elementet e mbijetesës. Pavarësisht veprimeve apo mosveprimeve në Shqipëri, ndihet se ka veprime që sjellin pasoja të rënda në shoqëri, dhe është koha ku krimet në mjedis kërkojnë një përgjigje të fortë institucionale dhe reagim të shoqërisë civile dhe të mbarë shoqërisë⁴.

Kjo ka qenë një nga arsytet që disa vende kanë ashpërsuar politikat penale për krimet kundër mjedisit dhe reflektim në formimin dhe krijimin e strukturave në përgjigje të tij. Një strukturë e aftë për tu ballafaquar me dëmtimet e rënda mjedisore, është një pozicionim i duhur për këtë qëllim. Në vështrimin historik administrimi i mjedisit dhe burimeve natyrore nuk ka pasur asnjëherë një qëndrueshmëri si një e vetme, por mbas viteve '90 nevojat për administrimin e vlerave natyrore kanë ardhur në rritje, si dhe iniciativat ligjvënëse në fushën e mjedisit nuk kanë munguar, por duke mos pasur një administratë të qëndrueshme, qartësi në format e administrimit, korrupsion dhe indiferencë qytetare, këto ligje kanë hasur dhe po hasin vështirësi në zbatimin e tyre. Sot, kur kemi struktura të reja MM, një pushtet të saporeformuar vendor të cilit do t'i transferohen pasuri të mëdha natyrore siç janë pyjet kullotat etj., kjo situatë nxjerr si detyrë një nevojë të koordinimit mes të gjithë aktorëve. Në 20 vitet e fundit janë zhdukur 120 mijë ha pyje. Kjo deklaratë vjen nga ana qeverisë, por shifra është shumë më e madhe në fakt. E lexuar kjo shifër në nivel vendore, do të thotë se shumë zona janë në rrezik shkretimi dhe nuk mund të rigjenerohen. Një problem i madh janë dëmtimet në zonat e mbrojtura dhe ligatinore që bëjnë që shume zonave mund tu rrezikohet statusi i tyre sipas standardeve që kërkon Bashkimi Evropian.

Pozita juridiko-administrative e disa strukturave shtetërore, një shoqëri civile e përgjumur, mosrespektimi i ligjit dhe në disa raste vakuumi i ligjit dhe i akteve nënligjore, mungesa e përfshirjes së komunitetit në procesin e vendimmarrjes, paqartësitë e ndryshme kanë bërë që strukturat të veprojnë të shkëputura nga njëra-tjetra dhe mos të kenë të qartë detyrimin funksional, administrativ që buron nga ligji, dhe shuëe organizma janë larg misionit të tyre.

Korrupsioni dhe paaftësia, janë një problem kyç për të ardhmen e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore⁵.

Sipas raporteve, amendamentet kushtetuese shqiptare kanë vendosur kufizime për imunitetin e zyrtarëve publikë të nivelit të lartë dhe gjyqtarëve, por këto ndryshime ende nuk kanë çuar në ndonjë rast sipas dispozitave të reja (Komisioni Evropian, 2013). Përveç kësaj, përpjekje të mëtejshme për luftën kundër korrupsionit, "duke përfshirë krijimin e një historiku solid të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve" janë të nevojshme, për të përmbushur prioritetet (Raporti i Progresit, 2013 e në vijim). Prioritet për arritjen e aspiratës publike shqiptare për të ecur drejt standardeve të Bashkimit Evropian (Komisioni Evropian, 2013). Në këto kushte qasja rajonale dhe lokale e problemit sa vjen dhe bëhet më e rëndësishme. Nisur nga ana e situatës së mësipërme është shumë e rëndësishme që të kemi një reflektim për situatën e pyjeve dhe mjedisit, marrëveshje të përbashkëta, iniciativa për zgjidhje në kohë të konflikteve mjedisore, rivlerësim të situatës në terren dhe nxjerrja e produkteve në ndihmë të strukturave të cilat janë sa më afër vendit ku ndodh ngjarja apo dëmi mjedisor dhe

⁴ <http://www.themisnetwork.eu/tools/standard-operating-procedures/albania/general-sop/criminal-enforcement.html>

⁵ Standard Operating Procedures (SOPs) to prevent, detect and investigate environmental crimes. Create Standard Operating Procedures (SOPs) to prevent, detect and investigate environmental crimes for Albania. <http://www.themisnetwork.eu/about-themis/contacts.html>

sigurimi i transparencës për qytetaret për vendimet e gjykatës dhe denoncimet në prokurori.

Ne morëm në analize një sërë dokumentesh të rëndësishme në kohë dhe hapësirë (2013-2014), për të pasur një pikë reference për t'i dhënë vlerësimin e duhur situatës ku ne ndodhemi. Kjo analizë na qartëson që të nxjerrim sa më shpjet përgjegjësitë e duhura, e kryesisht ato penale. Përgjegjësia penale ndryshon nga përgjegjësia civile dhe administrative.

Ndëshkimi penal është më stigmatizues për individin dhe rrit vëmendjen e shoqërisë ndaj një çështje të caktuar. Masat e ndëshkimit shkojnë përtej dëmshpërblimit monetar, gjobave, ndalimit të ushtrimit të aktivitetit dhe hyjnë në sferën e kufizimit të lirive individuale⁶.

2.2. Veprat penale mjedisore^{7, 8, 9}

Veprat penale mjedisore sipas kodit penal shqiptar, janë si në vijim: neni 201, *Ndotja e ajrit*: e kufizuar për gazra dhe lëndë toksike radioaktive; neni 202, *Transportimi dhe depozitimi i mbeturinave toksike*: kufizuar tek mbeturinat toksike dhe radioaktive; neni 20/3 *Ndotja e ujërave*: me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik (më e gjerë); neni 204, *Peshkimi i ndaluar*: përgjegjësi shumë e shtrirë pa përkufizuar sasi (p.sh. mund të dënohet edhe një peshkatar individ)/ pozitiv dënimi i peshkimit me eksploziv dhe lëndë helmuese; neni 205, *Prerja e paligjshme e pyjeve*: i jepet përparësi kundërvajtjes administrative dënim relativisht i ulët; neni 206, *Prerja e drurëve dekorativ dhe frutorë*: dënime të lehta gjobë dhe burgim deri në 3 muaj; neni 207, *Shkatërrimi me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor* (futur në vitin 2008): dënime mjaft të ashpra 10-20 vjet. Mungojnë dënimet penale për mbetjet e vendit; ndotjet industriale si vepër penale e posaçme; ndotjen e tokës që është problem madhor. Dispozitat ekzistuese duhen riformuluar dhe duhet të realizohet projekti për miratimin e legjislacionit penal.

3. Shembuj real në praktike¹⁰

- Shembull mosfillimi

Më datë 17.11.2017, rreth orës 18:00, në aksin rrugor Cukal-Drisht, pikërisht sipër fshatit Drisht, njësia administrative Postribë, Bashkia Shkodër, shërbimet e policisë së komisarariatit....., gjatë kontrollit rutinë, kanë ndaluar automjetin kamion, tip "IFA" me targë _____, i ngarkuar me lëndë drusore (dru zjarri) i cili drejtohej nga shtetasi _____, banues në fshatin, njësia administrative rrethina. Kamioni së bashku me materialin drusor është sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe lënë në ruajtje në ambientet e _____. Sipas aktit të ekspertimit nr. 5 datë..... ekspertët e Drejtorisë së Menaxhimit Pyjeve dhe Kullotave në Bashkinë....., kanë dhënë *konkluzionin se*: sasia e lëndës drusore e ngarkuar në automjetin tip "IFA" me targa _____, është 10 mst dru zjarri të llojit lis. Nga studimi i materialeve të para hetimore të referuara nga komisarati i policisë.....,

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

⁶ <http://www.ligjet.org/>

⁷ https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf

⁸ <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-shkod%C3%ABr/gjykata-e-rrethit-shkod%C3%ABr/>

⁹ <http://www.pp.gov.al/>

¹⁰ <http://www.bashkiashkoder.gov.al>

rezultun se nuk plotësohen kërkesat ligjore për t'u regjistruar procedim penal, prandaj dhe duhet vendosur mosfillim i procedimit penale, pasi: nga analiza e faktit dhe të dhënat e grumbulluara, konkludohet se fakti objekt hetimi nuk përmban elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 205 i kodit penal, ku sanksionohet: *“Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”* Sa më sipër arrihet në konkluzionin se nuk provohet ekzistenca e veprës penale të parashikuar nga neni 205 i kodit penal, pasi fakti përbën kundërvajtje penale. Për këto arsye në bazë të neneve 290 /1 germa “ç”, dhe 291/1/2 të kodit të procedurës penale¹¹.

- Shembull pezullimi

Më datë 15.5.2017 rreth orës 10:30, është njoftuar salla operative e komisariatit të policisë nga shërbimi pyjor i Bashkisë, për shkak se në ekonominë pyjore “.....”, në malin e Shoshit kanë konstatuar një sasi lëndë drusore të prerë në mënyrë të paligjshme. Në lidhje me këtë ngjarje, nga policia gjyqësore janë kryer veprimet e para hetimore, ku janë pyetur shtetasit dhe, punonjës të shërbimit pyjor të Bashkisë, të cilët kanë shpjeguar se në datën 15.5.2017 kanë ushtruar kontrole në ekonominë pyjore “Shosh 2-2”, në Malin e Shoshit dhe në parcelat me nr. 35 dhe 36 kanë konstatuar tre kamionë tip “IFA”, dy prej të cilëve ishin pa ngarkesë, kurse tjetri ishte i ngarkuar me një sasi të vogël materiali drusor. Afër këtyre mjeteve është konstatuar një sasi prej 8 m³ materiale drusor të prerë, të rrezuar dhe bërë gati për transport. I pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale, Përgjegjësi i Sektorit Pyjor pranë Bashkisë, shtetasi ka deklaruar se: “Në përmbushje të detyrës funksionale, më datë 15.5.2017, kemi ushtruar kontroll në ekonominë pyjore “Shosh -2-2”. Gjatë kontrollit në parcelat me nr. 35-36 rrugës për në Dushman, kemi konstatuar një makinë tip “IFA” me targë AA 473 KJ e cila ishte e ndodhur në cep të rrugës e parkuar dhe pa shofer, dhe pa material drusor të ngarkuar. Në tërësinë e veprimeve hetimore, provohet fakti i ndodhur, prerja e paligjshme në pyje “të parashikuar si kundërvajtje nga neni 205 i kodit penal. Megjithëse janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore nuk është arritur të bëhet identifikimi i autorit/vë të kësaj ngjarje. Në këto rrethana çështja duhet pezulluar dhe aktet t'i kalojnë Seksionit të hetimit në komisariatit e policisë për hetime të mëtejshëm në lidhje me zbulimin e autorit/vë të veprës penale.

- Vendim pushimi

Me dt. 30.7.2017, në fshatin Postribë, shtetasit me profesion gazetar i janë dëmtuar me dashje gomat e automjetit të markës “Mercedez Benz”, në ngjyrë krem, me targë, me mbishkrimin “.....”. Rezulton se gazetari në fjalë po udhëtonte me pjesëtarët e familjes së tij në drejtim të Prekalit. Në një segment të dëmtuar të rrugës, kishte zbritur duke vënë re se rruga ishte bllokuar nga disa kamionë të ngarkuar me lëndë drusore. Ai kishte filluar të filmonte me celularin e tij. Pas këtij veprimi kishin zbritur nga kamionët rreth 15 persona duke i kërkuar të

¹¹ <http://www.themisnetwork.eu/tools/standard-operating-procedures/albania/general-sop/criminal-enforcement.html>

fshinte filmimet. Refuzimi i tij është bërë shkak që drejtuesi i kamionit të parë i shoqëruar edhe nga persona të tjerë, të shkonin tek mjeti i gazetarit, duke çarë gomat me prerje të përmasave nga 5 cm deri në 10cm.

Debatet lidhur me filmimin dyshojnë se drejtuesit (ose poseduesit) e mjeteve që po transportonin dru zjarri refuzonin të filmoheshin nga shtetasi gjë e cila lë për të dyshuar se këtë aktivitet e kishin në mënyrë të kundërligjshme siç është ajo e «Prerjes së paligjshme në pyje» parashikuar nga neni 205 i kodit penal. Në këto rrethana ka dalë e nevojshme kryerja e veprime të tjera hetimore për këtë vepër. Prandaj dhe çështja, është veçuar nga ajo e regjistruar me nr. 1304 për veprën penale të «Shkatërrimit të pronës» sipas nenit 150 kodit penal. Në tërësinë e veprimeve hetimore, është provuar, fakti i ndodhur, regjistruar me nr. 1304 për veprën penale të «Shkatërrimit të pronës» sipas nenit 150 kodit penal. Në këto rrethana, është kërkuar gjykatës së shkallës së parë Shkodër, pushimi i çështjes, pasi vlera e dëmit nuk ka pasojë të rënda, kërkesë e cila është pranuar. Me vendimin nr....., Gjykata e rrethit gjyqësor Shkodër ka vendosur pushimin e çështjes penale nr.....

Për sa më sipër, bazuar në nenin 328 pika 1 germa “b”, e kodit të procedurës penale,

Vendosa:

të pushoj hetimet për procedimin penal, të vitit 2017, për veprën penale “Prerja e paligjshme në pyje” parashikuar si kundërvajtje penale nga neni 205 i kodit penal, pasi fakti nuk parashikohet në ligj si vepër penale.

- Dërgim çështjes në gjyq për 205 ^{12,13}

Më datën 8.5.2011, në fondin pyjor kombëtar, ekonomia pyjore Koms, ngastra nr. 51/a dhe konkretisht në vendin e quajtur “Rrahu i Gjokës”, shtetasi Martin (Zenel), ka prerë në mënyrë të kundërligjshme, pa leje të organeve kompetente, drurë pyjorë të llojit ah 120 copë, me diametër nga 0.1 deri në 20 cm. Vlera e dëmit të shkaktuar është 960 000 lekë. Pas verifikimit, të konfirmuar edhe nga DSHP Mat, rezulton se kjo parcelë përfshihet në VKM nr. 108 datë 27.1.2009 pika “e” dhe dëmtimi i shkaktuar konsiderohet me pasojë të rënda në fondin pyjor.

Dispozita penale për këtë vepër parashikon dënim me gjobë dhe burgim. Lidhur me llojin dhe masën e dënimit mendoj që gjykata duhet të marrë parasysh në kompleksitet ato të parashikuara në nenin 48 dhe 49 kodit penal. Faktin që zona ku është bërë prerja e paligjshme hyn në VKM nr. 108 datë 27.1.2009 si zonë e veçantë dhe dëmi i shkaktuar konsiderohet pasojë e rëndë. Po kështu, mendoj se duhet të merret në konsideratë fakti se i pandehuri ka pranuar akuzën, ka shprehur pendim të thellë dhe ka dhënë shpjegime lidhur me arsyen e prerjes: për shkak të gjendjes ekonomike e familjare, - dhe është i padënuar me parë. Sa më sipër, duke konsideruar hetimin gjyqësor të plotë, akuzën në ngarkim të së pandehurit të provuar plotësisht, bazuar në nenin 378 kodit të procedurës penale, parashatroj para gjykatës këtë:

Kërkesë

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën e “Prerjes së paligjshme në pyje” dhe në bazë të nenit 205 kodit penal dënimin e tij me gjobë në

¹² <http://www.pp.gov.al/>

¹³ <http://www.bashkiashkoder.gov.al>

shumën 180 000 (njëqind e tetëdhjete mije) lekë.

Dërgim i çështjes në gjyq, për 204

Më datën 14.8.2015 rreth orës 14:00, forcat e policisë kufitare Shkodër, të dislokuara me shërbim në vendin e quajtur Lumi Buna, nga grykëderdhja deri në afërsi të fshatit Rec- Velipojë nga ora 06:00 deri në orën 18:00, i përbërë nga punonjësit e policisë..... kanë konstatuar se rreth orës 10:30 në afërsi të grykëderdhjes së Lumit Buna, të pandehurit....., me një mjet lundruar të ndryshkur dhe motor të vogël, duke lëvizur përmes Lumit Buna deri në grykëderdhjen e saj, ku njëri prej personave ka bërë hedhjen e lëndës plasëse. Pas 10 min, rreth orës 14:20 personi që mbante kapelën e bardhë, i pandehuri, ka filluar të mblihdhte peshk me kacare, ndërsa i pandehuri i pajisur me mjete zhytëse, zhytej në thellësi dhe nxirrte peshk mbi sipërfaqe. Ndërkohë kanë ndërhyrë forcat e policisë që ndodheshin në mjetin lundruar dhe janë afruar rreth 20-30 m duke bërë thirrje “Ndal, policia!”, ndërkohë shtetasi..... është hedhur në ujë duke u larguar me shpejtësi në breg, e duke u larguar nëpërmes shkurreve, ndërsa shtetasi që ndodhej në ujë është zhytur dhe ka dalë në breg nëpër kallamishte. Të favorizuar nga shkurret dhe kallamishtet nuk është bërë e mundur kapja e tyre. Pavarësisht nga qëndrimi i tyre fakti dhe autorësia e veprës penale u provua. Në rrethanat e mësipërme, të pandehurit në bashkëpunim njëri me tjetrin kanë konsumuar tërësisht elementët e veprës penale “Peshkimi i ndaluar”, të parashikuar si kundërvajtje penale nga neni 204/1 e 25 i kodit penal. Nga ana e të pandehurve gjatë këtij gjykimi nuk u paraqit asnjë provë apo kontestim ndaj atyre të paraqitura nga përfaqësuesi i akuzës.

1. Deklarimin fajtorë të të pandehurit për veprën penale “Peshkimi i ndaluar” kryer nën bashkëpunim, dhe në bazë të nenit 204/1 e 25 të kodit penal, dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim.

2. Deklarimin fajtorë të të pandehurit “Peshkimi i ndaluar” kryer nën bashkëpunim, dhe në bazë të nenit 204/1 e 25 të kodit penal, dënimin e tij me 3 (tre) muaj burgim.

3. Në bazë të nenit 190 kodit të procedurës, prova materiale: një mjet lundruar, varkë metalike e pamatrikulluar; një motor të markës “Merkuri” 2.2 HP; një rrjetë peshkimi dhe një lopatë druri të sekuestruar sipas procesverbalit të lënies në ruajtje të datës 14.8.2015 të kalojnë në favor të shtetit. Ndërsa, sasia prej 16 copë peshk të llojit “Levrek”, në sasinë prej 6 kg të asgjësohet.

4. Shkaqet dhe problematikat e legjislacionit penal shqiptar

4.1 Shkaqet:

- investimet e pakontrolluara të biznesit, përfshirë aktivitetin bujqësor;
- shfrytëzimi i pakontrolluar i burimeve natyrore;
- moskoordinimi i qeverisjes qendrore dhe asaj vendore në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit;
- mosmbledhja dhe mospërpunimi i mbetjeve industriale, si në zonat urbane edhe në ato rurale;
- përdorimi i rrugëve, lumenjve dhe liqeneve si pika hedhjeje të mbetjeve të prodhuara nga operatorët e bizneseve familjare;

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:
« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

- moskontrollimi i përdorimit pa kriter të ndotësve organikë të qëndrueshëm.

4.2 Problematikat

Zbatimi i ligjit penal mjedisor, nuk i përgjigjet realitetit. Parandalimi, zbulimi dhe ndëshkimi i kriminalitetit mjedisor, të krahasuara, janë më të ulëta. Zbatimi i ligjit penal mjedisor, nuk ka bërë të mundur të realizohen parimet bazë. Si rezultat i efektivitetit të ulët të zbatimit të ligjit penal mjedisor, shtetit dhe shoqërisë i janë shkaktuar dëme shoqërisht të rrezikshme, të pakompensuara e të parikthyeshme. Ndërsa, për veprat penale tradicionale, treguesit e zbatimit të ligjit janë në nivelin minimal (neni 201, 202, 203, 206, 207, e në vijim të kodit penal). Mungojnë struktura të specializuara për parandalimin e veprave të tjera penale mjedisore, përjashtojnë nenin 205 të kodit penal, ku ka një strukturë të policisë pyjore, e cila është joekzistuese. Nevojitet një legjislacion i dendur mjedisor; një legjislacion kuadër mjaft i plotë dhe që parashikon mekanizma për mbrojtjen e mjedisit; ka mangësi të mëdha në kapacitetet zbatuese të agjencive të kontrollit: mangësi në monitorime, mangësi në kapacitete teknike për kontroll paraprak gjatë procesit të lëshimit të lejeve mjedisore, VNM, VSM; ka konflikt interesi të hartuesve të VNM-ve dhe VSM-ve të paguar nga vetë subjekti zhvillues i projektit në kushtet kur nuk ka procedura kontrolli mbi paanësinë e ekspertit të VNM dhe VSM kur hartojnë këto raporte të rëndësishme; ka mangësi në legjislacionin penal dhe mangësi në legjislacionin për hidrokarburet (nuk vendosen garancitë e duhura mjedisore për rehabilitim mjedisi).

4.3 Nevoja për kapacitete

Kapacitete dhe cilësi të munguara në fushën e legjislacionit mjedisor penal, mund të përmendim këto, si më kryesoret: ligji penal mjedisor nuk i përgjigjet avancimit të ligjeve mjedisore në tersi; mungesa e strukturës dhe e aftësisë ndërthurje kompetencash mes policive dhe strukturave; indiferenca e Policisë së Shtetit, ose goditje me fushata; mungesa e një strukture të posaçme (inspektim - polici) për ndjekjen e krimit mjedisor; mungon policia gjyqësore mjedisore; nuk ka prokurorë dhe gjyqtarë të specializuar; vendosja e krimit mjedisor si pjesë e sigurisë kombëtare; formaliteti në bashkëpunim mes institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor; reflektimi në strategjitë dhe planet kombëtare për krimin mjedisor dhe përfshirjen e publikut në këtë proces; cilësimi juridik veprave penale kundër mjedisit lë shteg për abuzim. Në Shqipëri po shfaqen forma të reja të krimit mjedisor, deri në krim të organizuar dhe korrupsion mjedisor¹⁴.

5. Përfundime dhe rekomandime^{15,16,17}

- Përafrimi i ligjit penal mjedisor me legjislacionin mjedisor, që konsiderohet në standarde optimale.

- Përmirësime ligjore (akte bashkëpunimi) për vlerësimin dhe ndjekjen e krimit mjedisor në ligjet themelore të Policisë së Shtetit, SHISH dhe SHIU.

- Ngritja e strukturave të specializuara në prokurori, gjykatë dhe Polici të Shtetit për ndjekjen e krimit mjedisor dhe trajnimin e personelit për të përvetësuar teorinë e praktikave

¹⁴ OSCE, *Report Risk Assessment Corruption in Environment*.

¹⁵ <http://www.ligjet.org/>

¹⁶ <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-shkod%C3%ABr/gjykata-e-rrethit-shkod%C3%ABr/>

¹⁷ <http://www.pp.gov.al/>

bashkëkohore.

- Pozicionimi Inspektorati Policisë së Pyjeve në nivel vendor dhe ndarja e kompetencave të saj të policisë gjyqësore nga ana e Policisë së Shtetit; ose transferimi i kompetencave tek Policia e Shtetit, duke trajtuar ngritjen e strukturës si sektor i profesionit të veçantë.

- Përcaktimi i kufijve të saktë midis kundërvajtjeve administrative duke qartësuar elementet ekonomike dhe ekologjike.

- Plotësimi sa më shpejtë i akteve ligjore e nënligjore që iu referohen veprat penale mjedisore.

- Lidhja e drejtës së mjedisit me të drejtën civile, me të drejtën administrative, por edhe me të drejtën penale.

- Vëmendje veçantë ndaj sjelljeve të rrezikshme ndaj mjedisit.

- Shkatërrimi i pyjeve me zjarr: mbetjet e rrezikshme duhet të jenë në qendër të vëmendjes.

- Mjedisi natyror meriton mbrojtje të së drejtës civile, administrative dhe penale.

- Mjedisi si pjesë e rëndësishme e dinjitetit dhe ekzistencës njerëzore, për faktin që vetë jeta jonë është e ndërtuar mbi këtë mjedis.

- Ndërthurja e krimit mjedisor me krimet tjera (korrupsioni, krimi ekonomik-financiar); në shumicën e rasteve këto kryhen (vetëm ose në bashkëpunim) nga funksionarë apo njerëz në detyra shtetërore e publike të nivelit të mesëm dhe të lartë.

- Cilësimi juridik i veprës mbetet problem (administrative dhe penale, dëmi dhe pasoja).

- Rishikimi i kodit penal në fokus importi i mbetjeve, shkatërrimi pronës me zjarr, cenimi juridik i tokës, ashpërsimi i masave për pyjet, ujërat, ajrin, ndërtimet pa leje etj.

Problemet dhe shkaqet e dala nga analiza e mësipërme, reflektohen në nivel lokal (aty ku ndodh krimi dhe korrupsioni) duke u shoqëruar me specifikat e veta. Disa prej tyre në shtesë të atyre që thamë lartë janë:

- Mungesa e njohurive dhe aftësive të pushtetit vendor dhe administratës publike vendore për të marrë në mbrojtje pasuritë natyrore duke i shfrytëzuar ato racionalisht.

- Mungesa e njohurive në fushën legjislative dhe të biodiversitetit, kryesisht me ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të pasurive natyrore.

- Mungesa e kapaciteteve vepruese në zonat rurale si pasojë e migrimit të shtresës intelektuale nga këto zona drejt zonave me mundësi më të larta fitimi.

- Dëmtimi i zonave me vlera të rëndësishme natyrore si pasojë e aktivitetit fitimprurës, por pa kriter, kryesisht të banoreve lokalë.

- Mungesa dhe mosfunksionimi i strukturave civile lokale.

- Mungesa e shkëmbimit të informacionit si rezultat i mungesës së një infrastrukture të nevojshme.

- Niveli i ulët ekonomik i zonave dhe mungesa e alternativave për punësim.

- Mungesa e aftësive për konkretizimin e ideve për të justifikuar dhe për të bërë të mundur thithjen e fondeve, si nga shteti ashtu edhe nga donatorë të huaj.

- Mungesa e bashkëpunimit mes institucioneve shtetërore në nivel komunal, organizatave joqeveritare, institucioneve shkollore, etj.

- Për të gjithë këta faktorë (në nivel kombëtar dhe lokal) dhe të tjerë, tema reflekton në mënyrë të hapur fenomene të rrezikshme për mjedisin, dhe për vetë shoqërinë, duke e bërë atë më të ndjeshme, që nga parandalimi, deri tek zgjidhja ligjore e problemit dhe shuarja konflikteve mjedisor, duke vënë një balancë të qëndrueshme mes ekonomisë, mjedisit dhe zhvillimit social.

Bibliografi

- 1 <https://qbz.gov.al/eli/bnjz>
- 2 <http://www.ligjet.org/>
- 3 <http://www.themisnetëork.eu/tools/standard-operating-procedures/albania/general-sop/criminal-enforcement.html>
- 4 European Commission, 2013, Albania Progress Report
- 5 https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Kodi_Penal-1.pdf
- 6 <http://www.gjykata.gov.al/rrethi-shkod%C3%ABr/gjykata-e-rrethit-shkod%C3%ABr/>
- 7 <http://www.pp.gov.al/>
- 8 <http://www.bashkiashkoder.gov.al>
- 9 Standard Operating Procedures (SOPs) to prevent, detect and investigate environmental crimes. Create Standard Operating Procedures (SOPs) to prevent, detect and investigate environmental crimes for Albania. <http://www.themisnetëork.eu/about-themis/contacts.html>
- 10 OSCE_Report Risk Assessment Corruption in Environment



**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

**« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »**

231

Mbrojta e mjedisit në kuadër të standardeve të Bashkimit Evropian



■ **MSc. Qetësor GURRA**
Akademia e Sigurisë
Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit
qetesorgurra@gmail.com

■ **MSc. Jonida GURRA**
Drejtorja Vendore e Policisë,
Qarku Tiranë
gurrajonida7@gmail.com

Abstrakt

Kjo temë do të trajtojë standardet e larta mjedisore që shtetet evropiane supozohet të kenë. Natyrisht që fillimisht do të ketë një trajtesë shkencore, juridike të parametrave të lëndueshme. Të dhëna mbi realitetin nën petkun krahasues të së shkuarës dhe pritshmërive, perspektivës së të ardhmes. Politikat e mjedisit përveçse mbartin një rëndësi jetësore për tërësinë e ekosistemeve si kapitali më i çmuar që njerëzimi dhe gjallesat mund të kenë janë potenciali më i vyer për zhvillimin e politikave të integruara të cilat mund ta bëjnë Evropën më shumë konkurruese në përmirësimin e cilësisë dhe standardit të jetës. Uji, ndotja e ajrit dhe substancat kimike përbëjnë shqetësimet kryesore që Bashkimi Evropian synon të përmirësojë cilësisht. Ajo çka vlen të diskutohet është mënyra si është realizuar dhe vazhdon të bëhet mbrojtja e mjedisit në vende të ndryshme çka do të shpalosë mënyra të shumta implementimi veprimi në varësi të shkallës së zhvillimit të një shteti. Këto të fundit do të shërbejnë fort mirë si zëri i eksperiencës dobishme për vendin tonë, ku realisht zëri i buxhetit për mjedisin është si pëshpëritje përballë problematikave që u jepet më shumë përparësi. Në konkludim, përpara dhënies së rekomandimeve do të përshkruhet terreni ligjor dhe forca shtërguese sanksionuese, e cila ka nën fokus misionin për t'i bërë ballë sfidave globale mjedisore ku popullsia vazhdon të zgjerohet me ritme të pakontrollueshme. Shqipëria, si vend aspirant kandidat, mund të japë kontributin e saj në familjen e Bashkimit Evropian ku luhet një rol kyç në përpjekjet ndërkombëtare për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm në nivel global.

Fjalëkyçe:

mjedis, ekosistem, mbrojtje, standard, ligj, Bashkimi Evropian.

AKADEMIA
E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

« Krimi mjedisor,
siguria mjedisore
dhe siguria
kombëtare »

1. Hyrje

Problemet që lidhen me mbrojtjen e mjedisit janë ndër problemet më të mprehta me të cilat përballlet sot njerëzimi. Çështjet mjedisore përmbajnë problematika që lidhen drejtpërdrejtë me jetën e përditshme të njerëzve, ato nuk janë probleme të një natyre abstrakte, por janë të lidhura me hapësirën jetësore, cilësinë e jetës dhe vetë shëndetin e njerëzve, përfshirë dhe brezat e ardhshëm. Mbrojtja e mjedisit nuk ka të bëjë vetëm me mbrojtjen e jetës njerëzore, por me mbrojtjen e jetës të së gjithë organizmave të gjallë dhe specieve që popullojnë planetin tonë.

Ajo përfshin mbrojtjen e ajrit, ujit, tokës, kafshëve, bimëve, diversitetit biologjik. Mbrojtja e mjedisit ka të bëjë me mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë ushqimore, mbrojtjen e konsumatorit, sigurinë energjetike, e deri tek siguria bërthamore. Në gjuhën shqipe etimologjia e termit “mjedis” është interpretuar se rrjedh prej fjalës “midis” që do të thotë “ajo çka ndodhet midis njerëzve”. Sipas *Komisionit të së drejtës ndërkombëtare*, çështja e mbrojtjes ekologjike të një vendi është e të njëjtës rëndësi me situatat e rreziqeve të jashtëzakonshme që i kanosen vetë ekzistencës së shtetit, mbijetesës së tij politike apo ekonomike, ruajtjes së rendit të brendshëm, apo mbijetesës së një pjesë të popullsisë së tij.

Probleme të tilla si, shtimi eksponencial i popullsisë së botës, ndotja e ajrit dhe ujit, ngrohja globale dhe pasojat që rrjedhin prej saj, çarja e shtresës së ozonit, shiu acid, rritja e nivelit të deteve dhe oqeanëve, shkretëtirëzimi, zhdukja e specieve të ndryshme, prishja e ekosistemeve, shtimi i rasteve të fatkeqësive natyrore, organizmat e modifikuar gjenetikiisht e të tjera probleme si këto janë ato të cilat debatohen më shpesh aktualisht. Në kuadrin e politikave të ndjekura nga Shqipëria në rrugën e saj te integrimin evropian, politikat mjedisore zënë një vend të rëndësishëm.

Legjislacioni i plotë dhe i harmonizuar hedh bazat për një mbrojtje me të efektshme të mjedisit, për përmasimin e kapaciteteve dhe institucioneve, për rritjen e efikasitetit në përdorimin e burimeve natyrore, për reduktimin dhe parandalimin e problemeve mjedisore, në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm, si edhe për nxitjen e rritjes ekonomike.

2. Zhvillimi historik i legjislacionit mjedisor shqiptar

Në Shqipëri fillesat e legjislacionit mjedisor shfaqen në vitin 1993 në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përbën dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikat mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte që qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor, ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudha nga viti 1993 deri në vitin 1998, konsiderohet si etapa e parë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit (Hanxhari, 2012: 12). Tipari kryesor është prirja e përafritimit me legjislacionin e bashkimit evropian për mjedisin.

Në “Kushtetutën e Shqipërisë” janë të formuluar dy nene të veçanta që lidhen me mjedisin. Në njërin prej tyre njihet e drejta e publikut për të marrë informacion lidhur me gjendjen e mjedisit dhe masat që merren për mbrojtjen e tij, si pjesë e të drejtave të njeriut. Ndërsa në kuadër të objektivave sociale, shteti duhet të angazhohet për të njohur, mbrojtur e për të përmirësuar gjendjen e mjedisit, jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe për ata të ardhshmit. Ky qëndrim i mbajtur në kushtetutën shqiptare është në përputhje me frymën e dokumenteve themelore evropiane në fushën e mjedisit, ndër të cilat është edhe *Raporti Brundland* ku theksohet domosdoshmëria për ta ruajtur mjedisin duke e shfrytëzuar sa më pak të jetë e mundur në ditët e sotme, me qëllim që të shmanget dëmi, shpesh i riparueshëm ndaj brezave të ardhshëm. Nisur nga përmbajtja e neneve të kushtetutës lidhur me fushën mjedisore, mund të pohojmë se aty shihet fryma e kushtetutës së vendeve të tjera demokratike, që u kushtojnë rëndësi të një niveli më të lartë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, siç janë e drejta për informim e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshtatshëm, për të jetuar jo vetëm për brezat e sotëm, por edhe për ata të ardhshmit. Në fakt shumë ligje dhe akte nënligjore janë miratuar para hyrjes në fuqi të kushtetutës së vitit 1998.

Tiparet kryesore të legjislacionit shqiptar mjedisor (Hanxhari, 2012: 13) janë: ai është i ri, dinamik, i pasur, me tendenca përafritimi kryesisht me legjislacionin evropian të mjedisit. Legjislacioni shqiptar në fushën mjedisore grupohet në tre kategori: legjislacioni sektorial, legjislacioni kuadër si dhe legjislacioni penal për mbrojtjen e mjedisit. Legjislacioni sektorial karakterizohet nga fragmentimi dhe regjime sektoriale të pakoordinuara midis tyre që fillimisht u krijuan me qëllimin për të lehtësuar shpërndarjen e burimeve dhe për të trajtuar efektet mbi mjedisin gjatë shfrytëzimit të burimeve natyrore. Legjislacioni kuadër mjedisor është një ligj që rregullon kuadrin ligjor dhe institucional pa synuar ta rregullojë plotësisht atë sektor të caktuar.

Ky lloj legjislacioni është mjaft elastik pasi lejon daljen apo nxjerrjen e akteve nënligjore që bëjnë një rregullim më të hollësishëm të aspekteve të caktuara mjedisore dhe plotësojnë përmbajtjen e ligjit kuadër. Legjislacioni penal përcakton përgjegjësinë në raste të caktuara, lidhur me mjedisin; provimi i faktit se dikush është përgjegjës për një vepër penale shoqërohet me një dënim penal, gjobë ose burgim.

3. Legjislacioni shqiptar për të drejtën e mjedisit në Shqipëri

3.1 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e biodiversitetit

Veçoritë klimatike të Shqipërisë, pozicioni gjeografik, relievi dhe faktorët hidrologjikë dhe gjeologjikë të saj favorizojnë një zhvillim mjaft të madh të biodiversitetit. Habitatet e saj natyrore ofrojnë kushte për ekzistencën e rreth (Hanxhari, 2012: 13) 3200 llojeve bimësh të larta (30% të florës evropiane). Në Shqipëri, dëmet e shkaktuara në biodiversitet janë të shumta, si copëzimi i habitateve, dëmtimi, varfëria dhe degradimi i ekosistemeve dhe i habitateve, shfarosja e kafshëve të egra në habitatet e tyre natyrore etj. Ritmi i humbjeve të biodiversitetit në Shqipëri në këto 50 vitet e fundit mendohet të jetë nga më të lartët në Evropë. Dëme janë shkaktuar edhe nga grumbullimi intensiv i bimëve mjekësore, ku Shqipëria zë vendin e dytë në Evropë për eksportin e tyre. Në Shqipëri janë identifikuar rreth 91 specie të rrezikuara. Ekosistemet dhe habitatet më të rrezikuara në Shqipëri përfshijnë ato detare, bregdetare, grykëderdhjet e lumenjve, lagunat, liqenet bregdetare, livadhet dhe kullotat alpine.

Si rrjedhojë e iniciativave të ndërmarra, zonat e mbrojtura përfshijnë sot 15.8% të territorit të vendit. Për ruajtjen e biodiversitetit ka rëndësi të veçantë zgjerimi i zonave të mbrojtura, për të siguruar përfaqësimin e të gjitha llojeve të ekosistemeve në rrjetin e këtyre zonave, pasi ky është një prej elementeve kyç të një zhvillimi të qëndrueshëm. Strategjia dhe plani i veprimit për biodiversitetin përbën dokumentin kryesor që përcakton qëllimet, objektivat dhe masat për ruajtjen e biodiversitetit në Shqipëri për periudhën 2000-2015. Politikat e kësaj strategjie përfshihen edhe në strategjinë ndërsektoriale të mjedisit. Zgjerimi dhe forcimi i rrjetit të zonave të mbrojtura, si bazë për krijimin e rrjetit ekologjik të vendit dhe si pjesë e rrjetit evropian, vlerësohet si një nga objektivat më të rëndësishme të *Planit të veprimit të biodiversitetit për Shqipërinë*. Shqipëria është bërë palë në traktatet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen e biodiversitetit.

Ajo ka aderuar në “Konventën për biodiversitetin” dhe në “Protokollin e Kartagjenës për biosigurinë”, si dhe në “Konventën e Ramsarit për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”, “Konventën e Bërnes për ruajtjen e specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër” (Muharremaj, 2015: 167). Konventa për biodiversitetin kërkon prej palëve hartimin e strategjive dhe planeve për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit, krijimin e një sistemi për zonat e mbrojtura ose zonat ku nevojitet marrja e masave të veçanta për ruajtjen e tij. Strategjia dhe plani kombëtar i veprimit për mbrojtjen e biodiversitetit, i cili përcaktoi autoritetet përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve të Konventës si dhe strukturat rajonale të pyjeve, Inspektoratin e Mjedisit.

Për menaxhimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të llojeve, parashikohet përzgjedhja e një liste të zonave me interes për komunitetin, duke identifikuar dukuritë e tipave të habitateve dhe llojeve në çdo rajon përkatës biogeografik me qëllim propozimin në Komision Evropian të listës së zonave të cilat strehojnë këta tipa habitatesh dhe llojesh. Bashkimi Evropian po mbështet rritjen e kapaciteteve të Ministrisë së Mjedisit për hartimin e ligjeve dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar të mjedisit nëpërmjet projekteve të asistencës teknike.

Në kuadrin rajonal të Këshillit të Evropës, Shqipëria u bë palë në “Konventën e

Bernës për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës”, me ligjin nr. 8294 datë 2.3.1998, i cili ratifikoi këtë konventë. Detyrimet e marra përsipër synojnë të sigurojnë ruajtjen e florës dhe faunës së egër, vendbanimet e tyre natyrore, veçanërisht speciet dhe vendstrehimet, përfshirë speciet shtegtare të kërcënuara nga zhdukja dhe ato të pambrojtura. Me ligjin nr. 8692, datë 16.11.2000, Shqipëria aderoi në “Konventën e Bonit për ruajtjen e specieve shtegtuese të kafshëve të egra”, si edhe është bërë palë në marrëveshjet e mëpasme për delfinët, balenat, lakuriqët e natës dhe për shpendët shtegtarë euroaziatikë. Në zbatim të angazhimeve të marra përsipër në kuadër të këtyre marrëveshjeve janë hartuar disa plane të veçanta veprimi për mbrojtjen e pesë llojeve të rrezikuara të faunës.

Nga pikëpamjet institucionale, organet përgjegjëse për sigurimin e zbatimit të legjislacionit janë Ministria e Mjedisit, drejtorja e biodiversitetit dhe zonave të mbrojtura dhe drejtorja e pyjeve dhe administrata e zonave të mbrojtura. Në vitin 1996 Shqipëria u bë palë në “Konventën e Ramsarit për ligatinat me rendësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore”. Aktualisht janë shpallur tre zona të mbrojtura nga kjo konventë: Laguna e Karavastasë, Liqeni i Butrintit dhe Liqeni i Shkodrës, me synimin që të përfshihet edhe zona e liqeneve të Prespës. Në Konventën e Kombeve të Bashkuara (UNCCD) Shqipëria aderoi në vitin 2000, me miratimin e ligjit nr 8556 datë 22.12.1999.

Kërkesat e konventës përqendrohen kryesisht në mbrojtjen e tokës, e për këtë qëllim është hartuar edhe kuadri ligjor për administrimin dhe mbrojtjen e tokës. Një rol të rëndësishëm kanë edhe institucionet shkencore, siç është Instituti i Studimit të Tokave, veprimtaria e të cilit është monitorimi dhe cilësia e tokës bujqësore që përbën një nga aspektet e rëndësishme të monitorimit të mjedisit, për analizimin e të dhënave për erozionin e tokës si dhe për gjendjen e fondit të tokës bujqësore dhe cilësinë e saj.

Në ruajtjen e biodiversitetit roli i pyjeve është i pazëvendësueshëm. Statistikat tregojnë se pyjet zënë afro një milion hektar ose rreth 36% të sipërfaqes totale të Shqipërisë. Me ndryshimet e ndodhura pas viteve ‘90, dhe ecjen drejt ekonomisë së tregut, si në të gjithë sektorët ekonomike të vendit, edhe në sektorin e pyjeve erdhën duke u plotësuar politikat dhe kuadri ligjor mbi ekonominë pyjore dhe mjedisin në tërësi.

Duke iu referuar dispozitave të Traktatit të Bashkimit Evropian, mbrojtja e pyjeve nuk bën pjesë në fushat që janë kompetencë e Bashkimit Evropian, kështu që shtetet anëtare nuk janë të detyruara të ndjekin të njëjtën linjë veprimi duke e lenë menaxhimin e pyjeve në duart e secilit prej tyre. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asociimit Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të rëndësishme për sa i përket sektorit të pyjeve, me qëllim përafrimin e politikave dhe legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire*.

Si rrjedhojë e përpjekjeve për t’u çliruar nga pasojat e praktikave të shkuara aktualisht ka një sërë strategjish të vëna në veprim dhe vazhdueshmëri të procesit të përafrimit. Duke vepruar sipas detyrimeve të marra në kuadrin e procesit të stabilizim-asociimit, të *Strategjisë evropiane për pyjet* dhe *Strategjisë mbarëevropiane të diversitetit biologjik dhe të peizazheve*, Shqipëria ka miratuar në vitin 2003 “Strategjinë kombëtare të pyjeve dhe kullotave”, e cila përcakton linjat kryesore të veprimit për 25 vitet e ardhshme, duke formuluar kështu edhe një plan veprimi për dekadën në vijim. Mes objektivave të deklaruara renditet, ruajtja dhe rivendosja e ekuilibrave natyrore të burimeve pyjore, administrimi i qëndrueshëm i produkteve të tyre, sigurimi i kontributit sa më optimal të këtij sektori në zhvillimin ekonomik, lufta kundër varfërisë dhe zhvillimi i qëndrueshëm

i vendit. Në tërësi një pjesë e direktivave të Bashkimit Evropian janë përafuar në legjislacionin e brendshëm shqiptar, por gjithsesi, disa aspekte të rëndësishme nuk janë përfshirë në ligjin 9385 datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor” (Muharremaj, 2015: 172).

Privatizimi i pyjeve ashtu edhe shitja e produkteve të përfuara nga to janë të ndaluara. Gjithashtu, edhe procesi i kthimit të tokave pyjore ish pronarëve po ecën me ritme të ngadalta. Rregullorja 3528/86 datë 17.11.1986, e Këshillit të Bashkimit Evropian, e amenduar në vitet pasuese 1989, 1992, 1997, fokusohet në Mbrojtjen e Pyjeve duke krijuar një skemë monitorimi për dëmet e ardhura nga ndotja atmosferike (Muharremaj, 2015: 173).

3. 2 Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e ujit

Shqipëria është ndër vendet më të pasura në Evropë me ujëra, duke u renditur ndër vendet e para për frymë popullsie. Rrjeti i saj hidrografik përbehet nga lumenj, ujëra nëntokësore, përrrenj, laguna, liqene natyrore, liqene artificiale dhe dete. Për kushte gjeografike në të cilat ndodhet Shqipëria, respektimi i normave për përdorimin dhe menaxhimin e rrjedhave ujore ndërkombëtare është jetik, pasi rreth 33% e pellgut hidrografik ndodhet jashtë territorit shtetëror shqiptar, një gjë e rrallë në botë për ujërat kufitare ndërkombëtare (Hyseni, 2013: 104).

Prandaj është edhe e kuptueshme ndjeshmëria e lartë që u shfaq në marrëdhëniet diplomatike shqiptaro-maqedonase kur u diskutua para disa kohesh projekti maqedonas për devijimin e lumit Radika, si dhe debati që ka marrë shkas prej ndërhyrjeve të Greqisë në lumin Vjosa. Burimi kryesor i furnizimit me ujë të pijshëm në Shqipëri janë ujërat nëntokësore. Përdorimi i ujit për nevoja industriale ka rënë për shkak të mbylljes së një pjese të industrisë së rëndë. Humbjet e ujit në rrjetin shpërndarës janë të larta, për shkak të amortizimit të rrjetit dhe të ndërhyrjeve të paligjshme në të, qoftë nga pronarët e ndërtimeve pa leje, qoftë për veprimtari ekonomike joformale, siç është rasti i larjes së makinave. Kjo është një ndër arsyet e ndotjes së ujërave nëntokësore, të cilës i shtohen edhe ndotjet nga veprimtaritë industriale e bujqësore dhe nga shkarkimet e ujërave të zeza.

Ujërat sipërfaqësorë pranë zonave urbane karakterizohen nga ndotje prej lëndëve organike, me prejardhje kryesisht nga shkarkimet e ujërave të zeza të patrajtuara. Kjo bëhet shkak që edhe sëmundjet ngjitëse edhe epidemitë e shkaktuara nga ujërat e ndotura, të jenë në shkallë të lartë. Ndotja më e madhe e ujërave të lumenjve ndodh kur ata kalojnë pranë zonave të banuara, zonave industriale, zonave të nxjerrjes e të përpunimit të naftës, të cilat janë të ndotura me përbërje organike. Shqipëria përveç detyrimeve që ka marrë në kuadrin e zbatimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit është bërë palë në konventën e UNECE “Për mbrojtjen dhe përdorimin e rrjedhave ujore ndërkufitare dhe të liqeneve ndërkombëtare”, si dhe në protokollin shoqëruar “Për ujin dhe shëndetin” (Hyseni, 2013: 105). Shqipëria ka ratifikuar konventën “Për mbrojtjen e detit mesdhe nga ndotja dhe ruajtja e biodiversitetit”, si dhe protokollet shoqëruese. Në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar me vendet fqinje, për mbrojtjen e ujërave Shqipëria ka nënshkruar në vitin 2003 me Greqinë, “Marrëveshjen për krijimin e komisionit të përhershëm shqiptaro-grek për ujërat e ëmbla ndërkufitare”, “Marrëveshjen për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe të basenit të tij ujëmbledhës” me Maqedoninë, në vitin 2004, si dhe *Memorandumin e mirëkuptimit* me Malin e Zi për administrimin e ujërave të Liqenit të Shkodrës dhe

lumit të Bunës, në vitin 2010 (Hyseni, 2013: 105).

Në bazë të këtyre detyrimeve, Shqipëria duhet të përcaktojë dhe të zbatojë objektiva të qarta dhe të matshme për pakësimin e mëtejshëm të shkarkimeve ndotëse në ujërat ndërkufitare dhe në zonën bregdetare, si edhe duhet të hartojë plane të menaxhimit të aksidenteve për shmangien e ndotjes së detit. Adoptimi i direktivës kuadër të ujit, të BE-së, në legjislacionin shqiptar është realizuar me miratimin e ligjit numër 111/2012 datë 15.11.2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i cili ka përcaktuar edhe strukturën institucionale për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore, ku përfshihen Këshilli i Ministrave, ministria përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli Kombëtar i Ujit dhe sekretariati i tij teknik, ndërsa në nivel vendor, për menaxhimin e integruar të burimeve ujore ngrihen këshillat e baseneve ujore dhe agjencitë e baseneve ujore (Hyseni, 2013: 106).

Sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit drejton punën e institucioneve të specializuara në fushën e ujërave për hartimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, me afat 15-vjeçar, si edhe të planeve dhe të dokumenteve të tjera strategjike, me afat 6-vjeçar. Këshilli Kombëtar i Ujit është organi qendror vendimmarrës, ndërministror, që kryesohet nga kryeministri dhe trajton çështjet e administrimit dhe menaxhimit të integruar të burimeve natyrore ujore. Ai miraton planet dhe projektet ndërrajonale dhe kombëtare në fushat që lidhen me ruajtjen dhe administrimin e ujërave, si edhe kujdeset për zbatimin e traktateve ndërkombëtare për burimet ujore, në të cilat vendi ynë është palë.

Në rastet e marrëveshjeve me koncesion të cilat kanë si objekt burimet ujore me rëndësi kombëtare, ato hyjnë në fuqi pas ratifikimit nga kuvendi. Nenet 18-22 të ligjit i janë kushtuar bashkëpunimit ndërkombëtar për mbrojtjen e ujërave ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, për parandalimin e ndotjes së burimeve ujore, për garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përputhje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Në to përcaktohet se ujërat ndërkufitare mund të përdoren vetëm në mënyrë të kontrolluar, brenda kufijve shtetëror, pa dëmtuar kushtet natyrore dhe balancat biologjike dhe ekologjike të tyre. Për të siguruar mbrojtjen e burimeve ujore, subjektet që u njihet e drejta e shfrytëzimit të tyre duhet të pajisen me leje mjedisore, pas shqyrtimit të raportit të thelluar të ndikimit në mjedisin ujor. Ministria përgjegjëse ngarkohet me kontrollin e vazhdueshëm për të siguruar ruajtjen e gjendjes natyrore të faunës dhe florës së ujërave ndërkufitare. Ligji parashikon dhe krijimin e komisioneve të posaçme për administrimin e ujërave ndërkufitare.

Një nga risitë që ka sjellë ky ligj është edhe ndarja e ujërave në zona të ndryshme mbrojtjeje, duke përcaktuar si të tilla zonat higjeno-sanitare për mbrojtjen e burimeve ujore, zona për peshkim dhe rritjen e butakëve, zonat e prira ndaj eutrofikimit¹ dhe zonat në rrezik nga nitratet dhe nitratet, zonat e synuara për mbrojtjen e bimëve apo kafshëve, si dhe të habitateve, zonat e prira ndaj ndotjes, zonat e mbrojtjes emergjente, zonat e veçanta të ruajtjes, zonat e rrezikshme për shëndetin etj. Të gjitha këto zona duhet të jenë të identifikuar në “Kadastrën kombëtare të burimeve ujore”, e cila administrohet nga ministria përgjegjëse. E drejta për të marrë dhe për të përdorur informacion për burimet ujore u njihet shprehimisht çdo personi fizik dhe juridik, në

¹ EUTROPHICATION ~ pasurim i tepërt i lëndëve ushqyese në një liqen ose në një masë tjetër ujore, shpeshherë për shkak të rrjedhjeve nga toka, gjë e cila shkakton një shtim të jetës bimore dhe zhdukjen e jetës së kafshëve ujore nga mungesa e oksigjenit.

lidhje me dokumentet bazë dhe të dhënat e përdorura për hartimin e planeve të menaxhimit të baseneve dhe këtyre personave u krijohet mundësia për të marrë pjesë në procesin e konsultimit dhe komentimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore.

Krahas kadastrës, i rëndësishëm është edhe hartimi i regjistrit kombëtar të shfrytëzuesve të burimeve ujore, që përbën një bazë të dhënash të grumbulluara nga agjencitë zbatuese në terren, e cila evidenton të gjitha lejet e shfrytëzimit të burimeve ujore. Një strukturë tjetër e krijuar që në vitin 1998 është edhe *Enti rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura*, i cili funksionon si një institucion publik i pavarur dhe që i raporton Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë. Ndër reformat e kryera nga qeveria e re shqiptare në muajin janar 2014 u krijua Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, nën varësinë e Ministrisë së Mjedisit, siç parashikohet në *Planin kombëtar të integritimit evropian 2014-2020*, i cili do të garantojë zbatimin dhe imponimin e ligjit në fushën e mjedisit, pyjeve dhe ujërave.

Përveç këtij ligji janë miratuar edhe një sërë aktesh nënligjore për menaxhimin e burimeve ujore. Ndër to, përmendet vendimi i Këshillit të Ministrave numër 177 datë 31.5.2005, “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”, i cili plotëson kërkesat e direktivës kuadër të ujit të BE-së dhe ngarkon këshillat e baseneve ujëmbledhëse dhe agjencitë rajonale të mjedisit që çdo dy vjet të përgatisin dhe publikojnë programet për parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së mjediseve ujore pritëse nga shkarkimet e lëngëta (Hyseni, 2013: 110).

Këto programe duhet të përfshijnë identifikimin e shkarkimeve të lëngëta dhe të mjediseve ujore pritëse që ndoten etj. Masave dhe teknikave më të mira të mundshme për zvogëlimin e ndotjes, të bëjnë propozimet për zëvendësimin ose riciklimin e substancave të rrezikshme për veprimtaritë industriale etj. Çdo dy vjet, këshillat e baseneve ujëmbledhës, publikojnë raportet për gjendjen e ujërave të baseneve nën juridiksionin e tyre, lidhur me shkarkimet e lëngëta dhe largimin e llumrave nga impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura. Një akt tjetër i rëndësishëm nënligjor që nuk ka të bëjë vetëm me ujërat është VKM-ja numër 1189 datë 18.11.2009, “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”, ku në lidhje me ujërat, parashikohet monitorimi i treguesve që kanë të bëjnë me alkalinitetin, aciditetin, përmbajtjen e nitrateve, azotit e fosforit në ujërat sipërfaqësore e nëntokësore (Hyseni, 2013: 111). Pas tij u miratua edhe VKM-ja numër 797 datë 29.9.2010, “Për miratimin e rregullores higjeno-sanitare për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, përsëri në zbatim të *Direktivës kuadër për ujin*, që përcakton kriteret shëndetësore që duhet të plotësojnë ujërat e larjes për të siguruar cilësinë e tyre, me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik nga efektet negative të ndotjes, i cili u plotësua kohët e fundit prej VKM-së numër 246 datë 30.4.2014, “Për përcaktimin e normave të cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore” dhe VKM-së numër 321 datë 28.5.2014, “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”.

Në kuadër të sanksioneve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja, neni 203 i “Kodit penal të Republikës së Shqipërisë”, parashikon se ndotja e ujërave të deteve, lumenjve, liqeneve apo burimeve të rrjetit grumbullues e shpërndarës të ujërave me lëndë toksike, radioaktive apo substanca të tjera, që prishin ekuilibrin ekologjik, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet (shih, www.mjedisi.gov.al).

Kjo vepër penale, kur ka shkaktuar pasojë të rënda për jetën dhe shëndetin e njerëzve,

dënohet nga pesë deri në dhjetë vjet. Për sa i përket përafrimit me legjislacionin komunitar, Shqipërisë i duhet të ndërmarrë hapa serioze në këtë drejtim, sepse administrimi i ujërave është një nga fushat që ka rregullim më të gjerë. Politika e re evropiane e ujërave dhe *Direktiva kuadër e ujit*, janë të bazuara në qasjen e kombinuar, parimin e marrjes së masave paraprake, parimin e parandalimit, parimin sipas të cilit dëmet mjedisore duhen riparuar në burim, si edhe në parimin e mbajtjes parasysh të kushteve mjedisore specifike të rajoneve të ndryshme. Në Shqipëri, kapacitetet për menaxhimin e ujërave janë ende të kufizuara, dhe ngritja e tyre është një domosdoshmëri.

Përmbytjet e shkaktuara në jug të Shqipërisë si pasojë e daljes së lumenjve prej shtretërve të tyre në fund të janarit dhe në fillim të shkurtit 2015-ës duhet të shërbejnë si kampion alarmi për marrjen e masave urgjente. Një mangësi jo e vogël është mungesa e një strategjie për administrimin e burimeve ujore, e cila duhet hartuar sa më parë. Përpjekjet serioze duhen bërë për zbatimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian për ujërat, ku një rol të rëndësishëm luajnë organet e pushtetit vendor, të cilat në vetvete janë në proces transformimi dhe ristrukturimi. Duhet punuar sidomos për ushtrimin e kontroleve për mbrojtjen e ujërave nga ndotja dhe për hartimin e programeve të trajnimit për mënyrat e inspektimit dhe kontrollit të cilësisë së ujërave.

3.3. Legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e mjedisit nga mbetjet

Sistemi aktual i administrimit të mbetjeve në Shqipëri ka mangësi të theksuara. Ai kufizohet vetëm në largimin dhe depozitimin e tyre në vende të caktuara nga organet e qeverisjes vendore, por jo rrallëherë edhe në vende krejtësisht të papërshtatshme, duke mos përjashtuar as rrugët kryesore kombëtare. Administrimi i mbetjeve dhe veçanërisht i vendeve ku ato janë depozituar duhet të jete prioritet, për shkak të potencialit ndotës të tyre ndaj njeriut dhe mjedisit, kryesisht për tokën, ujërat nëntokësore dhe biodiversitetin, por në Shqipëri nuk duket që të konsiderohet si i tille, pasi është në një nivel shumë të ulët. Në Shqipëri janë bërë përpjekje për hartimin e legjislacionit për administrimin e mbetjeve që përfshijnë ligjet dhe aktet nënligjore për administrimin e tyre, duke synuar për afrimin me *acquis communautaire*, një vend qendror zë direktivat kuadër për mbetjet. Për këtë qëllim është hartuar edhe strategjia kombëtare e menaxhimit të mbetjeve dhe plani kombëtar i menaxhimit të mbetjeve të cilët u miratuan me vendim të Këshillit të Ministrave numër 175 datë 19.1.2011. Këto dokumente vërtetojnë që vetëm qytetet janë të pajisur me sisteme për grumbullimin e mbetjeve, por jo zonat rurale, ndërsa riciklimi mbetet në nivele shumë të ulëta (Muharremaj, 2015: 183).

Kryesisht mbetjet asgjësohen në vendgrumbullimet e tyre. Me disa përjashtime të vogla siç janë zonat e Sharrës në Tiranë dhe Bushatit në Shkodër, dhe ato që janë planifikuar të ngrihen në Maliq të Korçës e në Bajkaj të Sarandës, nuk ka vendgrumbullime të tjera të planifikuara sipas parametrave shkencore. Sistemet e grumbullimit në zonat rurale dhe në qytetet e vogla mungojnë krejtësisht, ndërsa pjesa me e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anën e rrugëve. Prej këtej, ato merren me pas nga rrjedhat ujore e për shkak të sistemit të ujërave nëntokësore në Shqipëri, shkaktojnë ndotje masive.

Shqetësuese është mungesa e një sistemi të sigurt të administrimit të mbetjeve të rrezikshme, ku pjesa më e madhe e grumbullimit dhe e riciklimit të tyre kryhen nga impiantet private, në mungese të kontrollit rigoroz nga autoritetet shtetërore. Edhe këto impiante riciklimi janë në hapat e para dhe varen nga importimi i sasisë më të

madhe të lëndës së parë për riciklim nga vendet e tjera. Një ndër aktet e para për administrimin e mbetjeve ishte ligji numër 8094 datë 21.3.1996, “Mbi heqjen publike të mbeturinave”. Ai përmbante dispozita të kufizuara si për sa i përket përkufizimit shumë të ngushtë të mbetjeve, duke lënë jashtë shumë prej tyre, ashtu edhe të kufizuara gjeografikisht pasi mbulonte vetëm hapësirën në brendësi të territoreve bashkiake e të komunave, sipas vijave kufizuese nën juridiksionin e tyre (Muharremaj, 2015: 187).

Pas tij u miratuan një sërë ligjesh të tjerë që përmbanin dispozita të ndryshme për administrimin e mbetjeve si ligji numër 8652 datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisë lokale”, ligji 8934 datë 5.9.2002 “Mbi mbrojtjen e mjedisit”, ligji numër 9010, datë 13.2.2003 “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta”, ligji numër 9663 datë 18.12.2006, “Mbi koncesionet” dhe ligji numër 9537 datë 19.5.2006, “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

Për të përmbushur detyrimet e marra përsipër në kuadrin e Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkuftare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimit të tyre”, ligji numër 8934, datë 5.9.2002 për mbrojtjen e mjedisit ndaloi importimin e lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme me qëllim ruajtjeje, depozitimi ose asgjësimi dhe ngarkoi Këshillin e Ministrave për hartimin e listës së lëndëve dhe të mbetjeve të rrezikshme të ndaluara dhe për hartimin e rregullave, procedurave, sasive dhe afateve përkatëse. Për këtë qëllim u miratua vendimi i Këshillit të Ministrave numër 806, datë 4.12.2003, “Për miratimin e rregullave dhe të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”, i cili parashikonte mundësinë e importimit të mbetjeve nga persona fizik dhe juridik, për t’i përdorur, përpunuar dhe ricikluar, me përjashtim të mbetjeve të rrezikshme, vetëm në kushtet kur përdorimi, përpunimi e riciklimi i tyre kryhet me teknologji bashkëkohore, që garanton mbrojtjen e shëndetit dhe të mjedisit, kur prej tyre përfitohen lëndë ose materiale të dobishme dhe kursehen lëndë të para dhe transportimi i tyre nuk ndikon negativisht në shëndetin e njeriut dhe në mjedis.

Me vendim të Këshillit të Ministrave numër 835 datë 28.12.2005, u miratua lista e mbetjeve të rrezikshme, mbetjeve dhe mbeturinave të tjera, që ndalohen me ligj të importohen, me qëllim ruajtjeje, depozitimi dhe asgjësimi, sipas përcaktimeve të bëra në “Katalogun shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, që nga ana e tij ishte miratuar me VKM numër 99 datë 18.2.2005, në përputhje me “Katalogun evropian të mbetjeve”. Për të përballur problematikat e mëdha që kanë lindur ndërmjet të tjerash edhe prej aktivitetit intensiv ndërtimor që prej fundit të viteve ‘90 në Shqipëri, në vitin 2003 u miratua ligji numër 9010 datë 13.2.2003, “Mbi administrimin e mbetjeve të ngurta”, i cili është amenduar më pas me ligjin numër 10137 datë 11.5.2009 dhe me ligjin numër 10463 datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (Muharremaj, 2015: 188).

Në fushën e veprimit të ligjit numër 9010 përfshihej administrimi i mbetjeve urbane, industriale, spitalore, ato të ndërtimit, mbetjet në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, të kanaleve kulluese e rezervuarve, mbetjet bujqësore e blegtorale, si edhe mbetjet e vëllimshme, duke përcaktuar rregullat për trajtimin e tyre. Neni 9 i tij i detyron personat fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilëve krijon mbetje, që të ndërtojnë linja dhe impiante për riciklimin dhe përpunimin e mbetjeve, në përputhje me teknologjinë, me natyrën dhe sasinë e mbetjeve që krijojnë, t’i ruajnë dhe t’i trajtojnë mbetjet që të mos vështirësojnë proceset pasuese të administrimit mjedisor të tyre dhe të ndajnë mbetjet që në burim.

